RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

"Auditim Financiar dhe Përputhshmërie"

BASHKIA MEMALIAJ

Tiranë, tetor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtimet	3
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4-11**
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Memaliaj	4
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	4
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	4
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	4-5
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5-7
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	7-8
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	8-11
II	**HYRJA**	**12-17**
1	Objektivat e auditimit	12
2	Qëllimi i auditimit	12
3	Identifikimi i çështjes	12-13
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13
5	Përgjegjësitë e audituesve	13-14
6	Kriteret e vlerësimit	14
7	Standardet e auditimit	14-15
8	Metoda e auditimit	15-17
9	Dokumentimi i auditimit	17
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**17-196**
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Memaliaj	17
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	17-196
2.1	Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025	17-30
2.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për vitin 2025	30-56
2.3	Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025	56-74
2.4	Auditim i prokurimeve për vitet 2024-2025	74-160
2.5	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit për vitet 2024-2025	160-177
2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV) për vitet 2024-2025	177-182
2.7	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM për vitet 2024-2025	182-189
2.8	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	189-196
IV	**REKOMANDIME**	**197-224**

Lista e shkurtimeve	
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Bashkia Memaliaj, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe Ligji nr. 68/2017, datë 24.07.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë. Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Memaliaj për periudhën e aktivitetit financiar për vitet 2024-2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve. Buxheti i Bashkisë Memaliaj si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 50, pikat 1-2. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Memaliaj si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt. Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2024, deri në datën 31.12.2025. Objektivat e auditimit sipas drejtimeve të auditimit janë si vijon:

* Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025;
* Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për vitin 2025;
* Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025;
* Auditim i prokurimeve;
* Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
* Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore;
* Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM;
* Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 60% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë dhe të vogël. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 6,784 mijë lekë për vitin 2025. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve, Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- ✓ Verifikimi i transaksioneve;
- ✓ Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- ✓ Intervistat;
- ✓ Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.,.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 41 gjetje dhe ka dhënë 47 rekomandime, nga ku masa organizative 33 gjetje me 39 rekomandime; masa për shpërblim dëmi 3 gjetje me 3 rekomandime; masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, (të ardhura të munguara) 5 gjetje me 5 rekomandimeve.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

1. Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, në total nga Bashkia Memaliaj së bashku me njësinë e varësisë Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka realizuar në total 18 procedura prokurimi me vlera të larta me fond limit në vlerën 435,481,171 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate të lidhur në vlerën 385,860,630 lekë pa TVSh. Me zgjedhje në total për vitet 2024-2025 janë audituar 11 procedura prokurimi me fond limit në vlerën 402,416,200 lekë pa TVSh dhe realizimin kontrate në vlerën 355,322,006.73 lekë pa TVSh në masën 92.4% të fondit limit të prokuruar, ku janë konstatuar parregullsitë e mëposhtme:

- Në 8 procedura me vlerë të fondit limit prej 353,302,444 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 310,039,957 lekë pa TVSh, në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1-2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar si dhe neni 39, neni 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës;
- Në 8 procedura me vlerë të fondit limit prej 364,506,497 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 320,721,052 lekë pa TVSh, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DT të miratuara nga AK Bashkia Memaliaj, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi në mosplotësimin e kritereve të vendosura në DT. Duke shpallur fitues OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT;

2. Në procedurën e prokurimit me objekt "Asfaltimi i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnjë dhe segmenti nga rruga Nacionale Haxhiaj" me fond limit në vlerën 10,589,304 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 9,545,004 lekë pa TVSh dhe "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-

Koshtan" me fond limit në vlerën 16,471,383 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 12,625,000 lekë u konstatua se, nga KVO nuk është aplikuar i njëjti standard në vlerësimin e operatorëve ekonomik konkretisht:
- Për procedurën e prokurimit me objekt "Asfaltimi i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnjë dhe segmenti nga rruga Nacionale Haxhiaj", nga KVO-ja janë s'kualifikuar OE "N." ShPK me vlerë oferte 7,434,714 lekë pa TVSh dhe OE "S." ShPK me vlerë oferte 9,090,480 lekë pa TVSh për arsye se nuk kanë paraqitur kontratë qiraje apo bashkëpunimi për 1 impiant prodhim inerte, 1 impiant prodhim betoni dhe 1 impiant prodhim asfalti e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve në distancë 50 km nga kantieri i punimeve të përcaktuar në DT, pra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca nr. 8, janë paraqitur vetëm kontratat e furnizimit por përcaktohet një dokument apo deklarim mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punime.
Ndërkohë që edhe për OE "S." ShPK me vlerë oferte 9,545,004 lekë pa TVSh i cili është kualifikuar i katërti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur Standard i Dyfishtë ku për të njëjtë situatë (pra nuk disponohet apo deklarohet dokumentacion mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punimeve për sa i përket impianteve të sipërcituar) duke kryer vetëm deklarimin sipas kontratave të furnizimit, KVO e ka shpallur fitues.
- Për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan" nga KVO-ja është s'kualifikuar OE "R.. C." ShPK me vlerë oferte 12,625,000 lekë pa TVSh për arsye se, në fazën e parë paraprake (dorëzimin e ofertave) në të cilën operatorët ekonomikë mund të dokumentojnë në Sistemin e Prokurimit Publik plotësimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojcën nr. 8, në rastin konkret ky dokumentacion është plotësuar nga OE i sipërpërmendur.
Mangësia e vetme në këtë Formular ka të bëjë vetëm me mos deklarimin e lejes së mjedisit nga pala e tretë (që lidhet disponibilitet e lejes së mjedisit nga OE që janë kontraktuara për kontratat e furnizimit) për kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit. KVO-ja ka kryer s'kualifikimin e OE "R.. C." ShPK për mos dorëzimin e dokumentacionit justifikues bashkëlidhur Shtojcës për pikat nr. 2.3.3.a, nr. 2.3.3.b dhe nr. 2.3.5, konkretisht si listëpagesa, vërtetim sigurimesh, kontrata pune dhe kontrata furnizimi, dokumentacion i cili paraqitet nga OE në fazën dorëzimit të dokumentacionit fizik provues përpara shpalljes së njoftimit të fituesit paraprak. Ndërkohë që për OE "E. C. C." ShPK me vlerë të ofertës 15,453,000 lekë i cili është kualifikuar i dyti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur Standard i Dyfishtë ku për të njëjtën situatë është kualifikuar në fazën paraprake në kushtet e mos dorëzimit bashkëlidhur dokumentacionin justifikues Shtojcës nr. 8, për pikën nr. 2.3.3.b dhe pikën nr. 2.3.5, kontrata pune, CV, diploma etj., apo kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit.
3. Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit dhe zhvillimit të territorit, u konstatuan 1 objekt që gjatë realizimit të punimeve të zbatimit ka pësuar ndryshime gjatë realizimit, pasi janë konstatuar devijime nga leja e ndërtimit e miratuar, shtimin e sipërfaqeve të ndërtimit dhe zhvillimi e objektit përtej kufirit të pronësisë. Përkatësisht lejen e ndërtimit me objekt: Bujtina "S. O.", me zhvillues z. E. B.
4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambienteve sportive" me nr. 1722/14 prot., datë 20.11.2024, lidhur midis AK Bashkia Memaliaj dhe Kontraktorit BOE "S." & "G.. C." ShPK me vlerë kontrate 173,942,580 lekë pa TVSh, u konstatuan volume dhe punime të pa realizuara në vlerën **1,425,567 lekë** pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Memaliaj.
5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara viti 2024", me fond limit në vlerën 33,675,090 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 30,978,367.54 lekë pa TVSh u konstatua se: Referuar Raportit Përmbledhës së hartuar dhe nënshkruar nga KVO-ja dhe Titullari i AK-së me shkresën nr. 1637/12 prot., datë 11.10.2024, ku për këtë procedurë kanë marrë pjesë 7 OE nga të cilët janë kualifikuar 4 OE dhe s'kualifikuar 3 OE, vërehet se është s'kualifikuar BOE "E." ShPK & "M." ShPK me

vlerë oferte 30,519,660 lekë pa TVSh me arsyen se, njëri prej operatorëve të BOE-së konkretisht "M." ShPK ka paraqitur disa punë të ngjashme për të cilat nuk i ka regjistruar si Nipte Sekondare, duke ju shmangur detyrimeve vendore.
Vlerësimi i KVO-së nuk është bërë i drejtë, pasi duke marrë në konsideratë faktin se kontratat e punëve publike i përkasin viteve 2019-2021, pra kusht vlen si arsye për s'kualifikim në qoftë se në kërkesën e DT do të kërkohej vërtetimi i taksave për vitet 2019-2021, ndërkoqë kërkesa i përket vitit 2023. OE "M." ShPK për vitin 2023 ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë me shkresën e datës 29.05.2024.
Pra rrjedhimisht nëse KVO-ja do të kualifikonte këtë BOE, në përputhje me qëllimin dhe parimet e LPP-së, Bashkia Memaliaj do të lidhte një kontratë me vlerë më pak nga kontrata që ka lidhur, me një diferencë prej **458,707.54 lekë** pa TVSh (30,978,367.54 - 30,519,660) dhe me një vlerë 550,449 lekë me TVSh e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Bashkisë Memaliaj.
6. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga DTTV-ja, në Bashkinë Memaliaj dhe Njësitë Administrative për vitin 2025 janë taksuar 3,195 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar".
Me qëllim vlerësimin nëse nga DTTV është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë "familjar", u kryqëzua informacioni i administruar nga kjo drejtori me informacionin e administruar nga Gjendja Civile. Sipas Gjendjes Civile në Bashkinë Memaliaj dhe Njësitë Administrative janë 6,946 familje, ndërkohë që për vitin 2025 janë taksuar 3,195 familje si dhe janë të përjashtuar 816 familje si pasojë e përfitimit të lehtësirave nga Paketa Fiskale.
Ndërkohë që për taksën e "Ndërtesës + Truallit" nuk është kryer faturimi i plotë ku janë shmangur nga tarifimi 2,147 abonentë familjarë në vlerën totale prej **854,560 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:
Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:
1. Nga Bashkia Memaliaj, Njësia e Prokurimit të merren masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, të shmanget aplikimi i kritereve të cilat nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.
2. Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e këtyre praktikave të parregullta, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për një përdorim me efektiv të fondeve në vlerën e kontraktuar 364,506,497 lekë pa TVSh. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.
3. Bashkia Memaliaj, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave në të ardhmen të marrin masat për të vlerësuar ofertat vetëm mbi bazën e kritereve dhe dokumenteve të kërkuara në DT, duke zbatuar të njëjtin standard vlerësimi për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës. Në rastet ku konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga OE nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT ose kur kriteret e aplikuara kanë interpretim mbi mënyrën e vlerësimit të tyre, nga KVO t'i kushtohet një rëndësi e veçantë gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit, me qëllim garantimin dhe trajtimin në mënyrë të barabartë të OE, transparencës dhe ligjshmërisë në procedurat e prokurimit.
4. Nga strukturat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Memaliaj të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të punimeve të ndërtimit në terren, si dhe për ndjekjen e zhvillimit të lejeve të ndërtimit të miratuara nga Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës e Bashkisë Memaliaj, deri në

përfundimin e tyre e në vijim, në mënyrë që objektet e realizuara të mos pësojnë ndryshime/ devijime nga leja e ndërtimit e miratuar dhe të zhvillohen brenda kufijve të pronësisë, pa cënuar pasuritë kufizuese.
5. Autoriteti Kontraktor Bashkia Memaliaj, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej 1,425,567 lekë pa TVSh nga kontraktori BOE "S." & "G.. C." ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.
6. Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mire përdorimin e fondeve publike me efiçencë dhe ekonomicitet.
7. Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrej grup pune me specialistë të fushës, për të koordinuar procesin për evidentimin e familjeve, për të cilat nuk janë përllogaritur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, duke rakorduar njëkohësisht informacionin mbi familjet e regjistruara sipas regjistrit të gjendjes civile me situatën faktike në terren, me qëllim arkëtimin e të ardhurave në vlerën 854,560 lekë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:
Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Memaliaj, KLSH ka dhënë **"Opinion të kualifikuar me rezervë"** për pasqyrat financiare dhe **"Opinion të kualifikuar"** për përputhshmërinë. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative, rekomandime për shpërblim dëmi, rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe rekomandime për arkëtimin e të ardhurave të munguara, uljen e borxhit tatimor.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2025:
a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë:
Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Memaliaj për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Memaliaj nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e Kualifikuar".

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare"*, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **6,784 mijë lekë,** llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2025, si dhe anomalitë e mëposhtme:
- Në gjendjen e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* nuk janë të përfshirë debitorët të kategorive si: *"Familjarë"* në vlerën 2,584,378 lekë; *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale"* në vlerën 170,622 lekë dhe *"Tarifa e licencimit për karburant"* në vlerën 1,600,000 lekë, duke e nënvlerësuar këtë llogari në vlerën 4,335,040 lekë;
- Vlera e mbetur në fund të vitit 2025 prej 6,099,103 lekë (kosto historike) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* për 37 projekt-studime për investime të kryera, nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme;
- Llogaritë 210 *"Toka, troje, terrene"* të pasqyruara në bilanc për vlerën 107,996 lekë dhe 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* në vlerën 2,308,380 lekë janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
- Në gjendjen e llogarisë 215 *"Mjete transporti"* është kontabilizuar vlera prej 3,312,750 lekë kosto historike që i përket automjeteve të dëmtuara që nuk janë në gjendje pune të konstatuara si të tilla në procesin e inventarizimit të cilat duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 24 *"Aktive afatgjata të dëmtuara"*;
- Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata materiale u konstatua se, për disa llogari janë aplikuar norma amortizimi jo në përputhje me rregullat kontabël konkretisht:
a) Për vitin 2025 është aplikuar normë amortizimi respektivisht në vlerën 12,000 lekë për llogarinë 210 *"Toka, troje, terrene"* dhe 739,660 lekë për llogarinë 211 *"Pyje, plantacione, kullota"*, në kushtet kur për këto llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi. Sipas informacionit kontabël llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"* është nënvlerësuar në vlerën 12,000 lekë dhe 211 *"Pyje, plantacione, kullota"* në vlerën 739,660 lekë;
b) Për llogarinë 215 *"Mjete transporti"* është aplikuar normë amortizimi në vlerën 8,960,000 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël për këtë llogari duhet të aplikohej normë amortizimi në masën 20% në vlerën 11,278,982 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 215 *"Mjete transporti"* është mbivlerësuar në vlerën 2,318,982 lekë;
c) Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)"* për llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"* është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2025, në vlerën 54,640,061 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 *"Pajisje kompjuterike"* nga aktivet e llogarisë bazë 218 *"Inventar ekonomik"* e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%;
- Vlera prej 395,290,129 lekë e kontratave në proces duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"* siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë;

II. Opinioni mbi përputhshmërinë:

a. Opinioni i kualifikuar:

Mbështetur në ISSAI 4000 *"Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë"*, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSh dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Bashkia Memaliaj me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Memaliaj, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e përputhshmërisë:

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit Bashkia Memaliaj në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, Paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, *"Deklarata e Limës"*; INTOSAI P-10, *"Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t"*, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSAI P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 *"Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë"*. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSh-së, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSh-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Memaliaj dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Në besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar mbështetur në konstatimet në vijim:

- Nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim;
- Bashkia Memaliaj deri më datë 31.12.2025, ka detyrime ndaj palëve të treta me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku në të përfshihen detyrimet për investime, mallra dhe shërbime vlerën **9,865,023 lekë;**
- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifat vendore dhe dhënia me qira e aseteve në mënyrë progresive më datën 31.12.2025, të kenë vlerën **56,493,325 lekë;**
- Nuk janë masat e duhura për përllogaritjen e taksave së pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, ndërtesës, truallit për 13 subjekte biznes i vogël në vlerën **213,720 lekë;** për taksat e truallit, ndërtesës për 2,147 abonentë familjarë në vlerën **854,560 lekë** dhe për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 3 subjekte në vlerën **416,245 lekë;**
- Në 11 procedura prokurimi me vlera të larta të audituara nga totali prej 18 procedura për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, me fond limit në vlerën 402,416,200 lekë pa TVSh dhe realizimin kontrate në vlerën 355,322,006.73 lekë pa TVSh në masën 92.4% të fondit limit të prokuruar u konstatua se:

Në **1** procedurë projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit; në **1** procedurë nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit konkretisht nuk argumentohen shërbimet që do të ofrojë institucioni duke kuadruar me disponibilitetin/kapacitetin e flotës së mjeteve dhe normativave mbi konsumin e karburantit; në **1** procedurë nuk disponohet një dokument mbi argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të specifikimeve teknike; në **2** procedura nuk është publikuar në Sistemin e Prokurimit Publik dosja teknike; në **8** procedura në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në **8** procedura OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DT të miratuara nga AK Bashkia Memaliaj, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi në mosplotësimin e kritereve të vendosura në DT.

- Për procedurën e prokurimit me objekt *"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara viti 2024"*, me fond limit në vlerën 33,675,090 lekë pa TVSh dhe realizim

kontrate 30,978,367 lekë pa TVSh u konstatua se, nga KVO janë s'kualifikuar 4 OE nga të cilët për OE 1-3 pretendimet qëndrojnë ndërsa për BOE *"E."* ShPK & *"M."* ShPK i klasifikuar i katërti në klasifikimin përfundimtar është kryer s'kualifikim i padrejtë, për të cilën Bashkia Memaliaj do të lidhte një kontratë me vlerë më pak nga kontrata që ka lidhur, me një diferencë prej **458,707.54 lekë pa TVSh e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Bashkisë Memaliaj** në krahasim me OE të klasifikuar i pesti në klasifikim përfundimtar;
- Për procedurën e prokurimit me objekt *"Asfaltimi i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnjë dhe segmenti nga rruga Nacionale Haxhiaj"* me fond limit në vlerën 10,589,304 lekë pa TVSh dhe *"Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan"* me fond limit në vlerën 16,471,383 lekë pa TVSh u konstatua se, nga KVO nuk është aplikuar i njëjti standard në vlerësimin e operatorëve ekonomik, pra për të njëjtën problematikë një OE është s'kualifikuar ndërsa OE pasardhës në klasifikimin përfundimtar është kualifikuar;
- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, u konstatua se zbatimi i projektit nuk është i saktë, duke evidentuar një efekt negativ me dëm në buxhet në vlerën **1,982,167 lekë;**
- Nga auditimi mbi procedurat e administrimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatuan mangësi dhe parregullsi në zbatimin e kuadrit ligjor të procedurave administrative konkretisht: u evidentuan raste të tejkalimit të afateve ligjore për shqyrtimin e kërkesave; miratimin e lejeve pa plotësimin e të gjitha kushteve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe dispozitat ligjore në fuqi; dokumentacion i paplotë ose i pasaktë në sistemin e-leje; mungesë e mendimeve dhe konfirmimeve të institucioneve përgjegjëse; mangësi në procedurat e ndjekura nga institucioni për lëshimin e certifikatave të përdorimit dhe devijime nga lejet e miratuara gjatë zbatimit të punimeve;
- Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit u konstatua se, IMTV-ja nuk ka dokumentuar në mënyrë të plotë veprimet e kryera pas konstatimit të shkeljeve dhe marrjes së vendimeve të pezullimit duke mos pasqyruar veprimet vijuese për verifikimin e zbatimit të vendimeve të pezullimit, ndjekjen e afateve, marrjen e vendimeve përfundimtare, ekzekutimin e masave administrative të vendosura si dhe masat e marra për ndjekjen në kohë të arkëtimin të detyrimeve që rrjedhin nga masat administrative dënim me gjobë;

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 295/1 prot., datë 17.03.2026, i ndryshuar me shkresën nr. 295/2 prot., datë 24.04.2026, dhe shkresën nr. 295/3 prot., datë 18.05.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.03.2026, deri më 23.06.2026, në institucionin Bashkia Memaliaj u krye auditmi "Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025". Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. H. (Përgjegjës Grupi)
2. A. K., Anëtar
3. O. F., Anëtar
4. Q. M., Anëtar
5. N. Ll., Anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat e auditimit: Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Bashkinë Memaliaj kishte si objektiva kryesore:
- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale *(ISSAI 1315)*[1];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit: Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Memaliaj është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes: Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit *(ISSAI 13)*, nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme nëse fondet janë administruar siç duhet dhe nëse të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.
Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Memaliaj, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditiv, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Memaliaj.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese të Bashkisë Memaliaj, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në

[1] *Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.*

zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.,.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Përgjegjësia jonë *(audituesit e KLSH-së)*, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet me opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike *(p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.,)*;
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;
Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Memaliaj, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016, "Për prokurimin publik" i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar;

- VKM nr. 894, datë 04.11.2015, "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit" i ndryshuar;
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim";
- Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016, "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve" i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;
- Etj.,

7. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 200 "Parimet themelore të auditimit financiar";
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 2000-2899 "Udhëzues të Auditimit Financiar";
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 2300 "Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare";
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë" si dhe ISSAI 4200;
- INTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik";
- INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm";
- INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.,;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.,;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH;

8. Metoda e auditimit: Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.
Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:
1. Kontrolli aritmetik:
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).*
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:
Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, *"Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.,. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.
4. Kontrolli i vlerësimit:
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
5. Konfirmim nga të tretët:
Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
6. Kontrolli sipas një treguesi:
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.,.
7. Intervistimi:
U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Memaliaj me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.
8. Raporte dhe Informacione:
U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.
Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit
Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar

kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[2].
Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.
Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[3].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 *"Dokumentimi i Auditimit"*, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.
Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimin e mbajtur, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

[2] ISSAI 1315

[3] *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin "Bashkia Memaliaj":

Bashkia Memaliaj kufizohet në veri me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Tepelenë dhe në perëndim me Bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Memaliajt. Në përbërje të kësaj Bashkie ndodhen 6 Njësi Administrative: Memaliaj, Memaliaj Fshat, Lutfinje, Buz, Krahës dhe Qesarat. Infrastruktura rrugore e Bashkisë Memaliaj ka njohur një përmirësim relativ gjatë viteve të fundit në përfundimin e ndërtimit të akseve rrugore Tepelenë - Memaliaj dhe Fier - Memaliaj.

Bashkia Memaliaj është lidhur me linja të transportit publik me kryeqytetin dhe qytete e afërta. Sipërfaqet e gjelbërta në qytet janë 192,625 m^2; mbulime me ndriçim në zonat urbane dhe rurale vetëm qyteti; shërbim me ujë dhe kanalizime, mbulimi 10%, mbulimi me shërbim pastrimi në masën 30%. Në territorin e Bashkisë së Memaliajt gjenden 15 rezervuare në funksion të ujitjes së tokave bujqësore, gjë që favorizon kultivimin e produkteve bujqësore në këtë zonë. Prej vitesh është evidentuar potenciali energjitik në segmentet e Kalivaçit.

Bashkia Memaliaj është e pasur me bimësi si në lloje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve që shtrihet deri në lartësinë 600 - 800 m, brezi i dushkut 800 - 1200 m, pyjet foragjere, halore dhe të përzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi afër 1,000 m. Bashkia e Memaliajt ka ende burime minerare në formën e rezervave të qymyrgurit me fuqi të lartë kalorifike (por me përqindje të lartë squfuri 3 herë më tepër se normat e BE).

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar për vitin 2025:

2.1.1. *Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së;*

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.

Ky auditim u kryer për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Memaliaj, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit":

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

- Parimi nr. 1. "Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike";
- Parimi nr. 2. "Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje";

- Parimi nr. 3. "Titullari/Nëpunësi Autorizues krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë";
- Parimi nr. 4. "Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave";
- Parimi nr. 5. "Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale".

Parimi nr. 1. *"Njësia publike demostron angazhimin për integritetin dhe vlerat etike"*:

- Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Memaliaj në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Institucioni organizohet, funksionon dhe vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 115, datë 19.12.2022, të Këshillit Bashkiak me objekt "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Memaliaj".
Në këtë dokument janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit. Punonjësit e institucionit janë njohur me rregulloren e brendshme në mënyrë manuale dhe elektronike, por evidentohet se nuk ka trajnime për njohjen e saj.
Duke qenë se Bashkia Memaliaj ka patur ndryshime të shumta të strukturës organike, ku është bërë kalimi i disa sektorëve në nivel drejtorie. Vihet re se në Rregulloren e brendshme përgjithësisht nuk reflektohen këto ndryshime.
Me Vendimin nr. 65, datë 07.07.2023, të Këshillit Bashkiak është miratuar Rregullorja e Re e Brendshme mbi funksionimin dhe organizimin e institucionit. Me Vendimin nr. 39, datë 21.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar Kodi Etik i institucionit, në mbështetje të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik. Për më tepër rregullat e etikës janë të përfshira edhe në nenin 16, të Rregullores së Brendshme të institucionit. Në këtë nen përcaktohen edhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Evidentohet se nuk ka procedura për shkeljen e rregullave mbi etikën, por ato ndiqen e zbatohen, duke u mbështetur në ligjin e Nëpunësit Civil, Kodin e Punës dhe Kodin e Etikës.
- Struktura organizative e Bashkisë Memaliaj ka pasur ndryshime të shpeshta por evidentohet se në Rregulloren e Brendshme të institucionit nuk janë reflektuar këto ndryshime.
- Për sa i përket trajnimeve lidhur me kodin e sjelljes dhe etikën punonjësit e Bashkisë Memaliaj kanë ndjekur trajnime online të zhvilluara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në faqen zyrtare të saj http: www.aspa.gov.al.
- Me shkresën nr. extra prot., datë 16.01.2020, është hartuar Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Memaliaj.
- Lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorrupsion, vlen të theksojmë se bashkia i zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, *por ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla.*
- Nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.
- Performanca e nëpunësve të Bashkisë Memaliaj është vlerësuar për periudhë gjashtë mujore mbështetur në VKM-në nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë" i ndryshuar dhe ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kodin e Punës nuk është kryer vlerësimi vjetor.

Parimi nr. 2. *"Titullari/Nëpunësi Autorizues/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje"*:

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Titullari i bashkisë nuk mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike për të gjithë komponentët. Nuk ka Urdhër të Titullarit

për miratimin e Planit të Veprimit për KB dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani.
Ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve periodike nga drejtoritë e bashkisë dhe njësitë e varësisë, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.
- Nuk ka raportime për të gjitha dobësitë e kontrollit të brendshëm dhe as për realizimin e objektivave. Titullari nuk ka miratuar plan menaxhimi për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në kontrollin e brendshëm.
- Titullari i bashkisë me shkresën nr. 437 prot., datë 13.02.2026, ka përcjellë pranë Ministrisë së Financave "Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm" dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm.
- Me shkresën nr. 607 prot., datë 27.02.2026, nga Bashkia Memaliaj është plotësuar dhe dërguar pranë Ministrisë së Financave, Pyetësorin e Vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon të MFK-së.
- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.
Parimi nr. 3. *"Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"*:
Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
Institucioni vepron mbi bazën e Rregullore të Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 65, datë 07.07.2023, të Këshillit Bashkiak e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Memaliaj.
Me Urdhrin nr. 95, datë 26.12.2014, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative e institucionit për vitin 2025. Numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në Aparatin e Bashkisë Memaliaj dhe njësive të varësisë shkon 253 punonjës.
Struktura e Bashkisë Memaliaj për vitin 2025 vijon si më poshtë:
- ✓ 189 punonjës me Kod Pune;
- ✓ 43 punonjës Nëpunës Civil;
- ✓ 5 punonjës kanë qenë në periudhë prove përgjatë vitit 2025;
- ✓ 3 punonjës kanë konfirmuar statusi e nëpunësit civil;
- ✓ 8 pozicione pune në shërbimin civil kanë qenë vakante;
- ✓ 13 punonjës kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës;
- ✓ 51 punonjës janë emëruar në detyrë;
- ✓ 4 punonjës kanë dalë në pension;
- ✓ 55 punonjës janë të komanduar në detyrë;

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale, që përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë etj.,.
- Janë kryer trajnime të punonjësve në periudha të ndryshme të vitit 2025, sipas fushave dhe shkresave përkatëse.

Për sa i përket punonjësve administrativ dhe të terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Referuar Kreut II, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit të miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 108/2016, përcaktohet që:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune kriteret për rekrutimin e tyre përcaktohen bashkëlidhur shpalljes së vendit vakant të punës sipas specifikave të secilit pozicion. Mbi politikat dhe praktikat e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe sektorëve si dhe ka një ndarje detyrash dhe përgjegjësish deri në nivel përgjegjës sektori dhe specialisti. Me zgjedhje në dosjet e personelit u konstatua se ka mungesë dokumentacioni, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe as objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Memaliaj ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësinë vendore.
- Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar dhe miratuar deklaratë të misionit dhe një strategji të miratuar me objektivat dhe prioritetet strategjikë në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Nuk janë zhvilluar mbledhje të menaxherëve të strukturave/njësive të vartësisë mbi diskutime për plan strategjik.
- Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia nuk përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi nr. 4. *"Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave"*:

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se nuk disponohet një dokument lidhur me miratimin e përshkrimeve të punës.

- Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale në të cilën përfshihen librezat e punës, vërtetimet të gjendjes gjyqësore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale të punës.
- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve, sa i takon procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, është realizuar procesi i vlerësimit në përputhje me procedurat e hollësishme të përcaktuara në VKM-në nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Parimi nr. 5. *"Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale"*:

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

- Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, konstatohet se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme.
- Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.
- Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë. Me Urdhrin nr. 9, datë 14.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, i përbërë nga 8 (tetë) punonjës. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion u konstatua se GMS është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, gërma "b", neni 24, pika 2. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se takimet e GMS, nuk dokumentohen me procesverbale. Evidentohet se nuk është përfshirë në vendimin e ngritjes së GMS-së, Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit, si anëtar pa të drejtë vote. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 27, pika 2.

- Nuk është hartuar "Plani i Përgjithshëm Strategjik i Zhvillimit" me afat 5 (pesë) vjeçar i Bashkisë Memaliaj. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 32.
- Nuk ka programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional te punonjësve. Këto veprime janë në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.
- Ankesat dhe kërkesat e paraqitura pranë bashkisë, regjistrohen në zyrën e Protokollit me një ndalesë dhe më pas bëhen raportimet e nevojshme në sektorët përkatës. Procesi vazhdon me kthimin e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 119, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore".
- Ankesat nga jashtë depozitohen zyrtarisht pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, duke i'u adresuar Kryetarit të Bashkisë dhe përgjigjja merret në Drejtorinë përkatëse.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut":

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

- Parimi nr. 6. "Specifikimi i objektivave të përshtatshëm";
- Parimi nr. 7. "Identifikimi dhe analiza e risqeve";
- Parimi nr. 8. "Mundësia e riskut të mashtrimeve";
- Parimi nr. 9. "Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme";

Parimi nr. 6. *"Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva"*:

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA dhe Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

- Nga auditimi i të dhënave, duke marrë në konsideratë se bashkia duhet të specifikoj dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur PBA, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.

Planifikimi i PBA-së 2025-2027 është miratuar me VKB-në nr. 3, datë 28.02.2024. Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.
- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, konstatohet se janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjesave me publikun.
- Gjatë vitit 2025 janë organizuar Dëgjesë Publike, ku morën pjesë qytetarë, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e bashkisë. Për të cilën është hartuar edhe procesverbali me nr. 2836/3 prot., datë 05.12.2025.
- Nuk ka hartuar plan-veprime operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar. Konstatohet se objektivat e miratuara nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet emailit apo shkresave zyrtare. Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.
- Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Parimi nr. 7. *"Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave"*:
Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.
- Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi konstaton se njësia publike nuk ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.
Regjistri i Riskut për vitin 2025 nuk është hartuar nga Bashkia Memaliaj. Ky regjistër duhet të jetë sipas formatit që përcaktohet në Manualin e MFK-së. Në përgjithësi, duhej plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një regjistër risku. Në këtë regjistër duheshin përshkruar disa nga risqet kryesore për vitin 2025, duke krijuar një pamje më analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve para dhe pas kontrollit. Gjithashtu duheshin përcaktuar nevojat për kontrollet e mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe zotëruesit e riskut. Disa nga risqet që duheshin identifikuar kanë të bëjnë me objektiva si, thellimi i veprimeve gjatë procesit të përgatitjes së draft buxhetit; përputhshmëria me vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak; pagat mujore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; drafti i situacionit mujor të shpenzimeve për çdo program; drafti i situacionit mujor të të ardhurave; raportimi financiar tek institucionet e tjera (MF dhe Dega e Thesarit); integriteti i kontabilistit; inventari i pronave; administrimi i biletave të tregut të lirë; përfundimi i dokumenteve për likuidim; urdhri i pagesës; koordinim me thesarin për të verifikuar të ardhurat dhe shpenzimet; pagesat e PAK dhe ndihmës ekonomike; mbledhja e borxheve të papaguara; dhe pagesa në kohë e kreditorëve. Gjithashtu nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut për vitin 2025, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, konform Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike", pika nr. 5.3.
- Nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Parimi nr. 8. *"Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve"*:
Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se Bashkia Memaliaj nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi nr. 9. *"Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme"*:

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

- Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi konstatohet se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel të ulët.
- Bashkia Memaliaj ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit":

Veprimtaritë e kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

- Parimi nr. 10. "Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit";
- Parimi nr. 11. "Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë";
- Parimi nr. 12. "Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave".

Parimi nr. 10. *"Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit":*

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

- Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ende ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.

Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

- Nga të dhënat e vëna në dispozicion, konstatohet se hartë proceseve të punës ka vetëm një prej drejtorive të bashkisë, Drejtoria e Financës.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.,. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.,).

- Në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve.
Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.
- Bashkia Memaliaj ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet dhe ka hartuar një procedurë të miratuar për menaxhimin e aktiveve por jo sipas formateve të parashikuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
- Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" i ndryshuar, por referuar procesit të realizuar në vitin 2025 është konstatuar se, nuk aktive të vlerësuara apo të nxjerra jashtë përdorimit.

Parimi nr. 11. *"Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë"*:

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
- Bashkia Memaliaj ka në përdorim disa sisteme qeveritare si AMFIS dhe e-leje për të cilat rregullat e përdorimit janë të përcaktuara nga AKSHI. Postimi i tyre kryhet nga AKSHI i cili për çdo përdorim i ofron bashkisë manuale dhe rregullore përdorimi. Të dhënat ruhen në cloud. Përveç sistemeve fikse, bashkia nuk përdor sisteme të tjera dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.
- Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Parimi nr. 12. *"Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave"*:

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
- Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.
- Bashkia Memaliaj nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

Gjurma e auditimit:

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

- Bashkia Memaliaj nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to. Ato duhet të përfshijnë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

IV. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi":

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

- Parimi nr. 13. "Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor";
- Parimi nr. 14. "Komunikimi i brendshëm";
- Parimi nr. 15. "Komunikimi i jashtëm":

Parimi nr. 13. *"Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor"*:

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

- Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.*
- Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
- Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Parimi nr. 14. *"Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm"*:

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve u komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.
- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë.
- Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi nr. 15. *"Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm"*:

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore por evidentohet që punonjësit duke përdorur adresat zyrtare të e-mailit, "bashkia.memaliaj@bashkiamemaliaj.gov.al"

Nga auditimi i të dhënave në faqen të Bashkisë Memaliaj me datë 22.05.2026, konstatohet se siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me:
- Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar;
- Buxhetin e miratuar të bashkisë;
- Raporte periodike të zbatimit të buxhetit;
- Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit;
- Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet;
- Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.
-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

V. Komponenti: "Monitorimi":

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

- Parimi nr. 16. "Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta";
- Parimi nr. 17. "Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive".

Parimi nr. 16. *"Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm"*:

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
- Institucioni ka përcaktuar në Rregulloren e Brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme nuk monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së. Për vitin 2025 me shkresën nr. 607 prot., datë 27.02.2026, është dërguar pranë Ministrisë së Financave, pyetësore për vetëvlerësimin për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ndërsa Raporti dhe Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm me shkresën nr. 437 prot., datë 13.02.2026.
- Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm .

- Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

- Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Parimi nr. 17. *"Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë"*:

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.
- Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296,

datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pika 2-3, 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike", Aneksi 2, "Regjistri dhe matrica e riskut" dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2, hapi 5.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe **z. B. C.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.1.2. *Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm;*

Bashkia Memaliaj ka përfshirë në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Për vitin 2025 me Vendimin nr. 9, datë 27.01.2025, të Këshillit Bashkiak dhe Urdhrin nr. 51, datë 25.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj është miratuar struktura e Njësisë së Auditit të Brendshëm e përbërë me 3 (tre) pozicione pune 1 (një) Përgjegjës i NjAB dhe 2 (dy) Specialist Auditi.

Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Memaliaj, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

NjAB në Bashkinë Memaliaj për vitin 2025 ka funksionuar me 1 (një) auditues duke mos qenë e plotë, sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj, konkretisht z. F. K. me detyrë Përgjegjës Sektori.

Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura për plotësimin e strukturës së NjAB për arsye se për 2 (dy) pozicionet vakante Specialist Auditi nuk është shpallur procedurë konkurimi.

Të dhënat mbi përbërjen e Sektorit të NjAB për vitin 2025 paraqiten si më poshtë:

Nr.	Periudha	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme	Aktualisht në punë apo larguar, data
1	F. K.	Përgjegjës	I lartë	6	2012	Po	Në punë
2	Vakant	Specialist	-	-	-	-	-
3	Vakant	Specialist	-	-	-	-	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

Përsa i takon trajnimeve periodike, që duhet të realizojë stafi i audituesve që janë pjesë e Njësisë së Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Memaliaj vihet re se janë ndjekur rregullisht trajnime të vijueshme profesionale nga Përgjegjësi i NjAB.

1. Karta e Auditimit të Brendshëm është miratuar me shkresën nr. 873/1 prot., datë 23.05.2023, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5. Me shkresën nr. 1286 prot., datë 10.10.2022, është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm MFE për vitet 2026-2028 me shkresë nr. 2315 prot., datë 17.10.2025, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Referuar shkresës me nr. 2278 prot., datë 18.10.2024, synohen të realizohen 7 auditime.

3. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2025, është dërguar në DHAB me shkresën nr. 437 prot., datë 13.02.2026, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të

Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.6.

4. Struktura e Projekt Raporteve dhe e Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2025 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të NjAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuara në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

6. Regjistri i Riskut i NjAB për vitin 2025 është hartuar dhe miratuar me nr. 364 prot., datë 12.02.2025. Të dhënat e detajuara për dosjet e përzgjedhura për t'u audituar, paraqiten në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 1.**

✓ *Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.*

Duke u bazuar në planin vjetor për vitin 2025 për auditimet të cilat do të realizohen nga NjAB, i cili është miratuar me shkresën nr. 2278 prot., datë 18.10.2024, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

- *Auditim në Sektorin e MZSh;*
- *Auditim në Ndërmarrja e Shërbimeve Publike me objekt "Detyrimet e prapambetura";*
- *Auditim në Shoqatën e Futboll K. M. me objekt "Detyrimet e prapambetura";*
- *Auditim në Futboll K. M.;*
- *Auditim në Bashkinë Memaliaj me objekt "Mbi shkallën e rregullshmërisë së aktivitetit të saj";*
- *Auditim në Bashkinë Memaliaj me objekt "Detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2025";*
- *Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të AB dhe KLSh;*

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, (Seksioni VI, Kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

Referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

- Për vitin 2025 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t'u kryer 7 auditime, nga të cilat deri më datën 31.12.2025, kanë përfunduar 7 auditime në masën 100%.
- Sipas llojit, auditimet kanë qenë:
  - Auditime Përputhshmërie 6 (gjashtë);
  - Të tjera 1 (një);

Të dhëna mbi numrin e auditimeve dhe llojeve të tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimi t	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:				Shër bime Këshi		Anga zhim		
			përputhshmërisë	performancës	financiare	A. Informacionit	të kombinuara			Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+ 3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2
1	Auditim në Sektorin e MZSH	1	1							1	
2	Auditim në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike	1	1							1	
3	Auditim në Shoqatën e F. K. M.	1	1							1	
4	Auditim në F. K. M.	1	1							1	
5	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të AB	1								1	

6	Auditim në Bashkine Memaliaj Drejtoritë	1	1							1	
7	Auditim mbi detyrimet e prapambetura	1	1		1					1	
Totali		**7**	**6**	**0**	**1**	**0**	**0**	**0**	**0**	**7**	**0**

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

VITI 2025						
Nr.	**Subjekti i Audituar**	**Numri i rekomandimeve**	**Pranuar**	**Zbatuar**	**Në proces**	**Pa zbatuar**
1	Rekomandime organizative	32	32	18	6	10
2	Rekomandime për arkëtime	2	2	0	0	2
Totali		**34**	**34**	**18**	**6**	**12**

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion u konstatua se, me përjashtim të MZSh Bashkia Memaliaj, subjektet e tjera të cilat janë audituar nga NjAB nuk kanë paraqitur planin mbi zbatimin e rekomandimeve.

✓ *Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.*

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

- Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, *"Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese"*, në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.
- Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.
- Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Auditit të Brendshëm është miratuar konform legjislacionit përkatës.
- Dosjet e Përhershme janë hapur dhe janë të arkivuara.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për vitin 2025:

✓ *Programimi i PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor;*

Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, ka dal Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Memaliaj me nr. 9, datë 14.01.2025, për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP). Ndër të tjera një prej angazhimeve që do të kenë grupet e sipërpërmendura do të jetë edhe përcaktimi i programeve buxhetore konkretisht:

- Programi planifikimi, menaxhim dhe administrim;
- Programi i shërbimeve publike me ekip menaxhimi;
- Programi i menaxhimit të infrastrukturës dhe planifikimit të territorit;
- Programi i infrastrukturës sociale ku përfshihet arsimi, sporti, kultura dhe shërbimi social;

Në këtë urdhër është caktuar z. B. C. kryetar i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, znj. K. Sh. Koordinator Risku dhe znj. E. E. Koodrinator i GMS.

a. *Faza e parë e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm:*

Faza e parë e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm njihet si faza strategjike. Vendimet më të rëndësishme në nivel strategjik dhe buxhetor, do të merren gjatë fazës strategjike dhe do të përkthehen në tavane të qëndrueshme dhe të pandryshueshme të shpenzimeve të cilat duhet të respektohen gjatë fazës teknike. Të gjitha vendimet kryesore strategjike/prioritare për financimin e politikave të reja merren gjatë fazës strategjike, duke përfshirë edhe vendimet për investimet e reja.

Pjesë e kësa faze është edhe raportimi në Këshillin Bashkiak nga titullari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 31 Janar të vitit 2024, për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave. Raporti i vlerësimit dhe parashikimeve duhet të përmbajë edhe parashikimet afatmesme të të ardhurave duke përfshirë të dhënat për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme buxhetore. Ky dokument duhet të miratohet nga Këshilli Bashkia jo më vonë se data 1 Mars 2024.
Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, Kryetari i Bashkisë përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin Bashkiak, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi brenda datës 15 Mars 2024.
Me Vendimin nr. 33, datë 17.05.2024, të Këshillit Bashkiak janë miratuar Tavanet Përgatitore për Programin Afatmesëm 2025-2027, konfirmuar bazueshmëria ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 464/1 prot., datë 3 1.05.2024. Në këtë dokument është miratuar plani i të ardhurave për PBA-në 2025-2027 konkretisht:

000/Lekë

Emërtimi	2024	2025	2026	2027
Plani i transfertës së kushtëzuar	147,884	164,061	172,622	182,204
Plani i transfertës s ecifike	271,115	337,804	287,238	140,036
Plani i të ardhurave të Bashkisë Memalia	68,675	64,852	63,413	64,665
Totali i të ardhurave	**487,674**	**566 717**	**523,273**	**386 905**

Tavanet e shpenzimeve për PBA-në 2025-2027 paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

000/Lekë

Emërtimi	Plani 2024			Plani 205			Plani 2025			Plani 2026		
Llogaritë	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231
Vlera	193,176	82,798	211,700	212,466	92,267	261,984	222,179	96,709	204,385	232,130	101,914	52,861
Totali			**487,674**			**566,717**			**523 273**			**686,905**

Pjesë e dokumentacionit të parashikimit nuk janë përfshirë parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet përpara vitit buxhetor. Vlen të theksohet se, Tavanet Përgatitore për Programin Afatmesëm 2025-2027, janë miratuar afërsisht 2 muaj me vonesë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", Kaptitulli I, pikat 3-4.

b. *Faza e dytë e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm:*

Kryetari i Bashkisë duhet të përgatisi dhe të dërgojë për miratim brenda datës 15 Korrik 2024 Tavanet Përfundimtare në Këshillin Bashkiak. Këshilli Bashkiak miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik 2024.
Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion u konstatua se, kjo fazë nuk është aplikuar nga Bashkia Memaliaj, por Tavanet Përfundimtare janë bërë si pjesë e vendimit për miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025/2027", Kapitulli 1, pika 26.

c. *Faza Përfundimtare e PBA-së:*

Është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallra e shërbimeve, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve etj.,. Në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje, në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, gjatë fazës strategjike të përgatitjes së PBA-së 2025-2027, nga Kryetari i Bashkisë dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik janë zhvilluar më datat 3-5 Dhjetor të vitit 2024, 5 (pesë) takime konsultative me përfaqësues të shoqërisë. Këshilli Bashkiak me shkresën nr. 2663 prot., datë 27.11.2024, ka nxjerr njoftimin për konsultimin publik në kuadër të hartimit të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, Paketës Fiskale dhe Buxhetit Vjetor 2025. Nga përfaqësuesit e Bashkisë janë zhvilluar dëgjesa publike në Njësitë Administrative Buz, Luftinjë, Krahës dhe Qesarat duke mbajtur njëkohësisht edhe procesverbalet respektive:

- Procesverbali nr. 2663/1 prot., datë 03.12.2024, mbi dëgjesën publike në NjA Buz;
- Procesverbali nr. 2663/2 prot., datë 03.12.2024, mbi dëgjesën publike në NjA Luftinjë;
- Procesverbali nr. 2663/3 prot., datë 04.12.2024, mbi dëgjesën publike në NjA Krahës;
- Procesverbali nr. 2663/4 prot., datë 04.12.2024, mbi dëgjesën publike në NjA Qesarat;

- Procesverbali nr. 2760 prot., datë 05.12.2024, mbi dëgjesës publike në qytetin Memaliaj;

Pas marrjes së mendimeve përfundimtare (sipas rastit) nga Ministria e Financave dhe bashkërendimit me projektbuxhetin vjetor, Kryetari i Bashkisë përgatit Projekt Programin Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak, së bashku me projektbuxhetin vjetor jo më vonë se data 30 Nëntor e vitit buxhetor.
Me shkresën nr. 2813 prot., datë 13.12.2024, nga Kryetari i Bashkisë është adresuar pranë Këshillit Bashkiak Relacioni për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe PBA-së për vitet 2025-2027, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025/2027", Kapitulli I, pika 44.
Për vitin 2025 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetet vjetore që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me Vendimin nr. 97, datë 23.12.2024, të Këshillit Bashkiak si dhe VKB-të përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1025/1 prot., datë 31.12.2024.
Për vitin 2025, buxheti bazë/fillestar vjetor është në vlerën 349,745 mijë lekë i ndarë në dy kategori konkretisht:

I. Të ardhurat gjithsej në vlerën 349,745 mijë lekë:
- Transferta e pakushtëzuar në vlerën 174,032 mijë lekë;
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 107,513 mijë lekë;
- Të ardhura nga buxheti i pavarur *(të ardhurat e veta)* në vlerën 33,200 mijë lekë;
- Të ardhura të trashëguara nga viti 2024 në vlerën 35,000 mijë lekë;

II. Shpenzimet gjithsej në vlerën 349,745 mijë lekë:
- Për pagat (600) në vlerën 196,934 mijë lekë;
- Për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (601) në vlerën 32,399 mijë lekë;
- Për shpenzimet operative (602) në vlerën 42,349 mijë lekë;
- Transferta korente të brendshme (604) në vlerën 5,702 mijë lekë;
- Transferta për buxhete familjarë e individë (606) në vlerën 2,200 mijë lekë;
- Fond rezervë + kontigjencë (609) në vlerën 10,399 mijë lekë;
- Mbrojtja civile (609) në vlerën 9,762 mijë lekë;
- Shpenzime kapitale (231) në vlerën 50,000 mijë lekë.

Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Memaliaj.
Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

a. Zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike;
b. Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore;
c. Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve rurale;
d. Zhvillimi i turizmit;
e. Zhvillimi cilësor dhe mbështetja Bujqësisë.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore". Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara,

burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme). Programi i të ardhurave për vitin 2024 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr. 4, datë 27.01.2025, me objekt "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025". Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Memaliaj për vitin 2025 është 349,275 mijë lekë.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	Buxheti Faktik 2024	Faza e 1 PBA 2025	Faza e 11 PBA 2025	Projekt Buxhet 2025
600	Paga	158,281	212,313	212,313	196,934
601	Sigurime Shoqërore	23,994	17,020	17,020	32,399
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	53,172	62,878	76,301	62,510
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0
606	Transferta për Buxhete Familjar & Individë	11,790	7,534	7,534	7,902
I	**Shpenzime Korrente**	**247,236**	**299,745**	**313,168**	**299,745**
230	Kapitale të Patrupëzuara	2,070	0	2,420	0
231	Kapitale të Trupëzuara	79,472	50,000	67,668	50,000
Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		**81,543**	**50,000**	**70,088**	**50,000**
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale me financim të huaj		**0**	**0**	**0**	**0**
II	Shpenzime Kapitale	**81,543**	**50,000**	**70,088**	**50,000**
III	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limiti	0	0	0	0
I + II + III Totali i Shpenzimeve		**328,779**	**349,745**	**383,255**	**349,275**

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025 paraqitet si më poshtë:

Lekë

Emërtimi	Viti 2024	Viti 2025
Të ardhurat faktike	347,828,000	390,428,983
Shpenzimet faktike	276,601,077	348,212,263

Të dhënat në formë tabele për planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim:

000/Lekë

Bashkia Memaliaj + Ndërmarrjet e varësisë								
Artikulli	Emërtimi	(1) Fakti i vitit paraardhës 2024	(2) PBA plan viti 2025	(3) Buxheti vjetor plani fillestar 2025	(4) Buxheti vjetor plani i rishikuar 2025	(5) Fakti i 12 mujor viti 2025	(6) = (5) – (4) Diferenca	% e realizimit
600	Paga	158,281	212,313	196,934	196,934	(1,400)	(1,400)	99.2%
601	Sigurime Shoqërore	23,994	17,020	32,399	32,399	(750)	(750)	97.6%
600 + 601	**Paga + Sigurime**	**182,274**	**229,333**	**229,333**	**229,333**	**(2,150)**	**(2,150)**	**99%**
602	Mallra dhe shërbime të tjera	53,172	62,878	42,349	53,971	(362)	(362)	99.3%
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	-
604	Transfertakorrente të brendshme	6,631	0	5,702	5,702	0	0	100%
605	Transferta korrente të huaja	0	0	0	0	0	0	-
606	Transferta për buxhete familje & individë	5,159	0	2,200	4,000	(2,200)	(2,200)	45%
602 + 606	**Shpenzime operative**	**0**	**7,534**	**20,161**	**27,334**	**1,488**	**(25,846)**	**5.4%**
Shpenzime korrente		64,962	70,412	70,412	91,007	62,599	(28,408)	68.7%
230	Kapitale të patrupëzuara	2,070	0	0	2,420	0	(2,420)	0%
231	Kapitale të trupëzuara	79,472	50,000	50,000	67,668	58,430	(9,238)	86.3%
Totali	**Shpenzime kapitale**	**81,543**	**50,000**	**50,000**	**70,088**	**58,430**	**(11,658)**	**83.6%**
Totali (korrente + kapitale)		**328,779**	**349,745**	**383,255**	**390,428**	**348,212**	**(42,216)**	**89.18%**

Për vitin 2025, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor) është miratuar me VKB-në nr. 97, datë 23.12.2024. Në këtë VKB-në, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën 33,200,000 lekë, të ardhura të trashëguara nga viti 2024 në vlerën 35,000,000 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 174,032,000 lekë dhe transferta specifike ka vlerën 107,513,000 lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 349,745,000 lekë po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 349,745,000 lekë. Gjatë vitit 2025, janë marrë gjithashtu

edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në Dhjetor të viti 2025). Këto ndryshime paraqiten si më poshtë:
- Me Vendimin nr. 17, datë 27.02.2025, është marrë vendim nga Këshilli Bashkiak Memaliaj është miratuar buxheti shtesë për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 33,510,006 lekë. Lista e investimeve të reja të parashikuara në buxhetin vjetor të vitit 2025 nga të ardhurat e veta dhe grandi paraqiten në **Aneksin nr. 2, Tabela nr. 1.** *Pasqyra përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2025 sipas VKB-ve përkatëse:*

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2025			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 97 datë 23.12.2025	Buxheti shtesë miratuar me VKB nr. 17, datë 27.02.2025	Vlera	Llogaria	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2025	33,200	0	33,200	600	196,934	0	196,934
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2025	10,000	12,707	22,707	601	32,399	0	32,999
Total të ardhurat e veta	**43,200**	**12,707**	**55,907**	602	42,349	18,795	**61,144**
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	12,442	10,707	23,149	604	5,702		5,702
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	12,558	10,095	22,653	606	2,200	1,800	4,000
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2025	174,032	5,871 Me VKM	179,903	230-231	50,000	20,088	70,088
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2025	107,513	1,302 Me VKM	108,815	609	20,161		20,161
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	**306,545**	**27,975**	**334,520**				
Totali te ardhurave	**349,745**	**40,683**	**390,428**	**Totali Shpenzimeve**	**349,745**	**40,683**	**390,428**

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA-në, PBA-ja për vitet 2025-2027 krahasuar me planin buxhetor për vitin 2025 dhe Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2025, paraqiten respektivisht në **Aneksin nr. 2, Tabelat 2-4.**

2.2.1. *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative:*

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga pushteti qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.
Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.
Gjatë periudhës së audituar, janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit, këto lëvizje janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.
Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.
Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Memaliaj dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar.
Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.
Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.
Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Memaliaj ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse

për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit Tepelenë, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve.
Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër, konkretisht si më poshtë:
Me VKB-në nr. 17, datë 27.02.2025, "Për miratimin e shpërndarjes së të ardhurave të trashëguara dhe grandit të pa përdorur të vitit 2024 për vitin 2025", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 230/1 prot., datë 11.03.2025, është kryer shpërndarja në vlerën 33,510,006 lekë të detajuara sipas tabelës **(në Aneksin nr. 2, Tabela nr. 5.)** së mëposhtme:

000/Lekë

Nr.	Funksionet	Programi	Artikulli	Kapitulli 01	Kapitulli 05	Shuma
1	Shpenzime operative	01110	602	11,622,357	0	11,622,357
2	Shpenzime operative	01110	606	1,800,000	0	1,800,000
3	Shpenzime operative	01110	230	2,420,000	0	2,420,000
4	Shpenzime operative	01110	231	4,960,400	0	4,960,400
5	Shpenzime operative	01110	231	0	12,707,249	12,707,249
Totali				**20,802,757**	**12,707,249**	**33,510,006**

- Me VKB-në nr. 20, datë 25.03.2025, "Për miratimin në parim për rritjen e numrit me 6 (gjashtë) punonjës në organikën e Sektorit të MZSH-së në Bashkinë Memaliaj", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën 298/1 prot., datë 11.04.2025;
- Me VKB-në nr. 44, datë 28.05.2025, "Për miratimin e projektit të ndërtimit me objekt "Riparimi i shkarjeve në rrugët fshatrave Martalloz, Lagja Meçaj, Lulëzim, Fshat Memaliaj", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën 531/1 prot., datë 19.06.2025, është pakësuar llogaria 609 "Rezervat" në vlerën 1,017,046 lekë dhe shtuar në gjendjen e llogarisë 602 "Shpenzime operative";
- Me VKB-në nr. 52, datë 30.06.2025, "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga zjarri z. B. S.", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën 607/1 prot., datë 14.07.2025, është akorduar familjes së shtetasit z. B. S. ndihmën emergjente në vlerën 348,845 lekë nga fondi i emergjencave civile i miratuar për vitin 2025;
- Me VKB-në nr. 53, datë 30.06.2025, "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga zjarri znj. F. K.", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën 607/1 prot., datë 14.07.2025, është akorduar familjes së shtetasit znj. F. K. ndihmën emergjente në vlerën 696,986 lekë nga fondi i emergjencave civile i miratuar për vitin 2025;
- Me VKB-në nr. 114, datë 24.07.2025, të Kryetarit të Bashkisë "Për disa ndryshime në buxhet brenda të njëjtit program", është pakësuar llogaria 609 "Rezervat" në vlerën 1,045,831 lekë dhe shtuar në gjendjen e llogarisë 606 "Transferta për buxhete dhe individë";
- Me VKB-në nr. 160, datë 04.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë "Për disa ndryshime në buxhet brenda të njëjtit program", është pakësuar llogaria 604 "Transferta të brendshme" në vlerën 1,302,000 lekë dhe shtuar në gjendjen e llogarisë 600 "Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli", në zbatim të Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025";
- Me Urdhrin nr. 278, datë 31.12.2025, të Kryetarit të Bashkisë "Për rialokimin e fondit nga llogaria ekonomike 604 në llogarinë ekonomike 602", është pakësuar llogaria 604 "Transferime të brendshme" në vlerën 4,613,084 lekë dhe shtuar në gjendjen e llogarisë 602 "Shpenzime operative" në zbatim të Aktit Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025" i ndryshuar". Nga Këshilli Bashkiak Memaliaj është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

000/Lekë

Planifikimi i të ardhurave viti 2025		Planifikimi i shpenzimeve 2025	
Burimi i të ardhurave		600 Paga	196,934
Të ardhura të planifikuara për vitin 2025	33,200	601 Sigurime Shoqërore	32.399
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm nga viti 2024	35,000	602 Mallra dhe shërbime të tjera	42,349
Total të ardhura të veta	**68,200**	604 Transfertakorrente të brendshme	5,702
Transfertë		606 Transferta për buxhete familje & individë	2,200
Transfertë e pakushtëzuar	174,032	609 Fond Rezervë + kontigjencë	10,399
Transfertë e pakushtëzuar sektoriale	107,513	609 Mbrojtje civile	9,762
Totali i të ardhurave nga transfertat e buxhetit të shtetit	281,545	231 Shpenzime kapitale	50,000
Totali i të ardhurave	**349,745**	**Totali i shpenzimeve**	**349,745**

Buxheti i konsoliduar (Aparati i Bashkisë + Njësia e Varësisë Drejtoria e Shërbimeve) për vitin 2025 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 349,745 mijë lekë. Të dhënat mbi ndryshimet buxhetore të ndodhura përgjatë vitit 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/Lekë

Periudha Buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjatë vitit		Pakësuar/Shtuar Artikulli			
	Nr. Datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Shtesa	Shuma	Pakësime	Shuma
2025	Nr. 97, datë 23.12.2024	**349,745**	Nr. 17, datë 27.02.2025	33,510	602	11,622	-	0
					606	1,800	-	0
					231	17,668	-	0
					230	2,420	-	0
			Totali I	**33,510**		**33,510**		**0**
			Për shlyerje detyrime nga MF	4,613	602	4,613	-	0
			Shpërblim zjarrëfikës	1,302	602	1,302	-	0
			Totali II	5,915		5,915		0
			Totali 1 + II + Buxheti Fillestar	**389,170**		**389,170**		**0**

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Memaliaj konstatohet se për vitin 2025, gjendja fillestare e planit të çelur së bashku me fondet e trashëguara është 349,745 mijë lekë. Me VKB e sipërpërmendura ka pasur shtesë buxheti në vlerën 39,425 mijë lekë ku totali ka shkuar në vlerën 389,170 mijë lekë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të hartimit dhe zbatimit të buxhetit".

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar.

Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2025, u konstatua se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit 2025, buxheti i Bashkisë Memaliaj ka pësuar ndryshime nëpërmjet VKB, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit Memaliaj dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave dhe tarifave të Bashkisë dhe të granteve.

Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Memaliaj janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Tepelenë, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive. Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve. Gjatë auditimit, rezulton se Kryetari i Bashkisë ka raportuar normalisht në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

2.2.2. *Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit:*

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Memaliaj, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Memaliaj, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuara nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror. Tabela fiskale e konsoliduar mbi realizimin e treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

000/Lekë

Grand Buxheti i Bashkisë Memaliaj					
Llogaria	**Emërtimi**	**Plani 2025**	**Fakti 2025**	**Diferenca**	**Realizimi nw %**
600	Paga	202,500,600	200,795,390	1,705,210	99.1
601	Sigurime Shoqërore	33,168,560	32,408,630	759,930	97.7
602	Mallra dhe shërbime të tjera	62,729,775	55,718,940	7,010,835	88.8
604	Transfertakorrente të brendshme	7,607,770	7,58,980	18,790	99.7
606	Transferta për buxhete familje & individë	120,903,520	119,966,300	937,220	99.2
609	Transferta korrente të huaja	19,570,120	0	19,570,120	0
230	Kapitale të patrupëzuara	2,420,000	2,413,960	6,040	99.7
231	Kapitale të trupëzuara	397,315,625	379,132,600	18,183,025	95.4
Totali	**Shpenzime kapitale**	**846,215,970**	**798,024,800**	**48,191,170**	**94.3**

Për vitin 2025 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën **846,215,970 lekë** dhe realizuar në vlerën **798,024,170 lekë** në masën **94.3%** me një diferencë mosrealizimi në vlerën **48,191,170 lekë,** e ndarë kjo sipas burimeve të financimit:

- **Të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore** janë planifikuar në vlerën 33,200 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 30,345 mijë lekë në masën 91.4% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 2,854 mijë lekë;
- **Transferta e pakushtëzuar** është planifikuar në vlerën 178,645 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 158,329 mijë lekë në masën 88.6% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 20,315 mijë lekë;
- **Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale** është planifikuar në vlerën 110,073 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 107,510 mijë lekë në masën 97.6% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 2,563 mijë lekë;
- **Të ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm** janë planifikuar në vlerën 68,510 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 52,026 mijë lekë në masën 75.9% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 16,483 mijë lekë;
- **Funksionet e deleguara që kanë si burim financimi transfertën e kushtëzuar** janë planifikuar në vlerën 456,646 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 449,814 mijë lekë në masën 98.5% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 6,832 mijë lekë.

000/Lekë

Bashkia Memaliaj + Ndërmarrjet e Varësisë 2025					
Artikulli	**Emërtimi**	**Buxheti vjetor përfundimtar 2025**	**Realizimi viti 2025**	**Diferenca**	**Realizimi në %**
600	Paga	196,934	195,534	(1,400)	99.2
601	Sigurime Shoqërore	32,399	31,649	(750)	97.6
602	Mallra dhe shërbime të tjera	53,971	53,609	(362)	99.3
604	Transfertakorrente të brendshme	5,702	5,702	0	100
606	Transferta për buxhete familje & individë	4,000	1,800	(2,200)	45
230	Kapitale të patrupëzuara	2,420	0	(2,420)	0
231	Kapitale të trupëzuara	67,668	58,430	(9,238)	86.3
Totali (korrente + kapitale)		**390,428**	**348,212**	**(42,216)**	**89.18**

Lekë

Nr.	**Emërtimi**	**Plani 2025**	**Fakti 2025**	**Diferenca**	**Realizimi %**
I	**Të ardhurat e Pushtetit Vendor**	**33,200,000**	**30,345,649**	**2,854,351**	**91.4**
1	Taksat e veta vendore	14,700,000	10,022,997	4,677,003	68.1
a	Taksa mbi pasurinë	3,400,000	1,833,882	1,566,118	53.9
b	Biznesi i vogël	0	0	0	-
c	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	2,000,000	1,364,288	635,712	68.2
d	Taksa të tjera vendore	9,300,000	6,824,827	2,475,173	73.3
2	**Të ardhura jo tatimore**	**8,900,000**	**6,715,681**	**2,184,319**	**75.4**
a	Tarifa e shërbimeve publike	7,300,000	5,407,251	1,892,749	74
b	Tarifa administrative	800,000	670,550	129,450	83.8

c	Të tjera jo tatimore	800,000	637,880	162,120	79.7
3	**Taksa të ndara**	**9,600,000**	**13,606,971**	**(4,006,971)**	**141.7**
a	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	2,000,000	2,065,877	(65,877)	103.2
b	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	3,600,000	6,018,815	(2,418,815)	167.1
c	Renta minerare	0	0	0	-
d	Tatimi mbi të ardhurat personale	4,000,000	5,522,279	(1,522,279)	138
e	Të tjera	0	0	0	-
II	**Shpenzime të Buxhetit Vendor**	**389,171,487**	**348,212,263**	**40,959,224**	**89.4**
1	Shpenzime korrente	320,341,254	289,782,013	30,559,241	90.4
a	Paga dhe fond i veçantë për paga	196,934,000	195,533,220	1,400,780	99.2
b	Kontribut për sigurimet shoqërore	32,399,000	31,649,530	749,470	97.6
c	Shpenzime operative	59,887,749	53,609,248	6,278,501	89.5
d	Të tjera korrente	29,863,000	8,990,015	20,872,985	30.1
2	**Shpenzime kapitale**	**70,087,729**	**58,430,250**	**11,657,479**	**83.3**
3	**Burimet e financimit**	**390,428,983**	**348,212,263**	**42,216,720**	**89.1**
a	Të ardhurat e veta vendore	33,200,000	30,345,649	2,854,351	91.4
b	Transferta e pakushtëzuar	178,645,609	158,329,650	20,315,959	88.6
c	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale	110,073,368	107,510,362	2,563,006	97.6
d	Të ardhurat e pa planifikuara (jasht limitit)	68,510,006	52,026,602	16,483,404	75.9
e	Financim i huaj	0	0	0	-
f	Huamarrje vendore vjetore	0	0	0	-

000/Lekë

Programet	Emërtimi i programit	Buxheti i vitit 2025	Plani vjetor i ndryshuar	Plani përfundimtar	Fakti
O6370	Ujësjellësa	51,000	151,100	151,100	145,011
O6190	Bonusi i qirave	1,628	2,064	2,064	1,627
O4240	Ujitje kullimi	8,000	8,000	8,000	8,000
O9230	Arsimi i mesëm shkolla e mesme	64,706	94,306	94,306	94,277
06190	Përmirësimi i banesave	6,240	31,240	31,240	31,240
10430	Ndihma ekonomike	54,791	114,494	114,494	114,331
O6210	KZAZ	92	1,477	1,477	1,452
O1170	Gjendja Civile	4,376	6,097	6,097	6,021
10910	Mbrojtja Civile	2,608	2,608	2,608	2,608
10910	Shkarje të rrugëve në NjA Buz & Luftinjë	44,602	44,602	44,602	44,589
O9120	Arsimi parashkollor	0	658	658	658
Totali		**237,784**	**456,646**	**456,646**	**449,814**

Analiza mbi realizimin e treguesve buxhetor për vitin 2025 sipas artikujve paraqitet si më poshtë:

- Artikulli **600 "Paga shpërblime dhe të tjera shpërblime personeli"** është planifikuar në vlerën 202,500 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 200,795 mijë lekë ose në masën 99.1% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 1,705 mijë lekë;
- Artikulli **601 "Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore"** është planifikuar në vlerën 33,168 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 32,408 mijë lekë ose në masën 97.7% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 759 mijë lekë;
- Artikulli **602 "Mallra dhe shërbime të tjera"** është planifikuar në vlerën 62,729 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 55,718 mijë lekë ose në masën 88.8% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 7,010 mijë lekë;
- Artikulli **604 "Transferime për buxhete familjare dhe individë"** është planifikuar në vlerën 120,903 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 119,966 mijë lekë ose në masën 99.2% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 937 mijë lekë;
- Artikulli **609 "Rezerva"** është planifikuar në vlerën 19,570 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 0 lekë;
- Artikulli **230 "Kapitale të pa trupëzuara"** është planifikuar në vlerën 2,420 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,413 mijë lekë ose në masën 99.7% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 6 mijë lekë;
- Artikulli **231 "Kapitale të trupëzuara"** është planifikuar në vlerën 397,315 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 379,132 mijë lekë ose në masën 95.4% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 18,183 mijë lekë;

Referuar nivelit të realizimit të fondeve buxhetore të Bashkisë pjesë e planit përfundimtar u konstatua se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara jo në nivele të mira në vitin 2025, konkretisht në masën 86.3%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Memaliaj në fillim të vitit buxhetor planifikon proçedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 5, gërma "a", Ligjin nr. 9936, datë

26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 3, pikat 24-25 dhe neni 47.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë: Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë, Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile dhe i Kontigjencës paraqitet në shumën 21,633 mijë lekë miratuar me VKB nr. 97, datë 26.12.2024.

Fondi Rezervë: Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, është krijuar Fondi rezervë. Në buxhetin e Bashkisë Memaliaj për vitin 2025, është planifikuar fond rezervë në vlerën 4,110 mijë lekë. Fondi Rezervë për periudhën nga data 01.01.2025, deri 31.12.2025, nuk është përdorur.

Fondi i Kontingjencës: Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Në buxhetin e Bashkisë Memaliaj është në vlerën 3,424 mijë lekë. Fondi i Kontigjencës për periudhën nga data 01.01.2025, deri 31.12.2025, nuk është përdorur.

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile: Në zbatim të nenit 65 të Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në buxhetin e Bashkisë Memaliaj për vitin 2025, është miratuar fondi i emergjencës në vlerën 14,099 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta. Fondi i Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile për periudhën nga data 01.01.2025, deri 31.12.2025, nuk është përdorur.

Për zvogëlimin e riskut, parandalimin, përballimin, funksionimin dhe dhënien e shërbimit nga Sektori i MZSH-së dhe Emergjencat Civile në rastet e fatkeqësive natyrore si dhe për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, financimi i Bashkive të Republikës së Shqipërisë realizohet edhe nëpërmjet transfertës së kushtëzuar konkretisht:

- ✓ **Për vitin 2025:**

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2024, datë 03.12.2024, "Për buxhetin e vitit 2025", neni 15, pikat 6-9, dhe shkresën nr. 492/1 prot., datë 25.02.2025, të AKMC-së administruar në Bashkinë Memaliaj me praktikën nr. 527 prot., datë 27.02.2025, fondi i akorduar në Programin "Emergjencat Civile" të MM-së i cili do të shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga MM-ja në bashkëpunim me MFE-në, ku me shkresën nr. 2126/1 prot., datë 19.02.2025, "Dërgohen buxhetet e bashkive për vitin 2025" ka përllogaritur për Bashkinë Memaliaj peshën specifike në masën 0.33% në vlerën **2,607,767 lekë.** Për përdorimin e këtyre fondeve në Degën e Thesarit Tepelenë për Artikullin 604 "Transferime korente të brendshme" janë funksional dy kode 91707AG *(Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve)* dhe 91707AB *(Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësitë të ndryshme).*

Nëpërmjet kësaj korrespodence MM-ja i kërkon Bashkisë Memaliaj që brenda datës 28.02.2025, me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, të kryej ndarjen e masës që do të përdoret sipas fondit në dispozicion. Me e-mailin e datës 28.02.2025, Bashkia Memaliaj i kthyer përgjigje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, fondet do të përdoren për Kodin e Produktit 91707AG në vlerën **2,000,000 lekë** dhe Kodin e Produktit 91707AB në vlerën **607,767 lekë.**

Shpërndarja e tyre në referencë të prioritizimit për përdorimin sipas dy Kodeve të Produkteve 91707AG dhe 91707AB është kryer pa u marrë më parë miratimi nga Këshilli Bashkiak Memaliaj, dhe për rrjedhojë nuk është marrë edhe konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në

nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të shpërndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, pikat 5-6.

Për parandalimin, përballimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore në Republikën e Shqipërisë janë hartuar tre dokumente strategjike në nivel qendror, konkretisht: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë: Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë si dhe Plani Kombëtar për Emergjrcat Civile, të cilat janë miratuar respektivisht me VKM-në nr. 168, datë 24.03.2023, "Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qëndror", VKM-në nr. 94, datë 22.03.2023, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë 2023-2030 dhe planet e veprimit" dhe VKM nr. 807, datë 28.12.2023, "Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile".

Në këto dokumente evidentohet edhe ekspozimi ndaj risqeve lidhur me emergjencat civile për Qarkun e Gjirokastër në të cilën përfshihet edhe Bashkia e Memaliaj. Në zbatim të tre dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, në pikat 1-2, evidentohen angazhimet dhe detyrat që kanë institucionet e njësive të vetëqeverisjes vendore për përfitimin e fondeve me qëllim reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile konkretisht:

"l. Bashkitë, për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, të përfitojnë nga buxheti qendror një fond të kushtëzuar për mbrojtjen civile. 2. Kriteret e përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, duhet të bazohen në:

a) Strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;

b) Vlerësimin vendor të riskut;

c) Planin vendor të emergjencave civile;

d) Planin e zhvillimit urban".

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2025, nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura për hartimin e katër dokumenteve në nivel vendor konkretisht: Strategjinë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë; Vlerësimin Vendor të Riskut; Planin Vendor të Emergjencave Civile dhe Planin e Zhvillimit Urban, *të cilat janë dokumente orientuese që shërbejnë për përdorimin e fondeve të akorduara nga buxheti qendror në formën e transfertës së kushtëzuar me qëllim zvogëlimin e riskut, parandalimin, përballimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore.* Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, në pikat 1-2. Realizimi i fondeve të ardhura në formën e transfertës së kushtëzuara paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Kodi	Përshkrimi	Fondi i akorduar	VIera e likuiduar
604	91707AG	Riparimi i shkarjeve në rrugët e fshatrave Matralloz, Lagja Meçaj, Lulëzim	2,000,000	2,000,000
604	91707AB	Likuidim i dëmeve të shkaktuara nga zjarri	607,767	607,767
Totali			**2,607,767**	**2,607,767**

Subvencione: Bashkia Memaliaj për vitin nuk ka pasur subvencione për vitin 2025.

Kredi të marra: Bashkia Memaliaj nuk ka marrë kredi për vitin 2025.

Shpronësimet: Bashkia Memaliaj nuk ka kryer pagesa për shpronësimet për vitin 2025.

Gjendja Financiare e Bashkisë Memaliaj:

Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2025, janë në masën 2.8% e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Memaliaj, më pak se 25% duke dëshmuar për një situatë jo vështirësi financiare. Detyrimet e prapambetura në muajin Dhjetor të vitit 2025 kanë qenë në vlerën 9,865 mijë lekë ndërsa shpenzimet faktike janë në vlerën 348,212 mijë lekë pra detyrimet ndaj totalit të shpenzimeve faktike janë në masën 2.8%.

2.2.3. *Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve:*

Detyrimet e prapambetura të vitit 2025:

Bashkia Memaliaj më datë 01.01.2025, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura në total vlerën 11,514,715 lekë me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku në të përfshihen detyrimet për investimet dhe mallra dhe shërbime.

Vlera e paguar përgjatë vitit 2025 për detyrimet e prapambetura është në vlerën 5,942,121 lekë.

Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më datë 31.12.2025, pa përfshirë detyrimet e krijuara në vitin 2025 është 11,514,715 lekë.

Vlera e detyrimeve të prapambetura të krijuara përgjatë vitit 2025, është 5,563,594 lekë. Ndërsa vlera e detyrimeve progresive deri më datë 31.12.2025, është në vlerën 9,865,023 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pika 162; nenin 52, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91.

Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Kodi i detyrimit të prapambetura	Emërtimi i detyrimit të prapambetura	Detyrimi i prapambetur progresiv më 31.12.2024	Vlera e paguar gjatë vitit 2025 për detyrimin e prapambetur (kolona 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të papaguara më 31.12.2025 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2025)	Detyrimi i prapambetur i krijuar gjatë vitit 2025 (situata më 31.12.2025)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetura pa paguar më 31.12.2025
602	Posta Shqiptare	174,539	0	174,539	0	174,539
602	OSHE	6,049,542	2,565,976	3,483,566	2,907,865	6,391,431
602	G. ShPK	150,407	0	150,407	0	150,407
602	S. Xh.	855,094	0	855,094	0	855,094
602	S. Xh.	899,988	0	899,988	0	899,988
602	A.	129,000	129,000	0	0	0
602	O.	99,000	99,000	0	0	0
602	C. F.	229,200	229,200	0	0	0
602	S. M.	117,600	117,600	0	0	0
602	P. B.	180,000	180,000	0	0	0
602	2…	120,000	120,000	0	0	0
602	K. ShPK	1,354,481	1,354,481	0	0	0
602	D. ShPK	1,020,000	1,020,000	0	0	0
602	UKT Mermalaj	135,864	135,864	0	0	0
230	I.	0	0	0	252,000	252,000
230	U…	0	0	0	214,920	214,920
602	Z. Zh.	0	0	0	407,175	407,175
602	E. L.	0	0	0	119,880	119,880
230	Th.	0	0	0	399,589	399,589
	Totali	**11,514,715**	**5,942,121**	**5,563,594**	**4,301,429**	**9,865,023**
Blerje makinë 3-aks nga fondet e AKMC					2,960,000	2,960,000
	Detyrime në total	**11.514.715**	**5,942,121**	**5,563,594**	**7,261,429**	**12,825,023**

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit:

- Me shkresën nr. 1196/1 prot., datë 27.05.2025, është dërguar raporti i treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Memaliaj për 4 mujorin e vitit 2025, pranë Ministrisë së Financave;
- Me shkresën nr. 2186 prot., datë 30.09.2025, është dërguar raporti i treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Memaliaj për 8 mujorin e vitit 2025, pranë Ministrisë së Financave;
- Me shkresën nr. 617 prot., datë 02.03.2026, është dërguar raporti i treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Memaliaj për 12 mujorin e vitit 2025, pranë Ministrisë së Financave, në përputhje me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore", pikat 19-23.

Vendimet gjyqësore:

Për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, nuk ka pasur likuidime për vendimet gjyqësore.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHSH, saktësia e raportimi buxhetor i tyre:

Lista e investimeve që ka pasur Bashkia Memaliaj të financuara nga Ministritë e Linjës për vitin 2025 së bashku me likuidimet e tyre, paraqitet në mënyrë të detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

Lekë

Nr.	Objekti i prokurimit	Vlera e plotw e kontratës me TVSh	Vlera e likujduar para vitit 2025	Vlera e likujduar 2025	Vlera e pa likujduar	Arsyet e mos likujdimit
1	Përmirësimi banesave 2024	37,174,041	30,934,431	6,239,610	0	
2	Përmirësimi banesave 2025	43,474,455		25,000,000	18,474,455	Pritet financimi për 2025
3	Rikonstruksion gjimnazi "S. Nivica"	173,942,580	53,557,000	98,267,610	22,117,970	Pritet financim
4	Blerje mjeti 3-aks	7,440,000		4,480,000	2,960,00	Pritet financim i vitit
5	Përmirësimi i skemës ujitëse Krahas	24,356,726	7,224,000	8,000,000	9,132,726	Pritet financim i vitit
6	Shkarjet në NjA Buz-Luftinje	61,726,516	21,617,800	40,108,716	0	
7	Ujësjellësi Rajonal Memaliaj	487,378,589	225,279,116	145,011,013	117,088,460	Pritet financim ivitit

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë, **z. B. C.** Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.2.5. *Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.*

a. *Struktura e Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore:*

Për vitin 2025 me VKB-në nr. 9, datë 27.01.2025, me objekt "Për miratim të nivelit të pagave të administratës së bashkisë dhe struktura të tjera", është miratuar numri i punonjësve dhe niveli i pagave të Bashkisë Memaliaj, duke marrë edhe konfirmimin mbi besueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 97/1 prot., datë 04.02.2025. Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 51, datë 25.02.2025, me objekt "Për miratimin e strukturës organizative të bashkisë për vitin 2025", është miratuar struktura organizative në të cilën detajohen pozicionet e punës për çdo drejtori të institucionit, ku bën pjesë edhe Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore. Kjo strukturë ka funksionuar për vitin 2025 me 9 (nëntë) punonjës, 1 (një) Drejtor Drejtorie, 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 6 (gjashtë) Specialist Tatimesh për Qytetin dhe Njësitë Administrative si Fshat Memaliaj, Krahës, Qesarat, Buz dhe Luftinjë. Struktura e Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore Bashkia Memaliaj për vitin 2025 pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i shkollës	I lartë ose i mesëm
1	Vakant	Drejtor Drejtorie	-	-
2	Vakant	Përgjegjës Sektori	-	-
3	V. Xh.	Specialist Tatimesh Qytet Memaliaj	Kimi Biologji	I lartë
4	A. I.	Specialist Tatimesh Qytet Memaliaj	Kontabilitet Financë	I lartë
5	Sh. L.	Specialist Tatimesh NjA Fshat Memaliaj	Agronomi	I lartë
6	J. Z.	Specialist Tatimesh NjA Qesarat	Shkenca Politike	I lartë
7	M. Ç.	Specialist Tatimesh NjA Buz	Mësuesi	I lartë
8	M. M.	Specialist Tatimesh NjA Luftinjë	Shkollë e Mesme Bujqësor Izvor	I mesëm
9	M. L.	Specialist Tatimesh NjA Krahës	Histori Gjeografi	I lartë

Përgjatë vitit 2025, pozicionet e punës si Drejtor i Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore dhe Përgjegjës Sektori kanë qenë vakante. Nga auditimi mbi mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga kjo drejtori u konstatua se, aktrakordimet mbi të ardhurat me Degën e Thesarit Tepelenë, aktrakordimet me Agjentët Tatimor, fatura mbi përllogaritjen e detyrimeve, njoftim detyrimi etj., nënshkruhen nga znj. V. Xh. me pozicion Specialist Tatimesh për Qytetin Memaliaj, në mungesë të plotësimit të vendit vakant të Drejtorit të kësaj drejtorie.
Në lidhje me këtë situatë nuk disponohet një Urdhër i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, që punonjësja në fjalë të jetë e autorizuar apo komanduar për pozicion vakant të Drejtorit të Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore, duke tejkaluar njëkohësisht kompetencat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të institucionit të miratuar me VKB-në nr. 12, datë 28.02.2023, me objekt "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Memaliaj", neni 31 "Specialist Tatimesh Qytet Memaliaj".

b. *Mënyra mbi mbajtjen dhe administrimin e taksave dhe tarifave vendore:*

Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore *(në vijim DTTV)* çdo fillim viti krijon një regjistër të ri elektronik në format E. për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Bazuar në regjistrin elektronik që këto njësi administrojnë *(veçmas për çdo njësi administrative)* DTTV në NjA Memaliaj dhe Zyrat e Taksave pranë NjA bëjnë menaxhimin e të dhënave sa i

përket regjistrimit/ç'regjistrimit, planifikimit, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtimeve për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.
- DTTV-ja për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit të mbylljes së regjistrit elektronik vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrit elektronik të ri vjetor. Të dhënat që administrohen nga regjistrin elektronik *(informacioni mbi subjektet tatimpagues që popullon regjistrin elektronik),* shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim *(evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat e nivelit të dytë apo QKB)* realizimi në drejtimin e Bashkisë Memaliaj dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit. Kontabiliteti përdor për veprimtarinë e tij evidencën e vënë në dispozicion nga DTTV-ja e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin E. i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor *(në të cilin nuk ka të dhëna mbi informacionin historik mbi subjektin)* si dhe nga informacioni që paraqesin drejt saj drejtoritë/sektorët të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit bëhet manualisht duke ulur efiçencën, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar.
- Auditimi i *"Regjistrin Elektronik"* për kategorinë *"Biznes"* dhe *"Familjar"*, është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky regjistër administron të dhëna për kategorinë *"Biznes"* dhe *"Familjar"*, në nivel lokal. Siguria e informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë të dhëna, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.
Siguria e informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Bazuar për sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: "Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria".
Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve dhe moszbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që i shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, proçesi, apo aktiviteti.
Përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin *(marrjen e vendimit)*, zbatimin, dhe kontrollin, për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni.
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji përcaktojnë kuadrin rregullator që shërben për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet e njësive publike, janë të përshtatshme dhe efektive, për të ofruar shërbime publike dhe për të adresuar risqet me efikasitet dhe efektshmëri. Objektivat e auditimit janë të sigurohet se njësia publike:

- *Pajtohet me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat;*
- *Siguron informacione operative dhe financiare të besueshme dhe të plota;*
- *Mbron informacionin dhe aktivet e saj.*

- DTTV-ja nuk ka një rregullore të brendshme të miratuar apo përshkrim të proceseve të punës së personelit që operon në "Regjistrin elektronik", ku të përcaktohen detyrat, përgjegjësitë sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën organizative të miratuar. Bashkia Memaliaj organizimin e veprimtarisë së DTTV-ja e bën duke u mbështetur vetëm në *"Regjistrin Elektronik" (veçmas për çdo njësi administrative).* Për çdo njësi administrative ky regjistër bën menaxhimin e të dhënave sa i përket regjistrimit/ç'regjistrimit, planifikimin, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtimeve dhe administrimin e debitorëve për abonentët familjarë, personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.
- Struktura e kategorizimit të regjistrit për bizneset dhe popullatën është e ndërtuar bazuar në paketën fiskale të miratuar. DTTV-ja çdo fillim viti krijon një regjistër të ri për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Procesi i popullimit të Regjistri Elektronik në DTTV dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues.
- Për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit mbylljes së regjistrit vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrit të ri vjetor. Raportet të cilat prodhohen nga informacioni që popullon regjistrin elektronik (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat enivelit të dytë apo QKB etj.,) shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim në drejtimin e Bashkisë Memaliaj dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Nuk administron një regjistër për të gjitha taksat/tarifat vendore sipas strukturës së paketës fiskale dhe për gjithë territorin që ka nën administrim qoftë dhe në formatin E. për të parandaluar për shembull, regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikime të paautorizuara të të dhënave.
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat dhe pagesat për detyrimet mbi taksat dhe tarifat vendore (lista e veprimeve të ndryshimeve sipas natyrës së veprimit).
- Nuk administrohen në dosjet e subjekteve proces-verbale sa i përket ndryshimeve që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat/pagesat e detyrimeve mbi taksat dhe tarifat vendore *(Credit Note).*
- Nuk ka bashkëveprim me burimet njerëzore për procedurën që ndiqet për përdorues të cilët janë punësuar rishtaz, larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturën organizative lidhur me ruajtjen e të dhënave përsonale për regjistrin elektronik që ata kanë marrë në administrim.
- Nuk ka një rregullore të brendshme apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë regjistër elektronik.
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga regjistri elektronik me formatet e përpunuara nga përdoruesit.
- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format excel dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.
- Drejtoritë/Sektorët të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk administrojnë regjistër për manaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifat që administron (Sipas strukturës së Paketës Fiskale). Këto drejtori nuk rakordojnë me DTTV-në lidhur me realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 4, datë 29.01.2025, me objekt "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025", dhe kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Memaliaj për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni

5, neni 11; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika "ç"; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" nenin 3; Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "Për sigurinë kibernetike" neni 4; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave"; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, nenet 2, 3, 5, 6, 20, 27, 28; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore" i ndryshuar; Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit", (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.07.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pikën 4, "Kërkesat e sigurisë" shkronja b, të "Rregullores për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pikën 4, gërma "a", të "Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike", miratuar me Urdhrin nr. 109, datë 10.06.2016, të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); Manualin e Auditit të Brendshëm të miratuara me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, pika 2.4.4.

c. *Taksat dhe tarifat vendore të aplikuara dhe të arkëtuara nga Bashkia Memaliaj:*

Përgjatë vitit 2025, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:

- Paketa Fiskale për vitin 2025 është miratuar me VKB-në nr. 4, datë 27.01.2025, me objekt *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025"*, duke marrë edhe njëkohësisht konfirmimin mbi besueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 97/1 prot., datë 04.02.2025.
- Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Memaliaj, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur rreth 24 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2025 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Memaliaj dhe Njësitë Administrative Memaliaj Fshat, Lutfinjë, Buz, Krahës dhe Qesarat, ndahen në 4 kategori:

1. *Biznes;*
2. *Familjarë;*
3. *Institucione;*

Kategoritë e mësipërme *(përjashtuar institucionet)* ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës dhe tarifës që aplikohet konkretisht:

- Kategoria e Parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël;
- Kategoria e tretë për efekt të taksave dhe tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi apo përdorim tokë bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalidë etj.,.

Llojet e subjekteve mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr.	Lloji	2025
1	Biznes i Madh	**10**
2	Biznes i Vogël	**122**
3	Institucione	**7**
4	Familje	**616**

Planifikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Nr.	Emërtimi i të Ardhurave				
A	Të ardhura nga taksat	Plani	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Taksë biznesi	0	0	0	-

2	Taksë mbi pasurinë e paluajtshme (Ndërtesa)	3,400,000	1,833,882	1,566,118	53.9
3	Taksë mbi tokën bujqësore	4,700,000	3,626,704	1,073,296	77
4	Taksë trualli	400,000	279,527	120,473	69.8
5	Taksë tregu	300,000	218,690	81,310	72.8
6	Taksë efekti në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	2,000,000	1,364,288	635,712	68.2
7	Taksë regjistrimi automjeti	3,600,000	6,018,815	(2,418,815)	167
8	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	200,000	35,000	165,000	17.5
9	Taksë tabele	300,000	122,880	177,120	40.9
10	Taksë studimi urbanistik	0	0	0	-
11	Tatimi vendor mbi xhiron e hoteleve dhe resorteve	0	0	0	-
Totali A		**14,900,000**	**13,499,786**	**1,400,214**	**90.6**
B	**Të ardhura nga tarifat**	**Plani**	**Fakti**	**Diferenca**	**Realizimi në %**
1	Tarifë pastrimi	5,000,000	3,892,140	1,107,860	77.8
2	Tarifë gjelbërimi	500,000	362,468	137,532	72.4
3	Tarifë ndriçimi	1,300,000	1,152,643	147,357	88.6
4	Tarifë leje transporti	300,000	125,190	174,810	41.7
5	Tarifë parkimi	200,000	110,300	89,700	55.1
6	Tarifë qira tokë bujqësore	1,000,000	311,234	688,766	31.1
7	Tarifë për objektet me qira	200,000	205,920	(5,920)	102.9
8	Tarifë qira trualli për antenat	2,000,000	2,065,877	(65,877)	103.2
9	Tarifë zënie hapësire publike	200,000	0	200,000	0
10	Të tjera tarifa (nga shitje mallrash)	700,000	53,755	646,245	7.6
11	Të tjera të ardhura	800,000	152,646	647,354	19
12	Tarifë për dru zjarri	500,000	190,700	309,300	38
13	Të ardhura nga shërbimet e MSHZ	0	1,000	(1,000)	-
14	Tarifë për kullotat	700,000	0	700,000	0
15	Tarifë për shtypshkrimet	100,000	14,500	85,500	14.5
16	Tarifë për shërbim varrimi	0	120,000	(120,000)	-
17	Sponsorizimet	0	500,000	(500,000)	-
18	Kamatë vonesa	0	64,014	(64,014)	-
19	Tarifë ushqimi nga kopshtet	800,000	637,880	162,120	79.7
20	Të tjera tatime mbi të ardhurat mbajtur në burim	4,000,000	5,522,279	(1,522,279)	138
21	Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	0	9,000	(9,000)	-
22	Tarifë për paisje me qira	0	340,000	(340,000)	-
23	Tarifë liçenca për shoqëri private	0	1,000,000	(1,000,000)	-
24	Të tjera taksa për shitjen e pasurive të paluajtshme	0	14,317	(14,317)	-
Totali B		**18,300,000**	**16,845,863**	**1,454,137**	**92**
Grand Totali A + B		**33,200,000**	**30,345,649**	**1,854,351**	**91.4**

Për vitin 2025 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë planifikuar në vlerën **33,200,000 lekë** dhe janë realizuar në vlerën **30,345,649 lekë** në masën **91.4%** me një diferencë mos realizimi ndërmjet planit dhe faktit në vlerën **2,854,351 lekë.**

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

- *"Taksë regjistrimi automjeti"* është planifikuar në vlerën 3,600,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 6,018,815 lekë ose realizuar në masën 167%.
- *"Të tjera tatime mbi të ardhurat mbajtur në burim"* është planifikuar në vlerën 4,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,522,279 lekë ose realizuar në masën 138%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- *"Tarifë pastrimi"* është planifikuar në vlerën 5,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,892,140 lekë ose realizuar në masën 77.8%.
- *"Tarifë gjelbërimi"* është planifikuar në vlerën 500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 362,468 lekë ose realizuar në masën 72.4%.
- *"Tarifë ndriçimi"* është planifikuar në vlerën 1,300,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,152,643 lekë ose realizuar në masën 88.6%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.

Nga DTTV-ja nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.
Në këtë konteks është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Memaliaj që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II, pika 2, gërma "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.

***<u>ç.</u>** Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Memaliaj sipas kategorive të tyre:*
Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, si dhe të trashëguara nga vitet e mëparshme:

Lekë

Nr.	Lloji i taksës dhe tarifave vendore	Gjendja më datë 31.12.2024	Shtesë gjatë vitit 2025	Pakësime gjatë vitit 2025	Gjendja më datë 31.12.2025
1	Trashëguar nga ish-komunat	19,352,193	0	0	19,352,193
2	Biznesi i madh	657,055	1,150,272	1,186,147	621,180
3	Biznesi i vogël	2,895,268	3,043,915	2,385,606	3,553,577
4	Institucione	89,753	505,100	120,353	474,500
5	Familjar	1,930,336	864,171	210,129	2,584,378
6	Taksë ndërtesë + truall	3,777,797	1,452,000	1,357,527	3,872,270
7	Taksa e tokës bujqësore	16,226,024	5,037,824	2,877,585	18,386,263
8	Tokë bujqësore me qira	5,090,085	2,017,562	1,456,302	5,651,345
9	Objekte me qira	339,300	250,000	145,920	443,380
10	Shërbim taxi	9,650	28,400	9,650	28,400
11	Taksë ndikimi në infrastrukturë për legalizimin	67,203	103,459	0	170,662
12	Tarifa e linçecimit për karburantet	1,400,000	200,000	0	1,600,000
Totali		**51,834,664**	**14,652,703**	**9,749,219**	**56,738,148**

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën sa më sipër konstatohet se, në mënyrë të përmbledhur vlera e detyrimit tatimor të vlerësuar, për taksa dhe tarifa vendore (gjelbërim, pastrim, ndriçim, ndërtesë, truall, toka bujqësore, ndikim në infrastrukturë, reklamë, tabelë, zënie të hapësirës publike, liçencim i karburanteve) më datë 31.12.2024, në vlerën 51,834,664 lekë, përgjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në vlerën 14,652,703 lekë dhe pakësime në vlerën 9,749,219 lekë ndërsa **gjendja progresive më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 56,738,148 lekë.** Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtim e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

***<u>d.</u>** Mënyra e përllogaritjes së taksave dhe tarifave vendore të aplikuara nga Bashkia Memaliaj për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025:*
<u>I.</u> *Kategoria "Biznes" dhe "Institucione":*
Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore u konstatua se:

- Në fund të vitit 2024 gjendja debitore për *biznesin e vogël* paraqitet në vlerën 2,895,268 lekë. Përgjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në vlerën 3,043,915 lekë dhe pakësime në vlerën 2,385,606 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja debitore progresive për 48 subjekte paraqitet në vlerën 3,553,557 lekë.
- Në fund të vitit 2024 gjendja debitore për *biznesin e madh* paraqitet në vlerën 657,055 lekë. Përgjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në vlerën 1,150,272 lekë dhe pakësime në vlerën 1,186,147 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja debitore progresive për 48 subjekte paraqitet në vlerën 621,180 lekë.
- Në fund të vitit 2024 gjendja debitore për *institucionet* paraqitet në vlerën 89,753 lekë. Përgjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në vlerën 505,100 lekë dhe pakësime në vlerën 120,353 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja debitore progresive për 48 subjekte paraqitet në vlerën 474,500 lekë.

dh. *Të dhënat mbi regjistrimin e subjekteve tatimpaguese dhe situatën e statusit të subjekteve aktiv dhe të mbyllur.*

Sipas të dhënave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore gjendja e subjekteve të biznesit privat që ushtrojnë aktivitet në territorin në juridiksionin e Bashkisë Memaliaj paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim të vitit 2025	Regjistrimet e reja	Mbyllur Aktivitetin	Gjendja në fund të vitit 2025
1	Biznesi i vogël	2025	117	9	4	122
2	Biznesi i Madh	2025	10	0	0	10
Gjithsej		**2025**	**127**	**9**	**4**	**132**

Nga të dhënat e pasqyrës më sipër, u konstatua se për periudhën objekt auditimi evidentohen 9 regjistrime të reja biznes i vogël dhe janë mbyllur 4 të tilla duke arritur në 122 subjekte biznes i vogël.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore dhe në bazë të korrespodencës u konstatua se ekzistojnë subjekte të pa liçencuara (QKB), të cilat janë evidentuar nga verifikimet në terren. Për vitin 2025 në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Memaliaj operojnë dhe ushtrojnë aktivitet 13 subjekte të biznesit të pa regjistruar në QKN, për të cilët nuk janë ndjekur procedurat ligjore për detyrimin e tyre për liçencimin dhe pagesën e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore, e për pasojë nuk kanë qenë objekt i taksave dhe tarifave vendore, duke sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritje vetëm për tarifën e pastrimit vlerën 9,100 lekë, ndriçimit vlerën 4,000 lekë, gjelbërimit vlerën 2,200 lekë, ndërtesë vlerën 900 lekë dhe truall vlerën 240 lekë (duke aplikuar tarifat më të ulta në vlerë), për subjektet e pataksuara, do të kishim 16,440 lekë * 13 subjekte mesatarisht **213,720 lekë duke krijuar të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Memaliaj.**

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 16.

Lista e subjekteve që ushtrojnë aktivitet biznesi të paregjistruar në QKB paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër	Mbiemër	Lloji i aktivitetit
1	V.	L.	Shërbime
2	L.	G.	Shitje me pakicë
3	L.	Sh.	Shitje me pakicë
4	F.	Gj.	Këpucar
5	Q.	Xh.	Këpucar
6	K.	K.	Rrobaqepës
7	N.	H.	Shitje me pakicë
8	E.	C.	Parukeri
9	E.	E.	Bar kafe
10	B.	M.	Shitje me pakicë
11	Y.	M.	Shitje me pakicë
12	A.	S.	Shitje me pakicë
13	N.	H.	Kasap

e. *Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:*

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit të aplikuar për vitin 2025 nga Bashkia Memaliaj të miratuar me VKB-në nr. 12, datë 28.02.2023, me objekt *"Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Memaliaj"*, neni 31 *"Përgjegjësi i Sektorit"*, është caktuar si personi i cili ka për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga Agjentët Tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta. Të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (ASHK Gjirokastër për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Gjirokastër, Drejtorinë e Shërbimit dhe Transportit Rrugor Gjirokastër dhe Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Memaliaj dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Tepelenë duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga Agjentët Tatimorë paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Lekë

Nr.	Agjenti Tatimorë	Lloji i taksës	Vlera e arkëtuar për vitin 2025
1	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	35,000
2	DSHTRR Gjirokastër	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	6,018,815
3	ASHK Gjirokastër	Taksa e kalimit të pronësisë	1,437
4	SHRUKGJ	Taksë ndërtese/tarifa shërbimi	2,549,964
Totali			**8,618,096**

a) Agjenti tatimor i ngarkuar për vjeljen e taksave dhe tarifave për abonentët familjarë në Bashkinë Memaliaj është caktuar Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër për vitin 2025 dhe paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve pranë sporteleve të SHRUKGJ dhe Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore në Njësitë Administrative përkatëse. Për realizimin e këtij shërbimi ndërmjet palëve është nënshkruar akt-marrëveshja protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 170 prot., datë 20.01.2025, dhe në SHRUKGJ me nr. 177 prot., datë 24.01.2025. Në rolin e agjentit tatimor SHRUKGJ përfiton një komision prej 4% të shumës së arkëtuar. Pjesë e faturimit dhe arkëtimit për llogari të Bashkisë Memaliaj përfshihen taksat dhe tarifat e mëposhtme:

- *Taksë trualli;*
- *Taksë ndërtese;*
- *Tarifë pastrimi;*
- *Tarifë ndriçimi;*
- *Tarifë gjelbërimi*
- *Taksa dhe tarifave vendore për Njësitë Administrative sipas Paketës Fiskale.*

Në tabelën më poshtë pasqyrohen detyrimet dhe likuidimet e kryera për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025:

Lekë

Nr.	Muaji	96 % për Bashkinë	4% për SHRUKGJ	Totali 100%	Data e likuidimit	Diferenca
1	Janar	76,066	3,169	79,235	04.03.2025	0
2	Shkurt	143,651	5,985	149,636	04.04.2025	0
3	Mars	261,527	10,897	272,424	09.05.2025	0
4	Prill	251,522	10,480	262,002	22.05.2025	0
5	Maj	255,231	10,635	265,866	07.07.2025	0
6	Qershor	244,126	10,172	254,298	01.08.2025	0
7	Korrik	254,897	10,620	265,517	27.08.2025	0
8	Gusht	262,502	10,937	273,439	24.09.2025	0
9	Shtator	254,932	10,622	265,554	22.10.2025	0
10	Tetor	236,143	9,839	245,982	27.11.2025	0
11	Nëntor	237,564	1,666	239,230	19.12.2025	0
12	Dhjetor	71,803	2,991	74,794	27.01.2026	0
Totali		**2,549,964**	**98,013**	**2,647,977**		**0**

b) Agjenti tatimor i ngarkuar për vjeljen e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin nga biznesi i vogël është Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër ku për kryerjen e këtij shërbimi përfiton 1% të vlerës së tarifuar. Për vitin 2025 nga Bashkia Memaliaj disponohet një akt-rakordim vjetor i mbajtur më datë 12.12.2025.

c) Agjenti i tatimor i ngarkuar për vjeljen e taksës vjetore për mjetet e përdorura është DSHTRRGJ, për vitin 2025 janë mbajtur akt-rakordimet si më poshtë:

Lekë

Nr.	Muaji	Numër Mjetesh	Vlera TVMP e plotë	Të ardhura për Bashkinë – 25% të TVMP	Data e likuidimit
1	Janar	89	1,213,868	288,294	18.02.2025
2	Shkurt	81	1,033,448	245,444	18.03.2025

3	Mars	62	1,047,180	248,705	24.04.2025
4	Prill	63	1,039,092	246,784	19.05.2025
5	Maj	76	941,499	223,606	19.06.2025
6	Qershor	74	1,069,654	254,043	18.07.2025
7	Korrik	100	1,279,729	303,936	18.08.2025
8	Gusht	105	1,532,830	364,047	16.09.2025
9	Shtator	90	1,123,208	266,762	28.10.2025
10	Tetor	109	1,293,611	307,233	25.11.2025
11	Nëntor	84	1,332,624	316,498	30.12.2025
Totali		**933**	**12,906,743**	**3,065,351**	

Shënim: *Në këtë akt-rakordimet mujore me DSHTRRGJ nuk është përfshirë muaji dhjetor, por referuar realizmit i të ardhurave bazohet në akt-rakodimin me Degën e Thesarit Tepelenë ku vlera e arkëtuar është 6,018,815 lekë.*

d) Për vitin 2025 ndërmjet DTTV-së Bashkisë Memaliaj dhe ASHK Gjirokastër nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë realizimi. Bashkia Memaliaj nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

ë. *Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi:*

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet shkresore të dërguara nga Drejtoria Vendore e AShK-së Gjirokastër dhe Drejtoria Vendore e AShK-së Tepelenë, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2025, i paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj. Nga DVAShK Gjirokastër dhe DVAShK Tepelenë, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë u konstatua se, nga Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës nuk është zbatuar pika 5 në Paketën Fiskale të Bashkisë Memaliaj të miratuar me Vendimin nr. 4, datë 27.01.2025, të Këshillit Bashkiak, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2025, nuk janë marrë masat e duhura për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër situata ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI-së, u konstatua se, për sa i përket arkëtimit të kësaj takse për debitorët e rezultuar deri më datë 31.12.2024, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës dhe Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mos pagesës së TNI, të ndjekin procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj.,) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitore progresive dhe e ndarë sipas viteve.

Lekë

Nr.	**Debitor TNI**	**Subjekte**	**Vlera**
1	Deri më datë 31.12.2024	3	67,203
2	Deri më datë 31.12.2025	25	103,459
Totali Progresiv		**28**	**170,662**

Lekë

Nr.	**Emër**	**Mbiemër**	**Shuma e TNI**	**Paguar**	**Debitor**
Debitorë të mbartur nga viti 2024					
1	N.	Z.	23,483	0	23,483
2	H.	K.	17,612	0	17,612
3	A.	H.	26,108	0	26,108
Totali A			**67,203**	**0**	**67,203**
Debitorë të krijuar përgjatë vitit 2025					
1	B.	D.	5,545	0	5,545
2	B.	J.	9,785	0	9,785
3	P.	Sh.	6,147	0	6,147
4	Sh.	M.	3,100	0	3,100
5	Gj.	D.	12,556	0	12,556

6	Y.	H.	32,290	0	32,290
7	S.	Ç.	16,310	0	16,310
8	A.	B.	9,246	0	9,246
9	A.	M.	8,480	0	8,480
10	S.	B.	22,000	22,000	0
11	A.	B.	8,969	8,969	0
12	B.	K.	17,938	17,938	0
13	Y.	D.	47,950	47,950	0
14	L.	C.	16,650	16,650	0
15	B.	O.	2,800	2,800	0
16	F.	K.	12,890	12,890	0
17	L.	J.	18,750	18,750	0
18	J.	H.	26,100	26,100	0
19	K.	B.	14,100	14,100	0
20	V.	S.	7,850	7,850	0
21	P.	Th.	6,686	6,686	0
22	E.	S.	1,141	1,141	0
23	P.	M.	3,920	3,920	0
24	H.	K.	17,612	17,612	0
25	Sh.	L.	21,950	21,950	0
Totali B			**350,765**	**247,306**	**103,459**
Totali A + B			**417,968**	**247,306**	**170,662**

Nga auditimi u konstatua se, gjendja debitore për mos likuidimin e TNI më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 67,203 lekë për tre individë. Përgjatë vitit 2025 janë pajisur me leje legalizimi 25 individë për të cilët është përllogaritur vlera 417,968 lekë për TNI, ku vetëm 16 individë kanë likuiduar vlerën 247,306 lekë si dhe 9 individë kanë mbetur debitorë në vlerën 103,459 lekë. Situata debitore progresive më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën **170,662 lekë.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.20106, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave vendore" i ndryshuar, neni 27 dhe Paketa Fiskale miratuar me VKB-në nr. 4, datë 27.01.2025, me objekt "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025", pika 5.

f. *Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Memaliaj:*

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Memaliaj mbi arkëtimin e taksës së Licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, në zbatim të legjislacionit në fuqi:
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar;
- VKM nr. 212, datë 16.03.2016, "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)";
- VKB-të për miratimin e Paketës Fiskale;
- Referuar të dhënave nga databaza e Inspektoratit Shtetërore Teknik Industrial (Institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Memaliaj dhe në Njësitë Administrative, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore, struktura e cila lëshon autorizimet për tregtimin e karburantit me pakicë të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, vendosi në dispozicion të grupit të auditimit dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë:

Lekë

Nr.	Subjekti	Adresa ku ushtron aktivitet sipas QKB	Afati i autorizimit		Detyrimi 31.12.2024	Detyrimi i krijuar 2025	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi				
1	G. O.	Rr. Tepelenë-Memaliaj Pranë Urës	30.05.2025	30.05.2030	0	1,000,000	1,000,000	0

2	K. ShPK	Rr. Ish Fabrika e Fosforit Memaliaj	15.04.2022	15.04.2027	0	0	0	0
3	R. ShPK	Rr. Tepelenë-Levan Qesarat	-	-	1,600,000	200,000	0	1,800,000
4	L. ShPK	Rr. Tepelenë-Levan Krahës	-	-	1,600,000	200,000	0	1,800,000
Shuma					3,200,000	1,400,000	1,000,000	3,600,000

Shënim: *Subjekti "K." ShPK e ka likuiduar të gjithë vlerën prej 1,000,000 lekë në vitin 2022, e cila i përket autorizimit me afat nga data 15.04.2022, deri më 15.07.2027.*

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër evidentohet se, në territorin e Bashkisë Memaliaj për vitin 2025 ushtrojnë aktivitet 4 subjekte. Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre u konstatua se, në fund të vitit 2025 janë debitorë 2 subjekte për të cilën Bashkia Memaliaj u ka përllogaritur vlerën e detyrimit gjithsej 3,600,000 lekë nga të cilat vlerën 400,000 lekë po përgjatë këtij viti për këto 2 subjekte. Konkretisht subjektet janë:

1. OE "G. C.." ShPK me Nipt K... me adresë Rruga Tepelenë Memaliaj pranë Urës i pajisur me Autorizimin nr. 1227/2 prot., datë 30.05.2025, me afat nga data 30.05.2025, deri më 30.05.2030, me objekt "Për tregtimin me pakicë të karburanteve e produkteve Bezinë Kategoria II/A, Gazoil Kategoria III/A dhe GLN Kategoria I/A", për të cilën nga DTT-ja është lëshuar fatura për arkëtim e datës 26.05.2025, në vlerën 1,000,000 lekë (përfshin afatin 5 vjeçar të autorizimit) duke u likuiduar sipas transaksionit të Degës së Thesarit Tepelenë sipas Kodit 7111021 më datë 29.05.2025.

2. OE "K." ShPK me Nipt L... me adresë Rruga Tepelenë-Memaliaj ish-Fabrika e Fosforit i pajisur me Autorizimin nr. 663 prot., datë 15.04.2022, me afat nga data 15.04.2022, deri më 15.04.2027, me objekt "Për tregtimin me pakicë të karburanteve për kategorinë e produkteve Naftë, Benzinë dhe Gaz", për të cilën nga DTT-ja është lëshuar fatura për arkëtim e datës 11.04.2022, në vlerën 1,000,000 lekë (përfshin afatin 5 vjeçar të autorizimit) duke u likuiduar sipas transaksionit të Degës së Thesarit Tepelenë sipas Kodit 7111021 më datë 08.05.2022.

3. OE "L." ShPK me Nipt K... me adresë Rruga Nacionale Tepelenë-Levan Krahës me objekt aktiviteti "Shitje ma pakicë e karburanteve si Gazoil, Benzinë, Benzol etj.,", ka ushtruar aktivitet pa liçencë për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025.

- Me shkresën nr. 1798 prot., datë 21.09.2023, Bashkia Memaliaj është adresuar Njësisë Administrative Krahës me kërkesë mbi vendosjen e dosjes së subjektit "L." ShPK;
- Me shkresën nr. 104/1 prot., datë 04.10.2023, Njësia Administrative Krahës ka dërguar pranë Bashkisë Memaliaj dosjen e subjektit "L." ShPK, në të cilën përfshihet dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Ekstrakti Historik mbi gjendjen e regjistrimit të datës 27.09.2016;
b) Gjendja e regjistrimit QKB e datës 25.11.2020;
c) Njoftimi debitor ndaj Bashkisë Memaliaj shkresa me nr. 76 prot., datë 27.05.2022;
d) Njoftim detyrimi shkresa nr. 62 prot., datë 21.07.2023, në vlerën totale prej 1,276,747 lekë nga të cilat vlera prej 119,600 lekë i përket vitit 2023;

Për vjeljen e detyrime ndaj subjektit "L." ShPK janë ndjekur këto hapa:

- Me shkresën nr. 1776 prot., datë 19.09.2023, Bashkia Memaliaj është drejtuar për bllokimin e llogarisë bankare të subjektit "L." ShPK, Bankave të Nivelit të Dytë si: R. B., B.. dhe O. B. dhe për dijeni Bankës së Shqipërisë, QKB Tiranë.
- Me shkresën nr. 1776/3 prot., datë 23.11.2023, Bashkia Memaliaj është drejtuar për bllokimin e llogarisë bankare të subjektit "L." ShPK, Bankave të Nivelit të Dytë si: R. B., A. B., T. B., P. C. B., I. S. P. B., C. B., F. I. B. A. dhe U.. B.;
- Në vijim të kërkesës me shkresën nr. 2521 prot., datë 04.12.2023, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve pranë MIE-së i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 604 prot., datë 18.01.2024, Bashkisë Memaliaj me atë të së cilës ka kërkuar nga ISHTI nëpërmjet shkresës nr. 9484/1 prot., datë 22.12.2023, kryerjen e një inspektimi për subjektin në fjalë, ku bashkëlidhur ndodhet edhe dokumentacioni përkatës.

Me shkresën nr. 11141/5 prot., datë 10.01.2024, të ISHTI-t administruar pranë MIE-së me praktikën nr. 9484/2 prot., datë 12.01.2024, evidentohet praktika e ndjekur mbi verifikimin në terrem ku ndër të tjera citohet se:

Më datë 08.01.2024, Inspektorët e ISHTI-t të pajisur me Autorizim për Inspektim nr. 1114/3 prot., datë 08.01.2024, kanë inspektuar stacionin e shitjes me pakicë të karburanteve "L." ShPK me Nipt K... me vendndodhje rruga Memaliaj-Levan, Krasë ku rezulton se subjekti i lartë përmendur nuk është i pajisur me Liçencë për tregtimin me pakicë të karburanteve.
Për shkeljet e konstatuara, ndaj subjektit "L." ShPK është vendosur sanksioni me gjobë në zbatim të Ligjit nr. 8450/1999, i ndryshuar. Bashkëlidhur kopje e dokumentacionit të mbajtur:
1. Autorizim Inspektimi Jashtë Programit nr. 11141/3 prot., datë 08.01.2024;
2. Listë Verifikimi nr. ISHTI-DQ-2024-000493-2, datë 08.01.2024;
3. Procesverbal Inspektimi nr. ISHTI-DQ-2024-000493-2, datë 08.01.2024;
4. Vendimi Përfundimtar i Inspektimit nr. ISHTI-DQ-2024-000493-5, datë 08.01.2024.
4. OE "R." ShPK me Nipt L... me adresën Rruga Nacionale Tepelenë-Velan Qesarat me objekt aktiviteti "Tregti me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikantë, lavazh", ka ushtruar aktivitet pa liçencë për peirudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025.
- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit u konstatua se, Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore përgjatë vitit 2025 nuk është drejtuar me shkresë subjektit "R." ShPK për pajisjen me liçencë për ushtrim aktviteti;
- Gjithashtu përgjatë vitit 2025 nuk ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet DTTV-së dhe Policisë Bashkiake, për penalizimin e këtij subjekti i cili nuk është i pajisur me liçencë për ushtrim aktiviteti në tregtimin e karburanteve;
- Nuk administrohen masa shtrënguese (bllokim të llogarive bankare);
- Përgjatë vitit 2025 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial dhe Ministrininë e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë për subjektin në fjalë, i cili ushtron aktivtet pa liçencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1, të Kreut II në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017;

Si konkluzion: Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese përgjatë vitit 2025 nga ana e struktura përgjegjëse të institucionit, në territorin e Bashkisë Memaliaj kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të hidrokarbureve dhe derivateve të tyre pa u pajisur me liçencë dhe njëkohësit nuk kanë kryer pagesën e tarifës së liçencimit kanë shkaktuar efekt financiar duke krijuar të ardhura të munguara për Bashkinë Memaliaj.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, neni 89, pika 2, neni 131, pika 1, gërma "b" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, Kreu II, Pika 15.1.

g. *Kategoria e familjarëve:*
Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Memaliaj dhe NjA, për vitin 2025 janë taksuar 3,195 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NjA, pasqyrohen si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Numri i familjeve të tarifuara	Familje të përjashtuara nga tarifimi	Nr. i familjeve sipas regjistrit civil
1	Qytet Memaliaj	1,177	816	2,484
2	Krahes + Qesarat	988	0	2,068
3	Fshat Memaliaj	746	0	916
4	Luftinj + Buz	1,100	0	1,506
Totali		**4,3011**	**816**	**6,974**

Me qëllim vlerësimin nëse nga Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore Bashkia Memaliaj është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë "familjar", u kryqëzua informacioni i administruar nga Sektori i Financës dhe Tatimeve Bashkia Memaliaj me informacionin e administruar nga Gjendja Civile.

Sipas gjendjes civile në Bashkinë Memaliaj dhe Njësitë Administrative janë 6,946 familje, ndërkohë që për vitin 2025 janë taksuar 3,195 familje si dhe janë të përjashtuar 816 familje si pasojë e përfitimit të lehtësirave nga Paketa Fiskale.
Vlen të theksohet për Takës e "Ndërtesë + Truall" nuk është kryer faturimi i plotë ku janë shmangur 2,147 abonentë familjarë në vlerën totale prej **854,560 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.**
Përllogaritja nga Grupi i Auditimit është kryer si më poshtë:
- Në zbatim të VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018, *"Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategoritë specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës"*, janë kryer veprimet si më poshtë:

Për qytetin

- Vlera prej 15,000 lekë përcaktuar nga EKB * 0.05% çmimi i referencës * 75 sipërfaqja në m^2 = 560 lekë;

Për fshatin

- Vlera prej 9,750 lekë përcaktuar nga EKB * 0.05% çmimi i referencës * 75 sipërfaqja në m^2 = 340 lekë;

Lekë

Nr.	Emërtimi	Nurmi i familjeve	Numri Regjistri Civil	Të përjashtuar	Familje të pa taksuara	Vlera e taksës	Vlera e pa përllogaritur
1	Qytet Memaliaj	1,177	2,484	1,668	491	560	274,960
2	Krahes + Qesarat	746	916	0	170	350	59,500
3	Fshat Memaliaj	988	2,068	0	1,080	350	378,000
4	Luftinj + Buz	1,100	1,506	0	406	350	142,100
Totali		**4,011**	**6,974**	**1,668**	**2,147**		**854,560**

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit dhe taksën e ndërtesës.

Lekë

Emërtimi	Gjendja debitore më datë 31.12.2024		Krijuar përgjatë vitit 2025		Gjendja në fund të vitit 2025
Familjarët	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Vlerë
	437	1,930,366	318	864,171	2,794,537

- Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2025 në mënyrë progresive janë abonentë familjarë në vlerën 2,794,537 lekë nga të cilat janë krijuar përgjatë vitit 2025, 318 abonentë familjarë në vlerën 864,171 lekë.
- Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se vlera debitore e kategorisë "Familjar" për taksat dhe tarifat vendore, në krahasim me fundin e vitit 2024 është rritur me 864,171 lekë, ç'ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.
- Sa i përket familjeve debitore, konstatohet se nga Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitore. Gjithashtu ndaj Bashkisë Memaliaj rezulton të jetë debitor UK Memaliaj si pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër për vitin 2025 në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë "Familjar".

Detyrimi që ka SHRUKGJ në fund të vitit 2025 (në rolin e agjentit tatimor) ndaj Bashkisë Memaliaj është në vlerën prej 1,125,309 lekë. Nga DTTV Bashkia Memaliaj për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor SHRUKGJ, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë "Familjar".

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pika 3, nenin 4, pikat 1-2, Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 42, pika 2, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, pika 3, neni 76, neni 89, pika 2, neni 117 dhe Udhëzimin nr. 17, datë 20.06.2022, "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore", Kreu III.

gj. *Taksa e tokës bujqësore:*

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore dhe nga NjA konstatohet se se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 4501 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 4539 ha, të cilat të ndara sipas kategorisë së tokës dhe Njësive Administrative paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Nr. fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqj e tokës së ndarë në HA	Sipërfaqja e tokës së dhënë me qira	Nr. i familjeve të trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
1	Komuna Krahës	10	1102	-	998
2	NjA Luftinjë	15	1037	-	1,201
3	Komuna Buz	13	1043	41	825
4	Komuna Qesarat	7	681	108	741
5	Komuna Fshat Memalij	1	676	10.6	746
Totali		**41**	**4539**	**159.6**	**4,501**

Planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme të sipërfaqes së tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere, informacion i cili i dërgohet nga NjA DTT në fazën e përgatitjes së buxhetit. Këto të dhëna nuk janë të sakta, edhe për faktin se ka mosrakordim të dhënash në mes të dhënave të NjA dhe të dhënave që disponon DTT. Planifikimi i të ardhurave sipas Bashkisë Memaliaj për vitin 2025 i taksës së tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Nr.	Kategorite e tokës	SIP/HA Bashkia Memaliaj	SIP/HA NJ.A Krahes	SIP/HA Qesarat	SIP/HA Buz	SIP/HA NJ.A Mem Fshat	SIP/ HA Luftinje	Vlera/HA	Plani
1	Kategoria 2								
2	Kategoria 3	339	25	102	22	135	55	1,400	474,600
3	Kategoria 4	407	42	98	25	95	147	1,350	549,450
4	Kategoria 5	504	174	96	48	77	110	1,250	631,250
5	Kategoria 6	560	190	70	87	63	150	1,200	672,000
6	Kategoria 7	1,114	340	56	420	16	282	1,100	1,225,400
7	Kategoria 8	1,043	331	50	441	14	207	1,100	1,147,300
Totali		**3,967**	**1102**	**472**	**1043**	**400**	**951**		**4,700,000**

Për marrjen e të dhënave të sakta mbi sipërfaqen e tokës së shpërndarë në disponim të fermerëve dhe të asaj në pronësi të Bashkisë u kërkua korrespondenca zyrtare e Bashkisë Memaliaj me Këshillin e Qarkut Gjirokastër cila nuk ekzistonte. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës konstatohet se, nga NjA disponohen regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere. Duhet theksuar se nuk kishte një përditësim të këtyre regjistrave në 10 vitet e fundit, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, nenet 23-24, dhe Ligji nr. 68/2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 12, pika 1. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për taksën e tokës bujqësore.

Lekë

Taksa e tokës bujqësore	Në fund të vitit 2024		Krijuar brenda vitit 2025		Në fund të vitit 2025	
	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlerë
Totali	1,961	16,226,024	528	2,160,239	2,489	18,386,263

Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2024 në mënyrë progresive vlera debitore është 16,226,024 lekë dhe në fund të vitit 2025 në mënyrë progresive janë 2,589 familje debitorë për vlerën 18,386,263 lekë, nga të cilat, në vitin 2025 është krijuar 2,160,239 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2024, në fund të vitit 2025 kemi rritje të vlerës debitore për taksën e tokës bujqësore, ç'ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e kësaj takse. Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitore.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pika 3, neni 4, pikat 1-2, nenet 20-24, Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 42, pika 2, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, pika 3, nenin 76, neni 89, pika 2, neni 117 dhe Udhëzimin nr. 17, datë 20.06.2022, "Për përcaktimin e uniformitetit

minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore", Kreu III.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë dhe **znj. V. Xh.** Specialist Tatimesh Qytet Memaliaj, **znj. A. I.** Specialist Tatimesh Qytet Memaliaj.

2.3. Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025:

2.3.1. *Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.*

2.3.2. *Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.*

2.3.3. *Invetarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.*

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Memaliaj për vitin 2025 (në të cilat përfshihen pasqyrat financiare ushtrimore të Bashkisë Memaliaj të depozituara pranë Degës së Thesarit Tepelenë me shkresën nr. 878 prot., datë 31.03.2026, dhe konfirmuar nga DTH Tepelenë me shkresën nr. 111 prot., datë 31.03.2026, dhe të Drejtorisë së Shërbimeve të depozituara pranë Degës së Thesarit Tepelenë me shkresën nr. 86 prot., datë 27.03.2026, dhe konfirmuar nga DTH Tepelenë me shkresën nr. 110 prot., datë 27.03.2026) janë të nënshkruara nga z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. B. C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Tepelenë me shkresën e datës 31.03.2026, dhe konfirmuar nga DTH Tepelenë me shkresën nr. 878/1 prot., datë 31.03.2026, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i

mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në E. dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar.

Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,.

Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Memaliaj për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.** Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2025:

Bashkia Memaliaj 2025, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për t'u shqyrtuar**
Paga (600)	195,533	0.70	25
Sigurime Shoqërore (601)	31,649	0.70	4
Mallra e Shërbime (602)	53,609	0.70	7
Investime të brendshme (230-231)	58,430	2.00	21
Të tjera transferime korrente (606)	0	0.70	0
Total	**339,221**		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	**6,784**		
Kalkulimi i precizionit	0		
Materialiteti	**6,784**		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	678		
Nëntotali	**6,106**		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	**5,495**		
Bashkia Memaliaj 2025, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për t'u shqyrtuar**
Të ardhurat nga buxheti	0	0.70	0
Të ardhurat e veta	30,345	0.70	43
Total	**30,345**		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	**607**		
Kalkulimi i precizionit	0		
Materialiteti	**607**		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	61		
Nëntotali	**546**		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	**492**		

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet invetarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", Pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,.

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 215, datë 16.10.2025, me objekt "Për kryerjen e inventarit të vlerave materiale monetare", konkretisht:

1. Kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale në institucionet që mbulohen nga Bashkia Memaliaj si më poshtë:

- Në shkollën e mesme “Sali Nivica”;
- Në shkollën 9 vjeçare “Nimete Progonati”;
- Në kopshtin e fëmijëve;
- Në pallatin e kulturës;
- Në administratën e bashkisë;
- Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.,.

2. Për kryerjen e inventarizimit të materialeve të institucioneve të mësipërme është ngritur grupi i punës i përbërë nga: z. M. D. kryetar dhe anëtarët znj. L. Ç., znj. A. I., z. E. H., z. A. D.
3. Kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale në institucionet që mbulohen nga Njësitë Administrative si më poshtë:

- Njësia Administrative Lutfinjë, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.,.;
- Njësia Administrative Qesarat, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.,.;
- Njësia Administrative Krahës, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.,.;
- Njësia Administrative Buz, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.,.;

4. Për kryerjen e inventarizimit të materialeve të institucioneve të mësipërme është ngritur grupi i punës i përbërë nga: z. M. D. kryetar dhe anëtarët znj. L. Ç., znj. A. I., z. E. H., z. A. D.
Vlen të theksohet se, përbërja e anëtarëve të komsionit të invetarizimit është e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 84. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej Nëpunësit Autorizues të institucionit por pa datë dhe pa numër protokolli.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2025, të pozicionit financiar të Bashkisë Memaliaj, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Lekë

Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**1,481,012,620**
Aktivet	1,621,450,457
Pasivet	140,437,837
Aktivet Neto	1,481,012,620

Lekë

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2025	**229,131,677**
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	97,521,738
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	37,053,113
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	94,556,826

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	94,569,416	68,510,006	26,059,410
50	Letra me vlerë	602,403	357,603	244,800
532	Vlera të tjera	2,349,919	28,737,563	(26,387,644)
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		**97,521,738**	**97,605,172**	**(83,434)**

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2025, në vlerën 68,510,006 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 94,569,416 lekë,

me një rritje në vlerën 26,059,410 lekë. Bazuar në Akt-rakordimin me Degën e Thesarit Tepelenë vlera prej 94,569,416 lekë si disponibilitet në thesar i përket Aparatit të Bashkisë e cila kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 51,640,727 lekë dhe 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 42,928,689 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pikat 49-50. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	Gjendja 31.12.2025
520	Disponibilitete në thesar	94,569,416
Totali		**94,569,416**
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	51,640,727
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	42,928,689
Totali		**94,569,416**
Diferenca		**0**

Lekë

Disponibilitete në thesar	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Të ardhura të trashëguara më datë 31.12.2025		51,640,727		51,640,727
5% i garancive të punimeve më datë 31.12.2024		26,094,899		26,094,899
Zhbllokimi i 5% të garancive të punimeve për vitin 2025			1,612,576	
5% garanci punime për vitin 2025		18,446,366		18,446,366
Të ardhura të trashëguara nga viti 2024			68,510,006	
Totali	**68,510,006**	**96,181,992**	**70,122,582**	**94,569,416**

- **Llogaria 50 "Letra me vlerë"** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 357,603 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 602,403 lekë me një rritje në vlerën 244,800 lekë në të cilën janë të përfshira Letra me Vlerë dhe Pullat Postare. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksin nr. 3, Tabela nr. 1.)** si më poshtë:

Lekë

Llogaria 50 "Letra me vlerë"	
Çelje e vitit 2025	357,603
Shtesa (K)	768,000
Pakësime (D)	523,200
Gjendja debitore në 31.12.2025	**602,403**

- **Llogaria 532 "Vlera të tjera"** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 28,737,563 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 2,349,919 lekë me një pakësim në vlerën 26,387,644 lekë. Bazuar në Akt-rakordimin me Degën e Thesarit Tepelenë vlera prej 2,349,919 lekë vlera të tjera i përket Drejtorisë së Shërbimeve, që i përket 5% të garancive të punimeve.

2. Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
31	Materiale	0	0	0
32	Inventar i imët	37,053,113	39,750,163	(2,697,050)
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		**37,053,113**	**39,750,163**	**(2,697,050)**

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 39,750,163 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 37,053,113 lekë me një pakësim në vlerën 2,697,050 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 37,053,113 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,697,050 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së invetarit" e cila paraqitet në vlerën 2,697,050 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 32 "Inventarë i imët"**, ka vlerën 37,053,113 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Inventarë i imët	Vlera
Çelje e vitit 2025	39,750,163
Shtesa (K)	37,053,113
Pakësime (D)	39,750,163
Gjendja në 31.12.2025	**37,053,113**

3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	48,437,125	(48,437,125)
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	11,181,933	(11,181,933)
431	Tatime e taksa	0	900,979	(900,979)
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	1,971,655	(1,971,655)
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	52,383,108	0	52,383,108
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	42,173,718	7,664,171	34,509,547
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		**94,556,826**	**70,155,863**	**24,400,963**
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
Totali		**0**	**0**	**0**

- **Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"** më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 52,383,108 lekë. Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSh në auditimin e mëparshëm, nga Bashkia Memaliaj janë kryer veprimet sistemuese duke kontabilizuar në gjendjen e kësaj llogarie debitorët nga taksat dhe tarifat vendore por jo vetëm, ku analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksin nr. 3, Tabela nr. 2.)** si më poshtë:

Lekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	48,437,125
Shtesa (K)	13,554,250
Pakësime (D)	9,608,267
Gjendja debitore në 31.12.2025	**52,383,108**

Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk janë të përfshirë debitorët të kategorive si "Familjarë" në vlerën 2,584,378 lekë, "Taksë ndikimi në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale" në vlerën 170,622 lekë dhe "Tarifa e liçencimit për karburant" në vlerën 1,600,000 lekë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Me shkresën e datës 30.03.2025, Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 52,383,108 lekë pa përfshirë disa kategori debitorësh në vlerën totale 4,355,040 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar në vlerën 4,355,040 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. Të dhënat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Lekë

Nr.	Lloji i taksës dhe tarifave vendore	Gjendja më datë 31.12.2024	Shtesë gjatë vitit 2025	Pakësime gjatë vitit 2025	Gjendja më datë 31.12.2025
1	Familjar	1,930,336	864,171	210,129	2,584,378
2	Taksë ndikimi në infrastrukturë për legalizimin	67,203	103,459	0	170,662
3	Tarifa e linçecimit për karburantet	1,400,000	200,000	0	1,600,000
Totali		**3,397,539**	**1,167,630**	**210,129**	**4,355,040**

- Gjendja e **llogarisë 4342 "Operacion me shtetin (të drejta)"** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 7,664,171 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 42,173,718 lekë me një rritje në vlerën 34,509,547 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksin nr. 3, Tabela nr. 3.)** si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)	
Çelje e vitit 2025	7,664,171
Shtesa (K)	56,228,285
Pakësime (D)	21,718,738
Gjendja debitore në 31.12.2025	**42,173,718**

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	II. Aktive Afatgjata	**1,392,318,780**	**1,112,296,439**	**280,022,341**
20	**1. Aktive Afatgjata jo materiale**	**5,273,879**	**6,099,103**	**(825,224)**
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	5,273,879	6,099,103	(825,224)
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	**2. Aktive Afatgjata materiale**	**1,386,722,901**	**1,106,197,336**	**280,525,565**
210	Toka, Troje, Terene	107,998	119,998	(12,000)
211	Pyje, Plantacione	2,308,380	3,048,040	(739,660)
212	Ndërtesa e konstruksione	490,105,818	388,859,907	101,245,911
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	861,481,308	678,677,166	182,804,142
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	3,803,738	5,631,296	(1,827,558)
215	Mjete transporti	19,955,145	24,729,975	(4,774,830)
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	8,960,514	5,130,954	3,829,560
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	**3. Aktive Afatgjata Financiare**	**322,000**	**0**	**322,000**
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	322,000	0	322,000
	4. Investime	**0**	**0**	**0**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	0	0	0

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"** më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 6,099,103 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,413,965 lekë, pakësime në vlerën 2,413,965 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 825,224 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,273,879 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	6,099,103
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**6,099,103**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	2,413,965
	5	Amortizim i shtesës	825,224
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	2,413,965
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	6,099,103
	5	Amortizim i akumuluar	825,224
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**5,273,879**

Vlera e mbetur në fund të vitit 2025 prej 6,099,103 lekë (kosto historike) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" për 37 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.
Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II, Aneksi 1, pika 2, klasa 2 dhe pika 5. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në **(Aneksin nr. 3, Tabela nr. 4).**

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 119,998 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përllogaritur amortizim vjetor në vlerën 12,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 107,996 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	119,998
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**119,998**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	12,000
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	119,998
	5	Amortizim i akumuluar	12,000
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**107,996**

- **Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 3,048,040 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përllogaritur amortizim vjetor në vlerën 739,660 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,308,380 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	3,836,800
	2	Amortizim i akumuluar	788,760
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**3,048,040**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	739,660
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	3,836,800
	5	Amortizim i akumuluar	1,528,420
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**2,308,380**

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur përkatësisht, 210 "Toka, troje, terrene" në vlerën 107,996 lekë dhe 211 "Pyje, kullota, plantacione" në vlerën 2,308,380 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuara me emërtesat se çfarë përfaqësojnë.
Për vitin 2025 është aplikuar normë amortizimi respektivisht në vlerën 12,000 lekë dhe 739,660 lekë, në kushtet kur për këto llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi. Sipas informacionit kontabël llogaria 210 "Toka, troje, terrene" është nënvlerësuar në vlerën 12,000 lekë dhe 211 "Pyje, plantacione, kullota" në vlerën 739,660 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe

Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetor në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 30.

- **Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"** më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 388,859,907 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 29,461,331 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 229,828,045 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 490,105,818 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksi nr. 3, Tabela nr. 5)** si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	589,226,621
	2	Amortizim i akumuluar	200,366,714
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**388,859,907**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	130,707,242
	5	Amortizim i shtesës	29,461,331
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	719,933,863
	5	Amortizim i akumuluar	229,828,045
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**490,105,818**

- **Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"** më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 678,677,166 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 242,510,954 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 575,165,880 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 861,481,308 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksi nr. 3, Tabela nr. 6)** si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,194,136,234
	2	Amortizim i akumuluar	515,459,068
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**678,677,166**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	242,510,954
	5	Amortizim i shtesës	59,706,812
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,436,647,188
	5	Amortizim i akumuluar	575,165,880
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**861,481,308**

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 5,631,296 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 14,471,842 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,803,738 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	18,275,580
	2	Amortizim i akumuluar	12,644,284
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**5,631,296**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	1,827,558
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	18,275,580
	5	Amortizim i akumuluar	14,471,842
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**3,803,738**

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 24,729,975 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,254,830 lekë, pakësime në vlerën 4,480,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 40,919,765 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 19,955,145 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 "Mjete transporti" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	56,394,910
	2	Amortizim i akumuluar	31,664,935
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**24,729,975**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	8,960,000
	5	Amortizim i shtesës	9,254,830
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	4,480,000
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	60,874,910
	5	Amortizim i akumuluar	40,919,765
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**19,955,145**

Për llogarinë 215 "Mjete transporti" në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 19,955,145 lekë. Në këtë vlerë është përfshirë edhe vlera prej 3,312,750 lekë që i përket 5 (pesë) mjeteve të dëmtuara (me emërtimin mjete transporti me vlerë respektivisht 200,000 lekë + 180,000 lekë + 955,000 lekë + 1,182,750 lekë + 795,000 lekë) të cilat nuk janë në gjendje pune të konstatuara si të tilla në procesin e inventarizimit.
Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi nr. 1, "Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)", 2.1, "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2", vlera 3,312,750 lekë e cila i përket kostos historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Pra nga llogaria 215 "Mjete transporti", duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Gjithashtu për këtë llogari është aplikuar normë amortizimi në vlerën 8,960,000 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël për këtë llogari duhet të aplikohej normë amortizimit në masën 20% në vlerën 11,278,982 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 215 "Mjete transporti" është mbivlerësuar në vlerën 2,318,982 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 36.

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 5,130,954 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 4,636,046 lekë, pakësime në vlerën 580,551 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 45,679,547 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,960,514 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 "Inventar ekonomik" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	46,174,455
	2	Amortizim i akumuluar	41,043,501
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**5,130,954**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	9,046,157
	5	Amortizim i shtesës	4,636,046
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	580,551
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	54,640,061
	5	Amortizim i akumuluar	45,679,547
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**8,960,514**

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2025, në vlerën 54,640,061 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 36.

Në gjendjen e **llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta"** është kontabilizuar vlera prej 322,000 lekë që i përket kuotave që posedon Bashkia Memaliaj si aksionare në masën 3.22% në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 31.

4. Investimet

Gjendja e llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2025 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht: Kontrata me nr. 1559/14 prot., datë 02.09.2025, me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" me vlerë kontrate 43,474,455 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 25,000,000 lekë; Kontrata me nr. 49/29 prot., datë 09.06.2024, me objekt "Ujësjellësi Rajonal Memaliaj" me vlerë kontrate 487,378,589 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 370,290,129 lekë. Vlera e likuiduar prej 395,290,129 lekë që i përket kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, llogaria 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në vlerën 0 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 0 lekë i cili kuadron me totalin e llogarisë 115 "Nga fondet e veta të investimeve" e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" në vlerën 0 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, gërma "c".

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Memaliaj më datën 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	1,421,048	48,437,125	(47,016,077)
42	Detyrime ndaj personelit	17,094,314	14,256,126	2,838,188
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,111,973	1,007,750	104,223
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	2,973,920	2,302,390	671,530
436	Sigurime shëndetësore	338,312	261,575	76,737
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	602,403	357,603	244,800
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	45,278,608	28,737,563	16,541,045
467	Kreditorë të ndryshëm	18,862,153	12,114,715	6,747,438
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	371,998	6,522,110	(6,150,112)

49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		**88,054,729**	**113,996,957**	**(25,942,228)**

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"** më datë 01.01.2025, është në vlerën 48,437,125 lekë në të cilën duhet të paraqiten faturat e pa likuiduara nga Bashkia Memaliaj, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 1,421,048 lekë me një pakësim në vlerën 47,016,077 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksin nr. 3, Tabela nr. 7) si më poshtë:**

Lekë

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Çelje e vitit 2025	48,437,125
Shtesa (K)	1,421,048
Pakësime (D)	48,437,125
Gjendja debitore në 31.12.2025	**1,421,048**

- **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 17,094,317 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2025 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	14,256,126
Shtesa (K)	17,094,317
Pakësime (D)	14,256,126
Gjendja debitore në 31.12.2025	**17,094,317**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
1	05.01.2026	5,034,555
2	05.01.2026	1,133,808
3	05.01.2026	455,549
4	05.01.2026	424,146
5	06.01.2026	3,401,276
6	06.01.2026	251,811
8	06.01.2026	114,588
11	06.01.2026	193,939
10	06.01.2026	83,126
9	06.01.2026	285,309
12	06.01.2026	72,782
15	13.01.2026	1,373,463
16	13.01.2026	234,084
18	13.01.2026	97,046
21	14.01.2026	23,182
22	15.01.2026	221,000
26	23.01.2026	30,000
27	23.01.2026	30,000
28	23.01.2026	56,440
1	06.01.2026	2,190,062
2	06.01.2026	593,905
4-5	06.01.2026	794,242
Totali		**17,094,314**

- **Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa",** paraqitet në vlerën 1,111,973 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	1,007,750
Shtesa (K)	1,111,973
Pakësime (D)	1,007,750
Gjendja debitore në 31.12.2025	1,111,973

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
17	13.01.2026	1,000,545
5	14.01.2026	111,428
Totali		**1,111,973**

- Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 2,973,920 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	2,302,390
Shtesa (K)	2,973,920
Pakësime (D)	2,302,390
Gjendja debitore në 31.12.2025	**2,973,920**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
14	13.01.2026	2,055,273
18	13.01.2026	70,856
4-5	14.01.2026	847,791
Totali		**2,973,920**

- Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 338,312 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2025	261,575
Shtesa (K)	338,312
Pakësime (D)	261,575
Gjendja debitore në 31.12.2025	**338,312**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
18	13.01.2026	6,879
14	13.01.2026	234,083
4-5	14.01.2026	97,350
Totali		**338,312**

- Llogaria 464 "Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave me vlerë" më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 357,603 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 602,403 lekë me një rritje në vlerën 244,800 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 464 "Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave me vlerë"	
Çelje e vitit 2025	357,603
Shtesa (K)	768,000
Pakësime (D)	523,200
Gjendja debitore në 31.12.2025	**602,402**

Lekë

Detyrime për t'u paguar për berjen e letrave me vlerë (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Pulla postare (arka)	92,243	63,000	104,000	51,243
Letra me vlere (individ)	265,360	705,000	419,200	551,160
Totali	**357,603**	**768,000**	**523,200**	**602,403**

- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Memaliaj në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 45,278,608 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2025	28,737,563
Shtesa (K)	21,089,000
Pakësime (D)	1,905,321
Gjendja debitore në 31.12.2025	**45,278,608**

- Për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Memaliaj janë ngurtësuar fonde në vlerën 5,547,212 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Tepelenë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 5,547,212 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten në **Aneksin nr. 3, Tabela nr. 8.**

- **Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2025, janë në vlerën 15,174,942 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, në vlerën 18,862,153 lekë me një rritje në vlerën 3,687,211 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksi nr. 3, Tabela nr. 9)** si më poshtë:

Lekë

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	15,174,942
Shtesa (K)	Nuk ka informacion
Pakësime (D)	Nuk ka informacion
Gjendja kreditore në 31.12.2025	**18,862,153**

- **Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 944,650 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 371,998 lekë me një pakësim në vlerën 572,652 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksi nr. 3, Tabela nr. 10)** si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"	
Çelje e vitit 2025	944,650
Shtesa (K)	371,998
Pakësime (D)	944,650
Gjendja debitore në 31.12.2025	**371,998**

- **Llogaria 475 "Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse",** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 0 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 52,383,108 lekë. Kjo llogari shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në të cilën përfshihen debitorët ndaj Bashkisë Memaliaj. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën **(Aneksi nr. 3, Tabela nr. 11)** si më poshtë:

Lekë

Llogaria 475 "Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse"	
Çelje e vitit 2025	0
Shtesa (K)	61,991,375
Pakësime (D)	9,608,276
Gjendja debitore në 31.12.2025	**52,383,108**

Lekë

Llogaria	**Emërtimi**	**31.12.2025**	**31.12.2024**
C	**AKTIVET NETO/FONDET (A-B)**	**1,481,012,620**	**1,220,556,608**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR**	**1,481,012,620**	**1,220,556,608**
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,429,371,893	1,152,046,602
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	51,640,727	68,510,006
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	**TOTALI I PASIVEVE (B+C)**	**1,621,450,457**	**1,334,553,565**

Lekë

Fondi i konoliduar	**Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"**	
1,481,012,620	**Mbyllje më datë 31.12.2025**	**Çelje më datë 01.01.2025**
	Debi	**Kredi**

			1,152,046,602	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2024
	7,474,516	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	393,638,318	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	106,463,461	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	2,697,050	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
Totali	**113,937,977**		**1,548,381,970**	
1,548,381,971 – 113,937,977 = 1,434,443,994				
1,434,443,994 – 1,429,371,893 = -5,072,101				

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 1,152,046,602 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 393,638,318 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 2,697,050 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 7,474,516 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 106,463,461 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është nënvlerësuar në vlerën 5,072,101 lekë. Diferenca në vlerën prej 5,072,101 lekë i përket Diferenca në vlerën prej 5,072,101 lekë i përket granteve të brendshme kapitale në natyrë.

- Llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore", më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 68,510,006 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 51,640,727 lekë me një pakësim në vlerën 16,869,279 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"	
Çelje e vitit 2025	68,510,006
Shtesa (K)	411,583,144
Pakësime (D)	428,452,423
Gjendja debitore në 31.12.2025	**51,640,727**

Lekë

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Të ardhurat gjithësej gjatë vitit 2025		411,583,144		411,583,144
Shpenzime e kryera gjithsej gjatë vitit 2025			359,942,417	(359,583,417)
Azhornimi i llogarisë 85 të vitit 2024 për vitin 2025			68,510,006	(68,510,006)
Totali	**68,510,006**	**411,583,144**	**428,452,423**	**51,640,727**

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 10,328,834 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 9,344,599 lekë ose me një pakësim në vlerën 984,235 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	**Emërtimi**	**31.12.2025**	**31.12.2024**
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**9,344,599**	**10,328,834**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**35,000**	**91,499**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	35,000	91,499
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**3,920,548**	**4,598,608**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	3,906,231	4,598,608
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	14,317	0
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**5,389,051**	**5,638,727**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	5,389,051	5,638,727
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	**0**
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0

7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	**5. Taksë e rrugës**	**0**	**0**
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**	**0**	**0**
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**	**0**	**0**

2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 9,136,383 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 8,959,956 lekë ose me një pakësim në vlerën 176,427 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**8,959,956**	**9,136,383**
710	**1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**2,923,031**	**3,535,265**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	2,923,031	3,535,265
711	**2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**6,036,925**	**5,601,118**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	4,017,330	4,157,079
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1,900,826	1,184,512
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	54,755	85,966
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
07115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	64,014	173,561
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	**3. Të tjera të ardhura jo tatimore**	**0**	**0**

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 "Grante korente",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 416,680,959 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 458,881,696 lekë ose me një rritje në vlerën 42,200,737 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	**V. GRANTE KORENTE**	**458,881,696**	**416,680,959**
720	**1. Grant korent i brendshëm**	**458,881,696**	**416,680,959**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	0	0
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	412,087,949	396,104,015
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	11,541,094	14,999,217
07205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	34,752,653	5,281,927
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	500,000	295,800
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	**2. Grant korent i huaj**	**0**	**0**
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve"** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 167,158,45 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 203,275,774 lekë ose me një rritje në vlerën 36,117,322 lekë.

- **Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 25,252,760 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 33,156,845 lekë ose me një rritje në vlerën 7,904,085 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tepelenë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
6001	Paga, personel i përhershëm	203,275,774	167,158,452
6002	Paga personel i përkohshëm	0	0
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	30,458,644	23,348,320
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	2,698,201	1,904,440
Totali		**236,432,619**	**192,411,212**

2. Blerje mallra dhe shërbime:
Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime",** në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 55,179,570 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 61,557,680 lekë ose me një rritje në vlerën 6,378,257 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tepelenë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
602	**III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME**	**61,557,827**	**55,179,570**
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,357,680	3,518,886
6021	Materiale dhe shërbime speciale	3,138,120	1,488,488
6022	Shërbime nga të tretë	17,668,241	18,145,667
6023	Shpenzime transporti	14,529,172	16,111,404
6024	Shpenzime udhëtimi	547,600	673,400
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	10,657,785	6,084,147
6026	Shpenzime për qiramarrje	358,600	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,178,345	119,828
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	12,122,284	9,037,750

3. Subvencionet:
Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Memaliaj nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025.

4. Transferime korente:
Gjendja e llogarisë së fondeve **604 "Transferime të brendshme"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 7,588,767 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.
Gjendja e llogarisë së fondeve **606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 119,966,311 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	V. TRANSFERIME KORENTE	**127,555,078**	**148,695,744**
604	**1. Transferime korente të brendshme**	**7,588,767**	**8,802,894**
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	7,588,767	8,802,894
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	0	0
606	**3. Transferime për buxhetet familjare e individë**	**119,966,311**	**139,892,850**
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	119,966,311	139,892,850

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 477,186,251 lekë dhe totali shpenzimeve është 425,545,524 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 51,640,727 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 51,640,727 lekë.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,.
Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore.

Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë.
Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

- **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to, shpërblimeve:**

Nga Bashkia Memaliaj është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:
Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, **z. B. C.** Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare të Aparatit të Bashkisë dhe **z. F. B.** Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, **znj. D. S.** Përgjegjës i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare të Drejtorisë së Shërbimeve.

2.4. Auditimi i prokurimeve publike për vitet 2024-2025:

2.4.1. *Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve publike;*

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet respektive të Këshillit Bashkiak.

2.4.2. *Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit;*

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Memaliaj (regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve) si dhe të dhënave nga Sistemi i Prokurimit Elektronik të APP-së për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten si më poshtë:

Lekë

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Procedurat e kryera nga Bashkia Memaliaj për vitin 2024					
Procedurë e hapur	6	312,111,906	275,573,289	36,538,616	11.7%
Procedurë e hapur e thjeshtuar	2	9,000,000	7,206,753	1,793,247	19.9%
Totali A	**8**	**321,111,906**	**282,780,042**	**38,331,863**	**11.9%**
Procedurat e kryera nga Drejtaria e Shërbimimeve Publike për vitin 2024					
Procedurë e hapur e thjeshtuar	1	8,772,000	8,103,861	668,139	7.62%
Totali B	**1**	**8,772,000**	**8,103,861**	**668,139**	**7.62%**
Totali A + B	**9**	**329,883,906**	**290,883,903**	**39,000,002**	**11.8%**
Lloji i procedurës	**Nr. Proc**	**Fondi limit pa TVSh**	**Kontrata pa TVSh**	**Fondi total i kursyer pa TVSh**	**% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit**
Procedurat e kryera nga Bashkia Memaliaj për vitin 2025					
Procedurë e hapur	3	73,048,324	64,003,713	9,044,611	12.3%
Procedurë e hapur e thjeshtuar	4	24,828,941	23,843,222	985,719	3.9%
Totali A	**7**	**97,877,265**	**87,846,935**	**10,030,330**	**10.2%**
Procedurat e kryera nga Drejtaria e Shërbimimeve Publike për vitin 2025					
Procedurë e hapur e thjeshtuar	2	7,720,000	7,129,792	590,208	7.64%
Totali B	**2**	**7,720,000**	**7,129,792**	**590,208**	**7.64%**
Totali A + B	**9**	**105,597,265**	**94,976,727**	**10,620,538**	**10**
Grand Totali	**18**	**435,481,171**	**385,860,630**	**49,620,541**	**11.39%**

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, në total nga Bashkia Memaliaj së bashku me njësinë e varësisë Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka realizuar në total 18 procedura prokurimi me vlera të larta me fond limit në vlerën 435,481,171 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate të lidhur në vlerën 385,860,630 lekë pa TVSh. Me zgjedhje në total për vitet 2024-2025 janë audituar 11 procedura prokurimi me fond limit në vlerën 402,416,200 lekë pa TVSh dhe realizimin kontrate në vlerën 355,322,006.73 lekë pa TVSh në masën 92.4% të fondit limit të prokuruar.

Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2024,** deri më **31.12.2024,** paraqiten si më poshtë:

1. Procedura e prokurimit me objekt **"Rikonstruksioni i rrugëve të njësive administrative",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2024.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrugëve të njësive administrative".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 2, datë 28.03.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 122, datë 07.08.2024. 1. Xh. K. (Jurist) 2. L. M. (Inxhinier) 3. A. I. (Ekonomist)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 53, datë 28.03.2024. 1. A. Xh. (Kryetar) 2. J. T. (Anëtar) 3. E. E. (Anëtar) Urdhri nr. 79, datë 23.05.2024, për ndryshimin e anëtarit të KVO, z. J. T. me z. V. K.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"		
5. Fondi Limit: 27,500,000 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** OE "C. R." ShPK me vlerë oferte 18,874,467.20 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit:** 8,625,532.80 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit:	**9. Burimi i Financimit:**	**10. Operatorët Ekonomikë**

16.04.2024.	Nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj në vlerën totale prej 33,000,000 lekë e ndarë kjo: - Për vitin 2024 në vlerën 19,000,000 lekë; - Për vitin 2025 në vlerën 14,000,000 lekë;	a) Pjesëmarrës: 3 OE b) S'kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 3 OE 1. OE "C. R." ShPK 2. OE "Sh." ShPK 3. OE "E. C. C." ShPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 746/18 prot., datë 04.07.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 22,649,360.64 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugëve të njësive administrative", janë siguruar fonde në vlerën 33,000,000 lekë nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj (e ndarë për vitin 2024 në vlerën 19,000,000 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 14,000,000 lekë), ku miratimi për përdorimin e këtyre fondeve është kryer nëpërmjet Vendimit nr. 93, datë 27.12.2023, të Këshillit Bashkiak Memaliaj me objekt "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", duke marrë njëkohësisht edhe konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1083/1 prot., datë 08.01.2024. Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 02.04.2024, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 51, datë 28.03.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K., znj. L. M. dhe znj. A. I.

Me Urdhrin nr. 52, datë 28.03.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 746/2 prot., datë 28.03.2024, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 27,500,000 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 746/3 prot., datë 28.03.2024, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur" me mjete elektronike. Me shkresën nr. 746/5 prot., datë 28.03.2024, NjP ka hartuar procesverbalin me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar znj. Xh. K. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik.

Me Urdhrin nr. 2, datë 28.03.2024, z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugëve të njësive administrative" me fond limit 27,500,000 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur".

Për realizimin e projekt zbatimit për këtë procedurë është angazhuar Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës. Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Preventivi i punimeve;
- Orto foto;
- Prerjet tërthore;
- Grafiku i punimeve;
- Relacioni Teknik dhe Specifikimet;

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 746/7 prot., datë 15.04.2024, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.4. Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P.1- A (Punime gërmimi në tokë);
- N.S. 18- A (Punime topogjeodezike);

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi. *Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

N.P.4. "Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale": Duke marrë shkas nga tipologjia dhe punimet e përfshira *(Shtresë çakulli t = 8 cm e përhapur ngjeshur me makineri; Stabilizant t = 10 cm dhe Shtresë binderi me zall lavatriçe t = 4 cm sipas preventivit të secilës prej rrugëve në njësitë administrative)* në Dokumentet Teknikë të Procedurës *(preventivë punimesh, projekt, specifikime teknike dhe relacion teknik pra objekti i prokurimit lidhet me rikonstruksion rruge)* u konstatua se, nga NjP **nuk është përfshirë kjo kërkesë në DT** në referencë të përcaktimeve të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar*, konkretisht: "Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore".

2. Në pikën nr. 2.4.1. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (*jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë*), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi *për periudhën 3 (tre) mujori i fundit*, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier të kualifikuar në fushën e sigurisë në punë, që disponon çertifikatë si **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë apo çertifikatën e kualifikimit.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Në pikën nr. 2.5. Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

d) Çertifikatën Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore **SA 8000:2014,** (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO*).

e) Çertifikatën Sistemi i cilësisë ISO 39001:2012 *(Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor);*(e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës për disponimin e çertifkatës **SA 8000:2014** nuk përmbush përcaktimet e parashikuara në rregullat e Prokurimit Publik, ku çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës konkretisht:

Standardi SA 8000:**2014** është bërë një standard i sistemit të menaxhimit që përcakton performancën e bizneseve në fusha që janë kritike për llogaridhënien sociale në mjediset e tyre të punës dhe siguron përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha fushat. Ky standard pasqyron parimet e përfshira në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe deklaratat e lëshuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës.

4. Në pikën nr. 2.10. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të asfaltit, për sa mësipër duhet të paraqesë dokumentacionin për:

Fabrik Asfalti me QKL në **Pronesi/kontrat**ë **noteriale qiraje/kontrat**ë **noteriale furnizimi** *(të vlefshme përgjatë gjithë afatit të kësaj kontrate).*

Për sa mësipër duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësise apo marrjes me qira, apo kontratë noteriale furnizimi, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

QKL - Fabrikë asfalti - Leje Mjedisi tipi B, Kodi: III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga Organe të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të paktën 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartëpërmendur shoqëruar me kontratën

noteriale të furnizimit *(e vlefshme përgjatë gjithë afatit të kësaj kontrate)*, si dhe me deklaratën e garancisë së prodhuesit ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë dhe afati i furnizimit.

4.1. Në pikën nr. 2.11. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnzimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht, për të përmbushur këtë, Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi noteriale, për të paktën 1 (një) Impiant prodhimi të materialeve Inerte që parashikohen në preventivin e procedurës së prokurimit. Për sa mësipër duhet të paraqitet dokumentacioni i pronësisë apo marrjes me qira, apo kontratë noteriale furnizimi, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si me poshtë: QKL - Impiant/fabrikë Inerte - Leje Mjedisi tipi B, Kodi: III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së inerteve nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga Organe të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të paktën 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartëpërmendur shoqëruar me kontratën noteriale të furnizimit *(e vlefshme përgjatë gjithë afatit të kësaj kontrate)*, si dhe me deklaratën e garancisë së prodhuesit ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara dhe afati i Kontratës. Operatorët Ekonomikë në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e **lejes mjedisore,** mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurues/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit. Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (inerte, asfalti, betone etj.,), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarin në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të Shtetit Shqiptar. Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K., **znj. L. M., znj. A. I.** në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 53, datë 28.03.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. A. Xh. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. V. K., znj. E. E..

Me Urdhrin nr. 79, datë 23.05.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është kryer një ndryshim në KVO duke u zëvendësuar z. J. T. me znj. V. K. Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 746/10 prot., datë 27.05.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 3 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "C. R." ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofertuara:

1. OE "C. R." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **18,874,467.20 lekë pa TVSh;**

2. OE "Sh." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **22,100,870 lekë pa TVSh;**
3. OE "E. C. C." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **22,242,031 lekë pa TVSh;**
Me shkresën nr. 746/13 prot., datë 30.05.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 746/14 prot., datë 30.05.2024. Me shkresën nr. 746/15 prot., datë 18.06.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afatve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme e OE "C. R." ShPK.
Nga auditimi i dokumentacionit të OE "C. R." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:
1. Në pikën nr. 2.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion kapacitet mbajtës mbi 25 ton	4 copë	Pronësi ose me qira
Kamioçinë me kapacitet mbajtës (3-4 ton)	4 copë	Pronësi ose me qira
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qira
Minieskavatorë	2 copë	Pronësi ose me qira
Rrul me Kompresor dhe Vibrim min10 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	3 copë	Pronësi ose me qira
Autobot uji me sprucator	1 copë	Pronësi ose me qira
Grejder	2 copë	Pronësi ose me qira
Paisje topografike GPS	1 copë	Pronësi ose me qira
Tabela sinjalistike sigurimi teknik	50 copë	Pronësi ose me qira
Rimorkio për transportin e makinerive	1 copë	Pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:leja e qarkullimit; çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; taksat vjetore, leja e transportit, foto përkatëse ballore dhe anësore;
b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve sipas afatit të kërkuar.
c) Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, (Autobitumatriçe) duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
d) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Nga OE "C. R." ShPK për plotësimin e kërkesës së disponibilitetit të katër mjeteve kamioçinë me kapacitet mbajtës **3-4 ton,** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit janë evidentuar mjetet me targë A...; A...; A... në pronësi dhe T... nëpërmjet Kontratës së Huapërdorimit me nr. 1916 Rep., nr. 1058 Kol., datë 21.05.2024.

Për tre nga këto mjete nuk përmbushet kapaciteti mbajtës i tyre konkretisht:
- Kamioçinë me targë A... me leje qarkullimi me nr. T..., me kapacitet **4.6 ton** (11,500 kg - 6,900 kg = 4,600 kg);
- Kamioçinë me targë A... me leje qarkullimi me nr. T..., me kapacitet **6.4 ton** (11,200 kg - 4,720 kg = 6,480 kg);
- Kamioçinë me targë A... me leje qarkullimi me nr. T..., me kapacitet **5.9 ton** (11,990 kg - 6,000 kg = 5,990 kg);

Mjetet Grejder të deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të disponueshme nga OE nëpërmjet Kontratave të Huapërdorjes nr. 4394 Rep., nr. 3616 Kol., datë 23.05.2017; nr. 5441 Rep., nr. 4332 Kol., datë 05.07.2018 dhe nr. 5441 Rep., nr. 4332 Kol., datë 05.07.2018, nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponojnë çertifikatën e

pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por deklarata doganore/Fatura Tatimore Blerje. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".

Për sa trajtuar më sipër OE "C. R." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në shpalljen fitues të OE "C. R." ShPK pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **z. A. Xh.** Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **znj. V. T., znj. E. E.**

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/15 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës znj. L. M., z. T. A., z. J. T., znj. K. Sh., znj. E. E., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Për OE "C. R.", në pikën 2.8 të dokumenteve të tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë kamionçinë me kapacitet 3-4 ton. Nga operatori ekonomik janë paraqitur dokumentet përkatëse, konkretisht kontrata e hua përdorjes me nr. 1916 Rep., dhe nr. 1058 Kol., datë 21.05.2024, nga e cila rezulton se kapaciteti mbajtës i kamionçinave të vëna në dispozicion eshtë më i lartë se kapaciteti i kërkuar në dokumentet e tenderit.

Në vlerësimin e bërë nga KVO për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, është marrë në konsideratë përmbushja e këtij kriteri, duke vlerësuar se mjeti i paraqitur përmbush kërkesën e përcaktuar në dokumentet e procedurës. Sa i përket mjetit Grejder, operatori ekonomik ka paraqitur faturën doganore përkatëse, e cila dokumenton importimin dhe në funksion të dokumentacionit të paraqitur, vërteton disponimin e mjetit nga ana e operatorit ekonomik.

Gjithashtu, në vlerësimin e ofertës është marrë në konsideratë edhe fakti se oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik "C. R." ka qenë oferta me vlerën më të ulët. Për sa më sipër, vlerësojmë se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik janë marrë në konsideratë kërkesat e përcaktuara në dokumentet e procedurës dhe dokumentacioni provues i paraqitur prej tij. KVO-ja ka shqyrtuar me rigorozitet përmbushjen e çdo kërkese të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe, për operatorët ekonomikë të sipërpërmendur, ka konstatuar mospërmbushje të kërkesave përkatëse të DT-së, të cilat kanë sjellë edhe vendimmarrjen për s'kualifikimin e tyre. Vendimmarrja e KVO-së është bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, në kërkesat e përcaktuara në DT dhe në detyrimin për të garantuar trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si dhe respektimin e parimeve dhe rregullave të procedurës së prokurimit.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Për sa i përket pretendimeve të paraqitura nga Juaj në këtë observacion ju bëjmë me dije se, në asnjë rast Ne nuk jemi shprehur se nuk disponohet një kontratë noteriale apo faturë/fletë zhdoganimi për disponibilitetin në pronësi apo me qira të një mjeti. Problematika e paraqitur lidhet me mos përmbushjen e kapacitetit/tonazhit mbajtës të mjetit të kërkuar në DT. Nuk do të thotë që për një mjet në qoftë se kapaciteti mbajtës është mbi kufijtë e përcaktuar në kriter konkretisht 3-4 ton për rastin konkret është i vlefshëm.

Vendosja e kufirit minimal dhe maksimal kufizon që OE që disponojnë një mjet me tonazh më të lartë se kufiri i përcaktuar të mos aplikojnë në procedurën e prokurimit.

Për mjetin Grejder dokumentacioni i zhdoganimit nuk është i vetmi dokumentacion që bënë të vlefshëm plotësimin e kriterit të parashikuar në DT, për arsye se ky mjet përfshihet në kategorinë e mjeteve teknologjike dhe sipas kritereve të DT dhe dispozitave ligjore përkatëse mbi qarkullimin rrugor duhet të jetë i pajisur edhe me lejen e qarkullimit, siguracionin, çertifikatë të kontrollit teknik etj.,. Vlen të theksohet se, nuk do të thotë që nga ana Juaj është shpallur fitues OE me vlerën e ofertës

më të ulët dhe plotësimi i kritereve të merret i ezauruar, OE shpallet fitues vetëm në rastin e plotësimit të të gjithë kritereve të përcaktuara në DT në referencë edhe të rregullave të LPP-së. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Procedura e prokurimit me objekt **"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2024.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 6, datë 25.07.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 110, datë 25.07.2024. 1. T. A. (Jurist) 2. J. T. (Arkitekt) 3. K. Sh. (Ekonomist)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 111, datë 25.07.2024. 1. A. Xh. (Kryetar) 2. L. M. (Anëtar) 3. E. E. (Anëtar) Nr. 164, datë 11.10.2024, për ndryshimin e përbërje së KVO-së: 1. znj. L. H. (Kryetar) 2. z. J. T. (Anëtar) 3. znj. E. E. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"		
5. Fondi Limit: 33,675,090 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** OE "A. I. C." ShPK me vlerë oferte 30,978,367.54 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit:** 2,696,722.46 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 05.09.2024.	**9. Burimi i Financimit:** Fondet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në vlerën totale prej 40,410,206 lekë e ndarë kjo: - Për vitin 2024 në vlerën 31,115,859 lekë; - Për vitin 2025 në vlerën 9,294,347 lekë;	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 7 OE b) S'kualifikuar: 4 OE 1. OE "S." ShPK; 2. OE "A." ShPK; 3. BOE "V. K." ShPK & "G.." ShPK; 4. BOE "E." ShPK & "M." ShPK; c) Kualifikuar: 3 OE 1. OE "A. I. C." ShPK; 2. BOE "E. C. C." ShPK & "M. K. & R. E." ShPK; 3. OE "S." ShPK;
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1637/17 prot., datë 11.10.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 37,174,041.05 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Memaliaj viti 2024", janë siguruar fonde në vlerën 40,410,206 lekë nga Buxheti i Shtetit për vitin 2024, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (e ndarë për vitin 2024 në vlerën 31,115,858.62 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 9,294,347 lekë) në zbatim të shkresës nr. 8086/9 prot., datë 20.06.2024, me objekt "Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2024". Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 25.07.2024, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 109, datë 25.07.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. T. A., z. J. T., znj. K. Sh.

Me Urdhrin nr. 110, datë 25.07.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit

limit. Me shkresën nr. 1637/2 prot., datë 25.07.2024, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 33,675,090.21 lekë pa TVSh.
Me shkresën nr. 1637/3 prot., datë 25.07.2024, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar z. "T.A" për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik. Me shkresën nr. 1637/5 prot., datë 25.07.2024, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur" me mjete elektronike.
Me Urdhrin nr. 6, datë 25.07.2024, z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" me fond limit 33,675,090 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur". Për realizimin e projekt zbatimit është angazhuar Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe Rural konkretisht punonjësi z. J. T. me profesion Arkitekt i pajisur me Liçencën nr. A... Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Planimetria e banesave;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;

Hartimi i kritereve të DT:
Me shkresën nr. 1637/7 prot., datë 11.10.2024, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.
Më datë 08.08.2024, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Memaliaj, rezulton se: Për procedurën me REF-15063-07-31-2024, me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" me fond limit 33,675,090 lekë pa TVSh, ka sygjeruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.
Me Urdhrin e datës 15.08.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullarit i AK-së, është pezulluar procedura e prokurimit në zbatim të reflektimeve sipas rekomandimeve të dhëna nga APP-ja.
Me Urdhrin e datës 15.08.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është hequr pezullimi mbi procedurën e prokurimit, ku me shkresën nr. 1637/9 prot., datë 11.10.2024, është hartuar procesverbali lidhur me reflektimin e rekomandimeve të dhëna nga APP-ja, duke hartuar njëkohësisht një Shtojcë në Dokumentet e Tenderit.
Për sa trajtuar më sipër, kriteret e aplikuara në DT janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:
Me Urdhrin nr. 111, datë 25.07.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. A. Xh. kryetar i komisonit dhe anëtarët znj. L. M., znj. E. E.
Me Urdhrin nr. 164, datë 11.10.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, përbërja e KVO-së ka përsuar një ndryshim konkretisht, znj. L. H. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. J. T., znj. E. E.
Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 1637/11 prot., datë 11.10.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 3 OE dhe s'kualifikuar 4 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "A. I. C." ShPK.
Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. OE "S." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **25,865,000 lekë pa TVSh;**

2. OE "A." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **26,652,018 lekë pa TVSh;**
3. BOE "V. K." ShPK (me Nipt J...) **& "G.." ShPK** (me Nipt L...) me vlerë të ofertës **29,360,654 lekë pa TVSh;**
4. BOE "E." ShPK (me Nipt J...) **& "M." ShPK** (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **30,519,660 lekë pa TVSh;**
5. OE "A. I. C." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **30,978,367.54 lekë pa TVSh;**
6. BOE "E. C. C." ShPK (me Nipt K...) **& "M. K. & R. E." ShPK** (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **33,169,985.63 lekë pa TVSh;**
7. OE "S." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **33,674,977.50 lekë pa TVSh;**
Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:
1. OE "S." ShPK për arsye se:
- Mos përmbushjen e pikën nr. 2.3.7, nga OE "S." ShPK në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit nuk pa paraqitur të dhëna mbi disponibilitetin e çertifikatave ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001-2018 e përditusuar, për më tepër që ky dokumentacion nuk është i ngarkuar në SPE.

2. OE "A." ShPK për arsye se:
- Nga KVO-ja një Raportin Përmbledhës citohet se, OE "A." ShPK ka paraqitur punë të ngjashme kontratën me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me objekt "Rikonstruksion dhe sinjalistikë Dega e Doganës Berat" viti 2021 dhe "Përmirësimi i banesave ekzistuese në Bashkinë Selenicë" viti 2023. Nga verifikimet e kryera në QKB, OE "A." ShPK nuk e ka paraqitur veprimtarinë në Bashkinë Berat dhe Selenicë, duke shmangur njëkohësit shlyrjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore.

Arsyeja e vlefshme për s'kualifikimin e OE "A." ShPK është vetëm mos paraqitja e vërtetimit për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Selencinë për vitin 2023, duke marrë në konsideratë faktin që OE ka paraqitur/publikuar në SPE si punë të ngjashme kontratën nr. 2633/1 prot., datë 05.12.2022, me objekt "Përmirësimi i banesave egzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara Loti II", me vlerë 12,899,361 lekë me TVSh dhe me afat zbatimi 180 ditë nga lidhja e kontratës.

Për sa i përket mos paraqitjes së vërtetimit për shlryerjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Berat për vitin 2023 **ky pretendim nuk qëndron,** duke marrë në konsideratë faktin që i referohet KVO-ja si punë e ngjashme/ publikuar në SPE kontratën nr. 16141 prot., datë 13.09.2021, "Rikonstruksioni dhe sinjalistikë Dega e Doganës Berat" me vlerë 27,614,546 lekë me TVSh dhe afat zbatimi 4 muaj nga data e marrjes në dorëzim të kantierit sipas grafikut të punimeve, **pra ky kusht vlen si arsye për s'kualifikim** në qoftë se në kërkesën e DT do të kërkohej vërtetimi i taksave për vitin 2021, ndërkoqë kërkesa i përket vitit 2023.
3. BOE "V. K." ShPK & "G.." ShPK për arsye se:
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.2.1, duke marrë në konsideratë faktin që OE "V. K." ShPK ka paraqitur bilancet për vitet 2021-2023 dhe OE "G.." ShPK për vitin 2021, por të pa shoqëruara me Raportin e Ekspertit Kontabën, kur ndodhet në kushtet që i plotëson kushtet për të qenë subjekt auditimi.

4. BOE "E." ShPK & "M." ShPK për arsye se:
- Nga KVO-ja në Raportin Përmbledhës citohet se, OE "M." ShPK ka paraqitur disa punë të ngjashme të cilat nuk i ka regjistruar si Nipte Sekondare, duke ju shmangur detyrime vendore.

Për sa trajtuar më sipër KVO ka kryer s'kualifikimin e BOE "E." ShPK & "M." ShPK me pretendimin se njëri prej operatorëve ekonomikë nuk ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkive Tiranë, Kukës, Divjakë dhe Durrës. Këtë situatë KVO e bazon mbi faktin se OE "M." ShPK ka paraqitur/publikuar në SPE disa kontrata për punë të ngjashme përgjatë viteve 2019-2021 në qytetet e sipërcituara, duke shmangur detyrimet tatimore për hapjen e Niptit Sekondar dhe mos pagesën për taksat dhe tarifat vendore, konkretisht për kontratat e mëposhtme:

- Kontrata nr. 2442 prot., datë 13.10.2020, të lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me objekt "Rehabilitimi i Lagjeve 4, 5 dhe 6 të Bashkisë Kukës", me vlerë 276,031,718 lekë me TVSh me afat deri më datë 15.12.2021;
- Kontrata nr. 46 prot., datë 31.10.2016, të lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me objekt "Përmirësimi i aksesit në zonat me aktivitet të lartë bujqësor të Myzeqesë", me vlerë 312,014,816 lekë pa TVSh me afat deri më datë 11.01.2021;
- Kontrata nr. 1271/11 prot., datë 09.10.2019, të lidhur me Unisversitetin Politeknik të Tiranës me objekt "Punime ndërtimore dhe rifiniture në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Inxhinierisë Mekanike", me vlerë 3,600,000 lekë me TVSh me afat deri më datë 12.09.2019;
- Kontrata nr. 997/1 prot., datë 03.07.2019, të lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Agim-Babunjë, Bashkia Divjakë", me vlerë 114,000,000 lekë me TVSh me afat deri më datë 27.05.2019;
- Kontrata nr. 3563/8 prot., datë 13.05.2019, të lidhur me Bashkia Tiranë me objekt "Rikonstruksioni i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rrugët "Demi Nazeri", "Princ Vidi" dhe "Gjok Doci", me vlerë 168,000,000 lekë me TVSh me afat deri më datë 09.06.2020;
- Kontrata nr. 3950/12 prot., datë 15.10.2019, të lidhur me Operatori i Sistemit të Transmetimit me objekt "Punime civile për riparime dhe rikonstruksionin e objeteve të nënstacioneve Rrashbull dhe Zemblak", me vlerë 12,504,600 lekë me TVSh me afat deri më datë 02.03.2020;
- Kontrata nr. 4512/11 prot., datë 31.03.2021, të lidhur me Drejtorinë Rajonale OSSH Durrës me objekt "Zgjerimi rrjeti 20kv, rikonstruksion kabine elektrike dhe ndërtim rrjeti TU për zonën e Shkallnurit, zgjatimi i fiderit 16 n/st Spitalle dhe demontimi i fider 61/63 n/st 35/6 kv Nis Kimike (porto Romano) dhe kthimi në linjë kabllore nëntokësore 20 kv i fiderit 44 n/st Shkkozet 110/20 (unazë me F12 n/st Spitalle) për në zonës e Vilës së Zogut", me vlerë 89,316,000 lekë me TVSh me afat deri më datë 20.08.2021;
- Kontrata nr. 668/11 prot., datë 27.07.2020, të lidhur me Universitetin Politeknik të Tiranës me objekt "Shërbim për mirëmbajten e ndërtesave të Universitetit Politeknik të Tiranës", me vlerë 2,639,718 lekë me TVSh me afat deri më datë 11.08.2020;

Ky pretendim nuk qëndron duke marrë në konsideratë faktin se kontratat e punëve publike i përkasin viteve 2019-2021, pra kusht vlen si arsye për s'kualifikim në qoftë se në kërkesën e DT do të kërkohej vërtetimi i taksave për vitet 2019-2021, ndërkoqë kërkesa i përket vitit 2023. OE "M." ShPK për vitin 2023 ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë me shkresën e datës 29.05.2024.

Diferenca e vlerës së ofertës ndërmjet BOE "E." ShPK & "M." ShPK të s'kualifikuar padrejtësisht dhe OE "A. I. C." ShPK të shpallur fitues është 458,707.54 lekë e cila ka ardhur si rezultat i vlerësimit të gabuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 2, neni 21, pika 2, neni 92, pika 3, ku përcaktohet që:

Neni 2 "Qëllimi":
Qëllim i këtij ligji është:
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
Neni 21 "Autoriteti kontraktor":
2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.
Neni 92 "Shqyrtimi i ofertave":
3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe

kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Me shkresën e datës 11.10.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 1637/12 prot., datë 11.10.2024. Me shkresën nr. 1637/14 prot., datë 11.10.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme e OE "A. I. C." ShPK.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE "A. I. C." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Në pikën nr. 2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

Nga OE "A. I. C." ShPK janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, në Bashkinë Tiranë vërtetimin e datës 19.04.2023, Bashkinë Librazhd vërtetimi nr. 1861 prot., datë 05.04.2023, Bashkinë Kavajë vërtetimi nr. 26 prot., datë 18.04.2023, Bashkinë Himarë vërtetimi nr. 1934 prot., datë 24.04.2023, Bashkinë Shkodër vërtetimi nr. 2441/1 prot., datë 18.04.2023, Bashkinë Devoll vërtetimi nr. 142 prot., datë 20.04.2023. Nga OE "A. I. C." ShPK nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Sarandë referuar likuidimeve për një kontratë nga Dega e Thesarit Sarandë ndërkohë që ka ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2023 në këtë qytet konkretisht, Kontrata me nr. 3 prot., datë 03.07.2023, me objekt "Shërbimi i pastrimit të qytetit Bashkia Sarandë":

- Fatura nr. 105, datë 21.08.2023, në vlerën 14,764,704 lekë regjistruar më datë 11.09.2023, dhe likuiduar më datë 14.09.2023, nga Dega e Thesarit Sarandë;
- Fatura nr. 115, datë 07.09.2023, në vlerën 14,815,689 lekë regjistruar më datë 25.12.2023, dhe likuiduar më datë 27.10.2023, nga Dega e Thesarit Sarandë;
- Fatura nr. 137, datë 12.10.2023, në vlerën 13,702,351 lekë regjistruar më datë 01.12.2023, dhe likuiduar më datë 06.12.2023, nga Dega e Thesarit Sarandë;

2. Pika nr. 2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 8-10 ton	Në pronësi ose me qira	1
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Autovinç vetëshkrakues 10 ton	Në pronësi ose me qira	1
4	Minieskavator	Në pronësi ose me qira	1
5	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
6	Depozitë uji 5000 litra	Në pronësi ose me qira	1
7	Matrapik për thyerje betoni	Në pronësi ose me qira	2
8	Vibrator beton	Në pronësi ose me qira	1
9	Betoniere	Në pronësi ose me qira	1
10	Saldatriçe	Në pronësi ose me qira	1
11	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	1
12	Komplet i ndihmes së shpejtë	Në pronësi ose me qira	6
13	Tabela	Në pronësi ose me qira	5
14	Prozhektor ndriçimi natën	Në pronësi ose me qira	3
15	Kokore	Në pronësi ose me qira	30

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: certifikata e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit teknik; polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -kontrata e qirasë; -certifikata e pronësisë së qiradhënësit; -leja e qarkullimit; -certifikata e

kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
- Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/akt-zhdoganimi/faturë tatimore/çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme.
- Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

OE "A. I. C." ShPK për disponibilitetin e një Autovinçi Vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 ton, ka paraqitur mjetin me targë A... Ky mjet referuar të dhënave të Lejes së Qarkullimit me nr. T..., pika nr. 6 "Kodi i karrocerisë", i përket kategorisë KE "Mjet për riparimin e linjave elektrike" dhe jo Autovinç.

Për sa trajtuar më sipër OE "A. I. C." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura nuk paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, por s'kualifikimi në mënyrë të padrejtë e BOE "E." ShPK & "M." ShPK dhe në shpalljen fitues të OE "A. I. C." ShPK në kushtet e mos plotësimit të të gjitha kritereve të DT, **veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **znj. L. H.** Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **z. J. T., znj. E. E.**

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/17 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës znj. L. H., znj. E. E., z. J. T., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Kualifikimi i operatorit ekonomik "A. I. C." është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.2.3, të DT pasi operatori ekonomik ka paraqitur vërtetimet për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha njësitë vendore ku ka ushtruar aktivitetin ekonomik. Sa i përket mjetit me numër regjistrimi T..., në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet shoqërisë "E." dhe operatorit ekonomik në fjalë, mjeti është specifikuar si autovinç vetëshkarkues. Gjithashtu, nga materialet fotografike të paraqitura nga operatori ekonomik, rezulton se mjeti i paraqitur përputhet me përshkrimin e percaktuar në kontratë. Për këtë arsye, KVO-ja e ka konsideruar këtë kërkesë si të përmbushur. Në vlerësimin e operatorit ekonomik është marrë në konsideratë edhe përvoja e tij në realizimin e punëve të ngjashme, si dhe historiku i zbatimit të kontratave të mëparshme. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni është vlerësuar se bëhet fjalë për një operator ekonomik me përvojë në fushën përkatëse dhe me kapacitete për realizimin e objektit të kontratës, duke garantuar zbatimin me korrektësi të punimeve, respektimin e kërkesave kontraktuale, si dhe efektivitetin dhe cilësinë e punimeve që do të realizohen. Për sa i përket operatorëve ekonomikë të s'kualifikuar, konkretisht OE "S." ShPK, OE "A." ShPK, BOE "V. K" dhe "G.." ShPK, si dhe BOE "E." dhe "M." ShPK, KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitir nga secili operator ekonomik dhe verifikimit të kërkesave të percaktuara në DT nga Njësia e Prokurimit, ka kryer vlerësimin në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara n DT. KVO-ja ka shqyrtuar me rigorozitet përmbushjen e çdo kërkese të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe për operatorët ekonomikë të sipërpërmendur, ka konstatuar mospërmbushje të kërkesave përkatëse të DT-së, të cilat kanë sjellë edhe vendimmarrjen për s'kualifikimin e tyre. Vendimmarrja e KVO-së është bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, në kërkesat e përcaktuara

në DT dhe në detyrimin për të garantuar trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si dhe respektimin e parimeve dhe rregullave të procedurës së prokurimit.
Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: - Ne i referohemi trasaksioneve të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, ku provohet që subjekti nuk ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ky operator ka ushtruar aktivitet për vitin 2023. Jemi në rastin kur përmbajtja e dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, nuk rezulton i vërtetë, pra operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma "a" të LPP-së.
- Për sa i përket pretendimeve të paraqitura nga KVO, në asnjë rast nuk jemi shprehur që nuk disponohet kontratë qiraje për disponibilitetin e një mjeti Autovinç Vetëshkarkues por i referohemi lejes së qarkullimit me nr. T... të mjetit me targë A..., ku në pikën nr. 6 "Kodi i karrocerisë", i përket kategorisë KE "Mjet për riparimin e linjave elektrike" dhe jo Autovinç. Identifikimi i tipologjisë të mjetit nuk kryehet nëpërmjet të dhënave të kontratës së qirasë por bazuar në të dhënat e lejes së qarkullimit konkretisht kodi i karrocerisë.
- Siç e kemi cituar edhe në narrativën e Raportit Përfundimtar të Auditimit, problematika mbi s'kualifikimin e OE "A." ShPK nga KVO-ja vlen vetëm për mos shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Selenicë për vitin 2023 por nuk vlen si arsye për pretendimin tjetër ndaj Bashkisë Berat pasi kontrata e paraqitur nga ky OE si punë e ngjshme i përket viti 2021, ndërkohë që në kriteret e DT-së kjo kërkesë i përket vitit 2023.
- Vlen të theksohet që Ne jemi shprehur që s'kualifikimi i OE "S." ShPK; OE "A." ShPK dhe BOE "V. K." ShPK & "G.." ShPK ka qenë i drejtë duke përjashtuar vetëm një prej arsyeve ndaj OE "A." ShPK.
- S'kualifikimi nga KVO i referohet kontratave të punëve publike që i përkasin viteve 2019-2021, kusht i cili vlen si arsye për s'kualifikim në qoftë se në kërkesën e DT do të kërkohej vërtetimi i taksave për vitet 2019-2021, ndërkoqë kërkesa i përket vitit 2023. OE "M." ShPK për vitin 2023 ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë me shkresën e datës 29.05.2024. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Procedura e prokurimit me objekt **"Rehabilitimi i skemës ujitëse nga rezervuari i Krahësit, Dega Krahës dhe Zhulaj",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2024.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i skemës ujitëse nga rezervuari i Krahësit, Dega Krahës dhe Zhulaj".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 9, datë 22.10.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 171, datë 22.10.2024. 1. Xh. K. (Jurist) 2. B. Xh. (Agronom) 3. L. D. (Jursit)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 173, datë 22.10.2024. 1. B. K. (Kryetar) 2. B. C. (Anëtar) 3. T. A. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"		
5. Fondi Limit: 22,471,037 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** OE "C." ShPK me vlerë oferte 20,297,272 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit:** 2,173,765 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 20.11.2024.	**9. Burimi i Financimit:** Fondet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vlerën totale prej 26,965,245 lekë e ndarë kjo: - Për vitin 2024 në vlerën 8,000,000 lekë; - Për vitin 2025 në vlerën 8,000,000 lekë; - Për vitin 2026 në vlerën 10,965,245 lekë;	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 2 OE b) S'kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 1. OE "C." ShPK 2. BOE "A." ShPK & "E." ShPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 2313/14 prot., datë 19.12.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 24,356,726.40 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:
Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rehabilitimi i skemës ujitëse nga rezervuari i Krahësit, Dega Krahës dhe Zhulaj", janë siguruar fonde në vlerën 26,965,245 lekë

nga Buxheti i Shtetit për vitin 2024, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (e ndarë për vitin 2024 në vlerën 8,000,000 lekë, për vitin 2025 në vlerën 8,000,000 lekë dhe për vitin 2026 në vlerën 10,965,245 lekë) në zbatim të shkresës me objekt "Mbi çeljen e fondit për investimin e kërkuar nga Bashkia Memaliaj". Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 24.10.2024, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.
Me Urdhrin nr. 171, datë 22.10.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K. z. B. Xh. dhe znj. L. D.
Me Urdhrin nr. 172, datë 22.10.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 2313/2 prot., datë 22.10.2024, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 22,471,428 lekë pa TVSh.
Me shkresën nr. 2313/4 prot., datë 22.10.2024, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur" me mjete elektronike.
Me shkresën nr. 2313/5 prot., datë 22.10.2024, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar znj. Xh. K. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik.
Me Urdhrin nr. 9, datë 22.10.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Rehabilitimi i skemës ujitëse nga rezervuari i Krahësit, Dega Krahës dhe Zhulaj" me fond limit 22,471,037 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur".
Për realizimin e Projekt Zbatimit për këtë procedurë është kontraktuar Studio Projektimi "C..." me licencë nr. 6..., përgaqësuar nga z. V. M. Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Preventivi i punimeve;
- Specifikimet teknike;
- Grafiku i punimeve;

Dokumentacioni i sipërcituar është adresuar edhe pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 80/3 prot., datë 03.09.2024, në kuadër të bashkëpunimit institucional me qëllim realizimin e projektit të sipërcituar.

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 2313/7 prot., datë 25.10.2024, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit. Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:
1. Në pikën nr. 2.3.3. Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe proçedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve huridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme: Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:
Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:
- NP-1 A (Punime gërmimi në tokë);

- NP- 7 A (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje);
- **NP-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit);**

Për punimet speciale të ndërtimit:

- NS- 1A (Punime prishje ndërtimore);
- NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese);
- NS-18 A (Punime topogjeodezike);

NP - 12 "Punime të inxhinierisë së mjedisit": Duke marrë shkas nga punimet e përfshira në Dokumentet Teknike të Procedurës *(preventivë punimesh, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik)* u konstatua se, për zbatimin e objektit të kontratës, nuk janë parashikuar ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik, ose punime që përfshijnë në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eleminimin e prishjes së ekulibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte (përkufizimi i kategorisë NP-12 sipas VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar)*.

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në **Projekt.** Objekti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: *"VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte **të një projekti** mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore"*.

2. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipërcituar).

b. Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipërcituar).

c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipërcituar).

d. Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipërcituar.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës për disponimin e çertifikatës **ISO 39001:2012,** nuk përmbushin përcaktimet e parashikuara në rregullat e Prokurimit Publik, ku çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës konkretisht:

Çertifikimi ISO 39001-2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor)
Sistemi i administrimit të sigurisë rrugore dhe trafikut ISO 39001 është projektuar posaçërisht për ndërmarrjet e sektorit publik dhe privat që operojnë në rrugë dhe sistemin e trafikut. Në këto kompani, kompanitë e përfshira në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve ose transportimin e njerëzve ose mallrave në rrugë. Me këtë sistem, organizatat do të pozicionohen në mënyrë korrekte mbi sigurinë e trafikut rrugor, dhe organizata dhe ata që marrin shërbime nga këto organizata do të krijojnë një mjedis besimi në sigurinë rrugore dhe trafikun.

3. Në pikën nr. 2.3.8. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, **të përfshirë në liçensën e shoqërisë**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajit e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- **Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukture Transport 1 (një);**
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një);
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Marksheder 1(një);
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një);
- **Inxhinier Gjeolog 1 (një);**
- **Inxhinier Mjedisi 1 (një);**

Ekspertizat profesionale e **Inxhinierit të Mjedisit** është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në lidhje me kërkesën për **Inxhinierë Mjedisi, Gjeolog dhe Ndërtimi me Profil Infrastrukturë Transporti,** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve në fjalë.

Ky kriter nuk është i nevojshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga këta inxhinier. Në pikën "a", të nenit 1, të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projektet të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim, për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore. Testimi i formacionit të tokës konsiderohet i realizuar përpara realizimit të projektit, pasi në projekt janë përllogaritur zërat dhe sasia e shtresave të domosdoshme për realizimin e punimeve në objekt.

- Një (1) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në pune", i cili duhet të jetë i certifikuar "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në pune" në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe mbrojtjen në pune" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, "Për miratimin e rregullores për Sigurinë në Kantjer".

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr.

285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K., **z. B. Xh., znj. L. D.** në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

<u>Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</u>
Me Urdhrin nr. 173, datë 22.10.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. B. K. kryetar i komisonit dhe anëtarët z. B. C., z. T. A.
Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 2313/9 prot., datë 27.11.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 2 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "C." ShPK.
Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. OE "C." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **20,297,272 lekë pa TVSh;**
2. BOE "A." ShPK (me Nipt K...) **& "E." ShPK** (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **21,744,608 lekë pa TVSh;**
Me shkresën e datës 02.12.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 2313/11 prot., datë 02.12.2024. Me shkresën nr. 2313/13 prot., datë 19.12.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme e OE "C." ShPK.
Për sa trajtuar më sipër, nuk janë konstatuar parregullsi në vlerësimin e OE "C." ShPK të shpallur fitues.

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/18 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës znj. Xh. K., z. B. Xh., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:
<u>Pretendimi i subjektit:</u> Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë projektin dhe zbatimin e saj ka arsyetuar për vendosjen e pikës numër 2.3.3 NP 12 A (punimet e inxhinierisë së mjedisit), kjo kategori liçence përkon me ndërtime mirëmbajtje dhe rikonstruksione të veprave dhe punimeve të shpërndara në territor dhe vlerësimin të kompaksimit dhe zhvillimin të qëndrueshëm të ekosistemit përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme të aktivitetit botanik dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Marrë në konsideratë punimet të cilat janë kryer kanë të bëjnë me mjedisin dhe ruajtjen e disbalancave të bimësisë që do të preken nga kjo vepër e ndërtuar. Në pikën 2.3.3 është kërkuar çertifikimi ISO 39001:2012 sistemi i menaxhimit të sigurisë të trafikut rrugor. Në të gjithë gjatësinë e zbatimit të projektit kemi punime që ndërpresin rrugën nacionale Levan-Tepelenë dhe duke qenë se është rrugë e aksesushme rrugë nacionale është e nevojshme që të keni një kontroll të trakfikut për të shmangur aksidente gjatë punimeve që do të kryhen në këtë pikë për zbatimin e projektit.
<u>Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së:</u> Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Objekti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: "VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte të një projekti mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore". Kërkesa për disponibilitetin e Çertifikatës ISO 39001:2012 "Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor" lidhet drejtëpërdrejt me rikonstruksionin apo mirëmbajten e një aksi/segmenti rrugor të caktuar, ndërkohë që objekti i procedurës së prokurimit i përket rehabilitimit të një skeme ujitëse. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Procedura e prokurimit me objekt **"Riparim i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2024.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Riparim i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5, datë 15.07.2024 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedurë e hapur"	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 104, datë 15.07.2024. 1. T. A. (Jurist) 2. J. T. (Arkitekt) 3. K. Sh. (Ekonomist)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 106, datë 15.07.2024. 1. A. Xh. (Kryetar) 2. Xh. K. (Anëtar) 3. E. E. (Anëtar) Urdhri nr. 133, datë 21.08.2024, për ndryshimin e kryetarit të KVO, z. A. E. me znj. J. C.
5. Fondi Limit: 70,841,099 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK me vlerë oferte 51,438,765 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit:** 19,402,334 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 09.09.2024.	**9. Burimi i Financimit:** Fondet nga Ministria e Mbrojtjes në vlerën totale prej 85,009,319 lekë e ndarë kjo: - Për vitin 2024 në vlerën 29,753,261.65 lekë - Për vitin 2025 vlerën 55,256,057.40 lekë	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 12 OE b) S'kualifikuar: 6 OE 1. BOE "E. C." ShPK & "A." ShPK 2. OE "L.T.E C." ShPK 3. OE "K." ShPK 4. BOE "C." ShPK & "K." ShPk 5. OE "Z." ShPK 6. OE "S." ShPK c) Kualifikuar: 6 1. BOE "V. K." & "S." ShPK 2. OE "Sh." ShPK 3. OE "C." ShPK 4. OE "A." ShPK 5. OE "S." ShPK 6. OE "B." ShPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Vendimi nr. 1458/2024, i KPP-së administruar pranë Bashkisë Memaliaj me praktikën nr. 2289 prot., datë 21.10.2024.
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1583/15 prot., datë 04.11.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 61,726,516.80 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Riparimi i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz", janë siguruar fonde në vlerën 85,009,319 lekë nga Buxheti i Shtetit për vitin 2024, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes (e ndarë për vitin 2024 në vlerën 29,753,261.65 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 55,256,057.40 lekë) në zbatim të VKM-së nr. 307, datë 22.05.2024, "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore". Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 25.07.2024, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 104, datë 15.07.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. T. A., z. J. T., znj. K. Sh.

Me Urdhrin nr. 105, datë 15.07.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 1583/2 prot., datë 15.07.2024, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 70,841,099 lekë pa TVSh.
Me shkresën nr. 1583/3 prot., datë 15.07.2024, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar z. T. A. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik. Me shkresën nr. 1583/5 prot., datë 15.07.2024, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur" me mjete elektronike.
Me Urdhrin nr. 5, datë 15.07.2024, z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Riparim i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz" me fond limit 70,841,099 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur". Për realizimin e Projekt Zbatimit për këtë procedurë është kontraktuar Studio Projektimi "A." ShPK me Nipt L... dhe licencë nr. 6... me afat vlefshmërie deri më datë 29.01.2028, përfaqësuar nga z. B. H. Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Albumi i fotografive;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;
- Raporti teknik;

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën e datës 25.07.2024, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.
Me shkresën e datës 13.08.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është pezulluar procedura e prokurimit referuar kërkesës së bërë nga OE "H." ShPK. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe nga komunikimet verbale me punonjësit e institucionit pjesë e NjP, nga këtë të fundit nuk administrohet kjo kërkesë si pjesë e dosjes së kësaj procedure prokurimi.
Me shkresën e datës 13.08.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është hequr pezullimi mbi procedurën e prokurimit, ku me shkresën e datës 13.08.2024, është hartuar një Shtojcë në Dokumentet e Tenderit. Më datë 23.08.2024, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Memaliaj, rezulton se: Për procedurën me REF-14433-07-25-2024, me objekt "Riparimi i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz" me fond limit 70,841,099 lekë pa TVSh, ka sygjeruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Me shkresën e datës 03.09.2024, është hartuar procesverbali lidhur me reflektimin e rekomandimeve të dhëna nga APP-ja, duke hartuar njëkohësisht një Shtojcë në Dokumentet e Tenderit. Me shkresën e datës 03.09.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, ka pezulluar procedurën e prokurimit për arssye të paraqitjes së ankesës së OE "R. C. C." ShPK në Regjistrin Elektronik të Ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 2874/2024, datë 08.10.2024, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Më datën 07.10.2024, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër elektronik A/2024/4630 dhe me nr. 2874/2024 prot., datë 08.10.2024, nga BOE "A." ShPK & "E. C. C." ShPK. Objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimarrjes së KVO, mbi s'kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ky BOE.
Me shkresën nr. 2874/7 prot., datë 17.10.2024, KPP-ja ka paraqitur pranë AK Bashkia Memaliaj Vendimin nr. 1458/2024, të nënshkruar nga z. J. M. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. K. T., z. Gj. M., administruar pranë Bashkisë me praktikën nr. 2289 prot., date 21.10.2024.

Në këtë vendim citohet se: "Me shkresën nr. 306 prot., datë 16.10.2024, me objekt "Kërkesë për tërheqje nga ankimimi" protokolluar pranë KPP-së me nr. 2874/3 prot., datë 17.10.2024, BOE "A." ShPK & "E. C. C." ShPK, ka paraqitur pranë KPP-së një kërkesë për tërheqje nga ankesa për procedurën e mësipërme të prokurimit".
Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:
1. Në pikën nr. 2.3.2. Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar per keto punime.
a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë ose licencë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën 3 (tre) mujori i fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:
- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhiner Topograf/Gjeodet/Markshajder

b) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
a) Kontratë pune e vlefshme;
b) Diplomë;
(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkepunimit).
c) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën 1 (një) mujori i fundit, konkretisht:
- 1 (një) Inxhinier të kualifikuar në fushën e sigurisë në pune, që disponon çertifikatë si "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë,* secili operator ekonomik duhet të disponojë punonjësin, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes*).*
Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë apo çertifikatën e kualifikimit.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i

jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
2. Në pikën nr. 2.10. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të asfaltit, për sa mësipër duhet të paraqesë dokumentacionin për: **1 (një) Fabrik/Impiant Asfalti** me QKL në Pronësi/kontratë noteriale qiraje/kontrate noteriale furnizimi (të vlefshme përgjatë gjithë afatit të kësaj kontrate).
Mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 155 C deri në 170 C, Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët **se 100 km** nga vendndodhja e objektit të prokurimit.
Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit **jo më pak se 140 C**, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe VKM nr. 628, datë 15.07.2015. Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartëpërmendur shoqëruar me kontratën noteriale të furnizimit (e vlefshme përgjatë gjithë afatit të kësaj kontratë), si dhe me **deklaratën e garancisë së prodhuesit** ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara dhe afati i furnizimit.
4.1. Në pikën nr. 2.11. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi noteriale, për të paktën **1 (një) Impiant prodhimi të materialeve Inerte** që parashikohen në preventivin e veprës si çakull dhe stabilizant. Për sa mësipër duhet të paraqitet dokumentacioni i pronësisë apo marrjes me qira, apo kontrate noteriale furnizimi.
Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartëpërmendur shoqëruar me kontratën noteriale të furnizimit (e vlefshme përgjatë gjithë afatit të kësaj kontrate), si dhe me **deklaratën e garancisë së prodhuesit** ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara dhe afati i furnizimit.

Vendosja e këtij kriteri është i tepërt pasi kufizon pjesmarrjen e operatorëve të tjerë të cilët kanë vendodhjen në një largësi më të largët se 100 km nga segmenti i rrugës që do të shtrohet, pasi disa nga OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzierjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.

Operatorët Ekonomikë në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë kërkesa për paraqitjen e **lejes mjedisore,** mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurues/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (inerte dhe betone etj.,), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarin në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të Shtetit Shqiptar. Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. T. A., **z. J. T., znj. K. Sh.** në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 106, datë 15.07.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. A. Xh. kryetar i komisonit dhe anëtarët znj. Xh. K., znj. E. E.

Me Urdhrin nr. 133, datë 21.08.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është kryer një ndryshim në KVO duke u zëvendësuar kryetarin e komisionit z. A. Xh. me znj. J. C.

Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 1583/10 prot., datë 17.10.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 6 OE dhe s'kualifikuar 6 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE "A." ShPK (me Nipt K...) **& "E. C. C." ShPK** (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **44,851,558.50 lekë pa TVSh;**

2. OE "L." ShPK (me Nipt L...) me vlerë të ofertës **45,598,667.10 lekë pa TVSh;**

3. OE "K." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **45,675,107.34 lekë pa TVSh;**

4. BOE "C." ShPK (me Nipt L...) **& "K." ShPK** (me Nipt L...) me vlerë të ofertës **46,010,370 lekë pa TVSh;**

5. BOE "Sh." ShPK (me Nipt K...) **& "V. K." ShPK** (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **51,438,765 lekë pa TVSh;**

6. OE "Sh." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **51,551,693 lekë pa TVSh;**

7. OE "C." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **53,847,276 lekë pa TVSh;**

8. OE "A." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **54,241,478 lekë pa TVSh;**

9. OE "S." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **54,545,841 lekë pa TVSh;**

10. OE "B." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **60,214,930 lekë pa TVSh;**

11. OE "Z." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **70,839,726 lekë pa TVSh;**

12. OE "S." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **70,840,497 lekë pa TVSh;**

Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. BOE "A." ShPK & "E. C. C." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.1, për të cilën OE "E. C. C." ShPK ka paraqitur dokumentacion për dy kontrata punë publike:

1. "Rehabilitimi i rrugëve dytësore në zonën turistike Plepa-Golem";
2. "Emergjencë shembje në aksin rrugor Qafë-Dushk Sevaster";

Në kontratën e parë nuk konstatohet të ketë realizim punimesh "Babion me rrjetë tel xingato etj.,". Si rrjedhim nuk plotësohet puna e ngjashme për sa i përket llojit të punimeve me ato të projektit të objektit që prokurohet. Në kontratën e dytë evidentohet të ketë punime të ngjashme me objektin që prokurohet por nuk përmbushet niveli i përqindjes së parashikuar kërkesën e sipërpërmendur. Vlera totale e kontratës "Emergjencë shembje në aksin rrugor Qafë-Dushk Sevaster" është në vlerën 17,940,000 lekë pa TVSh ose në vlerën 21,528,000 lekë me TVSh. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga OE "E. C. C." ShPK pjesa e realizimit nga ky operator është në vlerën 10,764,000 lekë. Ky operator në referencë të kërkesës nr. 2.3.1, duhet të paraqiste dokumentacion për punë të ngjashme në vlerën 35,420,550 lekë pa TVSh. Ose në bazë të % të deklaruar në BOE do të duhej të paktën 31,878,495 lekë pa TVSh ose jo më të vogël se dyfishi respektivisht jo më pak se 127,513,978 lekë pa TVSh.

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.5, nga OE "A." ShPK nuk është paraqitur ISO 39001:2012 "Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugore" ose ekuivalente (e vlefshme).

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.10, dokumentacioni i paraqitur për Impiant Asfaltobeton, Inerte dhe Betone me vendodhje pasurie Z.K 2863, nr. pasurie 30/260 Bashkia Himarë, Palasë në pronësi të OE "E. C. C." ShPK, pra nuk respektohet distanca prej 100 km nga vendodhja e objektit që prokurohet.

- Pasaktësi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit konkretisht për 17 copë makineri dhe pajisje të dhënat e kontratës së marrjes me qira nuk janë të plota.

Më datën 07.10.2024, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër elektronik A/2024/4630 dhe me nr. 2874/2024 prot., datë 08.10.2024, nga BOE "A." ShPK & "E. C. C." ShPK. Objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimarrjes së KVO, mbi s'kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ky BOE.

Me shkresën nr. 2874/7 prot., datë 17.10.2024, KPP-ja ka paraqitur pranë AK Bashkia Memaliaj Vendimin nr. 1458/2024, të nënshkruar nga z. J. M. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. K. T., z. Gj. M., administruar pranë Bashkisë me praktikën nr. 2289 prot., date 21.10.2024.

Në këtë vendim citohet se: "Me shkresën nr. 306 prot., datë 16.10.2024, me objekt "Kërkesë për tërheqje nga ankimimi" protokolluar pranë KPP-së me nr. 2874/3 prot., datë 17.10.2024, BOE "A." ShPK & "E. C. C." ShPK, ka paraqitur pranë KPP-së një kërkesë për tërheqje nga ankesa për procedurën e mësipërme të prokurimit".

2. OE "L. C." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.1, për të cilën OE "L. C." ShPK ka ngarkuar në SPE disa kontrata punë publike të realizuara ndër vite kryesisht rrugë dhe ndërtesa, por të cilat nuk janë punë të ngjashme me objektin që prokurohet. OE duhej të paraqiste dokumentacion për punë të ngjashme në vlerën 35,420,550 lekë pa TVSh për 1 kontratë të vetme ose jo më të vogël se dyfishi respektivisht jo më pak se 141,682,198 lekë pa TVSh për disa kontrata.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.10, ka paraqitur 2 kontrata furnizimi për produktet e asfaltit por për asnjë nuk respektohet distanca prej 100 km nga vendodhja e objektit që prokurohet.

3. OE "K." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.10, në SPE OE "K." ShPK në kontratën e furnizimit nuk përshkruhet afati kalendarik i vlefshmërisë së saj por as emërtimi i objektit.
- Pasaktësi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit konkretisht për disa pajisje apo makineri të disponuara me qira, të dhënat e kontratës janë të paplota, të pasakta për sa i përket numrit të kontratës noteriale.

4. BOE "C." ShPK & "K." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.1, për të cilën BOE "C." ShPK & "K." ShPK ka ngarkuar në SPE disa kontrata punë publike të realizuara ndër vite por të cilat nuk janë punë të ngjashme me objektin që prokurohet. OE duhej të paraqiste dokumentacion për punë të ngjashme në vlerën 35,420,550 lekë pa TVSh për 1 kontratë të vetme ose jo më të vogël se dyfishi respektivisht jo më pak se 141,682,198 lekë pa TVSh për disa kontrata.
- OE "K." ShPK nuk ka të deklaruar numrin e punonjësve për tre mujorin e fundit në formularin e vetëdeklarimit. Nuk është paraqitur asnjë vërtetim për të kuptuar personelin mesatar 3 muajit të fundit. Do të mjaftonte vetëdeklarimi për periudhën e caktuar në Shtojcën nr. 7.
- Pasaktësi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit konkretisht për disa pajisje apo makineri të disponuara me qira, të dhënat e kontratës janë të paplota, të pasakta për sa i përket numrit të kontratës noteriale.

5. OE "Z." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.5, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponibilitetin e çertifikatave ISO 9001:2015, ISO 14001-2015, ISO 45001-2018 dhe ISO 39001:2012.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.1, nuk ka paraqitur asnjë kontratë që vërteton përvojën dhe punët e ngjashme sipas përcaktimeve të këtij kriteri.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.8, lidhur me numrin e automjeteve të parashikuara në DT.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.10, nuk ka paraqitur asnjë kontratë ose marrëveshje që garantojnë furnizimin me asfalt dhe materiale inerte.

6. OE "S." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.8, lidhur me numrin e automjeteve të parashikuara në DT.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.10, ku referuar kontratës së paraqitur nga OE "S." ShPK për furnizimin e produktit të asfaltit me OE "R." ShPK konstatohet se nuk përmbushet kriteri i

distances së largësisë nga vendodhja e objektit që prokurohet me vendodhjen e fabrikës e cila është më e largët se 100 km.
Me shkresën nr. 1583/10 prot., datë 17.10.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 1583/11 prot., datë 17.10.2024. Me shkresën nr. 1583/14 prot., datë 23.10.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme e BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK.
Nga auditimi i dokumentacionit të BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:
1. Në pikën nr. 2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

Nga OE "Sh." ShPK janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023 (pjesë e dokumentacion fizik të dosjes të dorëzuar pranë Bashkisë Memaliaj), në Bashkinë Tiranë vërtetimin e datës 28.05.2024, Bashkinë Mallakastër vërtetimin nr. 2071/1 prot., datë 03.05.2024, dhe Bashkinë Fier Faturën e Likudimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nr. 18.06.2024.

Nga OE "Sh." ShPK nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Vlorë referuar likuidimeve për një kontratë nga Dega e Thesarit Vlorë ndërkohë që ka ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2023 në këtë qytet konkretisht:
a) Kontrata nr. 705 prot., datë 18.04.2023, Këshilli i Qarkut Vlorë me objekt "Rikonstruksioni i disa akseve kryesore të Njësisë Novoselë":
- Fatura nr. 191/2023, datë 08.05.2023, në vlerën 16,150,000 lekë regjistruar më datë 24.05.2023, dhe likuiduar më datë 25.05.2023, nga Dega e Thesarit Vlorë;
b) Kontrata nr. 1857 prot., datë 14.02.2023, lidhur me Bashkinë Vlorë me objekt "Rikonstruksioni rruga Kërkovë":
- Fatura nr. 208, datë 30.05.2023, në vlerën 4,101,880 lekë regjistruar më datë 21.06.2023, dhe likuiduar më datë 22.06.2023, nga Dega e Thesarit Vlorë;
c) Kontrata nr. 6040 prot., datë 23.05.2023, lidhur me Bashkinë Vlorë me objekt "Rehabilitim sistemim rrugët e Rajonit 1, 2, 3, 4, 5":
- Fatura nr. 231, datë 22.06.2023, në vlerën 27,164,519 lekë regjistruar më datë 26.06.2023, dhe likuiduar më datë 27.06.2023, nga Dega e Thesarit Vlorë; *Vlen të theksohet se kjo kërkesë quhet e përmbushur në momentin e paraqitjes si dokumentacion në SPE dhe jo duke e deklaruar në Formularin Përmbledhës së Deklarimit. Nga auditimi u konstatua se, OE "Sh." ShPK dhe "V. K." ShPK nuk kanë ngarkuar në SPE dokumentacionin mbi shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023.*
2. Në pikën nr. 2.8. Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion:
a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike (pronësi ose me qira), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion kapacitet mbajtës mbi 25 ton	4 copë	Pronësi ose me qira
Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3-4 ton)	2 copë	Pronësi ose me qira
Fadromë Kovë përpara dhe mbrapa	1 copë	Pronësi ose me qira
Eskavatorë me zinxhirë	1 copë	Pronësi ose me qira
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qira
Buldozer	1 copë	Pronësi ose me qira
Minieskavatorë	1 copë	Pronësi ose me qira
Rrul Gome - Gome për Asfalt mbi 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Rrul Hekur - Hekur mbi 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Rrul Vibrues Gome - Hekur mbi 18 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Rrul me Kompresor dhe Vibrim min 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Autovinç/kamion me vinç	4 copë	Pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	2 copë	Pronësi ose me qira
Autobot uji me sprucator	1 copë	Pronësi ose me qira

Grejder	2 copë	Pronësi ose me qira
Paisje topografike GPS	1 copë	Pronësi ose me qira
Batipal/Montues *(për Guardrail)*	1 copë	Pronësi ose me qira
Freze Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qira
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qira
Kompresor	2 copë	Pronësi ose me qira
Betonforme/armaturë	500 m^2	Pronësi ose me qira
Prerëse kthyese hekuri	1 copë	Pronësi ose me qira
Makineri vijëzimi	1 copë	Pronësi ose me qira
Prerëse/sharrë asfalti	2 copë	Pronësi ose me qira
Pirun ngrites	2 copë	Pronësi ose me qira
Gjenerator	5 copë	Pronësi ose me qira
Fikse zjarri	5 copë	Pronësi ose me qira
Kuti të ndihmës së shpejtë	10 copë	Pronësi ose me qira
Semaforë sinjalistike për punime rrugore	1 copë	Pronësi ose me qira
Tabela sinjalistike sigurimi teknik	50 copë	Pronësi ose me qira
Projektor ndriçimi	10 copë	Pronësi ose me qira
Rimorkiator - Tërheqës	1 copë	Pronësi ose me qira
Rimorkio për transportin e makinerive	1 copë	Pronësi ose me qira

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; dhe fotot përkatëse;
- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve sipas afatit të kërkuar.
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, *(Autobitumatriçe)* duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Për mjetet Grejder (2 copë) të deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të disponueshme nga OE "Sh." ShPK në pronësi me numër shasie V... dhe C..., janë paraqitur deklaratat doganore, pra nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponojnë çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por deklarata doganore/Fatura Tatimore Blerje. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".

OE "Sh." ShPK për disponibilitetin e një Autoboti Uji me Sprucator, ka paraqitur mjetin me targë A... Ky mjet referuar të dhënave të Lejes së Qarkullimit me nr. F..., pika nr. 6 "Kodi i karrocerisë", i përket kategorisë CE "Çisterna për transportin e mallrave të rrezikshëm të ndezshme dhe nënprodukteve të naftës" dhe jo Autobot Uji me Sprucator.

Për sa trajtuar më sipër BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në shpalljen fitues të BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **znj. J. C.** Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **znj. Xh. K., znj. E. E.**

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/13 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës z. T. A., znj. E. E., znj. Xh. K., z. B. C., znj. L. M., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kriterin 2.10, i cili parashikon paraqitjen e një kontrate përdorimi, huaje, qiraje ose dokumentacioni që vërteton pronësinë mbi një fabrike ose impiant për prodhimin e asfaltobetonit, me kusht që ky impiant të ndodhet brenda një distancë jo më të madhe se 100 km nga kantieri i ndërtimit, si dhe të jetë i pajisur me lejen mjedisore përkatëse, sqarojmë se ky kriter është përcaktuar me qëllim garantimin e kapaciteteve dhe kushteve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt të kontratës. Argumentuar sipas VKM nr 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prkurimit publik" i ndryshuar, kërkesat e STASH 66-87 DHE STASH561-87, për të pasur një cilësi sipas standarteve të kërkuara për ndërtimin dhe shtrimin e asfaltit temperaturë e duhur për shtresën e asfaltit e cila nuk duhet të jetë më pak se 100 gradë pasi ngjeshja nuk bëhet e duhur dhe prish cilësinë e kërkuar dhe prishur lidhjen e elementëve përbërës midis tyre, e argumentuar dhe e mbeshtëtutr në ligje sipas PCV të argumentimit të kritereve dhe aprovuar nga APP është marrë në kosideratë kushti përkatës. KVO-ja ka s'kualifikuar të gjithë operatoret ekonomikë që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në dokumentet e DT-së. Lidhur me kriterin për paragitjen e një personi pergjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, sqarojmë se ky kriter është përcaktuar dhe miratuar në përputhje me kërkesat e parashikuara në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prkurimit publik" i ndryshuar duke marrë në konsideratë edhe numrin e lartë të punonjësve të kërkuar për zbatimin e këtij projekti. Kërkesa për disponimin e një personi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është vendosur me qëllim garantımin e respektimit të kërkesave ligjore dhe teknike në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe për të garantuar mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave të nevojshme gjatë realizimit të punimeve. Për sa i përket mjeteve Grejder, me numër shasie V... dhe C..., nga dokumentacioni doganor i paraqitur rezulton se deklaratat doganore janë lëshuar në emër të subjektit ekonomik që i ka paraqitur ato.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Vendosja e një distance të përcaktuar jo më larg se 100 km nga segmenti i rrugës që do të shtrohet për disponibilitetin e një fabrike në pronësi apo me qira asfalto-betoni, është kriter i tepërt pasi kufizon pjesëmarrjen e OE të cilët kanë vendodhjen në një largësi më të largët se 100 km pasi disa OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzierjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.

- Fryma dhe qëllimi i LPP është të nxisë pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në këtë kuptim, referuar zërave të termave të referencës, grafikut të punimeve dhe afatit kohor për realizimin e punimeve konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e operatorit ekonomik të llojit të makinerive të mësipërme është e ekzagjeruar. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. OE konkurues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore, mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.
- Kërkesa për disponim "Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë" është e dubluar dhe konsiderohet e tepërt. Në DT është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me certifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi certifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë certifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet certifikuese ndaj dhe kjo certifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- Për mjetin Grejder dokumentacioni i zhdoganimit nuk është i vetmi dokumentacion që bënë të vlefshëm plotësimin e kriterit të parashikuar në DT, për arsye se ky mjet përfshihet në kategorinë e mjeteve teknologjike dhe sipas kritereve të DT dhe dispozitave ligjore përkatëse mbi qarkullimin rrugor duhet të jetë i pajisur edhe me lejen e qarkullimit, siguracionin, çertifikatë të kontrollit teknik etj.,. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5. Procedura e prokurimit me objekt **"Blerje karburant për mjetet në inventar",** Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2024:

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje karburant për mjetet në invetar".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1, datë 15.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 8, datë 15.04.2024. 1. E. Sh. (Jurist) 2. D. S. (Ekonomist) 3. B. Xh. (Jurist)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 10, datë 15.04.2024. 1. T. A. (Kryetar) 2. J. C. (Anëtar) 3. J. T. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur e thjeshtuar"		
5. Fondi Limit: 8,772,000 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** BOE "K." ShPK me vlerë oferte 8,103,861 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit:** 668,139 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 08.05.2024.	**9. Burimi i Financimit:** Nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj në vlerën totale prej 8,772,000 lekë	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) S'kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 1. OE "K." ShPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 112/13 prot., datë 24.05.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 9,724,633 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritia e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje karburant për mjetet në inventar" për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve, janë siguruar fonde në vlerën 8,772,000 lekë nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj, ku miratimi për përdorimin e këtyre fondeve është kryer nëpërmjet Vendimit nr. 93, datë 27.12.2023, të Këshillit Bashkiak Memaliaj me objekt "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", duke marrë njëkohësisht edhe konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1083/1 prot., datë 08.01.2024.

Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 16.04.2024, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Bashkëlidhur këtij vendimi ndodhet e tabela e normativave dhe plani mujor mbi konsumin e karburantit për mjetet e Drejtorisë së Shërbimeve konkretisht:

Nr.	**Lloji i mjetit**	**Përdoruesi**	**Litra ose orë pune**	**Litra në muaj**
1	Makina tip Xhip B.	Administrata e Bashkisë	12	400
2	Makina tip Xhip Ch.	Administrata e Bashkisë	12	400
3	Mjete të marra me qira	5 Njësi Administrative	12	500
4	Furgoni	Administrata e Bashkisë	15	250
5	Makina Zjarrfikëse	PMNZSH	25	300
6	Makina zjarrfikëse (tip xh.)	PMNZSH	25	250
7	Makina xh. me karroceri	Drejtoria e Shërbimit	12	400
8	Eskavator J..	Drejtoria e Shërbimit	10	900
9	Eskavator C.	Drejtoria e Shërbimit	10	900
10	Makinë vetëshkarkuese tip B.	Drejtoria e Shërbimit	30	600
11	Makinë vetëshkarkuese tip M.	Drejtoria e Shërbimit	30	600
12	Makinë vetëshkarkuese tip B.	Drejtoria e Shërbimit	30	600
13	Minieskavator 5 Ton	Drejtoria e Shërbimit	5	300
14	Minieskavator 9 Ton	Drejtoria e Shërbimit	5	250
15	Makina Pastrimi	Drejtoria e Shërbimit	15	750
16	**Karburant Benzinë Betonierë dhe Motoshara**	**Drejtoria e Shërbimit**		**400**
Totali				**7,800**

Me Urdhrin nr. 8, datë 15.04.2024, të z. S. M. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. E. Sh., znj. D. S., z. B. Xh.
Me Urdhrin nr. 9, datë 15.04.2024, të z. S. M. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve në cilësinë e Titullarit të AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 112/2 prot., datë 15.04.2024, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 8,772,000 lekë pa TVSh.
Nga auditimi u konstatua se, nuk argumentohet sasia e karburantit e prokuruar prej 50,350 litra naftë dhe 3,800 litra benzinë duke marrë në konsideratë faktin që sasia e karbuantit e parashikuar në buxhetin vjetor të vitin 2024 është 88,800 litra naftë dhe 4,800 litra benzinë.
Për sasinë e karburantit të prokuruar nuk përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen me karburant, furnizimet e viteve të mëparshme dhe analiza e detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet së bashku me plan shpërdarjen për mjetet në Drejtorinë së Shërbimeve pranë Bashkisë Memaliaj. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimitpublik" i ndryshuar, neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".
Me shkresën nr. 112/3 prot., datë 15.04.2024, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar" me mjete elektronike. Me shkresën nr. 112/4 prot., datë 15.04.2024, NjP ka hartuar procesverbalin me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar z. E. Sh. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik.
Me Urdhrin nr. 1, datë 15.04.2024, të z. S. M. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve në cilësinë e Titullarit të AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Blerje karburant për mjetet në inventor" me fond limit 8,772,000 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur e thjeshtuar".

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën e datës 22.04.2024, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit. Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:
1. Në pikën nr. 2.2.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport fletë-analizë për produktin Naftë Euro-Disel Dl 10PPM, për disponimin e çertifikatës EN 590:2013 + Al:2017, AK pranon edhe mundësinë e disponimit të çertifikatës ekuivalente (të rinovuar) të njohur nga Standardet shqiptare SSH EN 590:2022, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj n.q.s është laborator i huaj duhet përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standardeve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të lëshuara jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave. Për sa i përket kërkesës se OE duhet të paraqesi "Fletë Analizë/Raport Testimi" për artikullin Naftë Euro-Disel Dl 10PPM, lëshuar jo më parë 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga ISHT ose nga një organ/subjekt i çertifikuar/autorizuar/akreditуar nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, fletë analiza ose raporti i testimit vlen për gjendjen në depozitë të sasisë së karburantit dhe jo për gjendjen e depozitës së muajit Dhjetor të vitit 2023 si afat maksimal i kërkuar në këtë kërkesë për të cilën sasia e karburantit mund të jetë shitur.
Në lidhje me kriterin për paraqitjen e "Fletë Analizë/Raport Testimi" për artikullin Naftë Euro-Disel Dl 10PPM vlen të theksohet se kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që mallrat e përdorur janë në

përputhje/sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK. Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE pjesëmarrës i cili duhet të jetë i pajisur me vërtetim të lëshuar nga ISHT-i (Inspektoriati Shtetëror Teknik), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburant siaps standardeve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë. Ky kriter bazohet në nenin 36, dhe nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" si dhe nenin 44, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"*, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. Sh., znj. D. S., z. B. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

<u>Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</u>
Me Urdhrin nr. 10, datë 15.04.2024, të z. S. M. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. T. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. J. C., z. J. T.
Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 112/8 prot., datë 10.05.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "K." ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofertuara:

1. OE "K." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **8,103,861 lekë pa TVSh;**

Me shkresën nr. 112/9 prot., datë 10.05.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve në cilësinë e Titullarit të AK-së, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 112/10 prot., datë 10.05.2024. Me shkresën nr. 112/11 prot., datë 14.05.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afatve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme e OE "K." ShPK.

Për sa trajtuar më sipër, nuk janë konstatuar parregullsi në vlerësimin e OE "K." ShPK të shpallur fitues.

<u>6.</u> Procedura e prokurimit me objekt **"Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambiente sportive",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2024.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambiente sportive".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 7, datë 07.08.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 122, datë 07.08.2024. 1. Xh. K. (Jurist) 2. J. T. (Arkitekt) 3. J. C. (Ekonomist)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 124, datë 07.08.2024. 1. L. M. (Kryetar) 2. T. A. (Anëtar) 3. E. E. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"		
5. Fondi Limit: 148,852,680 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** BOE "S." ShPK & "G." ShPK me vlerë oferte 145,880,556.75 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit:** 2,972,123.25 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.09.2024.	**9. Burimi i Financimit:**	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 3 OE

	Bashkëfinancim në vlerën totale prej 178,623,216 lekë e ndarë kjo: a) Vlera prej 26,793,481 lekë nga buxheti i Bashkisë Memaliaj - Për vitin 2024 në vlerën 8,250,000 lekë; - Për vitin 2025 në vlerën 18,543,482 lekë; b) Vlera prej 151,829,735 lekë fonde nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e ndarë kjo: - Për vitin 2024 në vlerën 55,000,000 lekë; - Për vitin 2025 në vlerën 96,829,734 lekë;	b) S'kualifikuar: 2 OE 1. BOE "L." ShPK & "N." ShPK 2. OE "D. P." ShPK c) Kualifikuar: 1 1. BOE "S." ShPK & "G." ShPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1722/14 prot., datë 20.11.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 173,942,580.1 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambiente sportive", janë siguruar fonde në vlerën 178,623,216 lekë si rezultat i bashkë financimit ndërmjet Bashkisë Memaliaj në vlerën prej 26,793,481 lekë (e ndarë për vitin 2024 në vlerën 8,250,000 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 18,543,482 lekë) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në vlerën 151,829,735 lekë (e ndarë për vitin 2024 në vlerën 55,000,000 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 96,829,734 lekë).

Miratimi për përdorimin e këtyre fondeve është kryer nëpërmjet Vendimit nr. 50, datë 19.07.2024, të Këshillit Bashkiak Memaliaj me objekt "Mbi miratimin e burimeve të financimit për Projektin "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambiente sportive" dhe shkresës me nr. 1815/5 prot., datë 27.03.2024, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me objekt "Transferim fondi për shpenzime kapitale" administruar pranë Bashkisë Memaliaj me praktikën nr. 738 prot., datë 28.03.2024. Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 20.08.2024, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 122, datë 07.08.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K., z. J. T. dhe znj. J. C.

Me Urdhrin nr. 123, datë 07.08.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 1722/2 prot., datë 07.08.2024, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 148,852,680 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 1722/3 prot., datë 07.08.2024, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar znj. Xh. K. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik.

Me shkresën nr. 1722/4 prot., datë 07.08.2024, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur" me mjete elektronike.

Me Urdhrin nr. 7, datë 07.08.2024, z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambientet sportive" me fond limit 148,852,680 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur".

Për realizimin e Projekt Zbatimit për këtë procedurë është kontraktuar Studio Projektimi "E. & L. C." me Nipt L... përfaqësuar nga Inxhinier z. B. B.. Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Formati i Aplikimit për Projektet me nr. 140 prot., datë 07.02.2024;
- Preventivi i punimeve;

- Grafiku i punimeve;
- Relacioni teknik;
- Specifikimet teknike;
- Projekt zbatimi;
- Oponenca Teknike e hartuar nga UP Tiranë me nr. 1597 prot., datë 16.07.2024;

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 1722/7 prot., datë 07.08.2024, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Më datë 06.09.2024, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Memaliaj, rezulton se: Për procedurën me REF-16723-08-204, me objekt "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambiente sportive" me fond limit 148,852,680 lekë pa TVSh, ka sygjeruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Ky e-mail është administruar pranë Zyrës së Protokollit në Bashkinë Memaliaj me praktikën nr. 1722/8 prot., datë 06.09.2024.

Me Urdhrin nr. 146, datë 20.09.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është pezulluar procedura e prokurimit në zbatim të reflektimeve sipas rekomandimeve të dhëna nga APP-ja.

Me Urdhrin nr. 147, datë 20.09.2024, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është hequr pezullimi mbi procedurën e prokurimit, ku me shkresën nr. extra prot., datë 20.09.2024, është hartuar procesverbali lidhur me reflektimin e rekomandimeve të dhëna nga APP-ja, duke hartuar njëkohësisht një Shtojcë në Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.2. OE duhet të paraqesin liçencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MIE, sipas formatit të miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008, *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi"*. Shqyrtimi i liçencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

1.1. Nënpika nr. 2.3.2/1. Kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Liçenca	Kategoritë e kryerjes së punimeve
1	N.P 1-A	Punime gërmimi në tokë
2	N.P 3-D	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
3	N.P 7-A	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
4	**N.P 12-B**	**Punime të inxhinierisë mjedisore**
5	N.S 1-A	Punime për prishjen e ndërtimeve
6	N.S 2-A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
7	N.S 4-B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
8	N.S 12-A	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
9	N.S 14-A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

NP - 12 "Punime të inxhinierisë së mjedisit": Duke marrë shkas nga punimet e përfshira në Dokumentet Teknike të Procedurës *(preventivë punimesh, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik)* u konstatua se, për zbatimin e objektit të kontratës, nuk janë parashikuar ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik, ose punime që përfshijnë në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eleminimin e prishjes së ekulibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte (përkufizimi i kategorisë NP-12 sipas VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar)*.

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në **Projekt.** Objekti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: *"VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte **të një projekti** mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore"*.

2. Në pikën nr. 2.3.2/2. Personelin kryesor, drejtues teknik në liçencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi;
- **1 (një) Inxhinier Mekanik;**
- **1 (një) Arkitekt;**
- **1 (një) Inxhinier Elektronik;**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi;**
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese"*.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë:

Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune, CV , të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Në pikën nr. 2.3.4. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës *(jo domosdoshmërisht drejtues teknik në liçencën e shoqërisë)*, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi;**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik;**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog;**

Sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8, *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese"*. Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë:

Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Ekspertizat profesionale e **Inxhinierit të Mjedisit** është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në lidhje me kërkesën për **Inxhinierë Mjedisi, Mekanik, Elektronik dhe Gjeolog,** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve në fjalë.

Ky kriter nuk është i nevojshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga këta inxhinier.

Në pikën "a", të nenit 1, të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projektet të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim, për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore;

Testimi i formacionit të tokës konsiderohet i realizuar përpara realizimit të projektit, pasi në projekt janë përllogaritur zërat dhe sasia e shtresave të domosdoshme për realizimin e punimeve në objekt.

Ekspertiza profesionale e **Arkitektit** është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike.

Në lidhje me kërkesën për Arkitekt duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e arkitektit.

Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga arkitekti.

3. Në pikën nr. 2.3.2/3. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2. B **"Grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve inerte dhe të ngurta"**, ku të përfsihen dhe kodet 17 05 04 dhe 17 09 04 në përputhje me parashikimet e VKM nr. 538, datë 26.05.2009, "Për licensat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera ligjore të përbashkëta" i ndryshuar.

Subjektet që kryejnë aktivitet, klasifikohen në operatorë ekonomikë që gjeneron mbetje urbane një Njësinë Administrative ku zhvillojnë aktivitet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, hapja e NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në NjA), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifat vendore (si taksë pastrimi, gjelbërimi, tabele etj., sipas ligjit dhe VKB-të përkatëse).

Referuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009, "Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", në Aneksin 1, Kategoria III, Licensimi i veprimtarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9, citohet se "Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjesim i mbetjeve të llojeve të ndryshme".

Kriteri për disponimin e liçencë me Kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve.

Nga auditimi në QKB, Aktiviteti i licensimit ***së ruajtjes së mbetjeve të ngurta,*** ekzistojnë një numër i limituar operatorësh ekonomik, duke zvogëluar ndjeshëm konkurrencën në procedurë. Referuar kërkesës së mësipërme për licencim, konstatohet se nuk është në përputhje me parashikimet ligjore të LPP.

4. Në pikën nr. 2.3.2/4. Operatori ekonomik duhet të jetë pajisur me Liçensë për Mbrojtje nga Zjarri të lëshuar nga QKL, Kodi I.2.A si dhe të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) ekspert zjarrfikës i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë me kodin përkatës të profesionit, të paktën periudhën e fundit të deklaruar.
Për ekspertin zjarrëfikës të paraqitet kontrata e punës dhe çertifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit.
Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, neni 26 *"Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit",* pika 6 *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese"*, si më sipër kërkuar.

4.1. Në pikën nr. 2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:
- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë **"Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave",** e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohen të tepërta këto kërkesa pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë.

Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

5. Në pikën nr. 2.3.2/5. Operatori ekonomik duhet të jetë pajisur me Liçensë për Ndikimin në Mjedis të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.A (1+2) si dhe të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) ekspert mjedisi i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë me kodin përkatës të profesionit, të paktën periudhen e fundit te deklaruar.
Për ekspertin e mjedisit të paraqitet kontrata e punës dhe çertifikatë e vlerësimit të ndikimit në mjedis.
Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 26 *"Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit"*, pika 6 *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese"*, si më sipër kërkuar.

Kriteri për disponimin e liçencës **Kodi III.2.A (1+2)**, nuk është në përputhje me përcaktimet e LPP-së që sanksionin që: *"...çdo kriter i veçantë duhet të jetë në perputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës",* e për rrjedhim, kërkesa për liçencat e sipërcituara duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

Sipas përcaktimit të pikës "a", të nenit 1, të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", sipas së cilës qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, ***përmes parandalimit,*** minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projektet të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim, për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore; Ekspertizat profesionale në fjalë janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

6. Në pikën nr. 2.3.5/2. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek të përgjithshëm**, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së nr.108, datë 09.02.2011, i ndryshuar me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti Kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik t'i vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës.

Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K., z. J. T., znj. J. C. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 124, datë 07.08.2024, të z. M. D. Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e Personit të Autorizuar nga Titullari i AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga znj. L. M. kryetar i komisonit dhe anëtarët z. T. A., znj. E. E.

Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 1722/12 prot., datë 17.10.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 OE dhe s'kualifikuar 2 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga BOE "S." ShPK & "G. C." ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE "L. C." ShPK (me Nipt L...) **& "N." ShPK** (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **99,836,027.80 lekë pa TVSh;**

2. OE "D. P." (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **145,000,000 lekë pa TVSh;**

3. BOE "S." ShPK (me Nipt J...) **& "G. C." ShPK** (me Nipt J...) me vlerë ekonomike të ofertës **145,880,556.75 lekë pa TVSh;**

Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:
1. BOE "L. C." ShPK & "N." ShPK për arsye se:
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.4/1, për të cilën për 1 nga punonjës "Teknik ndërtimi" është paraqitur dokumentacioni si Inxhinier Ndërtimi dhe jo Teknik me diplomë të shkollës së mesme referuar kërkesës në DT;
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.7, për të cilën për mjetet Minifadromë (mjet tekonologjik me goma) 1 copë nuk është i pajisur me targa regjistrimi, Makineri për shpërndarjen uniformë të kornizave të gomës të barit artificial në formularin e Vetë Deklarimit mungojnë të dhënat e faturës dhe Dumper (mjet teknologjike me goma) 2 copë nuk janë të pajisur me targa dhe dokumentacionin shoqërues në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, "Për transportin rrugor" i ndryshuar, neni 47 dhe neni 113;
- Oferta e paraqitur nga BOE për më tepër është ofertë anomalisht e ulët në masën 33%;
2. OE "D. P." për arsye se:
- Mos përmbushjen e pikën nr. 2.3.4/1, për të cilën krahas të dhënave në Formularin e Vetë Deklarimit nuk është plotësuar të dhënat për kodet e profesioneve etj., lidhur me kapacitet e fuqisë punëtore;
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.7, për të cilën për mjetet Eskavator me goma (mjet teknologjike me goma) janë deklaruar 2 copë, Fadromë me goma (mjet teknologjik) nuk është deklaruar asnjë copë, Dumer (mjet teknologjike me goma) është deklaruar 1 copë, Mjet funksional teleskopik (pirun + vinç) me krah mbi 10 m/vinç eskavator nuk është deklaruar asnjë copë dhe Autobetoniere me kapacitet 2.5-3m^3 (mjet teknologjik me goma) nuk është deklaruar asnjë copë;
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.7/1, pasi nuk është paraqitur kontratë laboratori për analizat e betonit, sipas standardit SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892-1:2016;
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.7/2, pasi nuk është paraqitur autorizimi dhe katalogët për listën e materialeve sipas kësaj kërkese;
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.4.2, pasi nuk është paraqitur grafiku i punimeve;
Me shkresën nr. 1722/13 prot., datë 17.10.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit. Me shkresën e datës 07.11.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme e BOE "S." ShPK & "G. C." ShPK.
Nga auditimi i dokumentacionit të BOE "S." ShPK & "G. C." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:
1. Në pikën nr. 2.3.2/3. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2. B "Grumbullim, **ruajtje** dhe transportim të mbetjeve inerte dhe të ngurta", ku të përfsihen dhe kodet 17 05 04 dhe 17 09 04 në përputhje me parashikimet e VKM nr. 538, datë 26.05.2009, "Për liçensat dhe lejet që trjtohen nga ose nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera ligjore të përbashkëta" i ndryshuar.

Nga OE "S." ShPK në Sistemin e Prokurimit Publik është paraqitur Liçensa e Kategorisë III.2.B, sipas Aktit të Miratimit nr. 9.., datë 12..., lëshuar nga AKM/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Në pikën nr. 2, të kësaj liçense citohet se: "Aktiviteti i liçensuar: "Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të ngrutra";

Nga OE "G.P.G. C." ShPK në Sistemin e Prokurimit Publik është paraqitur Liçensa e Kategorisë III.2.B, sipas Aktit të Miratimit nr. 9.., datë 15..., lëshuar nga AKM/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Në pikën nr. 2, të kësaj liçense citohet se: "Aktiviteti i liçensuar: "Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dherave";

Në liçensën e paraqitur nga secili operator ekonomik nuk është përfshirë **nënkategori ruajtja e mbetjeve të ngurta e kërkuar në kriterin nr. 2.3.2/3.**

Për sa trajtuar më sipër BOE "S." ShPK & "G. C." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më

sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në shpalljen fitues të BOE "S." ShPK & "G. C." ShPK pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **znj. L. M.** Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **z. T. A., znj. E. E.**

Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2025,** deri më **31.12.2025,** paraqiten si më poshtë:

7. Procedura e prokurimit me objekt **"Asfaltimi i Rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2025.

<table>
<tr><th colspan="3">a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Asfaltimi i Rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj".</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi:
Nr. 5, datë 13.03.2025</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:
Nr. 62, datë 13.03.2025.
1. Xh. K. (Jurist)
2. L. M. (Inxhinier)
3. K. Sh. (Ekonomist)</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 64, datë 13.03.2025.
1. T. A. (Kryetar)
2. B. C. (Anëtar)
3. M. S. (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:
"Procedurë e hapur e thjeshtuar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
10,589,304 lekë pa TVSh</td><td>6. Oferta fituese:
OE "S." ShPK me vlerë oferte 9,545,004 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
1,044,300 lekë pa TVSh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
01.04.2025.</td><td>9. Burimi i Financimit:
Nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj në vlerën totale prej 12,707,249 lekë.</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 4 OE
b) S'kualifikuar: 2 OE
1. OE "N." ShPK
2. OE "S." ShPK
c) Kualifikuar: 2
1. BOE "I. C." ShPK & "A. C." ShPK
2. OE "S." ShPK</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK:
Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK:
Nuk ka</td><td>13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës:
Nr. 648/16 prot., datë 30.05.2025</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSh):
11,454,004.80 lekë</td><td></td></tr>
</table>

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Asfaltim i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj", janë siguruar fonde në vlerën 12,707,249 lekë nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj, ku miratimi për përdorimin e këtyre fondeve është kryer nëpërmjet Vendimit nr. 17, datë 27.02.2025, të Këshillit Bashkiak Memaliaj me objekt "Miratimin e shpërndarjes së të ardhurave të trashëguara dhe grantit të pa përdorur të vitit 2024 për vitin 2025", duke marrë njëkohësisht edhe konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 230/1 prot., datë 11.03.2025.

Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 17.03.2025, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 62, datë 13.03.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K. znj. L. M. dhe znj. K. Sh.
Me Urdhrin nr. 63, datë 13.03.2025, z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit.
Me shkresën nr. 648/2 prot., datë 13.03.2025, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 12,707,164 lekë pa TVSh.
Me shkresën nr. 648/4 prot., datë 13.03.2025, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar znj. Xh. K. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik.
Me shkresën nr. 648/3 prot., datë 13.03.2025, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike".
Me Urdhrin nr. 5, datë 13.03.2025, z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Asfaltim i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj" me fond limit 10,589,304 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur e thjeshtuar".
Për realizimin e Projekt Zbatimit janë angazhuar dy punonjës nga institucioni konkretisht z. J. T. me profesion Arkitekt i pajisur me Liçencën nr. A... dhe z. P. H. me profesion Topograf. Nga verifikimi në internet u konstatua se, z. P. H. nuk është i pajisur me liçencën përkatëse në fushën e projektimit[4].
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 5.
Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Detyrë projektimi;
- Relacion dhe Specifikime Teknike;
- Foto në terren mbi situatën faktike;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;

Pjesë e Projekt Zbatimit ndodhet e Profili Tërthor për segmentet "Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj" ku parashikohen për t'u realizuar punimet sipas zërave:

- ✓ Punime gërmimi mbi shtresat ekzistuese;
- ✓ Profilizimi/mbushje me çakull 10 cm;
- ✓ Shtresë stabilizanti 15 cm;
- ✓ Shtresë binderi 5 cm;
- ✓ Shtresë asfalti 4 cm;

Në vijim të auditimit të dosjes së kësaj procedure u konstatua se, për realizimin e punimeve disa prej segmenteve nga Projekti akset "Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj", Bashkia Memaliaj nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve ka kryer punime mbi trasenë ekzistuese për realizimin e disa prej zërave nga Seksioni Profili Tërthor sipas situacionit të punimeve si më poshtë:

Nr.	Numri i Analizës	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia
1	3.87/a	Gërmim dheu eskavator goma 0.25 gjerësi deri 2m tokë zakonshme, kati III me shkarkim në tokë	m^3	300
2	3.207/1	Shtresë çakulli 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	2,500
3	3.164/2t	F.V. Tubo të brinjëzuar O400	ml	24
4	3.164/4t	F.V. Tubo të brinjëzuar O315	ml	6
5	2.262	Shtresë betoni C16-20	m^3	1.1

[4] https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/

Bashkëlidhur paraqiten disa nga seti i fotove për realizimin e punimeve të cituara më sipër:










Duke marrë në konsideratë faktin që dy prej zërave fillestar të parashikuara në Projekt Zbatimin për segmentet "Asfaltim i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj" konkretisht, "Punime gërmimi mbi shtresat ekzistuese" dhe "Shtresë çakulli 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri" janë realizuar me kapacitet e vetë institucioni, nga Bashkia Memaliaj si Autoritet Kontraktor ka prokuruar edhe dy prej zërave të tjerë nga Profili Tërthor "Shtresë stabilizanti" dhe "Shtresë binderi", sipas preventivit të punimeve si më poshtë:

Lekë

Nr.	Numër Analize	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	3.212/a	Shtresë stabilizanti t = 15 cm	m^2	6,493.2	464.89	3,018,623
2	3.221/1	Shtresë binderi t = 4 cm përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	6,493.2	1,165.94	7,570,681
Totali						**10,589,304**
TVSh 20%						**2,117,860**

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për objektin "Asfaltim i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj" u konstatua se, nuk është respektuar në mënyrë rigoroze detaji teknik në Seksionin Tërthor. Nga Bashkia Memaliaj është vendosur për t'u prokuruar duke përdorur vetëm shtresat stabilizant dhe binder, por përdorimi i shtresë binder pa vendosur shtresën përfundimtare "Asfalti" sjell degradimin e shpejtë të shtresës së binderit duke amortizuar njëkohësisht vet trupin e rrugës. Në lidhje me këtë situatë nga Bashkia Memaliaj ngrihen pretendimet se është vepruar në këtë formë për mungesë fondesh dhe krijimin e aksesit rrugor në këto lagje dhe fshatra.

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 648/7 prot., datë 13.03.2025, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Më datë 25.03.2025, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Memaliaj, rezulton se: Për procedurën me REF-41772-03-19-2025, me objekt "Asfaltim i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj" me fond limit 10,589,304 lekë pa TVSh, ka sygjeruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Më datë 26.03.2025, nga NjP është hartuar procesverbali lidhur me reflektimin e rekomandimeve të dhëna nga APP-ja, duke hartuar një Shtojcë në Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.3.c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjesit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

Emërtimi	Nurmi
Teknik ndërtimi	1
Elektricist	1
Betonues	2
Hidraulik	2

Për punonjësin me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit,Operatorët Ekonomike duhet të plotesojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
Etj.,					

Për punonjësin e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

Kontratën individuale të punës; Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi/kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas Ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republiken e Shqiperise" i ndryshuar si dhe dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Në lidhje me kërkesën për punonjësit me **profesion elektriçist, betonues dhe hidraulik,** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen të përfshira në preventivin e punimeve, nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme aftësitë profesionale për këta punonjës.

2. Në pikën nr.2.3.3.d. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"*, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*. Për të përmbushur këtë kriter, OE duhet të paraqesin kontratë pune, diplomë dhe certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listë-pagesat e shoqërisë, të paktën për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

2.1. Në pikën nr. 2.3.3.e. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Ekspert Zjarrfikës" në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 152/2015, *"Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin"*, neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,

Diplomë/certifikatë, Librezë pune, si dhe të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën e të paktën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit ose eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi. Në rastin kur eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, çertifikata përkatëse, si dhe fatura e këtij shërbimi.
Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohen të tepërta këto kërkesa pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
3. Në pikën nr. 2.3.4. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul gome-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul cilinder-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Depozite uji mbi 500 litër	Në pronësi ose me qira	Copë 2
Kokore	Në pronësi ose me qira	Copë 19

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).
b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit të vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
d) Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Për fabrikën e asfaltit është kërkuar që të ketë distancë **50 km nga vendodhja e objektit për faktin që binderi dhe asfaltit të kenë temperaturën e duhur gjatë hedhjes** në objekt kjo në bazë dhe të VKM nr. 628, datë 15.07.2015, "Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve". Marrja e asfaltit nga një distancë më e largët do të ndikonte në cilësinë dhe temperaturat optimale të nevojshme për hedhjen e tij në trupin e rrugës duke patur parasysh edhe terren e veshtirë ku ndodhen keto rrugë.

Kërkesa për disponibilitetin e një mjeti "Eskavator me goma" është e pa argumentuar teknikisht për arsye se, kjo kërkesë shërben për realizimin e zërit të punimeve "Gërmim dheu me eskavator 0.25 gjerësi deri 2m tokë të zakonshme, kati III me shkarkim në tokë", pra ky zë është realizuar nga vetë institucioni, dhe nuk është i përfshirë në objektin e prokuruar.

Vendosja e këtij kriteri është i tepërt pasi kufizon pjesmarrjen e operatorëve të tjerë të cilët kanë vendodhjen në një largësi më të vogël se 50 km nga segmenti i rrugës që do të shtrohet, pasi disa nga OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzierjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.

4. Në pikën nr. 2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë:

a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni

c. 1 (një) Impiant prodhimi Asfalti

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit/asfaltit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit/asfaltit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve. Në rast se Njësi/Fabrikë në pronësi inerteve/betonit/asfaltit është në pronësi/me qira duhet të paraqitet edhe **Leja e mjedisit nga QKL** sipas ligjit ne fuqi. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike pikat e kriterit 2.4 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje**). Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Prodhimi i betonit kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. Në bazë të preventivit të punime nuk është parashikuar ndonjë sasi betoni për t'u sjell në kantier.

Operatorët Ekonomikë në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë kërkesa për paraqitjen e **lejes mjedisore,** mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurues/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (inerte dhe betone etj.,), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarin në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të Shtetit Shqiptar.

Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"*, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K., **znj. L. M., znj. K. Sh.** në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

<u>Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</u>
Me Urdhrin nr. 64, datë 13.03.2025, të z. A. M. në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. T. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. B. C., z. M. S.
Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 648/8 prot., datë 01.04.2025, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 2 OE dhe s'kualifikuar 2 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga BOE "I. C." ShPK & "A. C." ShPK.
Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. OE "N." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **7,434,714 lekë pa TVSh;**
2. OE "S." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **9,090,480 lekë pa TVSh;**
3. BOE "I. C." ShPK (me Nipt L...) & "A. C." ShPK (me Nipt L...) me vlerë të ofertës **9,415,140 lekë pa TVSh;**
4. OE "S." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **9,545,004 lekë pa TVSh;**
Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:
1. OE "N." ShPK sipas KVO-së për arsyet e mëposhtme:
- Mos përmbushjen e pikën nr. 2.3.5, për të cilën nuk është paraqitur asnjë dokument që vërteton se ka në pronësi 1 impiant prodhim inerte, 1 impiant prodhim betoni dhe 1 impiant prodhim asfalti dhe as kontratë qiraje ose bashkëpunimi e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve në distancë 50 km nga kantieri i punimeve të përcaktuar në DT.
2. OE "S." ShPK sipas KVO-së për arsyet e mëposhtme:
- Mos përmbushjen e pikën nr. 2.3.5, për të cilën nuk është paraqitur asnjë dokument që vërteton se ka në pronësi 1 impiant prodhim inerte, 1 impiant prodhim betoni dhe 1 impiant prodhim asfalti dhe as kontratë qiraje ose bashkëpunimi e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve në distancë 50 km nga kantieri i punimeve të përcaktuar në DT.

Vlen të theksohet se KVO-ja ka kryer s'kualifikimin e OE "N." ShPK dhe OE "S." ShPK për arsye se, nuk kanë paraqitur kontratë qiraje apo bashkëpunimi për 1 impiant prodhim inerte, 1 impiant prodhim betoni dhe 1 impiant prodhim asfalti e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve në distancë 50 km nga kantieri i punimeve të përcaktuar në DT, pra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca nr. 8, janë paraqitur vetëm kontratat e furnizimit por përcaktohet një dokument apo deklarim mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punime. Ndërkohë që edhe për OE "S." ShPK i cili është kualifikuar i katërti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur **<u>Standard i Dyfishtë</u>** ku për të njëjtë situatë (pra nuk disponohet apo deklarohet dokumentacion mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punimeve për sa i përket impianteve të sipërcituar) duke kryer vetëm deklarimin sipas kontratave të furnizimit, KVO e ka shpallur fitues.
Me shkresën nr. 648/9 prot., datë 16.04.2025, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 648/10 prot., datë 16.04.2025. Me shkresën nr. 618/11 prot., datë 17.04.2025, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme BOE "I. C." ShPK & "A. C." Shpk.
Me shkresën nr. 648/12 prot., datë 20.05.2025, nga KVO-ja është hartuar procesverbali i rivlerësimit duke s'kualifikuar **BOE "I. C." ShPK & "A. C." Shpk pasi është tërhequr nga gara në këtë fazë të prokurimit.**
Me shkresën nr. 648/15 prot., datë 23.05.2025, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit, në përfundim të afateve të ankimit ku është shpallur si oferta më e sukseshme OE "S." ShPK.
Nga auditimi i dokumentacionit të OE "S." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:
<u>1.</u> Në pikën nr. 2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ne zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit

duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). *Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

OE "S." ShPK në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka paraqitur të dhëna apo të ketë ngarkuar dokumentacion/vërtetime të cilat lëshohen nga institucionet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në SPE mbi likudimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në të cilat ka ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2024.

2. Në pikën nr. 2.3.4. Numri dhe lloji i makinerive,paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul gome-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul cilinder-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Depozite uji mbi 500 litër	Në pronësi ose me qira	Copë 2
Kokore	Në pronësi ose me qira	Copë 19

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).

b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit të vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.

d) Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.

Mjeti Grejder nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por deklarata doganore datë 14.06.2016. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".

Për sa trajtuar më sipër OE "S." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në shpalljen fitues të OE "S." ShPK pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **z. T. A.** Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **z. B. C., z. M. S.**

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/14 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës z. T. A., z. M. S., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në pikën 2.3.5 është kërkuar impiant për prodhimin e asfaltit bazuar në kërkesat e STASH 66-87 DHE STASH561-87 për të pasur një cilësi sipas standarteve të kërkuara për ndërtimin dhe shtimin e asfaltit. Duke marrë në konsideratë dhe largësinë e vendit ku ndodhet kantieri si dhe amortizimin e rrugës për të shkuar në pjesën që do të shtrohet si dhe temperaturë e duhur për shtresën e asfaltit e cila nuk duhet të jetë më pak se 100 gradë pasi ngjeshja nuk bëhet e duhur dhe prish cilësinë e kërkuar dhe prish lidhjen e elementeve përbërës midis tyre e argumentuar dhe e mbështetutr në ligje sipas PCV të argumentimit të kritereve dhe aprovuar nga APP është marrë në konsideratë kushti përkatës.

KVO-ja ka s'kualifikuar të gjithë operatorët ekonomikë që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në dokumentet e DT-së. Për operatorin ekonomik "S." ShPK, në pikën 2.2.3, janë paraqitur të gjitha dokumentet që vërtetojnë pagesën e taksave vendore. Ndërsa, në pikën 2.3.4, operatori ka paraqitur dokumentacionin përkatës, i cili ndodhet në protokoll.

Për mjetin Grejder, operatori ka paraqitur deklaratën doganore e cila në përputhje me përcaktimet e Kodit Rrugor, vërteton pronësinë mbi mjetin.

Gjithashtu, operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë furnizimi, të lidhur përpara publikimit të procedurës në sistem, për një impiant/fabrikë të prodhimit të asfaltit, e datës 31.03.2025, ndërmjet shoqërisë "E. C. C." dhe subjektit "S." ShPK e shoqëruar me lejet mjedisore sipas kushteve të përcaktuara në DT.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Vendosja e një distance të përcaktuar jo më larg se 100 km nga segmenti i rrugës që do të shtrohet për disponibilitetin e një fabrike në pronësi apo me qira asfalto-betoni, është kriter i tepërt pasi kufizon pjesëmarrjen e OE të cilët kanë vendodhjen në një largësi më të largët se 100 km pasi disa OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzierjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.

- Fryma dhe qëllimi i LPP është të nxisë pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve.

Në këtë kuptim, referuar zërave të termave të referencës, grafikut të punimeve dhe afatit kohor për realizimin e punimeve konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e operatorit ekonomik të llojit të makinerive të mësipërme është e ekzagjeruar.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. OE konkurues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre.

Rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore, mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

- Për mjetin Grejder dokumentacioni i zhdoganimit nuk është i vetmi dokumentacion që bënë të vlefshëm plotësimin e kriterit të parashikuar në DT, për arsye se ky mjet përfshihet në kategorinë e mjeteve teknologjike dhe sipas kritereve të DT dhe dispozitave ligjore përkatëse mbi qarkullimin rrugor duhet të jetë i pajisur edhe me lejen e qarkullimit, siguracionin, çertifikatë të kontrollit teknik etj.,.

Ne i referohemi Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit në të cilin OE "S." ShPK nuk ka paraqitur të dhëna apo të ketë ngarkuar dokumentacion/vërtetime të cilat lëshohen nga institucionet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në SPE mbi likudimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në të cilat ka ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2024. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

8. Procedura e prokurimit me objekt **"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2025.

<table>
<tr><th colspan="3">a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara".</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi:
Nr. 8, datë 09.07.2025</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:
Nr. 139, datë 09.07.2025.
1. Xh. K. (Jurist)
2. L. M. (Inxhinier)
3. K. Sh. (Ekonomist)</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 141, datë 09.07.2025.
1. T. A. (Kryetar)
2. B. C. (Anëtar)
3. E. E. (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:
"Procedurë e hapur"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
40,105,558 lekë pa TVSh</td><td>6. Oferta fituese:
OE "A. I. C." ShPK me vlerë oferte 36,228,713.24 lekë pa TVSh</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
3,876,844.76 lekë pa TVSh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
06.08.2025.</td><td>9. Burimi i Financimit:
Fondet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në vlerën totale prej 48,126,670 lekë e ndarë kjo:
- Për vitin 2025 në vlerën 25,000,000 lekë;
- Për vitin 2026 në vlerën 23,126,670 lekë;</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 4 OE
b) S'kualifikuar: 2 OE
1. OE "A." ShPK
2. BOE "N." ShPK & "I." ShPK
c) Kualifikuar: 2 OE
1. OE "A. I. C." ShPK
2. OE "D." ShPK</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK:
Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK:
Nuk ka</td><td>13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës:
Nr. 1559/14 prot., datë 02.09.2025</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSh):
43,474,455 lekë</td><td></td></tr>
</table>

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Memaliaj viti 2025", janë siguruar fonde në vlerën 48,126,670 lekë nga Buxheti i Shtetit për vitin 2025, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (e ndarë për vitin 2025 në vlerën 25,000,000 lekë dhe për vitin 2026 në vlerën 23,126,670 lekë) në zbatim të shkresës nr. 839/1 prot., datë 24.06.2025, me objekt "Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2025", duke marrë edhe njëkohësisht miratimin me Vendimin nr. 44, datë 28.05.2025, të Këshillit Bashkiak Memaliaj me objekt "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025". Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 15.07.2025, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 139, datë 09.07.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K., znj. L. M., znj. K. Sh.

Me Urdhrin nr. 140, datë 09.07.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 1559/2 prot., datë 09.07.2025, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 40,105,558 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 1559/4 prot., datë 09.07.2025, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur" me mjete elektronike.

Me shkresën nr. 1559/5 prot., datë 09.07.2025, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar znj. Xh. K. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik.

Me Urdhrin nr. 8, datë 09.07.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" me fond limit 40,105,558 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur" me mjete elektronike. Për realizimin e Projekt Zbatimit është

angazhuar Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe Rural konkretisht punonjësi z. J. T. me profesion Arkitekt i pajisur me Liçencën nr. A... Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Planimetria e banesave;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 1559/7 prot., datë 16.07.2025, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

Referuar rregullave të PP, Autoriteti Kontraktor nuk e ka hartuar këtë kërkesë të DT-së në funskion të kësaj procedure prokurimi, duke marrë në konsideratë faktin që kërkesa për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore duhet të jetë për detyrimet e maturuara deri në momentin që zhvillohet procedura dhe jo të dy viteve të mëparshme.

2. Në pikën nr. 2.4. Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P-1 A (Punime gërmimi në tokë);
- N.P-3 A (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada);
- N.S-2 A (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre);
- N.S-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura e to);

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

NP - 1 "Punime gërmimi në tokë": Duke marrë shkas nga punimet e përfshira në Dokumentet Teknike të Procedurës *(preventivë punimesh, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik)* u konstatua se, për zbatimin e objektit të kontratës, nuk janë parashikuar gërmime, sistemime dhe ndryshime në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore (përkufizimi i kategorisë NP-12 sipas VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar)*.

3. Në pikën nr. 2.3.2. Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për këto punime.

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë ose licencë përkatëse si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për periudhën 3 (tre) mujori i fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;

- 1 (një) inxhinier hidroteknik;
- 1 (një) inxhinier elektrik

b) Operatori Ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se ka të punësuar me kontratë pune të vlefshme të paktën 1 (një) punonjës të specializuar/kualifikuar, të pajisur me dëshmi/certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave ose të ketë marrëdhënie kontraktuale (kontratë të vlefshme) me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

3.1. Në pikën nr. 2.4.1. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën 3 (tre) mujori i fundit, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier të kualifikuar në fushën e sigurisë në punë, që disponon çertifikatë si "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").* K*riteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
Për secilin pjestar të stafit teknik te mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë apo çertifikatën e kualifikimit.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohen të tepërta këto kërkesa pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K., **znj. L. M., znj. K. Sh.** në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 141, datë 09.07.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. T. A. kryetar i komisonit dhe anëtarët z. B. C., znj. E. E.

Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 1559/8 prot., datë 06.08.2025, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 2 OE dhe s'kualifikuar 2 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "A. I. C." ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE "A." ShPK (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **29,494,626.56 lekë pa TVSh;**

2. BOE "N." ShPK (me Nipt L...) **& "I." ShPK** (me Nipt J...) me vlerë të ofertës **34,919,348 lekë pa TVSh;**

3. OE "A. I. C." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **36,228,713.24 lekë pa TVSh;**

4. OE "D." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **37,542,191.58 lekë pa TVSh;**

Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE "A." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.3, për të cilën në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar të dhëna mbi likudimin e detyrimeve vendore si dhe në SPE nuk ka ngarkuar dokumentacionin përkatës.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.3, për të cilën në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar të dhëna lidhur me vërtetimin nga Drejtoria e Administratës Tatimore mbi numrin e punonjësve për tre muajt e fundit kërkesë e parashikuar në DT si dhe në SPE nuk ka ngarkuar dokumentacionin përkatës.

2. BOE "N." ShPK & "I." ShPK për arsye se:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.3, për të cilën në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar të dhëna lidhur me vërtetimin nga Drejtoria e Administratës Tatimore mbi numrin e punonjësve për tre muajt e fundit kërkesë e parashikuar në DT si dhe në SPE nuk ka ngarkuar dokumentacionin përkatës.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.6, në listën e mjeteve konkretisht, nga BOE disponohent vetëm 1 miniautobetoniere nga dy të kërkuara në DT.
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.7, ku nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 45001-2023.

Me shkresën nr. 1559/9 prot., datë 12.08.2025, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 1599/10 prot., datë 12.08.2025.

Me shkresën nr. 1599/13 prot., datë 01.09.2025, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme e OE "A. I. C." ShPK.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE "A. I. C." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Në pikën nr. 2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

Nga OE "A. I. C." ShPK janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, në Bashkinë Tiranë vërtetimin e datës 19.04.2023, Bashkinë Librazhd vërtetimi nr. 1861 prot., datë 05.04.2023, Bashkinë Kavajë vërtetimi nr. 26 prot., datë 18.04.2023, Bashkinë Himarë vërtetimi nr. 1934 prot., datë 24.04.2023, Bashkinë Shkodër vërtetimi nr. 2441/1 prot., datë 18.04.2023, Bashkinë Devoll vërtetimi nr. 142 prot., datë 20.04.2023. Nga OE "A. I. C." ShPK nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Sarandë referuar likuidimeve për një kontratë nga Dega e Thesarit Sarandë ndërkohë që ka ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2023 në këtë qytet konkretisht, Kontrata me nr. 3 prot., datë 03.07.2023, me objekt "Shërbimi i pastrimit të qytetit Bashkia Sarandë":

- Fatura nr. 105, datë 21.08.2023, në vlerën 14,764,704 lekë regjistruar më datë 11.09.2023, dhe likuiduar më datë 14.09.2023, nga Dega e Thesarit Sarandë;
- Fatura nr. 115, datë 07.09.2023, në vlerën 14,815,689 lekë regjistruar më datë 25.12.2023, dhe likuiduar më datë 27.10.2023, nga Dega e Thesarit Sarandë;
- Fatura nr. 137, datë 12.10.2023, në vlerën 13,702,351 lekë regjistruar më datë 01.12.2023, dhe likuiduar më datë 06.12.2023, nga Dega e Thesarit Sarandë;

Për sa trajtuar më sipër OE "A. I. C." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në shpalljen fitues të OE "A. I. C." ShPK pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **z. T. A.** kryetar Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **z. B. C., znj. E. E.**

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/16 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës znj. L. M., znj. Xh. K., z. T. A., znj. E. E., znj. K. Sh., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Sqarojmë se në hartimin e dokumenteve në pikën 2.2.3, është kërkuar shlyerja e taksave vendore për vitin 2023.

Ndoshta ky është një lapsus i vitit kalendarik për taksat vendore por është marrë në kosideratë nga APP dhe është argumentuar në PCV argumentinim e kriteve sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Në pikën 2.4, NP1 (Punime gërmimi në tokë), duke marrë në konsideratë zbatimin sipas preventivave përkatëse, kemi të bëjmë edhe me gërmime për hapjen e themeleve dhe bazave mbajtëse të strukturave aktuale.

Për këtë arsye, në këtë pikë është e nevojshme kërkimi i kësaj licence. KVO-ja, pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha kriteret e përcaktuara në DT, ka vlerësuar me rigorozitet të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Për sa i përket gjetjes së KLSH-së në lidhje me subjektin fitues, referuar pikës 2.2.3, OE-ja ka paragitur të gjitha vërtetimet për shlyerjen e taksave, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DT.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Ne i referohemi të dhënave të publikuara në SPE dhe procesverbalit mbi argumentimin e kritereve të veçanta për kualifikim, ku kriteri nr. 2.3.3, i përket vërtetimit për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023 dhe jo vitin 2024, pretendim i cili është paraqitur nga ana Juaj në këtë observacion.

Për më tepër që nuk disponohet edhe korrespodenca me APP-në në lidhje me përditësimin e këtij kriteri.

Për sa i përket pretendimeve mbi liçencën NP1 "Punime gërmimi në tokë" ju bëjmë me dije se, referuar zërave në preventivin e punimeve nuk janë parashikuar punime gërmimi në tokë, pra prishja e pllakave ekzistuese të godinave të cilën e referoni Ju në observacion nuk lidhet me punime gërmimi në tokë.

Ne i referohemi trasaksioneve të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, ku provohet që subjekti nuk ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ky operator ka ushtruar aktivitet për vitin 2023. Jemi në rastin kur përmbajtja e dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, nuk rezulton i vërtetë, pra operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma "a" të LPP-së. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

9. Procedura e prokurimit me objekt **"Blerje mjeti transporti 3 akse për Emergjencat Civile",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2025.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje mjeti transporti 3 akse për Emergjencat Civile".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 10, datë 04.08.2025	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 163, datë 04.08.2025. 1. Xh. K. (Jurist) 2. K. Sh. (Ekonomist) 3. M. S. (Arkitekt)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 165, datë 04.08.2025. 1. T. A. (Kryetar) 2. B. C. (Anëtar) 3. L. Ç. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur e thjeshtuar"		
5. Fondi Limit: 6,666,666 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** OE "S." ShPK me vlerë oferte 6,200,000 lekë pa TVSh.	**7. Diferenca me fondin limit:** 466,666 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 25.08.2025.	**9. Burimi i Financimit:** Fondet nga Ministria e Mbrojtjes në vlerën totale prej 8,000,000 lekë e ndarë kjo: - Për vitin 2025 në vlerën 4,480,000 lekë - Për vitin 2026 vlerën 3,520,000 lekë	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) S'kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 1. OE "S." ShPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1747/13 prot., datë 03.09.2025	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 7,440,000 lekë	

<u>Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:</u>

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje mjeti transporti 3 akse për Emergjencat Civile", janë siguruar fonde në vlerën 8,000,000 lekë nga Buxheti i Shtetit për vitin 2025, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes (e ndarë për vitin 2025 në vlerën 4,480,000 lekë dhe për vitin 2026 në vlerën 3,520,000 lekë) në zbatim të VKM-së nr. 127, datë 28.02.2025, "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore" dhe shkresës me nr. 1016/1 prot., datë 27.05.2025, të Ministrisë së Mbrojtjes me objekt "Mbi aplikimin në programin "Emergjencat Civile" 2025".
Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 05.08.2025, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.
Me Urdhrin nr. 163, datë 04.08.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K., znj. K. Sh., z. M. S.
Me Urdhrin nr. 164, datë 04.08.2025, z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 1747/2 prot., datë 04.08.2025, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 6,666,666 lekë pa TVSh, ku ndër të tjera citohet se, preventivi është hartuar dhe bazuar pas rezultateve të testimit të tregut.
Në dosjen e procedurës së prokurimit, nga NjP nuk administrohet dokumentacioni mbi testimin e tregut. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 76, pika 1, gërma "b", ku përcaktohet që:

Neni 76 "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit":
1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:
b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

Specifikimet Teknike janë hartuar nga Njësia e Prokurimit sipas shkresës me nr. 1747/7 prot., datë 13.08.2025, në të cilën janë përfshirë kërkesat e mëposhtme:

<u>Kamion vetëshkarkues me 3 Akse:</u>

➢ Viti i Prodhimit	Jo më parë se 2015;
➢ Gjendja	I ri ose i përdorur;

➢ Karburanti	Naftë;
➢ Drejtimi	Timoni në krah të majtë;
➢ Emetimi i Gazrave	Min. Euro 6;
➢ Kambio	Manuale/Automatike;
➢ Fuqia e motorrit	Min. 350 kW - Max.370 kW;
➢ Timoni	Hidraulik;
➢ Numri i akseve	3;
➢ Konfigurimi i akseve	6x4;
➢ Pesha totale e mjetit me ngarkesë	Min. 26,000 kg - Max. 30,000 kg;
➢ Kapaciteti mbartës i kazanit	jo më pak se 11 m^3
➢ Numri i dyerve të kabinës	2;
➢ Numri i pasagjerëve në kabinë perfshire shoferin	Minimumi 2;
➢ Sistemi i frenimit	ABS;
➢ Mbrojtëse anësore	Alumini;
➢ Xhamat	Komandim elektrik;
➢ Sistem A/C Ajër i kondicionuar	Po;
➢ Pasqyrat elektrike	Po;

Nga NjP për hartimin e specifikimeve teknike disponohen vetëm të dhënat e mësipërme, por nuk paraqitet një dokument mbi argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 78, pika 2, ku përcaktohet që:

Neni 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit":
2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, ***specifikimet teknike,*** *kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.* ***Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht,*** *si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*

Hartimi i kritereve të DT:
Me shkresën nr. 1747/7 prot., datë 13.08.2025, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.
Për sa trajtuar më sipër, kriteret e aplikuara në DT janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K., **znj. K. Sh., z. M. S.** në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:
Me Urdhrin nr. 165, datë 04.08.2025, të z. A. M. në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. T. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. B. C., znj. L. Ç.
Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 1747/8 prot., datë 25.08.2025, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "S." ShPK.
Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. OE "S." ShPK (me Nipt L...) me vlerë të ofertës **6,200,000 lekë pa TVSh;**
Me shkresën e datës 27.08.2025, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 1747/9 prot., datë 27.08.2025. Me shkresën nr. 1747/12 prot., datë 29.08.2025, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme OE "S." ShPK.
Për sa trajtuar më sipër, nuk janë konstatuar parregullsi në vlerësimin e OE "S." ShPK të shpallur fitues.

Marrja në dorëzim:
Me Urdhrin nr. 184, datë 08.09.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur komsioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga znj. K. Sh. kryetar i

komisionit dhe anëtarët z. G. K., z. O. C. Nga komisioni i sipërcituar është hartuar procesverbali më datë 09.09.2025, i marrjes në dorëzim të automjetit 3 akse marka 3.. M.. me numër shasie V... *(brenda afatit të parashikuar në grafikun e lëvrimit të mallrave)*, duke u bërë hyrje në magazinën e institucionit me Fletë-Hyrjen nr. 46, datë 09.09.2024, shoqëruar edhe me faturën tatimore nr. 144/2025, datë 09.09.2025, në vlerën 7,440,000 lekë me TVSh likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 487, datë 24.09.2025.

10. Procedura e prokurimit me objekt **"Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2025.

<table>
<tr><th colspan="3">b. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan".</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi:
Nr. 3, datë 04.02.2025</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:
Nr. 28, datë 04.02.2025.
1. Xh. K. (Jurist)
2. M. S. (Arkitekt)
3. L. H. (Ekonomist)</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 30, datë 04.02.2025.
1. L. M. (Kryetar)
2. B. C. (Anëtar)
3. B. Xh. (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:
"Procedurë e hapur"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
16,471,383 lekë pa TVSh</td><td>6. Oferta fituese:
OE "E. C. C." ShPK me vlerë oferte 12,625,000 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
3,846,383 lekë pa TVSh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
21.02.2025.</td><td>9. Burimi i Financimit:
Nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj në vlerën totale prej 20,000,000 lekë.</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 2 OE
b) S'kualifikuar: 1 OE
1. OE "R. C." ShPK
c) Kualifikuar: 1
1. OE "E. C. C." ShPK</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK:
Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK:
Nuk ka</td><td>13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës:
Nr. 315/12 prot., datë 21.03.2025</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSh):
18,543,600 lekë</td><td></td></tr>
</table>

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan", janë siguruar fonde në vlerën 20,000,000 lekë nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj, ku miratimi për përdorimin e këtyre fondeve është kryer nëpërmjet Vendimit nr. 97, datë 23.12.2025, të Këshillit Bashkiak Memaliaj me objekt "Për miratimin e buxheit për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027", duke marrë njëkohësisht edhe konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1025/1 prot., datë 31.12.2024. Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 01.04.2025, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 28, datë 04.02.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K., z. M. S. dhe znj. L. H.

Me Urdhrin nr. 29, datë 04.02.2025, z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 315/2 prot., datë 04.02.2025, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 16,471,383 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 315/2 prot., datë 04.02.2025, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar znj. Xh. K. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik. Me Urdhrin nr. 3, datë 04.02.205, z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan" me fond limit 16,471,383 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur". Për realizimin e Projekt Zbatimit për këtë procedurë është kontraktuar Studio

Projektimi “H. K. A.” ShPK me Nipt K... përfaqësuar nga Inxhinierët z. K. S., z. Sh. S., z. V. S. dhe z. Y. S. Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Profili tip;
- Foto në terren mbi situatën faktike;
- Relacion teknik dhe specifikimet teknike;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;

Pjesë e Projekt Zbatimit ndodhet e Profili Tërthor për segmentin “Toç-Koshtan” ku parashikohen për t’u realizuar punimet sipas zërave:

- ✓ Punime gërmimi mbi shtresat ekzistuese;
- ✓ Profilizimi/mbushje me çakull 10 cm;
- ✓ Shtresë stabilizanti 10 cm;
- ✓ Shtresë binderi 5 cm;
- ✓ Shtresë asfalti 4 cm;

Në vijim të auditimit të dosjes së kësaj procedure u konstatua se, për realizimin e punimeve të një prej segmenteve nga Projekti aksin “Toç-Koshtan”, Bashkia Memaliaj nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve ka kryer punime mbi trasenë ekzistuese për realizimin e disa prej zërave nga Seksioni Profili Tërthor sipas situacionit të punimeve si më poshtë:

Nr.	Numri i Analizës	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia
1	3.87/a	Gërmim dheu eskavator goma 0.25 gjerësi deri 2m tokë zakonshme, kati III me shkarkim në tokë	m^3	800
2	3.207/1	Shtresë çakulli 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	5,200
3	3.164/2t	F.V. Tubo të brinjëzuar O400	ml	30
4	3.164/4t	F.V. Tubo të brinjëzuar O315	ml	12
5	2.262	Shtresë betoni C16-20	m^3	2
6	2.88	Mur bllok betoni 20 cm lartësi 3m me llaç përzier M15	m^3	3
7	2.166	F.V. Hekur beton periodik	t	0.12

Bashkëlidhur paraqiten disa nga seti i fotove për realizimin e punimeve të cituara më sipër:













Duke marrë në konsideratë faktin që dy prej zërave fillestar të parashikuara në Projekt Zbatimin për segmenti "Toç-Koshtan" konkretisht, "Punime gërmimi mbi shtresat ekzistuese" dhe "Shtresë çakulli 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri" janë realizuar me kapacitet e vetë institucioni, nga Bashkia Memaliaj si Autoritet Kontraktor ka prokuruar edhe dy prej zërave të tjerë nga Profili Tërthor "Shtresë stabilizanti" dhe "Shtresë binderi", sipas preventivit të punimeve si më poshtë:

Lekë

Nr.	Numër Analize	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	3.212/a	Shtresë stabilizanti t = 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	10100	464.89	4,695,389
2	3.221/1	Shtresë binderi me granil gur kav, 4 cm me makineri	m^2	10100	1,165.94	11,775,994
Totali						**16,471,383**
TVSh 20%						**3,294,276**

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan" u konstatua se, nuk është respektuar në mënyrë rigoroze detaji teknik në Seksionin Tërthor. Nga Bashkia Memaliaj është vendosur për t'u prokuruar duke përdorur vetëm shtresat stabilizant dhe binder, por përdorimi i shtresë binder pa vendosur shtresën përfundimtare "Asfalti" sjell degradimin e shpejtë të shtresës së binderit duke amortizuar njëkohësisht vet trupin e rrugës. Në lidhje me këtë situatë nga Bashkia Memaliaj ngrihen pretendimet se është vepruar në këtë formë për mungesë fondesh dhe krijimin e aksesit rrugor në këto fshatra.

Për sa i përket dokumentacionit teknik në lidhje me zbatimin e objektit të kontratës u konstatua se, Projekt Zbatimi nuk është publikuar në Sistemin e Prokurimit Publik. Mos publikimi i të gjithë dokumentacionit pjesë e dosjes teknike në SPE është shkelje e kërkesave të parashikuara në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2020, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 15 "Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit", pika 3, ku përcaktohet që:

Pika 3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:
a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:
*- **projektin** dhe specifikimet;*
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 315/6 prot., datë 05.02.2025, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi"* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1 A	Punime gërmimi në tokë
2	NP-4 B	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
3	NS-5 A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
4	NS-6 B	Sinjalistika rrugore jodriçuese
5	NS-7 A	Barriera dhe mbrojtje rrugore

Në referencë të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar, për disa prej liçencave pjesë e kërkesave të DT, përkufizohen në këtë formë:

N.P-1. "Punime gërmimi në tokë": Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

N.S-5. "Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut": Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.

N.S-6. "Sinjalistika rrugore jodriçuese": Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

N.S-7. "Barriera dhe mbrojtje rrugore": Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, new jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

Duke marrë shkas nga punimet e përfshira në preventivin e punimeve u konstatua se, për zbatimin e objektit të kontratës, nuk janë parashikuar punime gërmi apo punime që lidhen me mirëmbajten dhe ristrukturimin e sinjalistikës rrugore ndriçuese apo jo ndriçuese.

2. Në pikën nr. 2.3.3.b. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi me Profil Strukturist 1 (një);
- Inxhinier Gjeodet 1 (një);
- Inxhinier Mjedisi 1 (një);
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një);
- Inxhinier Elektrik 1 (një);

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e vlefshme;
- Diploma;
- CV;
- Licencë;

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për këtë arsye të paraqitet deklaratë përkatëse nga Administratori i Shoqërisë.

Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. *Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të*

deklarojnë për punonjësin e kërkuar si më sipër, emër/mbiemer, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.
Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 26 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", pika 6 "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese", si më sipër kërkuar.

Inxhinieri i Ndërtimit me profil strukturist shërben për hartimin e projekteve, përllogarit ngarkesën e përhershme dhe të përkohshme të strukturave të objekteve civile dhe industrial.

Ekspertizat profesionale e **Inxhinierit të Mjedisit** është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në lidhje me kërkesën për **Inxhinierë Ndërtimi me profil strukturist, Mjedisi dhe Elektrik** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve në fjalë. Ky kriter nuk është i nevojshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga këta inxhinier.

Në pikën "a", të nenit 1, të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projektet të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim, për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore;

Testimi i formacionit të tokës konsiderohet i realizuar përpara realizimit të projektit, pasi në projekt janë përllogaritur zërat dhe sasia e shtresave të domosdoshme për realizimin e punimeve në objekt.

3. Në pikën nr. 2.3.3.c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

Emërtimi	Sasia
Teknik ndërtimi	1 (një)
Elektriçist	1 (një)
Betonues	2 (dy)
Hidraulik	2 (dy)

Për punonjësin me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, Operatorët Ekonomik duhet të plotesojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/çertifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
Etj.,					

Për punonjësin e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:
- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional, çertifikatë, diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas Ligjit nr. 15/2017, *"Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, si dhe dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara*

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Në lidhje me kërkesën për punonjësit me **profesion elektriçist, betonues dhe hidraulik,** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen të përfshira në preventivin e punimeve, nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme aftësitë profesionale për këta punonjës.

4. Në pikën nr. 2.3.3.d. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"*, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*. Për të përmbushur këtë kriter, OE duhet të paraqesin kontratë pune, diplomë dhe certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listë-pagesat e shoqërisë, të paktën për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

4.1. Në pikën nr. 2.3.3.e. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Ekspert Zjarrfikës" në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 152/2015, *"Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin"*, neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, Librezë pune, si dhe të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën e të paktën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit ose eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi. Në rastin kur eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, çertifikata përkatëse, si dhe fatura e këtij shërbimi.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohen të tepërta këto kërkesa pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

5. Në pikën nr. 2.3.4. Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me goma	**Në pronësi ose me qira**	**Copë 1**
Fadromë me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Makineri prerëse asfalti	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Minieskavator	**Në pronësi ose me qira**	**Copë 1**
Rrul gome-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul cilindër-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator betoni	**Në pronësi ose me qira**	**Copë 1**
Depozitë uji mbi 500 litër	Në pronësi ose me qira	Copë 2
Kokore	Në pronësi ose me qira	Copë 40
Jelek	Në pronësi ose me qira	Copë 40

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).

b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit të vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt

i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
d) Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Për fabrikën e asfaltit është kërkuar që të ketë distancë **50 km nga vendodhja e objektit për faktin që binderi dhe asfaltit të kenë temperaturën e duhur gjatë hedhjes** në objekt kjo në bazë dhe të VKM nr. 628, datë 15.07.2015, "Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve". Marrja e asfaltit nga një distancë më e largët do të ndikonte në cilësinë dhe temperaturat optimale të nevojshme për hedhjen e tij në trupin e rrugës duke patur parasysh edhe terren e veshtirë ku ndodhen keto rrugë.

Kërkesa për disponibilitetin e një mjeti "Eskavator me goma", "Minieskavator" dhe "Vibrator betoni" është e pa argumentuar teknikisht për arsye se, kjo kërkesë shërben për realizimin e zërave të punimeve si: gërmim, përhapje çakulli, shtresë betoni etj., pra zëra të cilat janë realizuar nga vetë institucioni, dhe nuk janë të përfshira në objektin e prokuruar.

Vendosja e këtij kriteri është i tepërt pasi kufizon pjesmarrjen e operatorëve të tjerë të cilët kanë vendodhjen në një largësi më të vogël se 50 km nga segmenti i rrugës që do të shtrohet, pasi disa nga OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzierjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.

6. Në pikën nr. 2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë:
a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte
b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni
c. 1 (një) Impiant prodhimi Asfalti
Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit/asfaltit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit/asfaltit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve. Në rast se Njësi/Fabrikë në pronësi inerteve/betonit/asfaltit është në pronësi/me qira duhet të paraqitet edhe **Leja e mjedisit nga QKL** sipas ligjit ne fuqi. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike pikat e kriterit 2.4 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit,* ***në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje****). Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Prodhimi i betonit kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. Në bazë të preventivit të punime nuk është parashikuar ndonjë sasi betoni për t'u sjell në kantier.

Operatorët Ekonomikë në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se

në këtë kërkesa për paraqitjen e **lejes mjedisore,** mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurues/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (inerte dhe betone etj.,), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarin në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të Shtetit Shqiptar. Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"*, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K. z. J. T., znj. J. C. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 30, datë 04.02.2025, të z. A. M. në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga znj. L. M. kryetar i komisonit dhe anëtarët z. B. C., z. B. Xh.

Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 31/7 prot., datë 21.02.2025, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 OE dhe s'kualifikuar 1 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "E. C. C." ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE "R. C." ShPK (me Nipt 8...) me vlerë të ofertës **12,625,000 lekë pa TVSh;**

2. OE "E. C. C." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **15,453,000 lekë pa TVSh;**

Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE "R. C." ShPK sipas KVO-së për arsyet e mëposhtme:

- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.3.a, për të cilën nuk është paraqitur listë pagesa e deklarimeve të punonjësve të regjistruar në Tatime;
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.3.b, duke mos paraqitur kontratën e punës, diplomën, CV dhe liçencën për inxhinierët: ndërtimi me profil strukturist, gjeodet, mjedisi dhe hidroteknik;
- Mos përmbushjen e pikës nr. 2.3.5 pasi nuk është paraqitur dokumentacion mbi posedimin apo kontratë qiraje për impiantin e prodhimit të asfaltit, betonit dhe inerte të shoqëruar me leje mjedisore.

Nga auditimi i dokumentacionit të publikuar nga OE "R. C." ShPK, Formulari i Vetëvlerësimit Shtojca nr. 8, është deklaruar se:

Për pikën nr. 2.3.3.a, disponon fuqinë punëtore në total prej 55 punonjës në listë pagesat për tre muajt e fundit;

Për pikën nr. 2.3.3.b, disponon inxhinierët sipas kualifikimeve: z. G. A. Inxhinier Ndërtimi me Profil Strukturist; z. B. S. Inxhinier Topograf; z. M. H. Drejtues Teknik i specializuar si Ekspert Zjarri dhe Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave; z. E. V. Inxhinier Hidroteknik; z. K. P. Inxhinier Elektrik; z. A. B. Inxhnier Ndërtimi në rolin e Teknikut të Ndërtimit certifikuar në rolin e Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë; z. Sh. K. Elektriçist; z. M. K. Betonues; z. R. K. Betonues; z. A. R. Hidraulik; z. R. F. Hidraulik; z. A. Sh. Manovrator; z. F. A. Manovrator; z. Ç. Sh. Shofer; z. T. Gj. Shofer.

Për pikën nr. 2.3.5, është paraqitur Kontrata e Furnizimit Impiant Prodhimi Inertesh me nr. 46/2 prot., datë 20.2.2025, Kontratë Furnizimi Impiant Prodhim Asfalti nr. 46/3 prot., datë 20.02.2025, Kontrata e Furnizimit Impiant Prodhim Asfalti nr. 46/4 prot., datë 20.02.2025;

Vlen të theksohet se KVO-ja ka kryer s'kualifikimin e OE "R. C." ShPK në fazën e parë paraprake (dorëzimin e ofertave) në të cilën operatorët ekonomikë mund të dokumentojnë në Sistemin e Prokurimit Publik plotësimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojcën nr. 8, në rastin konkret ky dokumentacion është plotësuar nga OE i sipërpërmendur. Mangësia e vetme në këtë Formular ka të bëjë vetëm me mos deklarimin e lejes së mjedisit nga pala e tretë (që lidhet disponibilitet e lejes së mjedisit nga OE që janë kontraktuara për kontratat e furnizimit) për kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit. KVO-ja ka kryer s'kualifikimin e OE "R. C." ShPK për mos dorëzimin e dokumentacionit justifikues bashkëlidhur Shtojcës për pikat nr. 2.3.3.a, nr. 2.3.3.b dhe nr. 2.3.5, konkretisht si listëpagesa, vërtetim sigurimesh, kontrata pune dhe kontrata furnizimi, dokumentacion i cili paraqitet nga OE në fazën dorëzimit të dokumentacionit fizik provues përpara shpalljes së njoftimit të fituesit paraprak.

Ndërkohë që për OE "E. C. C." ShPK i cili është kualifikuar i dyti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur **Standard i Dyfishtë** ku për të njëjtën situatë është kualifikuar në fazën paraprake në kushtet e mos dorëzimit bashkëlidhur dokumentacionin justifikues Shtojcës nr. 8, për pikën nr. 2.3.3.b dhe pikën nr. 2.3.5, kontrata pune, CV, diploma etj., apo kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit. Me shkresën nr. 315/8 prot., datë 25.02.2025, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky i fundit me shkresën nr. 315/9 prot., datë 25.02.2025. Me shkresën nr. 315/11 prot., datë 17.03.2025, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme OE "E. C. C." ShPK.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE "E. C. C." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Në pikën nr. 2.3.4. Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me goma	**Në pronësi ose me qira**	**Copë 1**
Fadromë me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Makineri prerëse asfalti	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Minieskavator	**Në pronësi ose me qira**	**Copë 1**
Rrul gome-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul cilindër-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator betoni	**Në pronësi ose me qira**	**Copë 1**
Depozitë uji mbi 500 litër	Në pronësi ose me qira	Copë 2
Kokore	Në pronësi ose me qira	Copë 40
Jelek	Në pronësi ose me qira	Copë 40

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).

b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit të vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.

d) Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Për mjetin Kamion me numër shasie W... me targë A... kapaciteti mbajtës i tij është 10.76 ton (18,000 kg - 7,240 kg = 10,760 kg) referuar të dhënave në lejen e qarkullimit me numër G..., ndërkohë që në kriter kërkohet kapaciteti mbajtë mbi 20 ton.

Mjeti Grejder nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por vetëm faturën tatimore të blerjes me nr. 22, datë 30.11.2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".

Mjeti Autobitumatriçe me numër shasie W... me targë A... i marrë me qira nga Shoqëria "A. O." nëpërmjet Kontratës me nr. 888 Rep., nr. 340 Kol., datë 19.02.2025, nuk është i pajisur me të gjithë dokumentacionin e parashikuar në këtë kërkesë, pasi mungon çertifkata e kontrollit teknik, polica e sigurimit të detyrueshëm së mbajtjes së mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Për sa trajtuar më sipër OE "E. C. C." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në shpalljen fitues të OE "E. C. C." ShPK pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **znj. L. M.** Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **z. B. C., z. B. Xh.**

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/12 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës znj. Xh. K., z. M. S., znj. L. H., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Është bërë gjetja në pikën nr. 2.3.3/b (inxhinier ndërtimi me profil strukturist), ku është argumentuar kriteri sipas VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe arsyetohet me faktin se në pjesën e zbatimit të rrugës kemi kanale kulluese nga të dy krahët dhe terren me përqindje lartësie në kufi maksimal të lejimit të ndërtimit dhe të hedhjes së asfaltit dhe për këtë është kërkuar profili i kërkuar i specifikuar i inxhinierit të ndërtimit, inxhinier mjedisi arsyetuar se në rrugë kemi të bëjmë me një zonë të pyllëzuar me florë dhe faun specifike sipas lartësisë së përcaktimit të brezave të bimësisë. Në pikën nr. 2.3.4, është përcaktuar kërkimi i një impianti prodhim asfalti dhe impianti prodhim beton 50 km nga vendodhja e objektit. Ky kriter argumentuar, marrë parasysh largësinë e kantierit të ndërtimit si dhe terreni i vështirë rruga e amortizuar të cilat ndikojnë në rrënien e temperaturës së asfaltit dhe ngjeshja nuk bëhet në mënyrën e duhur duke arritur në mos realizimin 100 % të punës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Impianti i prodhimit të asfaltit dhe betonit duhet të jenë të pajisur me liçencë mjedisore, sipas përcaktimit të legjislacionit shqiptar, pasi në këto kushte vërtetohet cilësia e produktit që ato nxjerrin. Këto kritere janë miratuar edhe nga APP-ja.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në lidhje me kërkesën mbi disponibilitetin e inxhinierëve ndërtimi me profil strukturist dhe mjedisi, në preventivin e punimeve nuk është parashikuar asnjë zë punimesh apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza e inxhinierëve në fjalë. Objekti i prokurimit i përket asfaltimit nëpërmjet dy shtresave binder dhe asfalt, ndërkohë që zërat e tjerë të punimeve si: gërmime, mbushje me çakull, tombino etj., janë realizuar nga vetë Bashkia Memaliaj pra nuk kanë qenë objekt prokurimi. Në kushte të tilla nga ana Juaj si Autoritet Kontraktor nuk mund të parashikohen kërkesa për të cilat janë realizuar në një fazë tjetër nga vetë institucioni por vetëm atë që tenderohet. Inxhinieri me profil strukturist shërben për hartimin e projekteve, përllogarit ngarkesën e përhershme dhe të përkohshme të strukturave të objekteve civile dhe industrial dhe inxhinieri i mjedisit ezaurohet si kërkesë në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Vendosja e një distance të përcaktuar jo më larg se 50 km nga segmenti i rrugës që do të shtrohet për disponibilitetin e një fabrike në pronësi apo me qira asfalti, është kriter i tepërt pasi kufizon pjesëmarrjen e OE të cilët kanë vendodhjen në një largësi më të largët se 50 km pasi disa OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzierjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.
Fryma dhe qëllimi i LPP është të nxisë pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në këtë kuptim, referuar zërave të termave të referencës, grafikut të punimeve dhe afatit kohor për realizimin e punimeve konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e operatorit ekonomik të llojit të makinerive të mësipërme është e ekzagjeruar. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. OE konkurues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore, mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.
- Ndërsa për rastin e dytë problematika lidhur me impiantin e beton nuk lidhet me distancën prej 50 km apo me vërtetësinë e dokumentacionit që duhet të paraqes operatori ekonomik por me faktin që në preventivin e punimeve nuk janë parashikuar zëra betoni.
- Në dijeninë e Grupit të Auditimit nuk rezulton ndonjë dispozitë ligjore në të cilën të citohet se, në rast se APP-ja si organ shtetëror monitorues dhe rekomandues nuk sygjeron përditësime apo përmirësime të një kriteri të veçantë për kualifikim, kriteri është i vlefshëm. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

11. Procedura e prokurimit me objekt **"Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan",** Bashkia Memaliaj zhvilluar në vitin 2025.

c. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan".		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 4, datë 04.02.2025	**2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:** Nr. 31, datë 04.02.2025. 1. Xh. K. (Jurist) 2. M. S. (Arkitekt) 3. L. H. (Ekonomist)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Nr. 33, datë 04.02.2025. 1. L. M. (Kryetar) 2. B. C. (Anëtar) 3. B. Xh. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"		
5. Fondi Limit: 16,471,383 lekë pa TVSh	**6. Oferta fituese:** OE "E. C. C." ShPK me vlerë oferte 15,150,000 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit:** 1,321,383 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 04.03.2025	**9. Burimi i Financimit:** Nga Buxheti i Bashkisë Memaliaj në vlerën totale prej 20,000,000 lekë.	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) S'kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 1. OE "E. C. C." ShPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK:** Nuk ka	**13. Përgjigje nga APP apo KPP:** Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 316/13 prot., datë 21.03.2025	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 18,180,000 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan", janë siguruar fonde në vlerën 20,000,000 lekë nga buxheti vjetor për vitin 2025 i Bashkisë Memaliaj, ku miratimi për përdorimin e këtyre fondeve është kryer nëpërmjet Vendimit nr. 97, datë 23.12.2025, të Këshillit Bashkiak Memaliaj me objekt "Për miratimin e buxheit për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027", duke marrë njëkohësisht edhe konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1025/1 prot., datë 31.12.2024. Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tepelenë në formatin elektronik më datë 01.04.2025, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 31, datë 04.02.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. Xh. K. z. M. S. dhe znj. L. H.

Me Urdhrin nr. 32, datë 04.02.2025, z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, është caktuar Njësia e Prokurimit për përllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 316/2 prot., datë 04.02.2025, nga NjP është hartuar procesverbali mbi përcaktimin e fondit limit në vlerën 16,471,383 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 316/3 prot., datë 04.02.2025, NjP ka hartuar procesverbali me anë të së cilit ka caktuar/autorizuar znj. Xh. K. për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimit Publik. Me shkresën nr. 316/4 prot., datë 04.02.2025, NjP është drejtuar Titullarit të AK-së me një rekomandim mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur me mjete elektronike".

Me Urdhrin nr. 4, datë 04.02.2025, z. A. M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK-së, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan" me fond limit 16,471,383 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur".

Për realizimin e Projekt Zbatimit për objektin "Rikonstruksioni dhe asfalitimi i rrugës Ninesh-Levan" (për të cilën është prokuruar rikonstruksioni për vetëm 3 km nga ky segment rrugor), nga Bashkia Memaliaj është kontraktuar z. M. V. në rolin e Ekspertit të Jashtëm me Liçencën nr. K..., nga Bashkia Memaliaj është kontraktuar z. M. V. si Ekspert i Jashtëm. Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Projekt zbatimi;
- Profili tip;
- Ortofo nga Geo Portali;
- Raport Teknik;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;

Pjesë e Projekt Zbatimit ndodhet e Profili Tërthor për segmentin "Ninesh-Levan" ku parashikohen për t'u realizuar punimet sipas zërave:

- ✓ Punime gërmimi mbi shtresat ekzistuese;
- ✓ Profilizimi/mbushje me çakull 10 cm;
- ✓ Shtresë stabilizanti 10 cm;
- ✓ Shtresë binderi 5 cm;
- ✓ Shtresë asfalti 4 cm;

Në vijim të auditimit të dosjes së kësaj procedure u konstatua se, për realizimin e punimeve të një prej segmenteve nga Projekti aksin "Ninesh-Levan", Bashkia Memaliaj nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve ka kryer punime mbi trasenë ekzistuese për realizimin e disa prej zërave nga Seksioni Profili Tërthor sipas situacionit të punimeve si më poshtë:

Nr.	Numri i Analizës	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia
1	3.87/a	Gërmim dheu eskavator goma 0.25 gjerësi deri 2m tokë zakonshme, kati III me shkarkim në tokë	m^3	500
2	3.207/1	Shtresë çakulli 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	4,000

3	3.164/2t	F.V. Tubo të brinjëzuar O400	ml	12
4	3.164/4t	F.V. Tubo të brinjëzuar O600	ml	36
5	2.262	Shtresë betoni C16-20	m^3	3
6	2.88	Mur bllok betoni 20 cm lartësi 3m me llaç përzier M15	m^3	1.8
7	2.166	F.V. Hekur beton periodik O6-10	t	0.05
8	2.54/2	Mur guri lartësi deri 3m me llaç çimento M.15	m^3	12.5

Bashkëlidhur paraqiten disa nga seti i fotove për realizimin e punimeve të cituara më sipër:








Duke marrë në konsideratë faktin që dy prej zërave fillestar të parashikuara në Projekt Zbatimin për segmenti "Ninesh-Levan" konkretisht, "Punime gërmimi mbi shtresat ekzistuese" dhe "Shtresë çakulli 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri" janë realizuar me kapacitet e vetë institucioni, nga Bashkia Memaliaj si Autoritet Kontraktor ka prokuruar edhe dy prej zërave të tjerë nga Profili Tërthor "Shtresë stabilizanti" dhe "Shtresë binderi", sipas preventivit të punimeve si më poshtë:

Lekë

Nr.	Numër Analize	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	3.212/a	Shtresë stabilizanti t = 10 cm përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	10100	464.89	4,695,389
2	3.221/1	Shtresë binderi me granil gur kav, 4 cm me makineri	m^2	10100	1,165.94	11,775,994
Totali						**16471383**
TVSh 20%						**3,294,276**

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan" u konstatua se, nuk është respektuar në mënyrë rigoroze detaji teknik në Seksionin Tërthor. Nga Bashkia Memaliaj është vendosur për t'u prokuruar duke përdorur vetëm shtresat stabilizant dhe binder, por përdorimi i shtresë binder pa vendosur shtresën përfundimtare "Asfalti" sjell degradimin e shpejtë të shtresës së binderit duke amortizuar

njëkohësisht vet trupin e rrugës. Në lidhje me këtë situatë nga Bashkia Memaliaj ngrihen pretendimet se është vepruar në këtë formë për mungesë fondesh dhe krijimin e aksesit rrugor në këto fshatra.
Për sa i përket dokumentacionit teknik në lidhje me zbatimin e objektit të kontratës u konstatua se, ky dokumentacion nuk është publikuar në Sistemin e Prokurimit Publik, por vetëm preventivi i punimeve në të cilën përfshihen vetën dy zëra punimesh "Shtresë stabilizanti t = 10 cm e përhapur e ngjeshur me makineri" për sasinë 10,100 m^2 dhe "Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm me makineri" për sasinë 10,100 m^2. Mos publikimi i dosjes teknike në SPE është shkelje e kërkesave të parashikuara në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2020, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 15 "Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit", pika 3, ku përcaktohet që:

Pika 3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:
a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:
- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Hartimi i kritereve të DT:
Me shkresën nr. 316/7 prot., datë 05.02.2025, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.
Më datë 17.02.2025, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Memaliaj, rezulton se: Për procedurën me REF-37024-02-06-2025, me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan" me fond limit 16,471,383 lekë pa TVSh, ka sygjeruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Më datë 12.08.2024, nga NjP është hartuar procesverbali lidhur me reflektimin e rekomandimeve të dhëna nga APP-ja, duke hartuar një Shtojcë në Dokumentet e Tenderit.
Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor në hartimin e DT, kriteret nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurës e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:
1. Në Pikën nr. 2.3.3.b. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë,si më poshtë:
- Inxhinier Ndërtimi me profil strukturist 1 (një). Për secilin duhet të paraqiten:
- Kontratë punë e vlefshme;
- Diploma;
- CV;
- Liçencë;

Drejtuesit duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për këtë arsye të paraqitet deklaratë përkatëse nga Administratori i Shoqërisë. Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. *Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësin e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 26 *"Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit"*, pika 6

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese", si më sipër kërkuar.

Inxhinieri i Ndërtimit me profil strukturist shërben për hartimin e projekteve, përllogarit ngarkesën e përhershme dhe të përkohshme të strukturave të objekteve civile dhe industrial.

2. Në pikën nr. 2.3.3.c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

Emërtimi	Sasia
Teknik ndërtimi	1 (një)
Elektriçist	1 (një)
Betonues	2 (dy)
Hidraulik	2 (dy)

Për punonjësin me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, Operatorët Ekonomik duhet të plotesojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/çertifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
Etj.,					

Për punonjësin e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional, çertifikatë, diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas Ligjit nr. 15/2017, *"Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, si dhe dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Në lidhje me kërkesën për punonjësit me **profesion elektriçist, betonues dhe hidraulik,** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen të përfshira në preventivin e punimeve, nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme aftësitë profesionale për këta punonjës.

3. Në pikën nr. 2.3.3.d. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"*, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*. Për të përmbushur këtë kriter, OE duhet të paraqesin kontratë pune, diplomë dhe certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listë-pagesat e shoqërisë, të paktën për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

3.1. Në pikën nr. 2.3.3.e. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Ekspert Zjarrfikës" në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 152/2015, *"Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin"*, neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, Librezë pune, si dhe të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën e të paktën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit ose eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi. Në rastin kur eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, çertifikata përkatëse, si dhe fatura e këtij shërbimi.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018

(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohen të tepërta këto kërkesa pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

4. Në pikën nr. nr. 2.3.4. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul gome-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul cilinder-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Depozite uji mbi 500 litër	Në pronësi ose me qira	Copë 2
Kokore	Në pronësi ose me qira	Copë 19
Jelek	Në pronësi ose me qira	Copë 19

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).

b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit të vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.

d) Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Për fabrikën e asfaltit është kërkuar që të ketë distancë **50 km nga vendodhja e objektit për faktin që binderi dhe asfaltit të kenë temperaturën e duhur gjatë hedhjes** në objekt kjo në bazë dhe të VKM nr. 628, datë 15.07.2015, "Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve". Marrja e asfaltit nga një distancë më e largët do të ndikonte në cilësinë dhe temperaturat optimale të nevojshme për hedhjen e tij në trupin e rrugës duke patur parasysh edhe terren e veshtirë ku ndodhen keto rrugë.

Kërkesa për disponibilitetin e një mjeti "Eskavator me goma" është e pa argumentuar teknikisht për arsye se, kjo kërkesë shërben për realizimin e zërit të punimeve "Gërmim dheu me eskavator 0.25 gjerësi deri 2m tokë të zakonshme, kati III me shkarkim në tokë", pra ky zë është realizuar nga vetë institucioni, dhe nuk është i përfshirë në objektin e prokuruar. Vendosja e këtij kriteri është i tepërt pasi kufizon pjesmarrjen e operatorëve të tjerë të cilët kanë vendodhjen në një largësi më të vogël se 50 km nga segmenti i rrugës që do të shtrohet, pasi disa nga OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzierjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.

5. **Në pikën nr. 2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë:
a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte
b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni
c. 1 (një) Impiant prodhimi Asfalti
Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit/asfaltit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit/asfaltit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve. Në rast se Njësi/Fabrikë në pronësi inerteve/betonit/asfaltit është në pronësi/me qira duhet të paraqitet edhe **Leja e mjedisit nga QKL** sipas ligjit ne fuqi. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike pikat e kriterit 2.4 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje**). Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Prodhimi i betonit kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. Në bazë të preventivit të punime nuk është parashikuar ndonjë sasi betoni për t'u sjell në kantier. Operatorët Ekonomikë në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë kërkesa për paraqitjen e **lejes mjedisore,** mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurues/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit. Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (inerte dhe betone etj.,), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarin në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të Shtetit Shqiptar. Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"*, si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Xh. K., z. M. S., znj. L. H. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:
Me Urdhrin nr. 33, datë 04.02.2025, të z. A. M. në cilësinë e Titullarit të AK-së, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga znj. L. M. kryetar i komisonit dhe anëtarët z. B. C., z. B. Xh. Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 316/8 prot., datë 04.03.2025, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se ka qenë 1 OE pjesëmarrës i cili është kualifikuar, ku është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "E. C. C." ShPK.
Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. OE "E. C. C." ShPK (me Nipt K...) me vlerë të ofertës **15,150,000 lekë pa TVSh;**
Me shkresën nr. 316/9 prot., datë 10.03.2025, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, duke marrë edhe miratimin nga ky

i fundit me shkresën nr. 316/10 prot., datë 13.03.2025. Me shkresën nr. 316/11 prot., datë 13.03.2025, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, ku është shpallur si oferta më e sukseshme OE "E. C. C." ShPK.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE "E. C. C." ShPK të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Referuar Deklaratës mbi Disponueshmërinë e Mjeteve të publikuar në Sistemin e Prokurimit Publik OE "E. C. C." ShPK ka deklaruar se makineritë e paraqitura në këtë procedurë prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të tjera të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Nga auditimi u konstatua se, OE "E. C. C." ShPK ka angazhuar disa mjete konkretisht: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targë A...; Eskavator me goma me targë A...; Grejder me Faturë Tatimore Blerje nr. 22, datë 30.11.2015; Rul gome cilindër me Faturë Tatimore Blerje nr. 36, datë 31.01.2024; Rul cilindër- cilindër me Faturë Tatimore Blerje nr. 31, datë 13.04.2024, dhe Autobotë Uji me targë A..., në dy kontrata punë publike të nënshkruara me Bashkinë Memliaj.

a) Kontrata me nr. 316/13 prot., datë 21.03.2025, të lidhur ndërmjet Bashkisë Memaliaj dhe OE "E. C. C." ShPK me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan", me vlerë kontrate 18,180,000 lekë me TVSh. Për fazën e vlerësimit të ofertave, nga Titullari i AK-së është miratuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 316/10 prot., datë **13.03.2025,** ku është shpallur si oferta më e sukseshme ajo e paraqitur nga OE "E. C. C." ShPK.

b) Kontrata me nr. 315/12 prot., datë 21.03.2025, të lidhur ndërmjet Bashkisë Memaliaj dhe OE "E. C. C." ShPK me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan", me vlerë kontrate 18,543,600 lekë me TVSh. Për fazën e vlerësimit të ofertave, nga Titullari i AK-së është miratuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 315/9 prot., datë **25.02.2025,** ku është shpallur si oferta më e sukseshme ajo e paraqitur nga OE "E. C. C." ShPK.

2. Në pikën nr. nr. 2.3.4. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul gome-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul cilinder-cilindër	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
Depozite uji mbi 500 litër	Në pronësi ose me qira	Copë 2
Kokore	Në pronësi ose me qira	Copë 19
Jele	Në pronësi ose me qira	Copë 19

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).

b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit të vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.

d) Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.

Për mjetin Kamion me numër shasie W... me targë A... kapaciteti mbajtës i tij është 10.76 ton (18,000 kg - 7,240 kg = 10,760 kg) referuar të dhënave në lejen e qarkullimit me numër G..., ndërkohë që në kriter kërkohet kapaciteti mbajtë mbi 20 ton.

Mjeti Grejder nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por vetëm faturën tatimore të blerjes me nr. 22, datë 30.11.2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".

Për sa trajtuar më sipër OE "E. C. C." ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në shpalljen fitues të OE "E. C. C." ShPK pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, **znj. L. M.** Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët **z. B. C., z. B. Xh.**

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 1773/11 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga Grupi i Punës znj. L. M., z. B. Xh., z. M. S., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Për këtë procedurë prokurimi operatori i vetëm pjesëmarrës ka qenë subjekti "E. C. C." ShPK. Në kushte ku dokumentet e përgjithshme janë sipas kritereve të miratuara, nga KVO merr në konsideratë kohën e kryerjes së këtyre punimeve në favor të temperaturave që duhen për realizimin e tyre, si dhe mos dështimin e procedurës me qëllim shtyrjen e afatit të tyre. Ky operator ekonomik është shpallur fitues në një procedurë tjetër në Autoritetin Kontraktor Bashkia Memaliaj por në deklaratën e tij ka deklaruar se punimet do të kryhen jo në të njëjtën kohë por duke respektuar grafikun e secilës brenda afatit të përcaktuar në secilën prej tyre. Në këto kushte mjetet do të përdoren me kohë si në përfundimin e njërës punë, dhe në përfundimin e punës me këtë objekt brenda afateve të përcaktuara. Këtë e vërteton edhe përfundimi i punimeve që është sjellë për të dyja objektet e krahasuara brenda afatit të duhur. KVO ka vlerësuar sipas kritereve të vendosura në DT dhe përcaktimeve të vendosura në ligjet e prokurimit publik.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Ndodhemi përballë faktit që gjatë vlerësimit të dokumentacionit të OE "E. C. C." ShPK të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan", nuk janë hasur parregullsi vetëm për pjesën e deklaratës së angazhimit të mjeteve dhe makinerive por edhe në mos plotësimin e kërkesës nr. 2.3.4, të DT, konkretisht për dy prej mjeteve të paraqitura nga ky operator ekonomik, dokumentacioni i paraqitur është në mos përmbushje të kërkesave të DT.

- Problematika që lidhet me Deklaratën e dipsonibilitetit/angazhimit të mjeteve nuk lidhet me grafikun e punimeve që pretendohet nga ana Juaj, pavarësisht që edhe ky dokument nuk disponohet nga operatori ekonomik në të cilën të citoj se mjetet janë të angazhuara në një kontratë tjetër dhe do të përdoren sipas këtij grafiku punimesh), por jemi në fazën e deklarimit ku OE ka deklaruar që mjetet nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, ndërkohë që janë të angazhuar edhe në një kontratë tjetër. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

✓ **Procedurat e prokurimeve me vlera të vogla për vitet 2024-2025:**

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, në total Bashkia Memaliaj ka realizuar 47 procedura prokurimi me vlerë të vogël (19 procedura për vitin 2024 + 28 procedura për vitin 2025) me fond limit 35,060,347 lekë pa TVSh (10,880,000 lekë pa TVSh për vitin 2024 + 24,180,347 lekë pa TVSh për vitin 2025) dhe realizim kontrate 26,825,849 lekë pa TVSh (10,309,117 lekë pa TVSh për vitin 2024 + 16,516,732 lekë pa TVSh për vitin 2025). Përgjatë

kësaj periudhe janë realizuar edhe 92 procedura prokurimi me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSh me fond limit 8,829,760 lekë pa TVSh dhe realizim në vlerën 7,391,394 lekë pa TVSh. Funksionin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla për vitin 2024-2025 e kanë ushtruar z. B. C. dhe z. A. Xh. kryetar i komsionit dhe anëtarët znj. L. H., znj. Xh. K.. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla për vitin 2024 është ngritur me Urdhrat nr. 139, datë 10.09.2024, dhe nr. 103, datë 14.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj. Me zgjedhje nga 47 procedura të realizuara me fond limit 35,060,347 lekë pa TVSh janë audituar 10 procedura prokurimi me vlerë të vogël të publikuara në SPE në masën 21.2% të procedurave ndaj totalit. Në mënyrë tabelare paraqiten të dhënat mbi procedurat e audituara:

Lekë

Viti 2024/2025					
Nr.	**Objekti**	**Fondi limit**	**Vlera e kontratës**	**OE i shpallur fitues**	**Publikuar në APP**
1	Blerje materiale pastrimi/detergjent	1,000,000	652,000	H.	09.02.2024
2	Mbikqyrje punimesh rikonstruksion rrugësh administrative	451,687	391,875	G. C.	21.06.2024
3	Mbikqyrje përmirësimi i kushteve të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara	570,725	485,250	Th.	17.09.2024
4	Blerje kancelari për Bashkinë Memaliaj	1,000,000	541,000	I. O.	26.02.2024
5	Blerje kancelari për Bashkinë Memaliaj	798,500	700,000	L. D.	27.02.2025
6	Blerje uniforma për MZSH dhe Policinë Bashkiake	850,000	578,120	C.	27.02.2025
7	Blerje për veshje tradicionale të zonës se Bashkisë Memaliaj	888,900	888.000	B. M.	26.03.2025
8	Sigurimi i jetës së punonjësve të Sektorit të MZSH	350,000	328,600	A.	18.02.2025
9	Siguracioni i detyrueshëm për automjetet e Bashkisë	930,000	326,000	A. SHA	24.02.2025
10	Blerje detergjente për nevoja të Bashkisë Memaliaj	597,000	328,600	A.	18.02.2025
Totali		**7,436,812**	**4,614,903**		

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2024-2025

1. Me Urdhrin nr. 4, datë 12.02.2024, Kryetarit të Bashkisë z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. A. Xh. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. L. H. dhe znj. Xh. K. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje materiale pastrimi/detergjent për Bashkinë Memaliaj"** me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSh.

Më datë 01.07.2024, nga komisioni për testimin e tregut është hartuar procesverbali mbi përllogaritjen e fondit limit. Nga anëtarët e komisionit është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit. Nga auditimit i kësaj procedure në SPE u konstatua se, referuar klasifikimit përfundimtar të datës 14.02.2024, operatori ekonomik i kualifikuar i pari është OE "M. N. C." ShPK me vlerë oferte ekonomike prej 500,000 lekë pa TVSh.

Pas s'kualifikimit të 3 OE të renditur sipas klasifikimit përfundimtar të shoqëruar me procesverbalet respektive, është shpallur fitues OE "H." ShPK me fond limit 648,000 lekë pa TVSh i renditur i katërti.

- Mallrat janë marrë në dorëzim nga komisioni përkatës duke u bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 1, datë 26.02.2024;
- Nga OE fitues është lëshuar fatura elektronike nr. 7/2024, datë 26.02.2024, dhe likuidimi është kryer me USH nr. 158, datë 24.05.2024.
- Pagesa është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* neni 7;
- Nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi;
- Dosja e kësaj procedure është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

2. Me Urdhrin nr. 25, datë 20.06.2024, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga z. A. Xh. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. L. H., znj. Xh. K. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Mbikqyrje punimesh në objektin "Rikonstruksion i rrugëve të njësive administrative"** me fond limit 451,687.50 lekë pa TVSh.

- Nga anëtarët e komisionit është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit.

- Për sa i përket përllogaritjes së fondit limit, në dosjen e kësaj procedure administrohet një procesverbal pa datë dhe pa numër protokolli, për më tepër që nuk është i nënshkruar nga anëtarët e komsionit.
Në SPE më datë 21.06.2024, është shpallur fitues OE "G." ShPK me vlerë të ofertës 391,875 lekë pa TVSh i cili është renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.
- OE ka lëshuar faturën elektronik nr. 53/2024, datë 03.10.2024, ndërsa likuidimi është kryer me USH nr. 455, më datë 08.11.2024.
- Dosja e kësaj procedure është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

3. Me Urdhrin nr. 37, datë 10.09.2024, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. B. C. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. L. H., znj. Xh. K. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Mbikqyrje, përmirësimi i kushteve të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara"** me fond limit 570,725 lekë pa TVSh.
- Për sa i përket përllogaritjes së fondit limit, në dosjen e kësaj procedure administrohet një procesverbal pa datë dhe pa numër protokolli, për më tepër që nuk është i nënshkruar nga anëtarët e komsionit. Referuar klasifikimit përfundimtar OE të kualifikuar janë:
OE "P. D." ShPK me vlerë ekonomike 485,248,72 lekë pa TVSh i klasifikuar i pari në klasifikimin përfundimtar. Nga komisioni është mbajtur procesverbali i s'kualifikimit të OE "P. D." ShPK pasi ka bërë dorëheqje në SPE. Në SPE më datë 17.09.2024, është shpallur fitues OE "Th." me vlerë oferte ekonomike 485,250 lekë pa TVSh i cili është i renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar.
- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

4. Me Urdhrin nr. 9, datë 22.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga z. B. C. kryetar i komisionit e anëtarë znj. L. H., znj. Xh. K. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje kancelari për Bashkinë Memaliaj"** me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSh.
- Nuk ka kërkesë për pajisjen me bazë materiale drejtuar komisionit të prokurimeve me vlera të vogla.
- Nuk ka ndonjë dokument se si është përllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla. Në SPE më datë 26.02.2024, është shpallur fitues OE "I. O." me vlerë ekonomike 541,000 lekë pa TVSh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.
- USH nr. 163, datë 28.05.2024, i përket faturës elektronike nr. 3228, datë 04.03.2024.
Nëpërmjet procesverbalit pa numër protokolli i nënshkruar z. B. R., znj. E. S. dhe znj. A. H. në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë sipas FH nr. 2, datë 26.02.2024, dhe FH nr. 2, datë 04.03.2024.
- Pagesa është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* neni 7;
- Bazuar në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Ofertë konkretisht: "Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë 24 orë duke filluar nga dita e marrjes së njoftimit të fituesit", ndërkohë që OE është shpallur fitues më datë 26.02.2024, si dhe mallrat jo plotësisht, janë bërë hyrje në magazinë më datën 26.02.2024, ndërsa një sasi malli është bërë hyrje në magazinë më datë 04.03.2025, pra me vonesë. Këto veprime janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Ftesën për Ofertë publikuar në SPE më datë 22.02.2024.
- Dosja e kësaj procedure është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në*

Republikën e Shqipërisë" miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

5. Me Urdhrin nr. 4, datë 05.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga kryetar i komisionit z. B. C. dhe anëtarët znj. Xh. K. znj. L. H. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje kancelari për nevoja të Bashkisë Memaliaj"** me fond limit 798,500 pa TVSh.

- Nga auditimit i kësaj procedure në SPE u konstatohet se, bazuar në klasifikimin përfundimtar janë s'kualifikuar 5 OE konkretisht, OE "B. T.", OE "A. P.", OE "V. B.", OE "A. K.", OE "S. A.", për të cilët nga komisioni i sipërpërmendur jane mbajtur procesverbalet respektive të s'kualifikimit të tyre.

Në SPE më datë 27.02.2025, është shpallur fitues OE "L. D." me vlerë oferte ekonomike 700,000 lekë pa TVSh i cili është i renditur i gjashti në klasifikimin përfundimtar.

OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën elektronike nr. 150, datë 30.04.2025, në shumën 840,000 lekë me TVSh ku është likuiduar me transaksionin e datës nr. 254, datë 02.06.2025. Nëpërmjet procesverbalit të datës 04.03.2025, të nënshkruar nga z. B. R., znj. A. O. dhe z. B. C. e magazinierit znj. R. P., në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, janë marrë mallrat në dorëzim ku janë bërë hyrje në magazinë sipas FH nr. 10, datë 04.03.2025. Me shkresën nr. 184 prot., datë15.11.2024, ka kërkesë për pajisjen me materiale drejtuar Kryetarit të Bashkise, kërkesë e cila është miratuar.

- Nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit pra nuk dokumentohet si është kryer testimi i tregut.
- Pagesa është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* neni 7;
- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

6. Me Urdhrin nr. 5, datë 14.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga z. B. C. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. Xh. K., znj. L. H. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje uniforma për MZSH dhe Policinë Bashkiake"** me fond limit 850,000 lekë pa TVSh.

- Nga auditimit i kësaj procedure në sistemin e prokurimit publik të APP-së konstatohet se, referuar klasifikimit përfundimtar, operator ekonomikë të kualifikuar janë:

1. OE "E. K." me fond limit 480,000 lekë pa TVSh;
2. OE "A." me fond limit 499,000 lekë pa TVSh;

Për sa i përket OE të sipërpërmendur nga komisioni është mbajtur procesverbali i s'kualifikimit vetëm për OE "A." më datë 17.02.2025.

- Në SPE më datë 27.02.2025, është shpallur fitues OE "C." me fond limit 578,120 lekë pa TVSh i cili është i renditur i treti në klasifikimin përfundimtar.
- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën elektronike nr. 388, datë 02.05.2025, në shumën 693,744 lekë me TVSh ku është likuiduar me USH nr. 313, datë 24.06.2025.
- Nëpërmjet procesverbalit të datës 20.03.2025, të nënshkruar nga z. A. Sh., znj. L. Ç. dhe z. H. M. në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, janë marre mallrat në dorëzim ku janë bërë hyrje në magazinë sipas fletë-hyrjes datë 20.03.2025.

Për sa i përket OE të sipërpërmendur nga komisioni është mbajtur procesverbali i s'kualifikimit vetëm për OE "A." më datë 17.02.2025.

- Për OE "E. K.", nuk është mbajtur proces verbal s'kualifikimi veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, *"Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"* i ndryshuar, pika 14, gërma "a" dhe "b".

- Nuk ka kërkesë për pajisjen me materiale drejtuar komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;
- Nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit pra nuk dokumentohet si është kryer testimi i tregut;
- Pagesa është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* neni 7;
- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

7. Me Urdhrin nr. 17, datë 06.03.2025, të Kryetarit të Bashkise Memaliaj z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. B. C. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. Xh. K., znj. L. H. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje për veshje tradicionale të zonës së Bashkise Memaliaj"** me fond limit 888,900 lekë pa TVSh.
Në SPE më datë 16.03.2025, është shpallur fitues OE "J. M." i cili është renditur i pari në klasifikimin paraprak prej shtatë OE pjesëmarrës. Pas s'kualifikimit të gjashtë OE, për të cilët janë mbajtur procesverbalet respektive. Më datë 26.03.2025, është shpallur fitues OE "B. M." ku në klasifikimin paraprak është renditur në vendin e shtatë, me vlerë oferte ekonomike 888,000 lekë pa TVSh.
- Mallrat e marra në dorëzim janë bërë hyrje në magazinë sipas fletë-hyrjes nr. 24, datë 16.05.2025. OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën elektronike nr. 2/2025, datë 02.06.2025, në shumën 888,000 lekë me TVSh, ku është likuiduar me USH nr. 312, datë 24.06.2025, në O. B.
- Nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatëse për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administroj dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.
- Nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit pra nuk dokumentohet si është kryer testimi i tregut.
- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

8. Me Urdhrin nr. 6, datë 17.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. Xh. K. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A. Xh., znj. L. H. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Sigurimi i jetës së punonjësve të sektorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)"**, Bashkia Memaliaj Shërbime Sigurimi" me fond limit 350,000 lekë pa TVSh.
Është lidhur kontrata me nr. 1524 prot., datë 09.07.2024, mes AK Bashkia Memaliaj dhe OE "A. J.", për një periudhë 12 mujore.
- Me shkresën nr. 92 prot., datë 10.06.2024, dokumentohet kërkesa nga Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit.
Me procesverbalin më datë 26.06.2024, dhe pa numër protokolli, është bërë argumentimi dhe miratimi i specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga komisioni i prokurimit.
Nga anëtarët e komisionit është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit. Në SPE më datë 18.02.2025, është shpallur fitues OE "A." me vlere oferte ekonomike 328,600 lekë pa TVSh. OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën elektronike me nr. 40342/2025, datë 06.03.2025, në shumën 104,600 lekë dhe nr. 31924/2025-31933/2025, datë 21.02.2025, në shumën 224,000 lekë ku janë likuiduar me USH nr. 59, datë 24.2.2025, dhe nr. 120, datë 20.03.2025.
- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të*

Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë" miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

9. Me Urdhrin nr. 6, datë 17.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. B. C. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. Xh. K. dhe znj. L. H. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Siguracioni i detyrueshëm për automjetet e bashkisë"** me fond limit 930.000 lekë pa TVSh.
- Në SPE më datë 24.02.2025, është shpallur fitues OE "A." ShA me fond limit 328,600 lekë pa TVSh. OE i shpallur fitues ka lëshuar 12 siguracione për mjetet motorike të Bashkisë Memaliaj të datës 21.02.2025, e datës 06.03.2025, në shumën totale 328,600 lekë.
- Ky shpenzim është likuiduar me USH nr. 59, datë 24.02.2025 dhe nr. 120, datë 20.03.2025.
- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

10. Me Urdhrin nr. 16, datë 15.03.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj z. A. M. në cilësinë e titullarit të AK është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. B. C. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. Xh. K. dhe znj. L. H. i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje detergjente për nevoja të Bashkisë Memaliaj"** me fond limit 597,000 lekë pa TVSh.
Nëpërmjet procesverbalit të datës 21.03.2025, të nënshkruar nga znj. K. Sh., znj. M. B. dhe znj. A. H. në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, prezent ka qenë edhe magazinier znj. R. P. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë- hyrje nr. 11 e nr. 11/1, datë 21.03.2025. Fatura e datës 21.03.2025, likuiduar me USH nr. 240, datë 12.05.2025.
- Nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatëse për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administroj dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.
- Nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit pra nuk dokumentohet si është kryer testimi i tregut.
- Pagesa është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* neni 7;
- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e pa arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

Për sa trajtuar më sipër, në mënyrë të përmbledhur paraqiten problematikat e konstatuara lidhur me auditimin e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla:
- Në **5** raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administroj dokumentacionin e çdo procedure prokurimi;
- Në **5** raste nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit pra nuk dokumentohet si është kryer testimi i tregut;
- Në **1** rast nuk është mbajtur procesverbal s'kualifikimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, *"Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"* i ndryshuar, pika 14, gërma "a" dhe "b".
- Në **1** rast marrja në dorëzim e mallrave objekt kontrate është kryer në mënyrë pjesore, me një vonesë prej 6 ditësh, duke mos respektuar edhe afate e parashikuara në Ftesën për Ofertë të publikuar në SPE më datë 22.02.2024;
- Në **5** raste pagesa për likuidimin e fatuës tatimore të lëshura nga operatorët ekonomik është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* i ndryshuar, neni 7;

- Në **10** raste dosjet e prokurimeve me vlerë të vogël nuk janë inventarizuara dhe as arkivuara. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e titullarit të AK-së dhe **znj. Xh. K., z. B. C., znj. L. H., z. A. Xh.,** në cilësinë e komisionit të prokurimeve me vlera të vogla sipas rasteve të trajtuara në vijim të këtij aktkonstatimi.

2.4.3. *Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve;*

1. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës **"Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivia" dhe ambjenteve sportive, bashkia Memaliaj"** viti 2024.

a. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambjenteve sportive", Bashkia Memaliaj, viti 2024		
14. Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 1722/14 prot., datë 20.11.2024, midis AK Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit BOE "S." & "G. C." ShPK, përfaqësuar nga "S." ShPK nr. 13483 rep., datë 16.11.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh):** 173,942,580 lekë	**16. Miratim Leje për kryerjen e punimeve e objektit-po** Vendimi Bashkisë Memaliaj nr. 3, datë 18.11.2024.
17. Situacioni Përfundimtar: Faturë Pune me volume sipas faktit Vlera 173,941,384 lekë me TVSh	**18. Afati i kontratës në muaj:** Parashikuar: 12 muaj nga fillimi i punimeve Fillimi punimeve: 19.12.2024 Përfundimi faktik i punimeve: 29.09.2025	**19. Zgjatja e kontratës-Jo** *Brenda afateve kontraktuale* - Garancia e punimeve: 1 vit nga çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim (neni 21 i kontratës)
20. **Mbikëqyrësi i punimeve:** Kontratë mbikëqyrje nr. 2124/14 prot., datë 18.12.2024, midis AK Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit "Th.", përfaqësuar nga Ing. znj. Xh. Gj.	Liçensa MK.4...	Procedurë e Hapur, me TVSh. Vlera 2,338,530 lekë
21. **Kolaudatori i punimeve:** Kontratë nr. 2331 prot., datë 21.10.2025, midis AK dhe Kontraktorit "E. S.", përfaqësuar nga Ing. z. A. D.	Liçensa MK.3...	Procedurë "Blerje e vogël" Vlera 194,733 lekë me TVSh
22. Akt Kolaudimi	04.11.2025	
23. Akt marrje në dorëzim-po	Nr. 2667 prot., datë 13.11.2025	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1722/14 prot., datë 20.11.2024, midis AK Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit BOE "S." ShPK & "G. C." ShPK, përfaqësuar nga "S." ShPK, me prokurën e posaçme nr. 13483 Rep., datë 16.11.2024. Vlera e kontratës është 173,942,580 lekë me TVSh. Financimi i projektit është realizuar me mbështetjen e MAS dhe Buxhetit të Bashkisë Memaliaj. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 7 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Deklarata e lejes së ndërtimit është miratuar me Vendimin nr. 3, datë 18.11.2024, të Bashkisë Memaliaj. Projekti parashikon rikonstruksionin e Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambjenteve sportive, ku përfshihen punime rikonstruksioni të gjimnazit, suvatime, lyerje, çatie etj., punime elektrike, hidrosanitare dhe ngrohje. Gjithashtu parashikohet ndërtimin fushës së sportit kalçeto me bar artificial.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 2124/14 prot., datë 18.12.2024, midis AK Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit "Th." ShPK, përfaqësuar nga Ing. znj. Xh. Gj. me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK...
- Për kolaudimin e punimeve të është nënshkruar kontrata me nr. 2331 prot., datë 21.10.2025, midis AK dhe Kontraktorit "E. S." ShPK, përfaqësuar nga Ing. z. A. D., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK...
- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar me shkresën nr. 1722/17 prot., datë 23.12.2024, ku përcaktohet se fillimi i punimeve është realizuar më datë 19.12.2024. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 19.12.2024. Procesverbali i fillimit të punimive është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 19.12.2024. Njoftimi i përfundimit dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me nr. 1513/6 prot., datë 29.09.2025, dhe procesverbali i përfundimit të punimeve miratuar nga palët datë 29.09.2025, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 04.11.2025, dhe çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me nr. 2667 prot., datë 13.11.2025.
- Kontrata përbëhet nga 4 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"* Kreu II, pika 8.1; *"Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori"* dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 *"Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.
- Me kërkesën e mbikëqyrësit datë 17.06.2024, dhe të sipërmarrësit, kërkohet përdorimi i fondit rezervë prej 5 % bazuar në azhornimin faktik dhe zëra të rinj të cilët janë paraqitur me analizë cmimesh, të cilat janë negociuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Me kërkesën për propozim nr. 1513/5 prot., datë 22.09.2025, paraqitet nga mbikëqyrësi, relacioni shpjegues, tabela e lëvizjes së volumeve, preventivi i ripunuar dhe preventivi i fondit rezervë, të cilat me procesverbalin datë 22.09.2025, miratohen nga Bashkia Memaliaj.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave dhe verifikimit në terren datë 07.05.2026, u konstatuan disa parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Në kapitullin e punimeve I të prishjeve të Gjimnazit dhe palestër, zëri nr. 10, nr. Anal. 2.426/9 *"Prishje suvatimi i jashtëm"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 1,713.29 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 1,713.29 m^3. Nga verifikimi i dokumentacionit fotografik në dosjen teknike, postimet e ndryshme të shkollës gjatë punimeve në faqen e Ministrisë së Arsimit konstatohet se prishja e suvatimit të jashtëm në fasadën e objektit <u>*nuk është realizuar*</u>. Veshja e fasadës me polisterol + rrjetë + suva është realizuar direkt në suvatimin ekzistues të shkollës si në fotot e mëposhtme:





Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin zëri nr. 10, nr. Anal. 2.426/9 *"Prishje suvatimi i jashtëm"*, në sasinë prej 1,713.29 m^3 dhe me çmimin 800 lekë/ m^3, <u>*rezulton vlera 1,370,632 lekë pa TVSh.*</u>

2. Në kapitullin e punimeve I, të prishjeve të Gjimnazit dhe palestër, zëri nr. 16, nr. Anal. 3.158/5a *"Transport dheu me auto deri 5 km"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 966.97 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit 966.97 m^3. Në llogaritjet në librezën e masave pasqyrohet llogaritja e volumit të pishjeve të suvatimeve jashtme (1,713.29 m^3 x 0.02 m = **34.27** m^3), e cila nuk është realizuar referuar edhe trajtimit mësipër mbi prishjen e suvatimeve të jashtme. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht më tepër volume në zërin zëri nr. 16, Anal. 3.158/5a *"Transport dheu me auto deri 5 km"*, në sasinë prej 34.27 m^3 dhe me çmimin 500 lekë/ m^3, <u>*rezulton vlera 17,135 lekë pa TVSh.*</u>

3. Në kapitullin III të punimeve të çatisë, zëri nr. 3, nr. Anal. 2.206 *"Kaseta shkarkimi llamarine xingat"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 14 copë dhe në librezën e masave pasqyrohet realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit 14 copë. Referuar kushteve teknike të zbatimit *(nëse ekziston ulluk horizontal dhe verikal, nuk vendoset kasetë për shkak të lidhjes së tyre me njëri-tjetrin pa kasetë shkarkimi)* dhe verifikimit në objekt, u konstatua se në shkollën "Sali Nivica", nuk janë vendosur kasetat e shkarkimit llamarinë xingat, vetëm janë vendosur në kapitullin IV, punime tarrace, zëri nr. 5 tek pjesa e palestrës. Pra, sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht 14 copë kaseta shkarkimi dhe me çmimin përkatës 1,500 lekë/copa, <u>*rezulton vlera 21,000 lekë pa TVSh.*</u>

4. Në kapitullin V, të punimeve muraturës zëri nr. 2, nr. Anal. 2.76 *"Mur tulle me vrima t=20 cm, llaç përzier M-25"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 18.62 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë 18.62 m^3. Nga verifikimi i librezës së masave, konstatohet se nuk është zbritur volumi negativ i trarëve e arkitrarëve b/a C-16/20, në sasinë prej 1.12 m^3. Pra, sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht 1.12 m^3, në zërin *"Mur tulle me vrima t=20 cm, llaç përzier M-25"* dhe me çmimin përkatës 15,000 lekë/ m^3, <u>*rezulton vlera 16,800 lekë pa TVSh.*</u> Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **1,425,567 lekë pa Tvsh** *(16,800 + 21,000 + 17,135 + 1,370,632)* ose 1,710,680 me TVSh**, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon: Mbikqyrësi i punimeve **Ing. znj. Xh. Gj.** nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të kontratës nr. 2124/14 prot., datë 18.12.2024, dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: "Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit".

<u>2.</u> Mbi auditimin e zbatimit të kontratës **"Riparimi i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz, Bashkia Memaliaj"** viti 2024.

a. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Riparimi i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz", Bashkia Memaliaj viti 2024		
14. Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatimi punimesh me nr. 1583/15 prot., datë 04.11.2024, midis Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK, përfaqësuar nëpërmjet Kontratës së Bashkëpunimit me nr. 5962 Rep., nr. 1852 Kol., datë 28.10.2024, nga OE "V. K." ShPK.	**15.Vlera e kontratës (me TVSh):** 61,726,516.80 lekë	**16. Miratim Leje për kryerjen e punimeve e objektit-po** Vendimi Bashkisë Memaliaj nr. 3, datë 13.11.2024.
17. Situacioni Përfundimtar : Faturë Pune me volume sipas faktit Vlera 61,713,000 lekë me TVSh	**18. Afati i kontratës në muaj:**	**19. Zgjatja e kontratës-Jo** *Brenda afateve kontraktuale* - Garancia e punimeve:

	Parashikuar: 2 muaj sipas grafikut të punimeve: Fillimi i punimeve: Datë 13.11.2024 Përfundimi i punimeve: Datë 14.01.2025 Amendimi i kontratës me nr. 102/1 prot., datë 14.01.2025, për arsye shtyrje të afatit të punimeve deri më datë 14.03.2025. Përfundimi faktik i punimeve: Datë 14.03.2025	2 vit nga çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim
20. Mbikëqyrësi i punimeve: Kontratë mbikëqyrje nr. 1583/8 prot., datë 17.09.2024, midis AK Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit "P. D." ShPK, përfaqësuar nga Ing. z. S. T.	**Licensa** MK...	Procedurë e Hapur, me TVSh. Vlera 1,019,960.58 lekë
21. Kolaudatori i punimeve: Kontratë nr. 102/1 prot., datë 16.07.2025, midis AK dhe Kontraktorit "E. S.", përfaqësuar nga Ing. z. A. D.	Liçensa MK...	Procedurë "Blerje e vogël"
22. Akt Kolaudimi	22.09.2025	
23. Akt marrje në dorëzim-po	Nr. 102 prot., datë 14.11.2025	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1583/15 prot., datë 04.11.2024, midis AK Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit BOE "Sh." ShPK & "V. K." ShPK, përfaqësuar nga "V. K." ShPK, me prokurën e posaçme nr. 5962 Rep., nr. 1852 Kol., datë 28.10.2024. Vlera e kontratës është 61,726,516.80 lekë me TVSh. Financimi i projektit është realizuar me mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes në zbatim të VKM-së nr. 307, datë 22.05.2024, "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore". Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 7 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Kontrata e sipërpërmendur ka pasur Amendimin nr. 1, datë 14.01.2025, me shkresën nr. 102/1 prot., datë 14.01.2025, në të cilën është përfshirë ndryshimi i afatit të punimeve nga data 14.01.2025, deri më 14.03.2025. Deklarata e lejes së ndërtimit është miratuar me Vendimin nr. 3, datë 13.11.2024, të Bashkisë Memaliaj. Projekti parashikon ndërhyrjen në pesë segmente rruge me qëllim riparimin e shkarjeve dhe sjelljen këtyre akseve në gjendje sa më normale dhe të aksesueshme për banorët e fshatrave pjesë e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 1583/8 prot., datë 17.09.2024, midis AK Bashkisë Memaliaj dhe Kontraktorit "P. D." ShPK, përfaqësuar nga Ing. z. S. T., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK...
- Për kolaudimin e punimeve të është nënshkruar kontrata me nr. 102/1 prot., datë 16.07.2025, midis AK dhe Kontraktorit "E. S." ShPK, përfaqësuar nga Ing. z. A. D., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK...
- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar me shkresën nr. 130 prot., datë 13.11.2024, ku përcaktohet se fillimi i punimeve është realizuar më datë 13.11.2024. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët me shkresën nr. 1583/20 prot., datë 13.11.2024. Procesverbali i fillimit të punimive është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi me shkresën nr. 141 prot., datë 13.11.2024. Njoftimi i përfundimit dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me shkresën nr. 27 prot., datë 13.03.2025, dhe procesverbali i përfundimit të punimeve miratuar nga palët

datë 14.03.2025, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 22.09.2025, dhe çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me nr. 102 prot., datë 14.11.2025.
- Kontrata përbëhet nga 3 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"* Kreu II, pika 8.1; *"Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori"* dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 *"Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.
- Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 1583/21 prot., datë 03.12.2024, dhe të sipërmarrësit, kërkohet përdorimi i fondit rezervë prej 5 % bazuar në azhornimin faktik dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Me kërkesën për propozim nr. 1583/21 prot., datë 03.12.2024, paraqitet nga mbikëqyrësi, relacioni shpjegues, tabela e lëvizjes së volumeve, preventivi i ripunuar dhe preventivi i fondit rezervë, të cilat janë të miratuara nga Bashkia Memaliaj.
II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave dhe verifikimit në terren datë 14.05.2026, u konstatuan disa parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:
1. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 5, nr. Anal. 3.243/1 *"Brez betoni c16/20 mbi gabion, t=15 cm"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 5 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 5.16 m^3. Llogaritja në librezën e masave pasqyrohet duke lloagritur sipërfaqen e betonit 30.34 m^2 x 0.17 m = 5.16 m^3. Nga verifikimi i objektit në terren, u konstatua se lartësia e brezit të betonit ishte 10 cm ose 0.1m dhe nga llogaritjet rezulton se volumi i betonit duhej të ishte 30.34 m^2 x 0.1 m = 3 m^3. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht më tepër volumin prej **2.16 m^3** (5.16 m^3- 3 m^3) të zëri nr. 5, nr. Anal. 3.243/1 *"Brez betoni c16/20 mbi gabion, t=15 cm"* dhe me çmimin 10,000 lekë/ m^3, *rezulton vlera 21,600 lekë pa TVSh.*
2. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 6, nr. Anal. 3.396/1 *"Mbushje me zhavor pas gabionit"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 274 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 274 m^3. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se mbushja me zhavor *nuk ishte realizuar*. Pas gabionit u konstatua se ishte me materialin e njëjtë të gabionit ose tepricat krijuara nga ndërtimi i gabionëve. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 6, nr. Anal. 3.396/1 *"Mbushje me zhavor pas gabionit"*, në sasinë prej 274 m^3 dhe me çmimin 1,000 lekë/ m^3, *rezulton vlera 274,000 lekë pa TVSh.*
3. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 15, nr. Anal. 4.19 *"Prerje asfalti me disk në dy anët"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 100 ml dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 100 ml. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se prerja e asfaltit *nuk ishte realizuar*. Rruga ishte ekzistuese dhe nuk ekzistonte asnjë prerje asfalti apo hedhje asfalti të ri. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 15, nr. Anal. 4.19 *"Prerje asfalti me disk në dy anët"*, në sasinë prej 100 ml dhe me çmimin 100 lekë/ ml, *rezulton vlera 10,000 lekë pa TVSh.*
4. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 16, nr. Anal. 3.212/b *"Shtresë stabilizanti 10 cm"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 200 m^2 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në

sasinë prej 200 m^2. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se shtresa e stabilizantit *nuk ishte realizuar*. Rruga ishte ekzistuese dhe nuk ekzistonte asnjë shtresë stabilizanti apo hedhje stabilizanti gjatë rrugës. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 16, nr. Anal. 3.212/b *"Shtresë stabilizanti 10 cm"*, në sasinë prej 200 m^2 dhe me çmimin 300 lekë/ m^2, *rezulton vlera 60,000 lekë pa TVSh.*

5. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 3,** zëri nr. 10, nr. Anal. 3.185 *"Guard rail N2 anësore me 2 valëzime në 1 anë W 4 + aksesorë"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 70 ml dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 70 ml. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se guard railit ishte në gjatësinë 64 ml. Pra me një diferencë prej 6 ml (70ml - 64ml) dhe me çmimin 3,000 lekë/ml, *rezulton vlera 18,000 lekë pa TVSh.*

6. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 3,** zëri nr. 15, nr. Anal. 3.243/1 *"Beton C16/20 për lugun e betonit ekzistues te muri"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 5 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 5.32 m^3. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se lugu i betonit ekzistues te muri *nuk ishte realizuar*. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 15, nr. Anal. 3.243/1 *"Beton C16/20 për lugun e betonit ekzistues te muri"*, në sasinë prej 5 m^3 dhe me çmimin 10,000 lekë/ m^3, *rezulton vlera 50,000 lekë pa TVSh.*

7. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 4,** zëri nr. 14, nr. Anal. 3.185 *"Guard rail N2 anësore me 2 valëzime në 1 anë W 4 + aksesorë"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 60 ml dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 60 ml. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se guard railit ishte në gjatësinë 19 ml. Pra me një diferencë prej 41 ml (60ml – 19ml) dhe me çmimin 3,000 lekë/ ml, *rezulton vlera 123,000 lekë pa TVSh.* Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **556,600 lekë pa TVSh** (*123,000 + 50,000 + 18,000 + 60,000 + 10,000 + 274,000 + 21,600)* ose 667,920 me Tvsh**, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon: Mbikqyrësi i punimeve Ing. **z. S. T.** nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të kontratës nr. 1583/8 prot., datë 17.09.2024, dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit për vitet 2024-2025:

2.5.1. *Auuditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i çertifikatave të përdorimit;*

2.5.2. *Auditimi mbi përllogaritjen dhe arkëtimin e taksave për pajisjen me leje ndërtimi;*

Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit të miratuara për përiudhën 2024-2025:

Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës së Bashkisë Memaliaj dhe në bazë të sistemit e-leje, gjatë periudhës 01.01.2024, deri më 31.12.2025, është miratuar **1 leje** ndërtimi (ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2), **6 leje** ndërtimi (ndërtim të ri me siperfaqe deri në 250 m^2), **4 leje** ndërtimi (shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2), **1 leje** infrastrukture, **15 deklarata** paraprake për kryerje punimesh, **9 leje** zhvillimi dhe **4 çertifikata përdorimi,** të pasqyruara në tabelën nr. 1, si vijon.

Tabela nr. 1. *Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2025 nga sistemi e-Leje:*

Periudha 01.01.2024-31.12.2024	
Përshkrimi i lejes	**Numri i miratimeve**
Leje zhvillimi	8

Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	4
Leje ndërtimi për ndërtimi të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	1
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	4
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtimi ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	-
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	-
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	4
Leje rindërtimi, rikonstuksion dhe riparim të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funkunksioni	1
Çertifikatë përdorimi	3
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	-
Leje për ndryshim funksioni	1
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-
Njoftim fillim punimesh	3
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	-
Leje infrastrukture	1

Periudha 01.01.2025-31.12.2025	
Përshkrimi i lejes	**Numri i miratimeve**
Leje zhvillimi	1
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	2
Leje ndërtimi për ndërtimi të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	-
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	-
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtimi ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	-
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	-
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	11
Leje rindërtimi, rikonstuksion dhe riparim të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funkunksioni	-
Çertifikatë përdorimi	1
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	-
Leje për ndryshim funksioni	1
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-
Njoftim fillim punimesh	2
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	-
Leje infrastrukture	-

Burimi: Të dhënat të vendosura në dispozicion nga drejtoria e urbanistikës e Bashkisë Memaliaj.

Në bazë të analizës së riskut, vlerës më të lartë të preventivit/investimit, referuar sipërfaqes më të madhe të ndërtimit, si edhe tipologjisë së ndërtimit janë përzgjedhur 4 raste të lejeve të ndërtimit për tu audituar (2 raste për secilin vit) dhe 1 çertifikatë përdorimi, të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi i lejes së ndërtimit	Preventivi sipas subjektit
1	Ndërtim kapanon bujqësor dhe mur rrethues	Th. ShPK	Nr. 1, datë 29.05.2024	10,738,429 Lekë
2	Punishte për përpunimin e ullirit	M. V.	Nr. 8, datë 27.09.2024	4,654,758 Lekë
3	Rikonstruksion me shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat	I. Sh.	Nr. 2, datë 23.01.2025	8,444,364 Lekë
4	Magazinë me kontruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore	P. F. H.	Nr. 4, datë 29.04.2025	4,226,959 Lekë
5	Bujtina "S. O."	E. B.	Nr. 1, datë 26.06.2024	Çertifikatë përdorimi


Nga auditimi i dokumentacionit në dosje dhe të dhënat e sistemit e-leje, rezultoi se:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *"e-Leje"* të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Memaliaj, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Ndërtim kapanon bujqësor dhe mur rrethues"***, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 29.05.2024, referuar Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar si dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

Objekti i lejes së ndërtimit: *"Ndërtim kapanon bujqësor dhe mur rrethues"*





1. Njësia Strukturore: Nuk është miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor	2. Zhvilluesi: Shoqëria "Th." ShPK	3. Adresa e realizimit të punimeve: Njësia	4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2: PO/JO-PO

		Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj	
5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi: Data: 02.04.2024	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi: Nr. 1, datë 29.05.2024		4/1. Lloji i objektit: Objekt për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 39 ditë	7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 10,738,428.81 lekë		10/1. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- PO

<u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes:</u>

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **39 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.

<u>Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes:</u>

Leja e zhvillimit është miratuar me Vendimin nr. 1, datë 11.03.2024.

Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit në të cilën do të zhvillohet ndërtimi janë si më poshtë:

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	2688
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	418
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit total:	418
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	15.56%
Intensiteti i ndërtimit:	0.156
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	4.5
Numri i kateve mbi tokë:	1

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, në rastin konkret, është miratuar referuar kushteve të zhvillimit (kondicionet), si vijon:

Leja e ndërtimit bazohet në kondicionet e përcaktuara në VKM-në nr. 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"*, të ndryshuar. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, në kapitullin II/b, pika 10, përcaktohet që për objektet për grumbullimi, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme: b) Të respektojnë distancat minimale **7 metër** nga kufijtë e pronës dhe 10 m nga ndërtesa të tjera.

- Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, evidentohet që distanca minimale nga kufiri i pronës është 7.2 metra – 30.1 metra. Për sa më sipër, në përputhje me përcaktimet e pikës 10, kapitulli II.b, të VKM-në 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore" të ndryshuar*.
- Përsa i përket distancës nga objektet e tjera, objekti nuk kufizohet me objekte të tjera.

<u>Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:</u>

Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar (pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi), si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, ndër të tjera janë edhe *"dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta"*. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:

- Çertifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	*Nr. pasurie*	*ZK nr.*	*Lloji*	*Sipërfaqe totale/m²*	*Truall m²*	*Ndërtesë m²*	*Data e lëshimit të dokumentit*
1	111/4	2519	Arë	2688	-	-	17.01.2024

Nga verifikimi i dokumentave të pasurisë që merr pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **2,688 m²**. Sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se harta treguese dhe kartela e pasurisë janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës brenda 3 muajve të fundit, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në zbatim të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019, *"Për kadastrën"* në nenin 17, pika 4.

Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

Nga autoriteti përgjegjës janë marrë paraprakisht mendimet e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: Agjencia e Zhvillimit të Territorit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia për Eficencën e Energjisë; Autoriteti Rrugor Shqiptar; Drejtoria Vendore ASHK Gjirokastër; Instituti i Ndërtimit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Mjedisit; Operatori i Sistemit të Transmetimit; PMNZSH Qendrore; Ujësjellës Kanalizime Tepelenë.Në kërkesën për mendim drejtuar ASHK-së nga autoriteti përgjegjës, institucioni ka miratuar në heshtje, në kundërshtim me nenin e sipërcituar, në të cilin përcaktohet që: *"Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën*"/

- Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Konstatohet se në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi në llogaritjen e saj referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, përcakton se:

"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore". Gjithashtu, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore"* i ndryshuar, përcakton se: *"1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit...; 3/a. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë,... taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit"*, dhe VKB nr. 83, datë 15.12.2023, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 të Bashkisë Memaliaj"*, pika 5, pika 5, nënpika 3.

Niveli i taksës për ndërtime që destinohen në sektorin e bujqësisë është 2% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Memaliaj.

Vlera e preventivit sipas subjektit: 10,738,429 lekë x 3% (niveli i taksës për destinacionin në sektorin e bujqësisë) = 322,153 lekë.

Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **32,220 lekë**, ndërkohë që, sipas përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, vlera e TNI-së duhet të ishte **322,153 lekë**.


Përllogaritja jo e saktë e taksës nga autoriteti përgjegjës ka ndodhur për shkak të një lapsusi në llogaritjen e nivelit të taksë. Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se vlera prej **289,933 lekë**, përbën të ardhura të munguara për Bashkinë e Memaliaj.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1. z. A. M., Kryetar i Bashkisë Memaliaj; 2. znj. L. M., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës; 3. znj. V. K., me pozicion ish përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Urban dhe Kadastrës; 4. z. J. T., me pozicion specialist në Drejtorinë e Zhvillimit

Urban dhe Kadastrës; 5. z. T. A., me pozicion specialist në Drejtorinë Juridike; 6. Znj.V. Xh., me pozicion specialiste tek Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore;

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *"e-Leje"* të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Memaliaj, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Punishte për përpunimin e ullirit"***, për të cilën është marrë Vendimi **nr. 8, datë 27.09.2024**, referuar Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar si dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i lejes së ndërtimit: "Punishte për përpunimin e ullirit"</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>1.Njësia Strukturore:
Nuk është miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor</td><td>2. Zhvilluesi:
M.V.</td><td>3. Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Iliras, Bashkia Memaliaj</td><td>4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2:
PO/JO- JO</td></tr>
<tr><td>5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Data: 26.06.2024</td><td colspan="2">6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Nr. 8, datë 27.09.2024</td><td>4/1. Lloji i objektit:
Objekt për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore</td></tr>
<tr><td>5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës:
67 ditë</td><td colspan="2">7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 4,654,758 lekë</td><td>11. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- JO</td></tr>
</table>

<u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes:</u>

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **67 ditë**, duke tejkaluar afatet e përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.

<u>Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes:</u>

Leja e zhvillimit është miratuar me Vendimin nr. 6, datë 21.05.2024, përpara miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Objekti bën pjesë në tipologjinë e ndërtimit për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore dhe shqyrtimi i aplikimit për leje ndërtimi bazohet në *VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015,"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"* i ndryshuar. Në vijim të lejes së zhvillimit është aplikuar për pajisjen me leje ndërtimit, me treguesit e zhvillimit të pasqyruar më poshtë:

Treguesit e zhvillimit

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	31907
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	248
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit total:	248
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	0.8
Intensiteti i ndërtimit:	0.008
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	6.06
Numri i kateve mbi tokë:	1

Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në kundërshtim me disa nga kushtet kryesore të zhvillimit (kondicionet), si vijon:

- Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet rilevimi topografik dhe plani i vendosje së objektit të propozuar mbi fragmentin e hartës ekzistuese. Në mungesë të paraqitjes së gjendjes ekzistuese të parecëlës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, nuk mund të merret në konsideratë saktësia e vendosjes së njollës së objektit mbi hartën e treguese të pasurisë dhe distancat e shënuara nga kufiri i pronës. Gjithashtu nuk paraqiten objektet me të cilat objekti kufizohet dhe distancat ndërmjet tyre. Po ashtu edhe distanca ndërmejt objektit dhe trupit të rrugës. Në lidhje me respektimin e distancave nuk mund të përcaktohet nëse janë respektuar, pasi nuk paraqitet një plan i saktë mbi të cilën të verifikohen. Për sa më sipër, në mospërputhje me pikën 1/ç, të nenit 15; pikën 2, të nenit 34, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar dhe me pikën 10, të kapitullit II.b, të VKM-në nr. 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"*, të ndryshuar.
- Në përgjigjen e Autoritetit Rrugor Shqiptar, me shkresën nr. 5646 prot., datë 30.07.2024, shprehen se objekti duhet të respektojë distancën **prej 30 metra**, nga Rruga Interurbane Kryesore Aksi Levan- Tepelenë të kategorisë C. Mendimi i institucionit nuk është reflektuar në projekt dhe në planvendosjen e miratuar, në kundërshtim me VKM-në nr. 153, datë 07.04.2000, *"Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar.
- Përsa i përket projektit teknik janë konstatuar pasaktësi dhe mospërputhje ndërmjet projektit konstruktiv dhe projektint arkitektonik, pasi ndryshojnë përmasat e katit përdhe. Në projektin konstruktive platforma ka sipërfaqe 312 m^2, ndërsa në projektin arkitektonik sipërfaqja e katit përdhe është 248 m^2 . Në rastin konkret, diferneca në sipërfaqe ndikon edhe në aplimin për leje ndërtimi, nga leje me sipërfaqe deri në 250 m^2 , në aplikimin për leje të objektit të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2. Sa më sipër, në kundërshtim me pikën 1/1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, sipas të cilit *"...dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Projekti i ndërtimit hartohet konform kushteve të përcaktuara në lejen e zhvillimit/dokumentet e planifikimit dhe në bazë të tij lëshohet leja e ndërtimit".*
- Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë asnjë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: *"Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:..."*.

Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:

Referuar pikës 1/"b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi, si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, janë, ndër të tjera, edhe *"dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta"*. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:

-Çertifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	*Nr. pasurie*	*ZK nr.*	*Lloji*	*Sipërfaqe totale/m²*	*Truall m²*	*Ndërtesë m²*	*Datë e aplikimit*
1	222/20	1980	Kullotë	31907	-	-	12.06.2023

Sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **31907 m²**.

Në lidhje me sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës *brenda 3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019, *"Për kadastrën"*, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: *"Çertifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar"*. Gjithashtu, çertifikata e pasurisë është paraqitur në një kopje të vetme për të gjithë (tre) bashkëpronarët, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3, nenit 17, të Ligjit nr. 111/2018, *"Për kadastrën"*, sipas të cilit: *"Çertifikata e pronësisë i lëshohet vetëm personit pronar ose bashkëpronarëve. Në rastin e bashkëpronësisë certifikata hartohet në aq kopje sa është numri i bashkëpronarëve".*

- Në lidhje me pasurinë e sipërcituara, nga dokumentacioni i shqyrtuar në sistemin e-leje, për pasurinë që merr pjesë në zhvillim është regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me çertifikatë regjistrimi qiraje, në emër të zhvilluesit, për një afat 20 vjeçar. Në sistem nuk është ngarkuar kontrata e qirasë në të cilën përcaktohen kushtet e dhënies së qirasë, si dhe nuk paraqitet marrëveshja me pronarët e pronës në të të cilën do të zhvillohet ndërtimi.

Për sa më sipër nuk paraqitet marrëveshja me palët e treta, në kundërshtim me gëmën b), të pikës 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, në të cilën përcaktohet: *"Dokumentat që duhet të paraqisë aplikuesi për tu pajisur me leje ndërtimi..., si dhe marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta".*

Si konkluzion pranimi dhe miratimi i dokumentacionit që vërteton të drejtat pasurore, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë dhe/ose nuk është paraqitur në formën e kërkuar, përveç riskut të veprimeve tjetërsuese që mund të ndodhin mbi pasurinë, mund të shkaktojë problematika apo efekte negative edhe gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

- Nga dokumentacioni i audituar, në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: Agjencia e Zhvillimit të Territorit; Drejtoria Rajonale OSHEE Gjirokastër; Drejtoria Vendore ASHK Tepelenë; PMNZSH Memaliaj; Ujësjellës Kanalizime Tepelenë; Autoriteti Rrugor Shqiptar; Operatori i Sistemit te Transmetimit.
- Në përgjigjen e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, me shkresën me nr. 3888 prot., datë 31.07.2024, shprehet që: *"Bashkia Memaliaj si autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit, mund të vijojë, sipas fushës së kompetencës, me vazhdimin e procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij projekt-propozimi për pajisjen me Leje Ndërtimi, në përputhje me procedurat dhe kushtet e zhvillimit të përcaktuara në VKM-në Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar, **me kushtin e marrjes së konfirmimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, në zbatim të VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"* i ndryshuar si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.
- Nga autoriteti përgjegjës nuk është marrë mendim nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe leja është dhënë në kundërshtim me kushtin e përcaktuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit për të miratuar lejen e ndërtimit.

- Në kërkesën për mendim drejtuar ASHK-së nga autoriteti përgjegjës, institucioni ka miratuar në heshtje, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të Territorit"* i ndryshuar.

Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Konstatohet se në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi në llogaritjen e saj referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, përcakton se: *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore".* Gjithashtu, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore"* i ndryshuar, përcakton se: *"1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit...; 3/a. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë,... taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit",* dhe VKB nr. 83, datë 15.12.2023, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 të Bashkisë Memaliaj"*, pika 5, nënpika 3. Niveli i taksës për ndërtime që destinohen në sektorin e bujqësisë është 3% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Memaliaj.


Vlera e preventivit sipas subjektit: 4,654,758 lekë x 3% (niveli i taksës për destinacionin në sektorin e bujqësisë) = 139,643 lekë

Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është 139,643 lekë, sipas nivelit të taksës me 3%,

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1. z. A. M., Kryetar i Bashkisë Memaliaj; 2. znj. L. M., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës; 3. z. J. T., me pozicion specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës; 4. z. T. A., me pozicion specialist në Drejtorinë Juridike; 5. znj.V. Xh., me pozicion specialiste tek Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Memaliaj, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Rikonstruksion me shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat"***, për të cilën është marrë vendimi **nr. 2, datë 23.01.2025**, referuar Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 53, datë 24.12.2024, si dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i lejes së ndërtimit: "Rikonstruksion me shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat"

</td></tr>
<tr><td>1.Njësia Strukturore:
MM_UB_A1_510/2</td><td>2. Zhvilluesi:
I. Sh.</td><td>3. Adresa e realizimit të punimeve: Rr." Vjosa ",
Bashkia Memaliaj</td><td>4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2:
PO/JO- JO</td></tr>
</table>

5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi: Data: 03.12.2024	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi: Nr. 2, datë 23.01.2025	4/1. Lloji i objektit: Banim
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 39 ditë	7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 8,444,364 lekë	8. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- PO

Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes:
Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **39 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.
Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes:
Parcelat në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore *MM_UB_A1_510/2*, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:
Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: MM_UB_A1_510/2, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV***	***Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës	A.Banim 100% A1-Banim	Banim
Parcela minimale për zhvillim	K1=300 m²	300 m^2
Lartësia në kate	2 kate	2 kate
Lartësia në metra	9.2 metra	7.6 metra
Intesiteti i ndërtimit	0.3	0.64
KSHT	15 %	32 %

Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në mospërputhje me disa nga kushtet e zhvillimit (kondicionet), konkretisht si vijon:
- Referuar të dhënave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 53, datë 24.12.2024, lartësia në kate/lartësia në metra e objektit të propozuar është brenda parametrave dhe kondicioneve të lejuara.
- Në raport me respektimin e distancave, referuar pikës 11, të nenit 34, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, përcaktohet që: *"Për objektet ekzistuese, të ndërtuara përpara viteve 1990, propozimi për ndërtimin e shtesës 1 kat mbi objektin ekzistues, përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat objekt-objekt apo me kufirin e pronës, duke respektuar konturin e katit të fundit, si dhe lartësinë maksimale të numrit të kateve të parashikuara në PPV".*
-Në raport me koeficientin dhe intensitetin e ndërtimit, referuar Planit të Përgjithshëm Vendor, parametrat nuk janë në përputhje të plotë me ato të përcaktuara në të.
Situata e sipërcituar është nuk është në përputhje të plotë me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, sipas të cilit *"Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me përcaktimet e lejes së zhvillimit, dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit e ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë"* si dhe pikës 1, të nenit 32, e cila, ndër të tjera, citon se:
"Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie përcaktohen nga autoriteti i planifikimit në PPV...".
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit për leje ndërtimi u konstatua që planvendosja e miratuar ka pasaktësi në paraqitje, pasi në pozicionin kadastral pozicionohet plani i vendosjes dhe në skemën e vendosjes së truallit pozicionohet harta treguese, në mospërputhje me gërmën "c", të pikën 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së*

zhvillimit të territorit" i ndryshuar, sipas të cilit *"....dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese".*

Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë masa për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: *"Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...".*

Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:

Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi, si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, janë, ndër të tjera, edhe *"dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta".*

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:

- Çertifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	***Nr. pasurie***	***ZK nr.***	***Lloji***	***Sipërfaqe totale/m²***	***Truall m²***	***Ndërtesë m²***	***Datë e aplikimit***
1	153/13	1025	Truall	300	300	96	17.09.2024

Nga verifikimi i dokumentave të pasurisë që mërr pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohet objekti është **300 m²**. Sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës brenda *3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në përputhje me Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019, *"Për kadastrën"*, në nenin 17, pika 4.

Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: Agjencia e Zhvillimit të Territorit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia për Eficencën e Energjisë; Autoriteti Rrugor Shqiptar; Drejtoria Rajonale OSHEE Gjirokastër; Drejtoria Vendore ASHK Tepelenë; Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Mjedisit; PMNZSH Memaliaj; Ujësjellës Kanalizime Tepelenë.

Sa më sipër, në përputhje me kërkesat drejtuar institucioneve referuar përcaktimeve të pikës 6, të nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, sipas të cilit *"Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve...".*


- Në kërkesën për mendim drejtuar ASHK-së nga autoriteti përgjegjës, institucioni ka miratuar në heshtje, në kundërshtim me nenin e sipërcituar, në të cilin përcaktohet që: *"Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën".*

-*Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):*

Konstatohet se në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi llogaritjen e saj referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e*

territorit” i ndryshuar, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”* i ndryshuar, dhe VKB nr. 4, datë 27.01.2025, *“Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 të Bashkisë Memaliaj”*, pika 5, nënpika 3.
Niveli i taksës për ndërtime që destinohen në sektorin e bujqësisë është 3% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Memaliaj.
Konstatim: Referuar të dhënave të Paketës Fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak, në pikën 5, në përcaktimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, në nënpikën 3, citohet që: *“Niveli i taksës për ndërtime që destinohen për përdorim vetjak banimi është 3% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Memaliaj”*, ndërsa në tabelën e paraqitur mbi pjesën e cituar, për të njëjtën kategori niveli i taksës është 2%.
Ky lapsus i paraqitur në tabelë, ka ndikuar në llogaritjen e mënyrave të ndryshme të taksës së ndikimit në infrastrukturë ku në disa raste është është taksuar me 2% dhe në disa raste me 3%.
Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **168,888 lekë**, ndërkohë që, sipas përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, vlera e TNI-së duhet të ishte **253,331 lekë**.
Përllogaritja jo e saktë e taksës nga autoriteti përgjegjës ka ndodhur për shkak të llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë me nivelin e taksës në 2% nga 3 % të përcaktuar në pikën 5 dhe nënpikën 3 të Paketës Fiskale të miratuar, sipas llogaritjes së mëposhtme. Vlera e preventivit të ngarkuar në sistemin e-leje: 8,444,364 lekë x 3% = 253,331 lekë.
Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se vlera prej **84,443 lekë**, si diferenca ndërmjet vlerës së paguar konkretisht nga subjekti dhe vlerës të cilës realisht ky i fundit duhet të paguante, përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Memaliaj.
Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1. z. A. M., Kryetar i Bashkisë Memaliaj; 2. znj. L. M., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës; 3. z. J. T., me pozicion specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës; 4. z. T. A., me pozicion specialist në Drejtorinë Juridike; 5. znj. V. Xh., me pozicion specialiste tek Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin “*e-Leje*” të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Memaliaj, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***“Magazinë me kontruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore”***, për të cilën është marrë vendimi **nr. 4, datë 29.04.2025**, referuar Ligjit nr. 107/2014, *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”* i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 53, datë 24.12.2024, si dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:
Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

Objekti i lejes së ndërtimit: *“Magazinë me kontruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore”*			
			
1. Njësia Strukturore: MM_UB_A1_567/1	2. Zhvilluesi: P. F. H.	3. Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Zhulaj, Njësia	4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2:

		Administrative e Krahës, Bashkia Memaliaj	PO/JO- JO
5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi: Data: 27.03.2025	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi: Nr. 4, datë 29.04.2025		4/1. Lloji i objektit: Objekt për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 23 ditë pune	7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 4,226,959 lekë		8. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo-PO

Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes:

Konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **23 ditë** pune, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.

-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes:

Parcela në të cilën zhvillohet ndërtimi bën pjesë në njësinë strukturore MM_UB_A1_567/1, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 53, datë 24.12.2024, në bazë të kushtet të zhvillimit të paraqitura më poshtë:

Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësisë Strukturore: MM_UB_A1_567/1, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV***	***Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës	UB_Urban A1-Banim / A2-Banim dhe Shërbime	Objekt në funksion të bujqësisë
Parcela minimale për zhvillim	K1=300 m2	1620 m^2
Lartësia në kate	2 kate	1 kat
Lartësia në metra	9.2 metra	5.3 metra
Intesiteti i ndërtimit	0.3	0.1
KSHT	15%	10.6 %

Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në mospërputhje me disa nga kushtet zhvillimit (kondicionet), konkretisht si vijon:

Leja e zhvillimit është miratuar me Vendimin nr. 1, datë 11.02.2025. Në lejen e zhvillimit përcaktohet disa kushte të vecanta që duhen plotësuar përpara miratimit të lejes së ndërtimit, përkatësisht specifikohet kushti për respektimi i distancave të përcaktuara në VKM-në nr. 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"* të ndryshuar. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, në kapitullin II.b, pika 10, përcaktohet që për objektet për grumbullimi, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme: b) Të respektojnë distancat minimale **7 metër** nga kufijtë e pronës dhe **10 m nga ndërtesa të tjera.**

- Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, evidentohet që distanca minimale nga kufiri i pronës është 5.10 metra nga 7 metra që duhet të respektonte në bazë të tipologjisë së objektit.

Për sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 10, kapitulli II.b, të VKM-në nr. 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore",* të ndryshuar.

- Përsa i përket distancës nga objektet e tjera, është respektuar distanca minimale prej 10 metrash. Situata e sipërcituar është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, sipas të cilit *"Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me përcaktimet e lejes së zhvillimit, dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit e ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë"*.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi:

- Në planvendosjen e miratuar, pozicioni kadastral me skemën e vendosjes së truallit të ndërtimit dhe me planin e vendosjes së objektit për zhvillim është i njëjtë. Për sa më sipër, në kundërshtim me gërmën c), të pikën 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që në dokumentacionin që duhet të paraqitet për pajisjen me leje ndërtimi është edhe plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;
- Përsa i përket projektit teknik janë konstatuar pasaktësi dhe disa mospërputhje ndërmjet projektit konstruktiv dhe projektint arkitektonik, pasi ndryshojnë përmasat e strukturës. Sa më sipër, në kundërshtim me pikën 1/1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, sipas të cilit *"...dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Projekti i ndërtimit hartohet konform kushteve të përcaktuara në lejen e zhvillimit/dokumentet e planifikimit dhe në bazë të tij lëshohet leja e ndërtimit".*
- Autoriteti përgjegjës nuk ka marrë asnjë masë për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: *"Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:..."*. Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:

Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi, si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, janë, ndër të tjera, edhe *"dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta".* Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:

-Çertifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	***Nr. pasurie***	***ZK nr.***	***Lloji***	***Sipërfaqe totale/m²***	***Truall m²***	***Ndërtesë m²***	***Datë e aplikimit***
1	214/35	3932	Arë	1620	-	-	04.11.2024

Nga verifikimi i dokumentave të të gjitha pasurive që marrin pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **1620 m²**. Në lidhje me sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës *brenda 3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019, *"Për kadastrën"*, në nenin 17, pika 4.

- Nga autoriteti përgjegjës nuk është kërkuar mendim ASHK-së, për të konfirmuar statusin e pronësisë, në kundërshtim me nenin e sipërcituar, në të cilin përcaktohet që:


"Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën".

- Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

Nga dokumentacioni i audituar, konstatohet se nga autoriteti përgjegjës nuk është marrë asnjë mendimet nga autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Sa sipër, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 6, të nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.
-*Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):*
Në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi në llogaritjen e saj, referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore"* i ndryshuar dhe VKB nr. 4, datë 27.01.2025, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 të Bashkisë Memaliaj"*, pika 5, nënpika 3. Niveli i taksës për ndërtime që destinohen në sektorin e bujqësisë është 3% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Memaliaj.
Konstatim: Referuar të dhënave të Paketës Fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak, në pikën 5, në përcaktimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, në nënpikën 3, citohet që: *"Niveli i taksës për ndërtime që destinohen në sektorin e bujqësisë është 3% e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Memaliaj"*, ndërsa në tabelën e paraqitur mbi pjesën e cituar, për të njëjtën kategori niveli i taksës është 2%. Ky lapsus i paraqitur në tabelë, ka ndikuar në llogaritjen e mënyrave të ndryshme të taksës së ndikimit në infrastrukturë ku në disa raste është është taksuar me 2% dhe në disa raste me 3%.
- Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **84,940 lekë**, ndërkohë që, sipas përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, vlera e TNI-së duhet të ishte **126,809 lekë**. Përllogaritja jo e saktë e taksës nga autoriteti përgjegjës ka ndodhur për shkak të llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë me nivelin e taksës në 2% nga 3 % që duhet të ishte sipas përcaktimeve në pikën 5 dhe nënpikën 3 të Paketës Fiskale të miratuar për vitin 2025. Vlera e preventivit të ngarkuar në sistemin e-leje: 4,226,959 lekë x 3% = 126,809 lekë. Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se vlera prej **41,869 lekë**, si diferenca ndërmjet vlerës së paguar konkretisht nga subjekti dhe vlerës të cilës realisht ky i fundit duhet të paguante, përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Memaliaj.
Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1. z. A. M., *Kryetar i Bashkisë Memaliaj*; 2. znj. L. M., *me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës*; 3. z. J. T., *me pozicion specialist në Drejtorisnë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës*; 4. z. T. A., *me pozicion specialist në Drejtorinë Juridike*; 5. znj. V. Xh., *me pozicion specialiste tek Tatim Taksat;* 6. z. M. S., *me pozicion specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës.*

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të certifikatave të përdorimit në Bashkinë Memaliaj, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***Bujtina "S. O.",*** për të cilën është marrë vendimi **Nr. 1, datë 26.06.2024**, referuar Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin e ndërtimit"* i ndryshuar., u konstatua si vijon:
Të dhëna të përgjithshme mbi certifikatën e përdorimit:

Objekti i çertifikatës së përdorimit: *Bujtina "S. O."*
 

1. Leja e ndërtimit: Nr.4, Datë 09.06.2023 1/2. Afati i lejes së ndërtimit: Datë 24 muaj	2. Zhvilluesi: E. B.	3. Adresa e realizimit të punimeve: në Gllavë, Njësia Administrative Buzë, Bashkia Memaliaj	4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2: PO/JO- PO
5. Data e dorëzimit të kërkesës për certifikatë përdorimi: 04.06.2024	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje certifikatë përdorimi: Nr. 1, datë 26.06.2024		4/1. Lloji i objektit: Strukturë Turistike Bujtinë 5 kate
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 17 ditë	8.Vlera e preventivit sipas lejes së ndërtimit: 39,292, 395 lekë		

<u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes:</u>
Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për certifikatë përdorimi për **17 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi, në përputhje me përcaktimet e pikës 5, të nenit 42, të Ligjit nr. 107/2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, sipas të cilit *"Autoriteti përgjegjës vendos për lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda 55 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës për leje ndërtimi..."* dhe përcaktimet e pikës 6 dhe 7, të nenit 27, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar. *<u>Në lidhje me zbatimin e kushteve të përcaktuara në miratimin e lejes së ndërtimit:</u>* Nga dokumentacioni i shqyrtuar për aplikimin e certifikatës së përdorimit, në raport me plotësimin e kushteve të përcaktuara në lejen e ndërtimit të miratuar, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen si vijon:
- Leja e ndërtimit është miratuar në datën 09.06.2023 dhe është e vlefshmërinë për 24 muaj, referuar lejes së ndërtimit të miratuar. Kërkesa për certifikatë përdorimi është realizuar 2 vite pas përfundimit të punimeve, më datë 04.06.2025, brenda afatit të lejes së ndërtimit.
Në raport me destinacionin e zhvillimit të strukturës së realizuar është në përputhje me lejen e ndërtimit.
- *<u>Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me çertifikatë përdorimi:</u>*
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, u konstatua që ka mangësi të dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi.
Përkatësisht, në dosjen e lejes së ndërtimit të ngarkuar në sistem, leja e ndërtimit nuk shoqërohet me planvendosjen e miratuar, në kundërshtim me pikë f, të nenit 27/2, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.
- Në dokumentacionin e ngarkuar në kërkesën për pajisjen me certifikatë përdorimi, nuk është paraqitur projekti i miratuar në lejen e ndërtimit dhe projekti "a.." (i zbatuar), duke krijuar paqartësi mbi tipologjinë e objektit të propozuar dhe mbi kushtet e realizimit të tij. Gjithashtu, në aktet e kolaudimit/ aktkontrolle e mbajtura nuk janë paraqitur fotografi në të gjitha drejtimet të objektit dhe nuk janë të ngarkuar në sistem vetëm fotografitë e realizimit. Përsa më sipër, në kundërtim me pikën g dhe j, të 27/2, të VKM-së 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.
- Në dokumentacionin e ngarkuar, nuk pasqyrohet situacioni përfundimtar i punimeve, në kundërshtim me pikën 1/e), të nenit 27/2, të VKM-në 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, u konstatua që mungojnë aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.,), të lëshuara nga shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime" Sh.A, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, referuar gërmës "ë", të pikës 1, të nenit 27/2.


- Në dosjen e shqyrtuar nuk paraqitet *"Projekti për mirëmbajtjen e objektit"*, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, referuar gërmës "gj", të pikës 1, të nenit 27/2.
- Gjithashtu, pjesë e dokumentacioni nuk është certifikimi i montimit të ashensorëve dhe inspektimi final, në kundërshtim me pikën 1/h, të nenit 27/2, të VKm-së 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i dokumentacioni teknik mungon edhe raporti përfundimtar i auditimit të eficiencës së energjisë, certifikata përfundimtare e performancës së energjisë, e lëshuar nga Audituesi Energjetik i Çertifikuar dhe regjistruar pranë AEE-së, së bashku me *"Deklaratën e përgjegjësisë profesionale"*, nëpërmjet së cilës konfirmon dhe mban përgjegjësi për përputhshmërinë e projektit të përfunduar me legjislacionin në fuqi për performancën e energjisë së ndërtesave. me pikën 1/ll, të nenit 27/2, të VKm-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar.

<u>Në lidhje me miratimin e çertifikatës së përdorimit:</u>

- Nga verifikimi i përfundimit të punimeve të ndërtimit u konstatuan ndryshime në realizimin e objektit, zgjerim të strukturës konstruktive në të dy drejtimet, duke sjellë si pasojë edhe ndryshimin e gjurmës së ndërtimit/ koeficientin e shfrytëzimit të territorit/intensitetin e ndërtimit, etj, përkatësisht kondicioneve të miratuara në lejen e ndërtimit. Gjithashtu, shkallët e emergjencës të propozuara në lejen e ndërtimit, janë integruar si pjesë e objektit dhe në dy katet e para zgjerohet gjurma e objektit, duke tejkaluar kufirin e pronës.
- Në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3, përcaktohet se certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e Kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor.

Ndërsa në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.

- Bazuar në Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, të VKM-së 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, përcaktohet se: *"Në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të kontrollit , sipas shkronjave "ç" dhe "dh", të këtij neni, janë të detyrueshme". Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollet e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle".* Autoriteti vendor nuk ka kryer verifikimet e nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, duke sjellë si pasojë devijim të lejes së ndërtimit të miratuar, shtimin e volumeve dhe sipërfaqes së ndërtimit, duke ndryshuar/tejkaluar kondicionet urbane të miratuara Gjithashtu, shtimi/zgjerimi i volumeve dhe i gjurmës së ndërtimit, ndikon në zhvillimin e objektit përtej kufirit të pronës në të cilën po zhvillohet, **duke cënuar pasuritë e tjera me të cilat kufizohet**.







- Gjithashtu mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMTV-së të Bashkisë Memaliaj, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e tyre në zbatim të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, referuar nenit 51, inspektimi dhe nenit 52, kundravajtje administrative, si dhe Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin e ndërtimit"* i ndryshuar, në bazë të Nenit 10, në të cilin përcaktohen detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, **ka sjellë si pasojë devijimin nga leja e ndërtimit të miratuar, shtimin e sipërfaqeve të ndërtimit dhe zhvillimi i objektit jashtë kufirit të pronësisë.**

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: 1. z. A. M., *Kryetar i Bashkisë Memaliaj*; 2. z. M. D., me pozicion Zv. Kryetar i Bashkisë Memaliaj; 3. znj. L. M., *me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës*; 4. z. J. T., *me pozicion specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës*; 5. z. T. A., *me pozicion specialist në Drejtorinë Juridike*; 6. znj. V. Xh., *me pozicion specialiste tek Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore*; 7. z. L. H., me pozicion Kryeinspektor i IMTV-së; 8. z. S. S., me pozicion inspektor i IMTV-së; 9. z. M. L., me pozicion inspekrot i IMTV-së.

Për sa më sipër për këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion me nr. 273 prot., datë 21.08.2026, nga subjekti i audituar Bashkia Memaliaj, administruar në KLSH me praktikën nr. 295/8 prot., datë 26.08.2026, nga z. M. D., znj. L. M., znj. V. K., z. J. T., z. T. A., znj. V. Xh., z. L. H., z. S. S., z. M. L., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Objekti: "Ndërtim kapanon bujqësor dhe mur rrethues", me zhvillues shoqëria "Th." Shpk për të cilën leja e ndërtimit është nr. 1, datë 29.05.2024, ju informojmë se:

- Dokumenti i rifreskuar i pronësisë është tokë truall dhe ngelej në kopetencë të Bashkisë megjithatë në këtë periudhë nuk ishte miratuar PPV. Për Bashkinë Memaliaj PPV u miratua me VKB nr. 53, datë 24.12.2024.
- Për llogaritjen e TNI nga autoriteti përgjegjës është bërë lapsus. Shoqërisë "Th." ju dërgua shkresë zyrtare dhe është paguar diferenca në mandat arkëtimin nr. 459, datë 21.07.2026.

2. Objekti: "Punishte për përpunim ulliri", me zhvillues z. M. V., leje ndërtimi nr. 8, datë 27.09.2024.

- Në periudhën që doli leja nuk ishte miratuar PPV, u miratua me VKB nr. 53, datë 24.12.2024. Për tokat bujqësore që nuk ka pas PPV të miratuar, kalonte në kopetencë të AZHT-së.

3. Objekti: "Rikonstruksion me shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat", me zhvillues znj. I. Sh. u njoftua me shkrese zyrtare nr. 2325 prot., datë 18.08.2026, për diferencën e TNI (pasi pagesa është bërë 2%, jo 3%).

4. Objekti "Magazinë me konstruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore" u njoftua me shkrese zyrtare nr. 2326 prot., datë 18.08.2026, për diferencën e TNI (pasi pagesa është bërë 2%, jo 3%).

5. Objekti: "Bujtina "S. O." me zhvillues z. E. B. çertifikatë përdorimi nr. 1, datë 26.06.2024, shtesa nuk është ndërtim, është strukturë e përkohshme që instalohet për nevoja të çastit me material të montueshëm.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Ndodhemi përballë faktit që në këtë observacion citohen një korrespodencë mbi ri përllogaritjen e TNI si dhe për një rast specifik kryerjen e likuidimit të diferencës të konstatuar nga Grupi i Auditimit por mbetemi thjesht në këtë fazë, pasi bashkëlidhur nuk ndodhet korrespodenca e përmendur më sipër apo mandat arkëtimi përkatës.

Gjithashtu në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj në të cilin shpreheni që shtesat nuk janë ndërtim, nga Grupi i Auditimit është konstatuar që objekti është realizuar në ndryshim dhe devijim nga leja e ndërtimit e miratuar nga bashkia.

Nga fotot e përfundimit të objektit evidentohet që struktura e tij është e njëjtë në të dy zgjerimet anësore të saj.

Ndërsa në lidhje me mbulesën e volumit të shtuar në hyrje të objektit (që është me konstruksion metalik), struktura mbështetet mbi volumin në lartësinë 1 dhe 2 kateve që është objekt ndërtimi. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV) për vitin 2024-2025:

2.6.1. *Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi dhe mbi procedurat e ndjekura lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit;*

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) pranë Bashkisë Memaliaj ushtron veprimtarinë e tij bazuar në Ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative", VKM nr. 894, datë 04.11.2015, "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe procedurave përkatëse të ndjekura nga kjo strukturë, janë konstatuar parregullsi të cilat paraqiten si më poshtë vijon:

a. *Struktura e IMTV-së, përbërja e saj dhe mjetet në dispozicion:*

Referuar strukturës organizative të Bashkisë Memaliaj si dhe informacionit të paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e IMTV për periudhën nga data 01.01.2024-31.12.2025, u konstatua se ky Inspektoriat është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. Struktura e IMTV, është miratuar me Vendimin nr. 98 prot, datë 12.01.2024, e cila është e organizuar në nivel sektori.
Bazuar në të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për periudhën 2024-2025, rezultoi se kjo strukturë është përbërë nga 4 punonjës, konkretisht: 1 Kryeinspektor dhe 3 Inspektorë. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit evidentohet se vetëm Kryeinspektori, z. L. H., zotëron arsimin e lartë në profilin juridik, ndërsa punonjësit e tjerë të ngarkuar me funksionin e inspektorit, nuk rezultojnë të kenë kualifikimin e duhur profesional, pasi z. S. S. dhe z. M. L. kanë arsim të mesëm të përgjithshëm, ndërsa z. A. M. ka arsim të mesëm profesional. Për rrjedhojë, përbërja profesionale e kësaj strukture nuk është në përputhje me kërkesat ligjore për ushtrimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së territorit.
Në këtë rast, është vepruar në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
Pra për vitet 2024-2025 struktura e IMTV-së ka funksionuar jo vetëm e kufizuar në numër, por edhe nuk ka plotësuar kriterin e kualifikimit profesional të përcaktuar nga ligji. Theksohet se në përbërje të strukturës së IMTV-së ka pasur ndryshime gjatë periudhës objekt auditimi, pasi inspektori z. A. M. është emëruar më datë 11.01.2024, dhe është larguar më datë 27.02.2025, ndërsa më pas vendi vakant është plotësuar gjatë vitit 2026. Struktura e IMTV-së, Bashkia Memaliaj, për periudhën 2024-2025 si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Lloji i arsimit/dega	Data e emërimit	Data e largimit
1	L. H.	Kryeinspektor	I lartë Bachelor, Juridik	12.02.2025	
2	S. S.	Inspektor IMT	I mesëm i përgjithshëm	29.04.2024	
3	M. L.	Inspektor IMT	I mesëm i përgjithshëm	30.05.2025	
4	A. M.	Inspektor IMT	I mesëm profesional	11.01.2024	27.02.2025

Për kryerjen e aktivitetit të tij, IMTV, Bashkia Memaliaj nuk disponon logjistikën e nevojshme si automjet për lëvizje për nevoja të inspektimit ditor, si dhe nuk disponon mjet për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve.

b. *Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:*

IMTV ushtron detyrat dhe funksionet bazuar në planet mujore, tre mujore dhe/ose vjetore të punës, të cilat duhet të jenë të planifikuara dhe të hartuara nga Kryeinspektori i IMTV-së, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore", nënpika b.ii.
Në këtë kuadër, nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacioni dhe informacioni përkatës mbi hartimin periodik të këtyre planeve, si dhe përcjellja e tyre pranë strukturave të varësisë.

- *Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024:*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IMTV, në lidhje me hartimin dhe miratimin e planeve të punës për vitin 2024, është konstatuar se:

- Për vitin 2024 nuk janë hartuar planet e punës në mënyrë periodike, pasi nga ana e IMTV-së nuk janë vënë në dispozicion plane mujore të punës për këtë periudhë, kjo referuar dhe faktit që kjo strukturë nuk ka qenë e konsoliduar dhe ka funksionuar me 1 (një) specialist i cili ka kryer rolin e insepktorit ndërkohë që në vitin pasardhës është ngritur një strukturë me e plotë.

- *Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025:*

- Për vitin 2025, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IMTV, rezultoi se janë hartuar plane/urdhër pune për periudhat Janar-Shkurt 2025, Mars 2025, Prill-Maj 2025, Shtator 2025, si dhe për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2025, ndërsa për muajt Qershor, Korrik, Gusht dhe Tetor 2025 nuk ka të tilla. Gjithashtu vlen të theksohet se dhe urdhrat e hartuar nuk paraqiten të plota në përmbajtje dhe mjaftueshëm të detajuara, pasi nuk pasqyrojnë në mënyrë të qartë dhe konkrete përbërjen e grupit të inspektimit, ndarjen e detyrave ndërmjet inspektorëve, zonat apo objektet që do të kontrollohen, rëndësia e zonës së inspektimit si dhe organizimin e plotë të kontrollit në territor.

Pra në urdhrat/planet e punës nuk përshkruhet në mënyrë të detajuar mënyra e kryerjes së veprimtarisë inspektuese gjatë periudhës përkatëse. Gjithashtu nuk rezulton të jetë administruar një praktikë e plotë shkresore që të provojë korrespondencën ndërmjet IMTV-së dhe strukturës përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, lidhur me ndjekjen e lejeve të ndërtimit të miratuara pasi nuk ka të dhëna mbi përcjelljen periodike të lejeve pranë IMTV-së, mbi përzgjedhjen e objekteve për kontroll në varësi të rëndësisë, vendndodhjes, fazës së zhvillimit apo nivelit të riskut, si dhe mbi kryerjen e verifikimeve faktike në terren.

Në këtë kuptim, nuk janë administruar procesverbale kontrolli, akte konstatimi, korrespondencë ndërmjet strukturave apo vendime të cilat dokumentojnë se IMTV ka verifikuar zbatimin e kushteve të lejeve të ndërtimit gjatë realizimit të punimeve.

- *Raportimet pranë IKMT:*

IMTV duhet të përgatis dhe dërgoj të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh., vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licencave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", pika "f".

- Nga ana e IMTV-së nuk janë dërguar raportime periodike pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit apo korrespondencë ndërmjet tyre për periudhën objekt auditimi.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. L. H. në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV.

c. *Mbi dokumentimin e procesit të prishjes së objekteve të kundërligjshëm me evidenca fotografike:*

Në zbatim të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", inspektorët, gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, kanë detyrimin të dokumentojnë veprimet e kryera dhe të administrojnë në dosjen përkatëse aktet dhe provat që pasqyrojnë gjendjen faktike të konstatuar. Në këtë kuadër, neni 41 i këtij ligji i njeh inspektorit të drejtën për të kryer fotografime, filmime, matje dhe administrimin e mjeteve të tjera të provës, me qëllim dokumentimin e plotë të procesit të inspektimit dhe të veprimeve pasuese administrative.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vitet 2024-2025 u konstatua se, për rastet e evidentuara nga IMTV, janë nxjerrë gjithsej 2 vendime prishjeje, konkretisht: Vendimi i prishjes nr. 1, datë 25.04.2024, ndaj kundërvajtësit z. L. H., dhe Vendimi i prishjes nr. 2, datë 28.08.2024, ndaj kundërvajtësit z. L. M.

Për rastin z. L. H., referuar PV konstatimi datë 17.03.2024, është konstatuar kryerja e punimeve pa leje, vendosje muri me blloqe dhe konstruksion, për të cilën është nxjerrë Vendimi i prishjes

nr. 1, datë 25.04.2024, si dhe Vendimi i gjobës nr. 1, datë 25.04.2024, në vlerën 20,000 lekë, e cila rezulton e paguar. Megjithatë, nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që procesi i prishjes/ekzekutimit të vendimit të jetë dokumentuar me evidenca fotografike apo me akte të tjera provuese të administruara në dosjen individuale të procedurës.
Ndërsa për rastin z. L. M., referuar PV konstatimi datë 19.08.2024, është konstatuar ndërtim i ri në fshatin Vasjar, në fazat e para të themeleve me beton, pa leje ndërtimi. Për këtë rast është nxjerrë Vendimi i prishjes nr. 2, datë 28.08.2024, si dhe Vendimi i gjobës nr. 2, datë 28.08.2024, në vlerën 441,353.7 lekë.
Nga informacioni rezulton se gjoba e vendosur është amnistuar sipas VKM-së përkatëse, ndërsa vendimi i prishjes është objekt i procesit gjyqësor dhe ekzekutimi i tij është pezulluar përkohësisht me vendim gjykate. Për këtë arsye, vendimi i prishjes mbetet i paekzekutuar deri në një vendim përfundimtar të formës së prerë.
Në përfundim vetëm 1 (një) rast nuk paraqiten evidenca, prova fotografike në kundërshtim me ligjin për inspektimin.

d. *Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimeve të IMTV:*

Në auditimin e veprimtarisë së IMTV të Bashkisë Memaliaj, për periudhën 01.01.2024-31.12.2025, u morën për bazë të dhënat dhe dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga strukturat e IMTV-së, në të cilat pasqyrohen në formë tabelare konstatimet e kryera, vendimet e pezullimit të punimeve, vendimet e dënimit me masë administrative gjobë, si dhe vendimet e prishjes së objekteve të kundërligjshme paraqitur si më poshtë:

Çështja	Nr. 1	Nr. 2	Nr. 3	Nr. 4	Nr. 5	Nr. 6	Nr. 7
Kundërvajtësi	H. H.	H. Q.	L. H.	Xh. Xh.	L. H.	L. M.	M. Gj.
PV konstatimi	Nr. 1, datë 01.02.2024	Datë 02.02.2024	Nr.6, Datë 26.02.2024	Datë 18.03.2024	Datë 17.03.2024	Datë 19.08.2024	Nr. 8, datë 19.12.2025
PV pezullimi	Nr. 3, datë 09.02.2024	Nr. 1, datë 02.02.2024	Nr. 4, datë 27.02.2024	Nr. 5, datë 25.03.2024	-	-	-
Vendim prishje	-	-	-	-	Nr. 1, datë 25.04.2024	Nr. 2, datë 28.08.2024	-
Vendim gjobe	-	-	-	-	Nr. 1, datë 25.04.2024	Nr. 2, datë 28.08.2024	-
Shkelja	Rikonstruksion pa dokumentacion teknik dhe moszbatim i masave të sigurimit teknik	Dalje jashtë lejes së dhënë dhe ndërtim muri rrethues 2 m lartësi	Kryerje punimesh pa leje ndërtimi; referohen edhe shkelje të ligjit nr. 107/2014, i ndryshuar	Portë metalike pa leje ndërtimi me 2 kolona betoni	Vendosje muri me blloqe dhe konstruksion pa leje	Ndërtim i ri në fazat e para të themeleve me beton, pa leje ndërtimi, në fshatin Vasjar	Gërmim dherash dhe prishje e strukturës së tokës pa lejen përkatëse; inertet nuk janë depozituar në vendin e duhur
Vlera e gjobës	-	-	-	-	20,000 lekë	441,353.7 lekë	-
Statusi	-	-	-	-	Gjobë e paguar	Gjobë e amnistuar sipas VKM-së përkatëse; vendimi i prishjes në proces gjyqësor	Duhet verifikuar vijimi i procedurës
Inspektorët	A. M., S. S.	A. M., S. S.	A. M., S. S.	S. S.	A. M., S. S.	A. M., S. S.	M. Ç., S. S.

Përmbledhje e praktikave të IMTV-së sipas procesverbaleve të konstatimit dhe vendimeve pasuese.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë evidentuar 7 raste/procedura kontrolli, të dokumentuara me procesverbalet përkatëse të konstatimit. Në vijim të këtyre konstatimeve, në 5 raste është vijuar me vendim pezullimi të punimeve, në 2 raste është vijuar me vendim prishjeje dhe vendim dënimi me gjobë. Në rastet kur merret vendimi i pezullimit të punimeve, kjo masë duhet të vlerësohet si masë paraprake dhe e përkohshme, e cila merret kur është i nevojshëm një afat kohor për verifikimin ose plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, për sqarimin e rrethanave faktike, ose për krijimin e kushteve për marrjen e një vendimi përfundimtar administrativ.
Referuar procedurës së unifikuar të kontrollit të territorit, vendimi i pezullimit nuk përbën në çdo rast mbyllje përfundimtare të procedurës, por në varësi të rezultatit të verifikimit duhet të

pasohet, sipas rastit, me vendim për vijimin/mbylljen e procedurës, vendim dënimi me gjobë, vendim prishjeje ose masë tjetër administrative të përshtatshme me natyrën e shkeljes.
Nga shqyrtimi i praktikave rezultoi se në disa raste IMTV ka vepruar fillimisht me vendim pezullimi, duke shmangur menjëherë marrjen e masave më të rënda administrative, si vendimi i prishjes apo dënimi me gjobë.
Kjo mënyrë veprimi, referuar natyrës së disa prej kundërvajtjeve të konstatuara, duket se është orientuar nga nevoja për të verifikuar dokumentacionin, për t'i dhënë subjektit mundësinë e paraqitjes së akteve tekniko-ligjore, si dhe për të vlerësuar nëse ndërhyrjet kishin karakter të rëndë apo mund të trajtoheshin si shkelje me ndikim më të kufizuar në territor.
Gjithashtu, duhet mbajtur në konsideratë fakti se struktura e IMTV-së nuk konstatohet të ketë qenë plotësisht e konsoliduar në aspektin organizativ dhe profesional, duke funksionuar me burime njerëzore të kufizuara dhe jo gjithmonë me profil të specializuar teknik për vlerësimin e plotë të rasteve ndërtimore. Në këtë kontekst, veprimtaria e inspektoratit duket se ka pasur në fokus kryesisht ndërprerjen e menjëhershme të punimeve, parandalimin e përkeqësimit të situatës në terren dhe krijimin e mundësisë për verifikim të mëtejshëm, përpara marrjes së masave ekstreme administrative.
Megjithatë, në aspektin procedurial, për çdo rast të trajtuar me pezullim duhet të rezultojë i dokumentuar vijimi i mëtejshëm i praktikës, pra nëse subjekti ka paraqitur dokumentacion, nëse është kryer rikontroll, nëse shkelja është korrigjuar, apo nëse është vlerësuar e nevojshme marrja e vendimit të gjobës/prishjes.

e. *Ndjekja e procedurave të vjeljes së detyrimeve:*

Nga auditimi i ekzekutimit të vendimeve të dënimit me gjobë u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, nga IMTV janë vendosur 2 masa administrative me gjobë, në vlerën totale 461,353.7 lekë, përkatësisht: gjoba në vlerën 20,000 lekë, ndaj subjektit z. L. H., dhe gjoba në vlerën 441,353.7 lekë, ndaj subjektit z. L. M. Nga verifikimi i statusit të arkëtimit rezulton se nga vlera totale e gjobave të vendosura është arkëtuar vetëm shuma 20,000 lekë, ndërsa vlera 441,353.7 lekë nuk rezulton e arkëtuar. Kjo vlerë, në momentin e vendosjes së masës administrative, përbënte detyrim të arkëtueshëm dhe të ardhur të mundshme për buxhetin e bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë ekzekutimin e masave administrative të vendosura nga strukturat e kontrollit të territorit.
Në këtë kuptim, neni 16, i Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, parashikon detyrimin për pagesën e gjobës brenda afatit ligjor, ndërsa në rast mospagese, vendimi duhet të ndiqet për ekzekutim sipas procedurave ligjore. Gjithashtu, Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, përcakton masat administrative që vendosen nga strukturat inspektuese, ndërsa Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative" rregullon procedurën e kundërvajtjeve administrative dhe ndjekjen e ekzekutimit të vendimeve përkatëse.
- Nga auditimi konstatohet se vlera prej 441,353 lekë është përfshirë më pas në efektet e Ligjit nr. 127/2024, datë 19.12.2024, "Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake", botuar në Fletoren Zyrtare më datë 31.12.2024. Në nenin 1 të këtij ligji parashikohet shfuqizimi i masave administrative të paekzekutuara deri në hyrjen në fuqi të tij, të vendosura gjatë periudhës 1 janar 2015-30 nëntor 2024, ku përfshihet edhe masa administrative e sipërcituar.
Duhet theksuar se, përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 127/2024, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezultojnë të jenë administruar akte që provojnë ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimit, si njoftimi për pagesë, ndjekja e afateve ligjore, kalimi për ekzekutim të detyrueshëm, apo koordinimi me strukturat përkatëse juridike dhe financiare të bashkisë. Nëse këto procedura do të ishin ndjekur në kohë nga IMTV, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike

dhe Drejtorinë e Financës, ekzistonte mundësia që detyrimi të arkëtohej përpara hyrjes në fuqi të ligjit shfuqizues.
Në këto kushte, mosndjekja e dokumentuar e procedurave të ekzekutimit përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 127/2024, ka sjellë pamundësinë e arkëtimit të vlerës **441,353.7 lekë,** e cila, deri në momentin e shfuqizimit ligjor, përbënte detyrim të arkëtueshëm ndaj buxhetit të bashkisë.
Nërfundim, struktura e IMTV-së ka vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi në disa raste nuk rezulton e dokumentuar ndjekja e plotë e procedurës pas konstatimit të shkeljes dhe/ose pas nxjerrjes së vendimit të pezullimit, si dhe nuk rezultojnë të administruara në mënyrë të plotë aktet mbi ekzekutimin dhe ndjekjen e masave administrative të vendosura.
Konkretisht, kjo praktikë nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i cili përcakton se: *IMTV ka detyrë të ushtrojë kontrollin e territorit dhe, sipas rastit, të vendosë për përmbushjen e detyrimeve ligjore, gjobën, pezullimin e punimeve, prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, kallëzimin penal dhe vendimin e zhdëmtimit për shpenzimet e prishjes*.
Gjithashtu, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 894, datë 04.11.2015, "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit", e cila përcakton se: *pas kontrollit mbahet procesverbali ku pasqyrohen gjendja faktike, mangësitë dhe detyrat për subjektin, ndërsa brenda 10 ditëve nga procesverbali duhet të nxirret vendimi për masat përkatëse dhe sanksionet administrative. Po kjo VKM përcakton se vendimi i pezullimit është masë e përkohshme deri në 60 ditë dhe, sipas rastit, shoqërohet me vendim gjobe, kallëzim penal apo kërkesë për heqje licence, ndërsa nuk pengon marrjen e vendimit të prishjes kur konstatohet ndërtim i kundërligjshëm*; VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e cila përcakton se: *llojet e ndërhyrjeve që kërkojnë leje, deklaratë paraprake apo dokumentacion përkatës, si dhe detyrimin që kërkesat dhe aktet në fushën e zhvillimit të territorit të trajtohen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve dhe dokumentacionit shoqërues.*
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. L. H. Kryeinspektor i IMTV dhe inspektorët **z. S. S., z. M. L., z. A. M.**

2.7. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Asete dhe Pyje Kullota) të transferuara sipas VKM për vitet 2024-2025:
2.7.1. *Auditim mbi statusin e pronave të transferuara me VKM dhe rregjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës;*
Si çdo institucion publik Bashkia Memaliaj ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si, pronat, tokat dhe pasuritë natyrore.
Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Memaliaj i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve si dhe një pjesë e tyre nga shkrirja e ish-komunave aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Memaliaj.
Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Memaliaj duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.
Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion u konstatua se, Bashkia Memaliaj disponon listat e inventarit të pronave të paluajtshme të miratuara me VKM-të përkatëse për njësitë administrative përbërëse, përkatësisht Krahës, Memaliaj Fshat, Memaliaj, Qesarat, Luftinjë dhe Buz si dhe Bashkisë Memaliaj. Këto lista përbëjnë bazën e pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të Bashkisë dhe Njësive Administrative përkatëse.

- Në lidhje me administrimin dhe përditësimin e listave të pronave të paluajtshme, nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton të jetë kryer një proces i plotë verifikimi i gjendjes faktike të pronave në terren.
Konkretisht, nuk rezulton të jenë kryer evidentimet faktike për çdo pasuri të inventarizuar apo të transferuar në favor të Bashkisë, me qëllim krahasimin e të dhënave të listave të miratuara me VKM me gjendjen reale në terren, përditësimin e listave të inventarit, hartimin e dokumentacionit hartografik/kadastral dhe dërgimin e praktikave pranë ASHK-së për regjistrim dhe pajisje me dokumentacion pronësie.
Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj ka nxjerr Urdhrin nr. 380, datë 12.02.2025, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planeve të rilevimit, sipas modelit të Aneksit 4, të VKM nr. 782, datë 07.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale".
Ky grup pune përbëhet nga 1 kryetar dhe 5 anëtarë, ku ka si funksion hartimin e planeve të rilevimit dhe plotësimin e formularëve të inventarizimit për çdo pasuri, me të dhënat kadastrale përkatëse.
Për sa trajtuar më sipër u konstatua se, Bashkia Memaliaj ka ndërmarrë një hap fillestar për organizimin e procesit të evidentimit teknik/kadastral të pasurive por nuk disponon të dhëna apo dokumentacion provues që të vërtetojë përfundimin e procesit, pasi nuk realizuar plane rilevimi të hartuara për çdo pasuri, akte verifikimi në terren, lista të përditësuara të inventarit, dokumentacion hartografik/kadastral i plotësuar, praktika të depozituara pranë ASHK-së apo dokumentacion pronësie i përfituar si rezultat i këtij procesi.
Në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 782/2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale", përcaktohet se: plani i rilevimit për punime kadastrale është dokumenti hartografik që hartohet si rezultat i verifikimeve dhe matjeve në terren të pasurisë së paluajtshme dhe pasqyron gjendjen faktike të saj. Për rrjedhojë, në mungesë të planeve të rilevimit, të dhënave hartografike të përditësuara dhe dokumentacionit të dërguar pranë ASHK-së, nuk provohet përmbushja e plotë e procesit të rilevimit dhe përditësimit kadastral të pronave.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika 1, sipas të cilit institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
Në zbatim të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore", si dhe në mbështetje të pikave 9-11 dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, njësia vendore duhet të kishte realizuar në mënyrë të plotë procesin e inventarizimit, marrjes në dorëzim, administrimit dhe ndjekjes së aseteve të transferuara.
Në rastin konkret, ndonëse është ngritur një grup pune për hartimin e planeve të rilevimit, nuk provohet që ky grup të ketë finalizuar të gjithë ciklin e administrimit të aseteve, përfshirë marrjen në dorëzim me procesverbale, verifikimin faktik të pasurive, përditësimin e listave, regjistrimin në ASHK dhe pasqyrimin kontabël të tyre.
Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative u konstatua se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura krijimin e një sektori për menaxhimin dhe administrimin e aseteve.
Ky funksion kryhet nëpërmjet Specialistit të Aseteve, i cili është pjesë e strukturës së Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës. Kjo tregon se administrimi i aseteve nuk është organizuar nëpërmjet një strukture të posaçme dhe të dedikuar, me përgjegjësi të qarta për ndjekjen e plotë dhe të vazhdueshme të procesit të marrjes në dorëzim, inventarizimit, regjistrimit, administrimit, dhënies në përdorim/qira dhe pasqyrimit kontabël të pasurive.
Ndër të tjera Bashkia Memaliaj nuk ka një regjistër kontabël analitik të plotë në nivel bashkie për të gjitha asetet që zotëron apo administron.

Në mungesë të një regjistri të tillë, nuk sigurohet pasqyrimi i plotë, i saktë dhe i përditësuar i pasurive në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare, duke kufizuar mundësinë për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin financiar të tyre.
Për sa trajtuar më sipër, edhe pse nga Bashkia Memaliaj është ndërmarrë një masë paraprake duke ngritur grupin e punës, kjo masë nuk rezulton të jetë finalizuar në një proces të plotë administrimi, inventarizimi, rilevimi, përditësimi, regjistrimi dhe pasqyrimi kontabël të aseteve.
Për rrjedhojë, procesi i administrimit të pronave të paluajtshme të Bashkisë Memaliaj dhe NjA, nuk evidentohet të jetë realizuar në përputhje të plotë me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor të sipërcituar.
Bashkia Memaliaj ka në pronësi **2,858 pasuri** të cilat janë transferuar sipas VKM-ve, trajtuar si më poshtë:
- **Për njësinë Administrative Memaliaj** është miratuar lista e invetarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Memaliaj sipas lidhjes që i bashkëlidhet VKM nr. 974, datë 10.09.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj të Qarkut të Gjirokastrës". Lista me 44 fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 250, **me numër 200 pasuri;**
- **Për njësinë Administrative Memaliaj Fshat** është miratuar lista e invetarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Memaliaj sipas lidhjes që i bashkëlidhet VKM nr. 1239, datë 10.09.2008, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Memaliaj Fshat, të Qarkut të Gjirokastrës". Lista me 57 fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 400, **me numër 331 pasuri;**
- **Për njësinë Administrative Qesarat** është miratuar lista e invetarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Memaliaj sipas lidhjes që i bashkëlidhet VKM nr. 341, datë 12.05.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qasarat, të Qarkut të Gjirokastrës". Lista me 55 fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 353, **me numër 284 pasuri;**
- **Për njësinë Administrative Buz** është miratuar lista e invetarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Memaliaj sipas lidhjes që i bashkëlidhet VKM nr. 663, datë 29.11.2011, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Buz, të Qarkut të Gjirokastrës". Lista me 93 fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 667, **me numër 616 pasuri;**
- **Për njësinë Administrative Krahas** është miratuar lista e invetarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Memaliaj sipas lidhjes që i bashkëlidhet VKM nr. 657, datë 21.05.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Krahas, të Qarkut të Gjirokastrës". Lista me 100 fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 745, **me numër 672 pasuri;**
- **Për njësinë Administrative Luftinjë** është miratuar lista e invetarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Memaliaj sipas lidhjes që i bashkëlidhet VKM nr. 790, datë 16.11.2006, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Luftinjë, të Qarkut të Gjirokastrës". Lista me 112 fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 865, **me numër 755 pasuri;**

Nr.	Emërtimi	Numrat rendor sipas VKM	Numri i pronave të transferuara	Aplikuar për pajisje me çertifikatë pronësie	Porna të pajisura me çertifikatë	Prona të pa pajisura me çertifikatë
1	Bashkia Memeliaj	1-250	200	0	0	0
2	NjA Memaliaj Fshat	1-400	331	0	0	0
3	NjA Qesarat	1-353	284	0	0	0
4	NjA Buz	1-667	616	0	0	0
5	NjA Krahës	1-745	672	0	0	0
6	NjA Luftinjë	1-865	755	0	0	0
Totali			**2,858**	**0**	**0**	**0**

Për sa trajtuar më sipër evidentohet se, Bashkia Memaliaj ende nuk ka ndërmarrë masat e duhura për pajisjen me çertifikatë pronësie të pasurive të transferuara me VKM-të e sipërpërmendura.
Një prej faktorëve që ka ndikuar për mos realizimin e këtij procesi është edhe arsyeja që pjesë e Projekt Buxheteve Afatmesme apo Buxheteve Vjetore për vitet 2024-2025, nuk janë parashikuar fonde për nisjen e procedura për aplikimin me qëllim pajisjen me çertifikatë pronësie të pasuritë e transferuara në pronësi të institucionit. Një hap i rëndësishëm i kryer nga Bashkia Memaliaj është edhe aplikimi për pajisjen me çertifikatë pronësie për 9 objekte, ku deri më datë 23.06.2026, periudhë e cila përkon me përfundimin e periudhës objekt auditimi, aktulisht ky status mbetet i pa ndryshuar lidhur me aplikimin e tyre.
Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione", llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", Bashkia Memaliaj të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 6 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35, gërma "a", "b" dhe "c" për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione", llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore".
Në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme paraqiten pasuritë të pajisura me çertifikatë pronësie:

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. i pasurisë	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sipërfaqe truall m^2	Sipërfaqe ndërtimi m^2	Pasqyruar ose jo në bilancin e bashkisë
1	Tokë Truall + Ndërtesë Qendra Shëndetësore Memaliaj Godinë 3 kateshe dhe Lavanderi Godine Një Katëshe	5/456	06.06.2016	2646	Lagja nr. 1 Qytet Memaliaj	793.8	569.6	-
2	Tokë Truall (Shesh Funksional)	5/305	06.06.2016	2646	Qytet Memaliaj	1,079	-	-
3	Ambiente bosh ish-zyrave të punës dhe ish-zyrave të Bashkisë Memaliaj	5/310+1-1	28.10.2020	2646	Qytet Memaliaj	189	189	-

Nr.	Zona Kadastrale	Nr pasurise	Siperfaqe / ha	Toke
1	3111	3/2	0.0393	Arë
2	3111	3/7	0.15	Arë
3	3111	3/5	0.3577	Arë
4	1025	186/1	0.8168	Arë
5	3602	65/13	0.6	Arë
6	3719	341/5	0.665	Arë

Megjithatë, për pjesën e mbetur të pronave të inventarizuara apo të transferuara nuk rezulton dokumentacion që të provojë nisjen, vijimin apo përfundimin e procedurave të regjistrimit. Për rrjedhojë, procesi i pajisjes së pronave me dokumentacion pronësie rezulton i pjesshëm dhe i papërfunduar. Për vitet 2024-2025, u konstatua se nga Bashkia Memaliaj nuk ka pasur shitje të aseteve.

- **Fondi pyjor dhe kullosor:**

Referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive", pika 31, përcaktohet se:
"Sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Memaliaj, janë sipas shtojcës 29, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 643 (gjashtëqind e dyzet e tre)", e ndryshuar me VKM-në nr. 398, datë 13.05.2020, dhe VKM-në nr. 684, datë 02.09.2020, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe të kulltave", Bashkia Memaliaj ka në pronësi **279 ngastra** me sipërfaqe **1,510.14 ha** e ndarë kjo në 386.46 ha Kullotë për 97 ngastra; 885.61 ha Pyll për 117 ngastra; 65.66 ha Shkëmbor për 18 ngastra dhe 172.41 ha Inproduktive për 47 ngastra. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten të dhënat për secilën ekonomi pyjore dhe kullosore si më poshtë:

Ekonomia Pyjore	Kullotë Ngastra nëngastra	Sipërfaqe ha	Pyll Ngastra nëngastra	Sipërfaqe ha	Shkëmbore Ngastra nëngastra	Sipërfaqe ha	Inproduktive Ngastra nëngastra	Sipërfaqe ha
EP Buz	57	226.48	72	610.40	8	33.42	0	0
EP Krahës	36	155.62	40	220.82	10	32.24	0	0
EP Dragot	3	4.26	5	54.39	0	0	0	0
Dragot	1	0.10	0	0	0	0	2	0.42
Buz	0	0	0	0	0	0	45	171.99
Totali	**97**	**386.46**	**117**	**885.61**	**18**	**65.66**	**47**	**172.41**

- Bashkia Memaliaj që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, nuk është pajisur me çertifikatë pronësie për sipërfaqet pyjore, kullosore, shkëmbore dhe improduktive që administron.
- Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Memaliaj që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", pika 33, shtojca me nr. 31, në kundërshtim me pikën 64, pika 65, të kësaj VKM-je citohet se: "Ministri i Mjedisit dhe Kryetarët e Bashkisë përcaktojnë personat përgjegjës si anëtarë komisioni të përbashkët brenda 20 ditëve puna nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për transferimin e pronave nga Ministria e Mjedisit pranë Bashkisë Memaliaj, si dhe pika 66 Kryetarët e Bashkive regjistrojnë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor të transferuar nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe nuk ka iniciuar procedura për regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me çertifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore etj., që administron".
- Nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.,) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.
- Nga Bashkisë Memaliaj, nuk janë bërë sondazhe gjatë kullotjes për të mos lejuar futjen e bagëtive në kullotë jashtë kapacitetit kullosor të kontraktuar, në kundërshtim me Kreun III "Kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullosor për kullotje", pika 7 të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "Kiteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari".
- Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), në referim të nenit 5 "Planet e Mbarështimit", nenit 6 "Funksionimin e Shërbimit Pyjor", nenit 15/2 "Pronësia e Fondit Pyjor" të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, i ndryshuar.
- Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes, sipas Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", neni 29 "Organet e kontrollit", neni 30 "Dokumentimi".

2.7.2. *Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i dtyrimit për kontratat e lidhure;*

Subjektet qiramarrës:

- *Kontratat për dhënie me qira të tokës bujqësore:*

Bashkia Memaliaj administron 254 kontrata qiraje për tokën bujqësore konkretisht: 9 kontrata në NjA Fshat Memaliaj, 24 kontrata NjA Buz, 56 kontrata në NjA Luftinjë, 99 kontrata në NjA Qesarat dhe 66 kontrata në NjA Krahës të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2025 dhe me afat kryesit 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas përcaktimit të VKM-së nr. 373, datë 20.06.2018, *"Për tokën bujqësore"*, 6,000 lekë/Ha në vit. Në një vit buxhetor (2025), të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Memaliaj nga qiraja e tokës bujqësore 2,170,622 lekë nga të cilat ka arkëtuar vlerën prej 1,456,302 lekë me një diferencë në vlerën 714,320 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore më datë 31.12.2024, u konstatua gjendje debitore në vlerën 5,090,085 lekë. Gjatë vitit 2025 është faturuar vlera prej 2,170,622 lekë nga të cilat është likuiduar vlera prej 1,456,302 lekë me një diferencë mosarkëtimi në vlerën 714,320 lekë, ndërsa **gjendja debitore më datë 31.12.2025, paraqitet**

në vlerën 5,651,345 lekë në total për 159 individë debitorë. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë

Nr. i kontratave	Njësitë Administrative	Gjendja më datë 31.12.2024	Shtesat	Pakësimet	Gjendja më datë 31.12.2025	Nurmi i individëve debitorë
9	Fshat Memaliaj	363,717	156,777	19,440	501,054	2
24	Buz	1,210,620	267,186	172,813	1,304,993	14
56	Luftinjë	1,086,413	343,707	1,911,662	1,238,458	51
99	Qesarat	1,473,586	962,190	726,528	1,709,248	49
66	Krahës	955,749	287,702	345,859	897,592	43
254	**Totali**	**5,090,085**	**2,017,562**	**1,456,302**	**5,651,345**	**159**

- *Kontratat për dhënien me qira të sipërfaqen tokësore për vendosjen e antenave:*

Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Memaliaj dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri më datë 31.12.2023, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, *"Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"* i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligji nr. 57/2020, *"Për pyjet"*, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;
- VKM nr. 54, datë 05.02.2014, *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, i ndryshuar;

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2025 Bashkia Memaliaj ka aktive 3 kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve tokësore apo pjesë të fondit pyjor dhe kullosor për vendosjen e antenave, me afat nga 8 vite deri më 30 vite, me sipërfaqe nga 200 deri në 500 m^2. Detyrimi për vitin 2025 ka qenë në vlerën 980,000 lekë i cili është likuduar sipas transaksioneve të bankave të nivelit të dytë e njëjtë me aktrakordimin vjetor të mbajtur me Degën e Thesarit Tepelenë. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emër Mbiemër	Data e lidhjes së kontratës	Nr.	Afati Vite	Siperfaqja ne ha	Qiraja Vjetore	Detyrimi	Likuidimi	Diferenca
1	V.	11.12.2002	Nr. 1442	30	400 m^2	340,000	340,000	340,000	0
2	V.	27.03.2024	Nr. 647/1	8	500 m^2	340,000	340,000	340,000	0
3	O.	30.05.2025	Nr. 1257	20	200 m^2	300,000	300,000	300,000	0

- *Kontratat për dhënien me qira të objekteve:*

Nga Bashkia Memaliaj administrohen 19 kontrata aktive për dhënien me qira të objekteve brenda territorit të qytetit dhe në fshatrat Qesarat, Buz, Anë Vjosë dhe Toç. Për vitin 2025 për këto kontrata është përllogaritur detyrimi në vlerën 344,648 lekë ku është likuiduar vlera 146,100 lekë si dhe janë krijuar 2 debitorë në vlerën **198,548 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.** Të dhënat në mënyrë të përmbledhura paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë

Kontrata për dhënien me qira të objekteve									
A	**Kontrata nën 200 m^2**								
Nr.	**Emër Mbiemër**	**Nr.**	**Datë**	**Afati**	**Sipërfaqja në m^2**	**Qira mujore**	**Detyrimi**	**Likuiduar**	**Diferenca**
1	A. Sh.	277	30.01.2025	30.01.2025-30.01.2026	35	1,750	21,000	21,000	0
2	K. S.	161	20.01.2025	20.01.2025-20.01.2026	9	450	4,500	4,500	0
3	A. Ç.	263	30.01.2025	30.01.2025-30.01.2026	10	500	6,000	6,000	0
4	A. G.	267	30.01.2025	30.01.2025-30.01.2026	9	450	5,400	5,400	0
5	A. H.	295	31.01.2025	31.01.2025-31.01.2026	16	800	9,600	9,600	0
6	L. M.	115	15.01.2025	15.01.2025-15.01.2026	66	3,300	39,600	39,600	0
7	K. M.	965/2	11.06.2025	11.06.2025-31.12.2025	10	5,000	25,000	25,000	0
8	K. K.	1308	11.06.2025	11.06.2025-11.09.2025	10	10,000	30,000	30,000	0
9	S. I.	1778/1	08.08.2025	08.08.2025-08.08.2026	10	5,000	23,548	5,000	18,548
Totali A						**27,250**	**164,648**	**146,100**	**18,548**
B	**Kontrata mbi 200 m^2**								
1	B. M.	Ekstra	06.01.2025	06.01.2025-06.01.2026	300	15,000	180,000	0	180,000
Totali B						**15,000**	**180,000**	**0**	**180,000**
Totali A +B						**42,250**	**344,648**	**146,100**	**198,548**

- *Kontratat për dhënien me qira të fondit pyjor dhe kullosor:*

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2025 Bashkia Memaliaj ka aktive 2 kontrata për dhënien me qira të fondit pyjor dhe kullosor me afat 1 vjeçar deri në 3 vite, me sipërfaqe deri

në 1.2 ha me aktivitet vendosje linja për HEC dhe agriturizëm. Detyrimi për vitin 2025 ka qenë në vlerën 276,320 lekë i cili është likuduar sipas transaksioneve të bankave të nivelit të dytë e njëjtë me aktrakordimin vjetor të mbajtur me Degën e Thesarit Tepelenë. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emër Mbiemër	Data e lidhjes së kontratës	Nr.	Afati Vite	Siperfaqja në ha	Qiraja Vjetore	Detyrimi	Likuidimi	Diferenca
1	V. E. ShPK	29.08.2025	Nr. 1868/1	1	1.26 km	272,360	272,360	272,360	0
2	E. B.	03.02.2025	Nr. 304	3	0.02ha	3,960	3,960	3,960	0
Totali						**276,320**	**276,320**	**276,320**	**0**

- *Kontratat për dhënien me qira të kullotave dimërore dhe verore:*

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2025 Bashkia Memaliaj ka aktive 8 kontrata për dhënien me qira të fondit pyjor dhe kullosor për kullotjen e bagëtive konkretisht, 2 kontrata dimërore dhe 6 kontrata verore. Detyrimi për vitin 2025 ka qenë në vlerën 251,200 lekë i cili është likuduar sipas transaksioneve të bankave të nivelit të dytë e njëjtë me aktrakordimin vjetor të mbajtur me Degën e Thesarit Tepelenë. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emër	Mbiemër	Nr.	Data	Nr. mandat	Vlera e arkëtuar
Kontrata Verore						
1	A.	K.	1144/1	24.07.2025	894	29,000
2	D.	C.	1429/1	03.07.2025	920	40,000
3	A.	E.	824/1	30.06.2025	898	59,400
4	S.	M.	835/1	25.07.2025	939	29,800
5	N.	Sh.	906/1	25.07.2027	940	16,000
6	Xh.	Z.			871	23,000
Kontrata dimërore						
1	S.	M.		21.10.2025	1057	44,000
2	M.	Sh.	22/1	19.01.2026	42	10,000
Totali						**251,200**

- *Kontratat për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, lidhur me subjektet që ushtrojnë aktivitet minerar:*

Bashkia Memaliaj nuk ka vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerave dhe leje koncesionare të miratuara nga MIE si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi. Në lidhje me auditimin e të ardhurave nga asetet, grupi i auditimit bëri kërkesë drejtuar Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore për vendosjen në dispozicion të kontratave të qirave të fondit pyjor/kullosor të cilat ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare në territorin që administron Bashkia Memaliaj. Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Regjistrin e Lejeve Minerare të muajit Janar të vitit 2026, Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se për periudhën nga data 01.012025, deri më 31.12.2025, në territorin e Bashkisë Memaliaj ushtron aktivitet 1 subjekt, i cili nuk ka paguar detyrime për aktivitetin që kryen, pasi nuk është evidentuar nga Bashkia Memaliaj.

Konkretisht:

1. Subjekti "G." ShPK me Nipt K..., i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1.., datë 01..., për shfrytëzimin e vendburimit Krahës për llojin e Gëlqeror Pllakor dhe me sipërfaqen 0.24 km^2.

Këtë veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, pikën 6 të nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", pikat 3, 7, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit tëfonditpyjor" i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit tefondit kullosor".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj, **z. B. K.** Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Blegtorisë, Pyje Kullota, Veterinari, Mjedis, Ujitje Kullim, **z. B. Xh.** Përgjegjës i Sektorit të Inspektim, Pyje, Mjedis, Ujitje, Kullim, Bujqësi, **z. F. Z.** Përgjegjës Sektori i Menaxhimit të Pyjeve.

2.8. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Verifikimi i respektimit të afateve ligjore për njoftimin e KLSh-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe mbi verifikimin e raportimi në KLSh-së, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhefunksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

I. Respektimi i afatit prei 20 ditësh, për informimin e KLSh-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimime duke mos respektuar kështu edhe afatin 20 ditor. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhefunksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, gërma "j".

II. Respektimi i afatit ligior prei 6 muaish, për raportimin në KLSh, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Memaliaj ka kthyer përgjigje në KLSh me shkresën nr. 1058 prot., datë 17.04.2026, duke respektuar edhe njëkohësisht edhe afatin 6 mujor.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Memaliaj administruar në KLSh me nr. 469/6 prot., datë 20.10.2025, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 927/7 prot., datë 22.10.2025, janë rekomanduar gjithsej:

- **23** Masa Organizative;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës nr. 927/8 prot., datë 11.11.2025, të z. A. M. Kryetar i Bashkisë, është përcaktuar statusi i pranueshmërisë se rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	23	23	0
Totali	23	23	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Bashkisë Memaliaj:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	23	9	3	2	9
Totali	23	9	3	2	9
Totali në %	**100%**	**39.1%**	**13%**	**8.8%**	**39.1%**

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Zbatimi i rekomandimeve ***"Për masa me karakter organizativ"***. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 9 masa janë zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 9 masa nuk janë zbatuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit

financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Lidhur me implementimin e ligjit për menaxhimit financiar dhe kontrollit janë konstatuar të njëjta problematika edhe përgjatë vitit 2025 konkretisht:*

- Nuk ka program vjetor për trajnimin e stafit dhe një buxhet të alokuar për këtë problem;

- Në procesin e vlerësimit të punonjësve është kryer bërë vlerësimi 6 mujor i punonjësve që rregullojnë marrëdhinet me shërbimin civil, ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me kodin e punës nuk është kryer vlerësimi 1 vjeçar;

- Nuk ka hartuar dhe miratuar një regjistër risku për vitin 2025;

- Nuk ka të hartuar listën e proceseve/manuale të proceseve të punës;

- Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe ankesave, për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eleminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

Rekomandimi nr. 1.1, nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të Ilogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 94,569,416 lekë. Bazuar në Akt-rakordimin me Degën e Thesarit Tepelenë vlera prej 94,569,416 lekë si disponibilitet në thesar i përket Aparatit të Bashkisë e cila kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 51,640,727 lekë dhe 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 42,928,689 lekë.*

Rekomandimi nr. 2.1, është zbatuar plotësisht.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 26,094,899 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të 5% të garancive të punimeve në llogarinë 532 "Vlera të tjera", duke i kontabilizuar në Ilogarinë 466 "Kreditorëpër mjete në ruajtje".

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Llogaria 532 "Vlera të tjera" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 2,349,919 lekë. Nga gjendja e kësaj llogarie është pakësuar vlera prej 26,387,644 lekë që i përket 5% të fondeve të ngurtësuara të kontratave për punët publike si veprim sistemues duke e kontabilizuar atë në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".*

Rekomandimi nr. 3.1, është zbatuar plotësisht.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 48,437,125 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në llogarinë 411 "Klientë e llogari të ngjashme", duke i kontabilizuar në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm".

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Llogaria 411 "Klientë e llogari të ngjashme" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 0. Nga gjendja e kësaj llogarie është pakësuar vlera prej 48,437,125 lekë që i përket detyrimet që vijnë nga palët e treta kundrejt Bashkisë Memaliaj si veprim sistemues duke e kontabilizuar atë në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm".*

Rekomandimi nr. 4.1, është zbatuar plotësisht.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2025 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuara, që për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, t'i kontabilizojë në mënyrë të saktë në gjendjen e llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" dhe në rakordim me gjendjen në Ilogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti", në Formatin e Performancës së PF.

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Në pasqyrat financiare Klasa 4, Llogari të arkëtushme janë kryer veprimet sistemuese duke u pakësuar llogaritë 423,429 "Personeli, paradhënie, defiçite e gjoba" në vlerën 11,181,933 lekë, 431 "Tatime e taksa" në vlerën 900,979 lekë, 436 "Sigurime shoqërore" në vlerën 1,971,655 lekë. Sistemi është kryer duke kryer edhe rakordimin me llogarinë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" e cila për vitin 2025 paraqitet në vlerën 42,173,718 lekë.*

Rekomandimi nr. 5.1, është zbatuar plotësisht.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të regjistrohen në debi të llogarinë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" dhe në kredi të llogarive 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", 467 "Kreditorë të ndryshëm".

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Llogaria 486 "Shpenzime për periudhat e ardhshme" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 0. Nga gjendja e kësaj llogarie është pakësuar vlera prej 11,514,715 lekë që i përkasin detyrime që ka Bashkia ndaj të tretëve, si veprim sistemues duke i kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe 467 "Kreditorë të ndryshëm".*

Rekomandimi nr. 6.1, është zbatuar plotësisht.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime", duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,911,473 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Vlera e mbetur në fund të vitit 2025 prej 6,099,103 lekë (kosto historike) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" për 37 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.*

Rekomandimi nr. 7.1, nuk është zbatuar.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë 210 "Toka, troje, terrene" dhe 211 "Pyje, kullota, plantacione" dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 107,996 lekë dhe 211 "Pyje, kullota, plantacione" në vlerën 2,308,380 lekë, të cilat nuk janë të analizuara me emërtesat se çfarë përfaqësojnë.*
Rekomandimi nr. 8.1, nuk është zbatuar.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës në pasqyrat financiare të vitit 2025 të bëjë sistemimin e vlerës 3,312,750 lekë kosto historike e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përkasin llogarisë 215 "Mjete transporti" sistemimi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara".

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *VIera prej 3,312,750 lekë që i përket 5 mjeteve të dëmtuara të kontabilizuara në gjendjen e llogarisë 215 "Mjete transporti", të evidentuara të tilla nga procesi i inventarizimit, nuk janë kryer veprimet sistemuese për kontabilizimin e tyre në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara".*
Rekomandimi nr. 9.1, nuk është zbatuar.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për aplikimin e normës së amortizimit për llogaritë 202 "Studime dhe kërkime", 215 "Mjete transporti" dhe 218 "Inventar ekonomik" që nga momenti që aktivi ka filluar jetën e dobishme duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime" është përllogaritur normë amortizimi vjetor në vlerën 825,224 lekë, ndërsa për llogarinë 215 "Mjete transporti" është aplikuar normë amortizimi vjetor në vlerën 8,960,000 lekë ndërkohë që duhej të përllogaritej në vlerën 11,278,982 lekë duke e nënvlerësuar këtë llogari në vlerën 2,318,982 lekë. Për sa i përket llogarisë 218 "Inventar ekonomik" konstatohet e njëjta problematikë edhe përgjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2025, ku nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%.*
Rekomandimi nr. 10.1, është zbatuar pjesërisht.

11.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të Ilogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Në gjendjen e llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" është kontabilizuar vlera prej 322,000 lekë që i përket kuotave që posedon Bashkia Memaliaj si aksionare në masën 3.22% në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër.*
Rekomandimi nr. 11.1, është zbatuar plotësisht.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230-231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 2021 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Gjendja e Ilogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për Vitin 2025 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likujdimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht: Kontrata*

me nr. 1559/14 prot., datë 02.09.2025, me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" me vlerë kontrate 43,474,455 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 25,000,000 lekë; Kontrata me nr. 49/29 prot., datë 09.06.2024, me objekt "Ujësjellësi Rajonal Memaliaj" me vlerë kontrate 487,378,589 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 370,290, 129 lekë.

Rekomandimi nr. 12.1, nuk është zbatuar.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarive 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" duke përfshirë këtu edhe asetet e ish-komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione", llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", Bashkia Memaliaj të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 3 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie.*

Rekomandimi nr. 13.1, është në proces zbatimi.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 48,437,125 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në llogarinë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", duke i kontabilizuar në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm".

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 1,421,125 lekë. Nga gjendja e kësaj llogarie është pakësuar vlera prej 48,437,125 lekë që i përkasin detyrime që kanë të tretët ndaj Bashkisë Memaliaj, si veprim sistemues duke i kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm".*

Rekomandimi nr. 14.1, është zbatuar plotësisht.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet rregulluese në gjendjen e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore", duke kontabilizuar diferencën që i përket detyrimeve për sigurimet shëndetësore të cilat paguhen në muajin janar të vitit pasardhës në llogarinë 436 "Sigurime shëndetësore".

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Pjesë e Pasivit/Llogari të Pagueshme është përfshirë edhe llogaria 436 "Sigurime shoqërore" ku në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 338,312 lekë që i përket detyrimeve të papaguara për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës.*

Rekomandimi nr. 15.1, është zbatuar plotësisht.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 357,603 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të pullave postare dhe biletave të tregut në llogarinë 464 "Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave" me vlerë duke i kontabilizuar në llogarinë 50 "Letra me vlere".

Deri më datë 31.06.2026

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Llogaria 464 "Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave me vlerë" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 602,402 lekë. Nga*

gjendja e kësaj llogarie është pakësuar vlera prej 357,603 lekë që i përket letrave me vlerë, si veprim sistemues duke i kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 50 "Letra me vlerë".
Rekomandimi nr. 16.1, është zbatuar plotësisht.

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për analizimin e përdorimit për interes publik të fondeve që ju ka mbaruar periudha e garancisë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 31.12.2025

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Memaliaj janë ngurtësuar fonde në vlerën 5,547,212 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Tepelenë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 5,547,212 lekë.*
Rekomandimi nr. 17.1, nuk është zbatuar.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të hartojë dhe të mbajë një përmbledhje të detajuar të të gjitha ndryshimeve buxhetore të miratuara gjatë vitit, të shoqëruara me VKB-të përkatëse dhe me analiza të ndikimit financiar. Kjo do të ndihmonte në forcimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe përgjegjshmërisë në menaxhimin e buxhetit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Ndryshimet buxhetore për vitin 2025 janë kryer duke u bazuar në kuadrin rregullatorë në fuqi, shoqëruar njëkohësisht edhe me Vendimet e Këshillit Bashkiak përkatës, duke u reflektuar në sistemet financiare në raportet e monitorimit. Këto ndryshime nuk janë përmbledhur në një dokument të vetëm të strukturuar, të shoqëruar me analiza të detajuara.*
Rekomandimi nr. 18.1, nuk është zbatuar.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të zhvillojë analiza periodike mbi realizimin e buxhetit dhe të marrë masa korrigjuese për të shmangur devijimet. Po ashtu, përdorimi i raporteve të monitorimit duhet të kalojë nga formalitet në një mjet real menaxherial për drejtimin e financave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Për vitin 2024 referuar planit përfundimtar të buxhetit ishin parashikuar shpenzime në vlerën 390,428,983 lekë ndërsa realizimi në vlerën 348,212,263 lekë me një diferencë ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 42,216,720 lekë ose në masën 89.18% evidentohet se disa zëra janë realizuar në nivele të ulta konkretisht, 602 "Shpenzime operative" në masën 89%, 606 "Ndihma ekonomike" në masën 30.1% apo 231 "Investimet" në masën 83.36%*
Rekomandimi nr. 19.1, nuk është zbatuar.

20.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të hartojë një plan konkret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të krijojë një regjistër të përditësuar elektronik të tyre, si dhe të ndërlidh procesin e prokurimit me kufijtë e buxhetit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Detyrimet që ka Bashkia Memaliaj ndaj të tretëve më datë 31.12.2024, paraqiten në vlerën 15,174,942 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, në vlerën 18,862,153 lekë me një rritje në vlerën 3,687,211 lekë. Kryesisht vlerën më të lartë e zënë*

shpenzimet për energjinë elektrike në vlerën 6,391,431 lekë. Vlen të theksohet se, edhe pse nga institucioni janë kryer përpjekje për të ulur detyrimet, evidentohet një rritje e detyrimeve nga viti në vit.

Rekomandimi nr. 20.1, nuk është zbatuar.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të përgatisë një kalendar të detajuar për realizimin e investimeve, të forcojë bashkëpunimin ndërmjet sektorit të financës dhe prokurimeve, si dhe të kryejë analizë pas veprimit për çdo projekt të parealizuar për të përcaktuar shkaqet dhe përgjegjësitë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Lidhur me verifikimin e kontratave të punëve publike që janë realizuar me fondet e vetë Bashkisë apo në formën e grandeve që kanë ardhur nëpërmjet VKM-ve financuese për parandalimin e fatkeqësive natyrore, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Mbrojtjes kanë një afat kohor të shtrir në disa vite konkretisht:*

- Objekti "Përmirësimi i banesave" deri në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 është likuiduar vlera prej 25,000,000 lekë mbetet për t'u likuiduar vlera 18,474,455 lekë;

- Objekti "Rikonstruksioni i gjimnazit Sali Nivica" deri në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 është likuiduar vlera prej 151,824,610 lekë mbetet për t'u likuiduar vlera 22,117,970 lekë;

- Objekti "Përmirësimi i skemës ujitëse Krahas" deri në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 është likuiduar vlera prej 15,224,000 lekë mbetet për t'u likuiduar vlera 9,132,726 lekë;

- Objekti "Ujësjellësi Rajonal Memaliaj" deri në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 është likuiduar vlera prej 370,290,129 lekë mbetet për t'u likuiduar vlera 117,088,460 lekë;

Rekomandimi nr. 21.1, është në proces zbatimi.

22.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të hartojë një strategji të qartë për përmirësimin e performancës fiskale, të forcojë kapacitetet administrative të sektorit të tatim-taksave, dhe të zbatojë masa konkrete për rritjen e arkëtimeve, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë për ndjekjen e debitorëve dhe formalizimin e tatimpaguesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: *Për vitin 2025 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë planifikuar në vlerën 32,200,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 30,345,649 lekë në masën 94.2% me një diferencë mos realizimi ndërmjet planit dhe faktit në vlerën 1,854,351 lekë. Evidentohet se disa prej zërave fiskalë nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si "Tarifë pastrimi" në masën 77.8%, "Tarifë gjelbërimi" në masën 72.4% dhe "Tarifë ndriçimi" në masën 88.6%. Gjithashtu për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.*

Rekomandimi nr. 22.1, është zbatuar pjesërisht.

23.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe përshpejtimin e rekomandimeve në proces zbatimi si më poshtë:

a. Për 4 masa organizative të zbatuar pjesërisht, 3 masa në proces zbatimi dhe 7 masa të pa zbatuar: nr. 1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 13.1, 15.1 dhe 16.1;

b. Për 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, në proces zbatimi: nr. 1.1;

c. Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash, e pa zbatuar: nr. 1.1.
d. Për 1 masë disiplinore e pa zbatuar: nr. 1.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i Rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: *Me përjashtim të rekomandimeve nr. 6.1, dhe nr. 7.1, që i përkasin kategorisë masa organizative, për kryerjen e veprimeve sistemuese në gjendjen e llogarive 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" dhe 468 "Debitorë të ndryshëm", gjë e cila është kryer në pasqyrat financiare të vitit 2025, pjesa tjetër e rekomandimeve ndodhet në të njëjtën fazë.*
Rekomandimi nr. 23.1, është zbatuar pjesërisht.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Memaliaj nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim konkretisht:
- Nuk ka rishikuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mirë përcaktuara;
- Nuk rezulton të ketë urdhër për miratimin e Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij plani;
- Nuk janë kryer vlerësimet vjetore për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet e punës nëpërmjet Kodit të Punës;
- Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo Kodin e Etikës;
- Nuk ka hartuar strategjinë dhe regjistrin e risqeve, si rrjedhojë e kësaj nuk ka plan veprimi për menaxhimin e riskut. U konstatua mungesa e monitorimit dhe raportimeve në mënyrë periodike për risqet me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre. Bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi;
- Nuk ka hartuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës si dhe nuk janë hartuar hartat dhe manualet e proceseve të punës;
- Nuk ka hartuar dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pika 2-3, 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, *"Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike"*, Aneksi 2, *"Regjistri dhe matrica e riskut"* dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2, hapi 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj të merren masa të ngrejë një grup pune për hartimin dhe më pas miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, vlerësimi dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të aktivitetit të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2025 me Vendimin nr. 9, datë 27.01.2025, të Këshillit Bashkiak dhe Urdhrin nr. 51, datë 25.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj është miratuar struktura e Njësisë së Auditit të Brendshëm e përbërë me 3 *(tre)* pozicione pune 1 *(një)* Përgjegjës i NjAB dhe 2 *(dy)* Specialist Auditi. Nga auditimi u konstatua se, NjAB nuk ka funksionuar vetëm me Përgjegjësin e Njësisë ndërsa 2 *(dy)* pozicionet Specialist Auditi kanë mbetur të pa plotësuara përgjatë vitit 2025. Për më tepër Bashkia Memaliaj nuk ka ndërmarrë masa konkrete për fillimin e procedurave të rekrutimit ose shpalljen e vendeve vakante. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar, neni 8, neni 11, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 16 dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë25.10.2016, *"Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, Kapitulli III *"Organizimi dhe funksionimi i auditimit të brendshëm"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17-30 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore të merren masa për shpalljen dhe plotësimin e dy vendeve vakante për pozicionet Specialist të Auditit të Brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim sigurimin dhe funksionimin e plotë të NjAB, rritjen e efektivitetit të veprimtarisë të kësaj njësie dhe garantimin e një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm të institucionit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë përmbushur të gjitha fazat apo afatet ligjore mbi hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 konkretisht:

a) Faza e Parë e Përgatitjes së PBA-së:

- Pjesë e dokumentacionit të parashikimit nuk janë përfshirë parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet përpara vitit buxhetor;
- Tavanet Përgatitore për Programin Afatmesëm 2025-2027, janë miratuar afërsisht 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 3, datë 28.02.2024, *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"*, Kaptitulli I, pikat 3-4;

b) Faza e Dytë e Përgatitjes së PBA-së:

- Kjo fazë nuk është aplikuar nga Bashkia Memaliaj, por Tavanet Përfundimtare janë bërë si pjesë e vendimit për miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 3, datë 28.02.2024, *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"*, Kaptitulli 1, pika 26;

c) Faza Përfundimtare e PBA-së:

- Me shkresën nr. 2813 prot., datë 13.12.2024, nga Kryetari i Bashkisë është adresuar pranë Këshillit Bashkiak Relacioni për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe PBA-së për vitet 2025-2027, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e MF nr. 3, datë 28.02.2024, *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"*, Kapitulli I, pika 44. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Drejtoria e Financës të merren masat e duhura për realizimin e të gjithë fazave dhe respektimin e afateve për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2025 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën 846,215 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 798,024 mijë lekë në masën 94.3% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 48,191 mijë lekë, e ndarë kjo sipas burimeve të financimit:

- Të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore janë planifikuar në vlerën 33,200 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 30,345 mijë lekë në masën 91.4% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 2,854 mijë lekë;

- Transferta e pakushtëzuar është planifikuar në vlerën 178,645 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 158,329 mijë lekë në masën 88.6% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 20,315 mijë lekë;
- Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale është planifikuar në vlerën 1,10,073 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 107,510 mijë lekë në masën 97.6% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 2,563 mijë lekë;
- Të ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm janë planifikuar në vlerën 68,510 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 52,026 mijë lekë në masën 75.9% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 16,483 mijë lekë;
- Funksionet e deleguara që kanë si burim financimi transfertën e kushtëzuar janë planifikuar në vlerën 456,646 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 449,814 mijë lekë në masën 98.5% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 6,832 mijë lekë. Referuar planit përfundimtar të buxhetit të Bashkisë, fondet e planifikuara për investime kapitale kanë qenë 79,472 mijë lekë ndërsa realizimi faktik 58,430 mijë lekë në masën 86.3% me një mosrealizim prej 11,657 mijë lekë. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Memaliaj në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2014, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, gërma "a" dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 3, pikat 24-25 dhe neni 47. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të institucionit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të Ligjit nr. 115/2024, datë 03.12.2024, *"Për buxhetin e vitit 2025"* neni 15, pikat 6-9, dhe shkresën nr. 492/1 prot., datë 25.02.2025, të AKMC-së administruar në Bashkinë Memaliaj me praktikën nr. 527 prot., datë 27.02.2025, fondi i akorduar në Programin *"Emergjencat Civile"* të MM-së i cili do të shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga MM-ja në bashkëpunim me MFE-në, ku me shkresën nr. 2126/1 prot., datë 19.02.2025, *"Dërgohen buxhetet e bashkive për vitin 2025"* ka përllogaritur për Bashkinë Memaliaj peshën specifike në masën 0.33% në vlerën 2,607,767 lekë. Për përdorimin e këtyre fondeve në Degën e Thesarit Tepelenë për Artikullin 604 *"Transferime korente të brendshme"* janë funksional dy kode 91707AG *"Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve"* dhe 91707AB *"Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësitë të ndryshme"*. Nëpërmjet kësaj korrespondence MM-ja i kërkon Bashkisë Memaliaj që brenda datës 28.02.2025, me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojten civile, të kryej ndarjen e masës që do të përdoret sipas fondit në dispozicion. Me e-mailin e datës 28.02.2025, Bashkia Memaliaj i kthyer përgjigje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, fondet do të përdoren për Kodin e Produktit 91707AG në vlerën 2,000,000 lekë dhe Kodin e Produktit 91707AB në vlerën 607,767 lekë. Shpërndarja e tyre në referencë të prioritizimit për përdorimin sipas dy Kodeve të Produkteve 91707AG dhe 91707AB është kryer pa u marrë më parë miratimi nga Këshilli Bashkiak Memaliaj, dhe për rrjedhojë nuk është marrë edhe konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 414, datë

08.07.2021, *"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të shpërndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"* i ndryshuar, pikat 5-6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës të marrë masa që, fondet buxhetore që vijnë në formën e Transfertës së Kushtëzuar nëpërmjet AKMC-së të cilat shërbejnë për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, shpërndarja e tyre për përdorim, të kryhet në referencë të kategorizimit/prioritizimit në përqindjet përkatëse sipas dy Kodeve të Produkteve 91707AG dhe 91707AB, duke marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak si dhe njëkohësisht konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2025, nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura për hartimin e katër dokumenteve në nivel vendor konkretisht: Strategjinë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë; Vlerësimin Vendor të Riskut; Planin Vendor të Emergjencave Civile dhe Planin e Zhvillimit Urban, të cilat janë dokumente orientuese që shërbejnë për përdorimin e fondeve të akorduara nga buxheti qendror në formën e transfertës së kushtëzuar me qëllim zvogëlimin e riskut, parandalimin, përballimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021, *"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"* i ndryshuar, në pikat 1-2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj duhet të përmbushë pa vonesë detyrimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin për emergjencat civile, duke hartuar dhe miratuar:

- Strategjinë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë;
- Vlerësimin Vendor të Riskut;
- Planin Vendor të Emergjencave Civile;
- Planin e Zhvillimit Urban, të cilat duhet të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak dhe të harmonizohen me dokumentet kombëtare dhe rajonale. Zbatimi i këtyre dokumenteve do të mundësojë një planifikim më të mirë, koordinim efektiv ndërinstitucional dhe reduktim të ndjeshëm të riskut ndaj fatkeqësive natyrore në territorin e bashkisë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Memaliaj më datë 01.01.2025, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura në total vlerën 11,514,715 lekë me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku në të përfshihen detyrimet për investimet, mallra dhe shërbime. Përgjatë vitit 2025 për detyrimet e prapambetura është likuiduar vlera 5,942,121 lekë si dhe janë krijuar detyrime të reja në vlerën 4,301,429 lekë. Ndërsa vlera e detyrimeve progresive deri më datë 31.12.2025, është në vlerën 9,865,023 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 52, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, pika 162 dhe UMFE nr. 5, datë 27.12.2014, *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"*, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2025, pozicionet e punës si Drejtor i Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore dhe Përgjegjës Sektori kanë qenë vakante. Nga auditimi mbi mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga kjo drejtori u konstatua se, aktrakordimet mbi të ardhurat me Degën e Thesarit Tepelenë, aktrakordimet me Agjentët Tatimor, fatura mbi përllogaritjen e detyrimeve, njoftim detyrimi etj., nënshkruhen nga Specialisti i Tatimeve për Qytetin Memaliaj në mungesë të plotësimit të vendit vakant të Drejtorit të kësaj drejtorie. Në lidhje me këtë situatë nuk disponohet një urdhër i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, që specialist në fjalë të jetë i autorizuar apo komanduar për pozicion vakant të Drejtorit të Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore, duke tejkaluar njëkohësisht kompetencat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të institucionit të miratuar me VKB-në nr. 12, datë 28.02.2023, me objekt *"Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Memaliaj"*, neni 31. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore të merren masa për shpalljen dhe plotësimin e pozicionit vakant të Drejtorit të Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore. Deri në plotësimin e këtij vendi vakant, Kryetari i Bashkisë të nxjerr akte përkatëse për autorizimin ose delegimin e kompetencave, duke përcaktuar qartë punonjësin përgjegjës, objektin dhe afatin e autorizimit, në mënyrë që nënshkrimi i akteve administrative dhe ushtrimi i funksioneve të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me rregulloren e brendshme të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore çdo fillim viti krijon një regjistër të ri elektronik në format E. për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Nga auditimi i procesit të mbajtjes së taksave dhe tarifave vendore janë konstatuar problematikat si më poshtë:

- DTTV-ja nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit të mbylljes së regjistrit elektronik vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrit elektronik të ri vjetor;
- Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit;
- DTTV-ja nuk ka një rregullore të brendshme të miratuar apo përshkrim të proceseve të punës së personelit që operon në *"Regjistrin elektronik"*, ku të përcaktohen detyrat, përgjegjësitë sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën organizative të miratuar. Bashkia Memaliaj organizimin e veprimtarisë së DTTV-ja e bën duke u mbështetur vetëm në *"Regjistrin Elektronik" (veçmas për çdo njësi administrative)*;
- Nuk administron një regjistër për të gjitha taksat/tarifat vendore sipas strukturës së paketës fiskale dhe për gjithë territorin që ka nën administrim qoftë dhe në formatin E. për të parandaluar për shembull, regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikime të paautorizuara të të dhënave;
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat dhe pagesat për detyrimet mbi taksat dhe tarifat vendore *(lista e veprimeve të ndryshimeve sipas natyrës së veprimit)*;
- Nuk administrohen në dosjet e subjekteve proces-verbale sa i përket ndryshimeve që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat/pagesat e detyrimeve mbi taksat dhe tarifat vendore *(Credit Note)*;
- Nuk ka bashkëveprim me burimet njerëzore për procedurën që ndiqet për përdorues të cilët janë punësuar rishtaz, larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturën organizative lidhur me ruajtjen e të dhënave personale për regjistrin elektronik që ata kanë marrë në administrim;
- Nuk ka një rregullore të brendshme apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë regjistër elektronik;
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga regjistri elektronik me formatet e përpunuara nga përdoruesit;

- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format Excel dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit;
- Drejtoritë/Sektorët të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk administrojnë regjistër për menaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifat që administron *(Sipas strukturës së Paketës Fiskale)*. Këto drejtori nuk rakordojnë me DTTV-në lidhur me realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 4, datë 29.01.2025, me objekt *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025"*, dhe kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Memaliaj për informacion sa i përket gjendjes debitore *(detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore)* të subjekteve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, *"Për bazat e të dhënave shtetërore"* nenin 3, Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, *"Për sigurinë kibernetike"* neni 4, Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, *"Për bazat e të dhënave shtetërore"* Kreun II *"Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave"*, Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, *"Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar"* nenet 2, 3, 5, 6, 20, 27,28, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, *"Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore"* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të marrë masa për ndërtimin dhe zbatimin e një programi të plotë të sigurisë së informacionit, duke përfshirë të gjithë elementët përbërës të tij, si: krijimi i një mjedisi të sigurisë së informacionit, vlerësimi i riskut, hartimi i politikave të sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 33,200,000 lekë dhe realizimi në vlerën 30,345,649 lekë ose në masën 91.4% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 2,854,351 lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore u konstatua se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pika 1, 2 dhe 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave"* Kreu IV, pika 200. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet

paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.
10.2. Rekomandimi: Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 0 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, në vlerën 52,383,108 lekë. Në gjendjen llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* nuk janë të përfshirë debitorët e kategorive: *"Familjarë"* në vlerën 2,584,378 lekë; *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale"* në vlerën 170,622 lekë dhe *"Tarifa e licencimit për karburant"* në vlerën 1,600,000 lekë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Me shkresën e datës 30.03.2025, Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore ka adresuar pranë Drejtorisë së Financës gjendjen mbi borxhin tatimor progresiv e cila më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 52,383,108 lekë pa përfshirë disa kategori debitorësh në vlerën totale prej 4,335,040 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* është nënvlerësuar në vlerën 4,335,040 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, Seksioni 2.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* me kundërparti llogarinë 470 *"Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë"*.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

12. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 *"Studime dhe kërkime"* më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 6,099,103 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,413,965 lekë, pakësime në vlerën 2,413,965 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 825,224 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,273,879 lekë. Nga auditimi u konstatua se, vlera e mbetur në fund të vitit 2025 prej 6,099,103 lekë (kosto historike) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* për 37 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2 dhe pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 *"Studime e kërkime"*, duke riklasifikuar në llogaritë e investimeve përkatëse sipas llojit në vlerën 6,099,103 lekë për një paraqitje të plotë e të saktë të aktiveve afatgjata materiale, si dhe aplikimin e normës së amortizimit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pa ndryshuar në vite të shprehur

përkatësisht, 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 107,996 lekë dhe 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* në vlerën 2,308,380 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuara me emërtesat çfarë përfaqësojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II, pika 5, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë 210 *"Toka, troje, terrene"* dhe 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

14. Gjetje nga auditimi: Llogaria 215 *"Mjete transporti"* më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 19,955,145 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është kontabilizuar vlera prej 3,312,750 lekë (kosto historike) që i përket automjeteve të dëmtuara të cilat nuk janë në gjendje pune, të konstatuara si të tilla në procesin e inventarizimit. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi nr. 1, pika 2.1, vlera 3,312,750 lekë e cila i përket kostos historike mjetet e dëmtuara duhej të debitoheshin në llogarinë 24 *"Aktive afatgjata të dëmtuara"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës në pasqyrat financiare të vitit 2026 të bëjë sistemimin e vlerës 3,312,750 lekë (kosto historike) e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përkasin llogarisë 215 *"Mjete transporti"*, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 *"Aktive afatgjata të dëmtuara"*.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata materiale u konstatua se, për disa llogari janë aplikuar norma amortizimi jo në përputhje me rregullat kontabël konkretisht:

- Për vitin 2025 është aplikuar normë amortizimi respektivisht në vlerën 12,000 lekë për llogarinë 210 *"Toka, troje, terrene"* dhe vlerën 739,660 lekë për llogarinë 211 *"Pyje, plantacione, kullota"*, në kushtet kur për këto llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi. Sipas informacionit kontabël llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"* është nënvlerësuar në vlerën 12,000 lekë dhe 211 *"Pyje, plantacione, kullota"* në vlerën 739,660 lekë;
- Për llogarinë 215 *"Mjete transporti"* është aplikuar normë amortizimi në vlerën 8,960,000 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël për këtë llogari duhet të aplikohej normë amortizimi në masën 20% në vlerën 11,278,982 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 215 *"Mjete transporti"* është mbivlerësuar në vlerën 2,318,982 lekë;
- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)"* për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2025, në vlerën 54,640,061 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 *"Pajisje kompjuterike"* nga aktivet e llogarisë bazë 218 *"Inventar ekonomik"* e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në pasqyrat financiare të vitit 2026, të bëjë rishikimin, aplikimin dhe korrigjimin e llogaritjes së amortizimit të aktiveve afatgjata

materiale, duke zbatuar njëkohësisht normat e amortizimit në përputhje me rregullat kontabël për llogaritë 210 *"Toka, troje, terrene"*, 211 *"Pyje, plantacione, kullota"* 215 *"Mjete transporti"* dhe 218 *"Inventar ekonomik"* me qëllim paraqitjen në mënyrë të drejtë vlerën e aktiveve dhe amortizimin e tyre.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

16. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2025 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likujdimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht: Kontrata me nr. 1559/14 prot., datë 02.09.2025, me objekt *"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara"* me vlerë kontrate 43,474,455 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 25,000,000 lekë; Kontrata me nr. 49/29 prot., datë 09.06.2024, me objekt *"Ujësjellësi Rajonal Memaliaj"* me vlerë kontrate 487,378,589 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 370,290,129 lekë. Vlera e likuiduar prej 395,290,129 lekë që i përket kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"* siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"*, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

17. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Memaliaj në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 45,278,608 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Memaliaj janë ngurtësuar fonde në vlerën 5,547,212 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Tepelenë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 5,547,212 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II *"Për kolaudimin e puinimeve të ndërtimit"*, pikat 6-7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, në total nga Bashkia Memaliaj së bashku me njësinë e varësisë Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka realizuar në total 18 procedura prokurimi me vlera të larta me fond limit në vlerën 435,481,171 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate të lidhur në vlerën 385,860,630 lekë pa TVSh. Me zgjedhje në total për vitet 2024-2025 janë audituar 11 procedura prokurimi me fond limit në vlerën

402,416,200 lekë pa TVSh dhe realizimin kontrate në vlerën 355,322,006.73 lekë pa TVSh në masën 92.4% të fondit limit të prokuruar, ku janë konstatuar parregullsitë e mëposhtme:
- Në **1** procedurë *(Asfaltimi i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe segmenti nga rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj)* me fond limit 10,589,304 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 9,545,004 lekë pa TVSh, projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, neni 5;
- Në **1** procedurë *(Blerje karburant për mjetet në invetar)* me vlerë të fondit limit prej 8,772,000 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 8,103,386 lekë pa TVSh, nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit konkretisht nuk argumentohen shërbimet që do të ofrojë institucioni duke kuadruar me disponibilitetin/kapacitetin e flotës së mjeteve dhe normativave mbi konsumin e karburantit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 78, pika 2;
- Në **1** procedurë *(Blerje mjeti transporti 3 akse për Emergjencat Civile)* me vlerë të fondit limit prej 6,666,666 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 6,200,000 lekë pa TVSh, nuk disponohet një dokument mbi argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të specifikimeve teknike. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 78, pika 2;
- Në **2** procedura *("Rikostruksioni i rrugës kufiri Toç-Koshtan" dhe "Rikonstruksioni i rrugës kufiri Ninesh-Levan")* me vlerë të fondit limit prej 32,942,766 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 27,775,000 lekë pa TVSh, nuk është publikuar në Sistemin e Prokurimit Publik dosja teknike. Mos publikimi i të gjithë dokumentacionit pjesë e dosjes teknike në SPE është shkelje e kërkesave të parashikuara në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2020, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 15, pika 3;
- Në **8** procedura *("Rikonstruksioni i rrugëve të njësive administrative"; "Rehabilitimi i skemës ujitëse nga rezervuari i Krahësit, Dega Krahës dhe Zhulaj"; "Riparim i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz"; "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambiente sportive"; "Asfaltimi i Rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj"; "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara viti 2025"; "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan" dhe "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan")* me vlerë të fondit limit prej 353,302,444 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 310,039,957 lekë pa TVSh, në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar si dhe nenet 39 *"Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"* dhe neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës;
- Në **8** procedura *("Rikonstruksioni i rrugëve të njësive administrative"; "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara viti 2024"; "Riparim i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz"; "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambiente sportive"; "Asfaltimi i Rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnje dhe Segmenti nga Rruga Nacionale-Lagja Haxhiaj"; "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara viti 2025"; "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan" dhe "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Ninesh-Levan")* me vlerë të fondit limit prej 364,506,497 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 320,721,052 lekë pa TVSh, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DT të miratuara nga AK Bashkia Memaliaj, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi në mosplotësimin e kritereve të

vendosura në DT. Duke shpallur fitues OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO-ja nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82 *"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"* pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Titullarit të AK të marrë masa që për hartimin e projekteve dhe preventivave të punimeve, të ngrihen grupe pune/punonjës ose të kontraktohen subjekte të pajisura me licenca në fushën e projektimit në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, duke bërë njëkohësisht pjesë së dosjes së procedurës së prokurimit edhe licencën profesionale të hartuesit të projektit.

18.2. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve në procedurat e prokurimit në vijim, të marrë masat e duhura për argumentimin e nevojës për furnizimin me karburant mbi bazën/rakordimin e analizës së flotës së mjeteve, kilometrave të planifikuara, normativave mbi konsumin dhe nevojës reale të institucionit, ku e gjithë praktika të përfshihet në dokumentacionin e procedurës para nisjes së prokurimit me qëllim përllogaritjen në mënyrë sa më të saktë dhe reale të fondit limit.

18.3. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Personi Përgjegjës për Prokurimin të marrë masat e duhura për publikimin e plotë dhe në kohë reale në Sistemin e Prokurimit Publik të të gjithë dokumentacionit të dosjes së tenderit duke përfshirë edhe dosjen teknike për rastet e kontratave të punëve publike.

18.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Memaliaj, Njësia e Prokurimit të marrë masa që, specifikimet teknike të hartohen dhe të shoqërohen me dokumentacionin argumentues, teknik dhe ligjor, duke provuar njëkohësisht lidhjen e tyre me objektin e kontratës dhe nevojat reale të autoritetit kontraktor.

18.5. Rekomandimi: Nga Bashkia Memaliaj, Njësia e Prokurimit të merren masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, të shmanget aplikimi i kritereve të cilat nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

18.6. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e këtyre praktikave të parregullta, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për një përdorim me efektiv të fondeve në vlerën e kontraktuar **320,721,052 lekë pa TVSh.** Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijim

19. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt *"Asfaltimi i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnjë dhe segmenti nga rruga Nacionale Haxhiaj"* me fond limit në vlerën 10,589,304 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 9,545,004 lekë pa TVSh dhe *"Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan"* me fond limit në vlerën 16,471,383 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 12,625,000 lekë u konstatua se, nga KVO nuk është aplikuar i njëjti standard në vlerësimin e operatorëve ekonomik konkretisht:

a) Për procedurën e prokurimit me objekt *"Asfaltimi i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnjë dhe segmenti nga rruga Nacionale Haxhiaj"*, nga KVO-ja janë s'kualifikuar OE *"N."* ShPK me vlerë oferte 7,434,714 lekë pa TVSh dhe OE *"S."* ShPK me vlerë oferte 9,090,480 lekë pa TVSh për arsye se nuk kanë paraqitur kontratë qiraje apo bashkëpunimi për 1 impiant prodhim inerte, 1 impiant prodhim betoni dhe 1 impiant prodhim asfalti e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve në distancë 50 km nga kantieri i punimeve të përcaktuar në DT, pra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca nr. 8, janë paraqitur vetëm

kontratat e furnizimit por përcaktohet një dokument apo deklarim mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punime. Ndërkohë që edhe për OE *"S."* ShPK me vlerë oferte 9,545,004 lekë pa TVSh i cili është kualifikuar i katërti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur Standard i Dyfishtë ku për të njëjtë situatë (pra nuk disponohet apo deklarohet dokumentacion mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punimeve për sa i përket impianteve të sipërcituar) duke kryer vetëm deklarimin sipas kontratave të furnizimit, KVO e ka shpallur fitues.
b) Për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan"* nga KVO-ja është s'kualifikuar OE *"R. C."* ShPK me vlerë oferte 12,625,000 lekë pa TVSh për arsye se, në fazën e parë paraprake (dorëzimin e ofertave) në të cilën operatorët ekonomikë mund të dokumentojnë në Sistemin e Prokurimit Publik plotësimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojcën nr. 8, në rastin konkret ky dokumentacion është plotësuar nga OE i sipërpërmendur. Mangësia e vetme në këtë Formular ka të bëjë vetëm me mos deklarimin e lejes së mjedisit nga pala e tretë (që lidhet disponibilitet e lejes së mjedisit nga OE që janë kontraktuara për kontratat e furnizimit) për kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit. KVO-ja ka kryer s'kualifikimin e OE *"R. C."* ShPK për mos dorëzimin e dokumentacionit justifikues bashkëlidhur Shtojcës për pikat nr. 2.3.3.a, nr. 2.3.3.b dhe nr. 2.3.5, konkretisht si listëpagesa, vërtetim sigurimesh, kontrata pune dhe kontrata furnizimi, dokumentacion i cili paraqitet nga OE në fazën dorëzimit të dokumentacionit fizik provues përpara shpalljes së njoftimit të fituesit paraprak. Ndërkohë që për OE *"E. C. C."* ShPK me vlerë të ofertës 15,453,000 lekë i cili është kualifikuar i dyti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur Standard i Dyfishtë ku për të njëjtën situatë është kualifikuar në fazën paraprake në kushtet e mos dorëzimit bashkëlidhur dokumentacionin justifikues Shtojcës nr. 8, për pikën nr. 2.3.3.b dhe pikën nr. 2.3.5, kontrata pune, CV, diploma etj., apo kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, neni 2, neni 77 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 82. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
19.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave në të ardhmen të marrin masat për të vlerësuar ofertat vetëm mbi bazën e kritereve dhe dokumenteve të kërkuara në DT, duke zbatuar të njëjtin standard vlerësimi për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës. Në rastet ku konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga OE nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT ose kur kriteret e aplikuara kanë interpretim mbi mënyrën e vlerësimit të tyre, nga KVO t'i kushtohet një rëndësi e veçantë gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit, me qëllim garantimin dhe trajtimin në mënyrë të barabartë të OE, transparencës dhe ligjshmërisë në procedurat e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2025, në total Bashkia Memaliaj ka realizuar 47 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit 35,060,347 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 26,825,849 lekë pa TVSh, nga të cilat me zgjedhje janë audituar 10 procedura prokurimi me vlerë të vogël të publikuara në SPE në masën 21.2% të procedurave ndaj totalit ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:
- Në **5** raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administroj dokumentacionin e çdo procedure prokurimi;
- Në **5** raste nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit pra nuk dokumentohet si është kryer testimi i tregut;
- Në **1** rast nuk është mbajtur procesverbal s'kualifikimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, *"Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"* i ndryshuar, pika 14, gërma "a" dhe "b".

- Në **1** rast marrja në dorëzim e mallrave objekt kontrate është kryer në mënyrë pjesore, me një vonesë prej 6 ditësh, duke mos respektuar edhe afate e parashikuara në Ftesën për Ofertë të publikuar në SPE më datë 22.02.2024;
- Në **5** raste pagesa për likuidimin e faturës tatimore të lëshuar nga operatorët ekonomik është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"* i ndryshuar, neni 7;
- Në **10** raste dosjet e prokurimeve me vlerë të vogël nuk janë inventarizuara dhe as arkivuara. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të *"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës dhe Sektori Juridik përgjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla të marrë masa që:
- Përpara fillimit të procedurës të argumentojë dhe të dokumentojë nevojat e institucionit për mallra dhe shërbime;
- Të argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit;
- Për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël në rastet e s'kualifikimit të operatorëve ekonomikë referuar klasifikimit përfundimtar në SPE, s'kualifikimi i tyre të dokumentohet nëpërmjet procesverbale përkatës;
- Për rastet e vonesave në dorëzimin e mallrave, të merren dhe dokumentohen masat përkatëse në përputhje me kushtet e kontratës dhe legjislacionit në fuqi;
- Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.
- Për çdo dosje të procedurave të prokurimit me vlera të vogla pas përfundimit të vitit ushtrimor të inventarizohen si dhe të kryhet arkivimi i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratave për punë publike me objekt: *"Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambienteve sportive"* me vlerë 173,942,580 lekë me TVSh dhe *"Riparimi i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz, Bashkia Memaliaj"* me vlerë 61,726,516.80 lekë pa TVSh u konstatua se, kontrata e parë përbëhet nga katër situacione pjesore ndërsa kontrata e dytë nga tre situacione pjesore, të cilat nuk janë të shoqëruara me libreza masash pjesore. Ndërkohë në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"* Kreu II, pika 8.1 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-160 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës në të ardhmen të marrë masat e duhura, duke mos pranuar dhe mos likuiduar situacionet pjesore të punimeve pa u shoqëruar me dokumentacionin teknik të plotë. Për këtë qëllim t'i kërkojë Kontraktorit paraqitjen e librezës së masave, procesverbalin dhe dokumentacione të tjera teknike që dokumenton volumet e punimeve të realizuara, ndërsa Mbikëqyrësit të Punimeve ushtrimin e verifikimit të plotë mbi matjet, saktësinë e tyre dhe certifikimin vetëm të punimeve të kryera realisht, që dokumentacioni të jetë i plotë dhe i saktë për kryerjen e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** në të cilën shqyrtimi i kërkesës për leje ndërtimi është në tejkalim të afateve të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi. Përkatësisht në lejet me objekt: *"Punishte për përpunimin e ullirit"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 8, datë 27.09.2024, me zhvillues z. M. V. Këto veprime janë

në kundërshtim me nenit 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, neni 20 dhe neni 21 i VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 160-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në Bashkinë Memaliaj, të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi në bazë të afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit/zhvillimit u konstatuan **4 praktika** në të cilat pasqyrohet situata në lidhje me mosrespektimin e të gjitha kushteve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, në lejen e zhvillimit dhe me kriteret e përcaktuara për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, të tilla si: mosparaqitjen e saktë të planvendosjes së miratuar, mospasqyrimi i të dhënave të sakta të treguesve të zhvillimit, mosrespektimi i të gjitha distancave të përcaktuara, lartësia e ndërtimit, intensiteti i ndërtimit, koefiçienti i shfrytëzimi të territori, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Përkatësisht në lejet me objekt: 1. *"Ndërtim kapanon bujqësor dhe mur rrethues"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 29.05.2024, me zhvillues Shoqëria *"Th."* ShPK; 2. *"Punishte për përpunimin e ullirit"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 8, datë 27.09.2024, me zhvillues z. M. V.; 3. *"Rikonstruksion me shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 2, datë 23.01.2025, me zhvillues znj. I. Sh.; 4. *"Magazinë me konstruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 4, datë 29.04.2025, me zhvillues z. P. F. H. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 53, datë 24.12.2024, VKM-në 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"* të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 160-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në Bashkinë Memaliaj, përpara miratimit të lejeve të ndërtimit/zhvillimit të marrë masa për verifikimin nëse dokumentacioni teknik i ngarkuar në sistemin e-leje është i plotë, në përputhshmëri dhe nuk paraqet pasaktësi. Gjithashtu, të verifikoj nëse aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, me lejen e zhvillimit dhe me kriteret e përcaktuara për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, të tilla si: planvendosja e miratuar, treguesit e zhvillimit, intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e ndërtimit, respektimi i distancave, respektimi i tipologjisë së ndërtimit dhe destinacionin sipas njësisë strukturore përkatëse, sipas përcaktimit të tyre, në aktet përkatëse, në kohë dhe hapësirë.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat dokumentacioni teknik i ngarkuar në sistemin e-leje ka pasaktësi në paraqitjen e tij dhe evidentohen mangësi të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit. Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, kartelat e pasurive që marrin pjesë në zhvillim dhe hartat treguese nuk janë të përditësuara përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Gjithashtu është konstatuar mungesa e marrëveshjes me pronarët e pronës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi. Përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: 1.*"Punishte për përpunimin e ullirit"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 8, datë 27.09.2024, me zhvillues z. M. V.; 2. *"Magazinë me konstruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 4, datë 29.04.2025, me zhvillues z. P. F. H. Këto veprime janë

kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, nenin 15, pika 1/b dhe nenin 21, pika 6 dhe Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019, *"Për kadastrën"*, neni 17, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 160-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në Bashkisë Memaliaj të marrë masa që përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, të shqyrtojë dokumentacionin teknik në lidhje me saktësinë e paraqitjes së tij, si dhe të evidentohen/plotësohen mangësitë e konstatuara gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje ndërtimi. Gjithashtu, të marrë masa që të verifikojë paraprakisht të gjithë dokumentacion e nevojshëm që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, të pasqyroj gjendjen ligjore të përditësuar, të këtë të realizuar marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta, si dhe të marrë miratimet/konfirmimet nga institucionet përkatëse për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan **4 praktika** tek të cilat nuk janë marrë të gjitha mendimet dhe nuk është dhënë konformiteti nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe nga autoritetet e tjera publike, të cilat duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Mungesa e marrjes së miratimeve nga institucionet e tjera që duhet të shprehen ndikon në vlerësimin e duhur të kërkesës për leje ndërtimit dhe mungesën e trasparencës. Përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: 1. *"Ndërtim kapanon bujqësor dhe mur rrethues"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 29.05.2024, me zhvillues Shoqëria *"Th."* ShPK; 2. *"Punishte për përpunimin e ullirit"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 8, datë 27.09.2024, me zhvillues z. M. V.; 3. *"Rikonstruksion me shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 2, datë 23.01.2025, me zhvillues znj. I. Sh., 4. *"Magazinë me konstruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 4, datë 29.04.2025, me zhvillues z. P. F. H. Këto veprime janë kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, neni 21, *"Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor"*, pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 160-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në Bashkinë Memaliaj, të marrë masa që përpara miratimit të lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit, të merren mendimet dhe konformitetet nga të gjithë autoritetet e tjera publike të cilat duhen të shprehen për zhvillimin e propozuar, me qëllim respektimin e procedurave ligjore, rritjen e transparencës dhe shmangien e vendimmarrjes në mungesë të vlerësimeve të domosdoshme ndërinstitucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i certifikatave të përdorimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e-leje në kërkesën për pajisjen me certifikatë përdorimi nuk paraqitet i plotë, evidentohen mangësi në pasqyrimin e projektit *"a.."*, në pasqyrimin e realizimit të objektit në përputhje me lejen e ndërtimit, si dhe me kryerjen e të gjitha verifikimeve të nevojshme në terren (*nëse ka pasur ndryshime/devijime në zbatimin e punimeve të ndërtimit*) duke mbajtur aktkontrollet e detyrueshme, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Përkatësisht në certifikatat e përdorimit me objekt: Bujtina *"S. O."*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 26.06.2024, me zhvillues z. E. B. Këto veprime janë kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, neni 42, neni 51, VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i ndryshuar, neni 27, neni 27/1, neni 27/2, Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin e ndërtimit"*, neni 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 160-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në Bashkinë Memaliaj të marrë masa që përpara miratimit të certifikatës së përdorimit të shqyrtojë dhe të verifikojë në sistemin e-Leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet të paraqitet për pajisjen me certikatë, vërtetësinë/saktësinë e tij, si dhe të kryej verifikimet në terren për realizimin e punimeve të zbatimit, duke dhënë konformitetin e realizimit të objektetit në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar, nëpërmjet aktkontrolleve të detyrueshme (*përfundimi i karabinasë, i fasadave dhe sistemimit të jashtëm*).

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit dhe zhvillimit të territorit, u konstatua **1 objekt** që gjatë realizimit të punimeve të zbatimit ka pësuar ndryshime gjatë realizimit, pasi janë konstatuar devijime nga leja e ndërtimit e miratuar, shtimin e sipërfaqeve të ndërtimit dhe zhvillimi e objektit përtej kufirit të pronësisë. Përkatësisht lejen e ndërtimit me objekt: Bujtina *"S. O."*, me zhvillues z. E. B. Këto veprime janë kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, nenet 51-52 dhe me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i ndryshuar, neni 5, neni 12. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 160-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandim: Nga strukturat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Memaliaj të merren masa për të zhvilluar verifikime në terren të realizimit të lejes së ndërtimit të konstatuar nga grupi i auditimit me objekt Bujtina *"S. O."* me zhvillues z. E. B. dhe të merren masa për ndjekjen e të gjithë procedurave përkatëse për ndryshimet/devijimet nga leja e ndërtimit e miratuar nga Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës e Bashkisë Memaliaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës së IMTV-së në Bashkinë Memaliaj për vitet 2024-2025, kjo strukturë nuk ka qenë e plotësuar në numër dhe në përbërjen profesionale të kërkuar. Më konkretisht, struktura e IMTV-së është miratuar me 4 pozicione, përkatësisht 1 kryeinspektor dhe 3 inspektorë, por gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka qenë e plotësuar në mënyrë të vazhdueshme me staf profesional. Gjithashtu, nga verifikimi i dosjeve të personelit u konstatua se, me përjashtim të kryeinspektorit, inspektorët e emëruar nuk zotërojnë arsimin e lartë profesional të kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi për ushtrimin e funksioneve inspektuese. Përveç sa më sipër, IMTV-ja nuk disponon logjistikën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë inspektuese, si automjet për lëvizje në terren dhe mjete për ekzekutimin e vendimeve të prishjes, duke kufizuar efektivitetin e veprimtarisë së saj. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 177-182 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës së IMTV-së në përputhje me numrin e pozicioneve të miratuara dhe kërkesat profesionale të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Të sigurohet që punonjësit e emëruar në funksionet inspektuese të zotërojnë arsimin dhe kualifikimet e nevojshme profesionale për ushtrimin e detyrave të tyre, si dhe të merren masa për pajisjen e IMTV-së me logjistikën e nevojshme për kryerjen e kontrolleve në terren dhe ekzekutimin e vendimeve administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në lidhje me planifikimin, dokumentimin dhe raportimin e veprimtarisë inspektuese të IMTV-së, për vitin 2024 nuk janë hartuar plane/urdhra pune për ushtrimin e kontrolleve në territor, ndërsa për vitin 2025 janë hartuar plane/urdhra pune, por ato nuk paraqiten të plota dhe të detajuara sa i përket organizimit të kontrolleve, përbërjes së grupeve të inspektimit, objektet dhe zonat që do të kontrollohen.

Gjithashtu, nuk dokumentohet kryerja e raportimeve periodike pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, mbi punën e kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, neni 5, pika "f", si dhe me VKM-në nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore"*, nënpika "b.ii". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 177-182 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj në bashkëpunim me strukturën e IMTV-së të marrë masa për hartimin e planeve/urdhrave të punës për ushtrimin e kontrolleve në territor, duke përcaktuar qartë objektivat e kontrollit, zonat që do të kontrollohen, afatet, përbërjen e grupeve të inspektimit dhe mënyrën e dokumentimit të veprimtarisë inspektuese. Të bëhen raportime periodike për punën e kryer pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Memaliaj nëpërmjet VKM-ve respektive janë transferuar në pronësi/përdorim 2,858 pasuri dhe 279 ngastra me sipërfaqe pyjore dhe kullosore prej 1,510.14 ha. Nga auditimi konstatohet se, në lidhje me administrimin dhe përditësimin e listave të pronave të paluajtshme, sipërfaqeve pyjore e kullosore, si dhe pasurive të tjera në administrim të Bashkisë Memaliaj, nuk është kryer një proces i plotë verifikimi dhe përditësimi i gjendjes faktike të tyre në terren. Më konkretisht, nuk është kryer evidentimi i plotë për çdo pasuri të inventarizuar apo të transferuar në favor të Bashkisë, krahasimi i të dhënave të listave të miratuara me gjendjen reale në terren, përditësimi i listave të inventarit, hartimi i dokumentacionit hartografik/kadastral, si dhe dërgimi i praktikave pranë ASHK-së për regjistrim dhe pajisje me titull pronësie. Edhe pse Bashkia Memaliaj ka ndërmarrë një nismë fillestare duke ngritur një grup pune për hartimin e planeve të rilevimit për pasuritë, nuk ka të dhëna apo akte provuese që të vërtetojnë përfundimin e procesit pasi nuk gjenden plane rilevimi të hartuara për çdo pasuri, akte verifikimi në terren, lista të përditësuara të inventarit, dokumentacion hartografik/kadastral i plotësuar, praktika të depozituara pranë ASHK-së apo dokumentacion pronësie i përfituar si rezultat i këtij procesi. Nga të gjitha asetet që disponon Bashkiam vetëm 9 prej tyre të pasqyruara në kontabilitet janë të pajisura me certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 37, pika 1, Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"* i ndryshuar, VKM-në nr. 500, datë 14.08.2001, *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore"*, pikat 9-11 dhe 22, pasi njësia vendore nuk ka finalizuar procesin e inventarizimit, verifikimit faktik, regjistrimit në ASHK dhe ndjekjes së aseteve të transferuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 182-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për administrimin e aseteve, të marrë masa për përfundimin e plotë të procesit të evidentimit, verifikimit dhe përditësimit të pronave të paluajtshme të inventarizuara apo të transferuara në favor të Bashkisë. Të kryhet verifikimi faktik në terren për çdo pasuri, të hartohen planet e rilevimit, të përditësohen listat e inventarit, të plotësohet dokumentacioni hartografik/kadastral dhe të dërgohen praktikat pranë ASHK-së, me qëllim regjistrimin dhe pajisjen e pronave me dokumentacion pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Memaliaj nuk ka të krijuar një strukturë të posaçme për menaxhimin dhe administrimin e aseteve. Ky funksion kryhet nëpërmjet specialistit të aseteve, pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës duke mos garantuar një organizim të plotë institucional për ndjekjen e vazhdueshme të procesit të

marrjes në dorëzim, inventarizimit, regjistrimit, administrimit, dhënies në përdorim/qira dhe pasqyrimit kontabël të pasurive. Gjithashtu, nuk disponohet një regjistër kontabël analitik i plotë në nivel bashkie për të gjitha asetet që zotëron apo administron Bashkia. Në mungesë të këtij regjistri, nuk sigurohet pasqyrimi i plotë, i saktë dhe i përditësuar i pasurive në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare, duke kufizuar identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe administrimin efektiv të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 37, pika 1, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pika 26. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 182-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore të marrë masa për krijimin, organizimin dhe funksionimin e një strukturë të posaçme për menaxhimin dhe administrimit të aseteve, duke përcaktuar qartë rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave/punonjësve të ngarkuar me këtë funksion. Të merren masa për hartimin dhe përditësimin e një regjistri kontabël analitik të plotë për të gjitha asetet që Bashkia zotëron, me qëllim pasqyrimin e saktë të tyre në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Bashkia Memaliaj nuk ka vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare dhe leje koncesionare të miratuara nga MIE si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi. Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Regjistrin e Lejeve Minerare të muajit Janar të vitit 2026, Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se për periudhën nga data 01.012025, deri më 31.12.2025, në territorin e Bashkisë Memaliaj ushtron aktivitet 1 subjekt, i cili nuk ka paguar detyrime për aktivitetin që kryen, pasi nuk është evidentuar nga Bashkia Memaliaj. Konkretisht: Subjekti *"G."* ShPK me Nipt K.... i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1..., datë 01..., për shfrytëzimin e vendburimit Krahës për llojin e Gëlqeror Pllakor dhe me sipërfaqen 0.24 km^2. Këtë veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"* i ndryshuar, pikën 6 të nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, *"Për fondin kullosor"*, pikat 3, 7, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, *"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor"* i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, *"Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 182-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë masa për evidentimin dhe monitorimin e subjekteve që ushtrojnë aktivtet minerar në territorin e bashkisë, duke dokumentuar subjektin, vendodhjen dhe sipërfaqen e shfrytëzuar, bazë ligjore të ushtrimit të aktivitetit si dhe detyrimet që rrjedhin për bashkinë nga përdorimi/shfrytëzimi i sipërfaqeve. Për subjektet që ushtrojnë aktivitet minerar pa kontratë qiraje me bashkinë, të merren masa përkatëse brenda kompetencave ligjore të saj, ndërsa për çështjet që janë kompetencë të MIE/AKBN apo institucioneve të tjera, t'u kërkohet zyrtarisht informacioni dhe dokumentacioni përkatës dhe të ndiqet administrativisht situata deri në marrjen e masave nga institucionet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Memaliaj administruar në KLSH me nr. 469/6 prot., datë 20.10.2025, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 927/7 prot., datë 22.10.2025, janë lënë për zbatim

23 masa të kategorisë organizative të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e pranuara 9 masa janë zbatuar plotësisht, 3 masa është zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 9 masa nuk janë zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 189-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, rikërkojmë marrjen e masave nga Bashkia Memaliaj, për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 *"Studime e kërkime"*, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,911,473 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë 210 *"Toka, troje, terrene"* dhe 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës në pasqyrat financiare të vitit 2025 të bëjë sistemimin e vlerës 3,312,750 lekë kosto historike e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përkasin llogarisë 215 *"Mjete transporti"* sistemimi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 *"Aktive afatgjata të dëmtuara"*.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për aplikimin e normës së amortizimit për llogaritë 202 *"Studime dhe kërkime"*, 215 *"Mjete transporti"* dhe 218 *"Inventar ekonomik"* që nga momenti që aktivi ka filluar jetën e dobishme duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230-231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"*, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 2021 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarive 210 *"Toka, troje, terrene"*, 211 *"Pyje, kullota plantacione"*, 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* duke përfshirë këtu edhe asetet e ish-komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për analizimin e përdorimit për interes publik të fondeve që ju ka mbaruar periudha e garancisë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të hartojë dhe të mbajë një përmbledhje të detajuar të të gjitha ndryshimeve buxhetore të miratuara gjatë vitit, të shoqëruara me VKB-të përkatëse dhe me analiza të ndikimit financiar. Kjo do të ndihmonte në forcimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe përgjegjshmërisë në menaxhimin e buxhetit publik.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të zhvillojë analiza periodike mbi realizimin e buxhetit dhe të marrë masa korrigjuese për të shmangur devijimet. Po ashtu, përdorimi i raporteve të monitorimit duhet të kalojë nga formalitet në një mjet real menaxherial për drejtimin e financave publike.

20.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të hartojë një plan konkret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të krijojë një regjistër të përditësuar elektronik të tyre, si dhe të ndërlidh procesin e prokurimit me kufijtë e buxhetit të miratuar.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të përgatisë një kalendar të detajuar për realizimin e investimeve, të forcojë bashkëpunimin ndërmjet sektorit të financës dhe prokurimeve, si dhe të kryejë analizë pas veprimit për çdo projekt të parealizuar për të përcaktuar shkaqet dhe përgjegjësitë.

22.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj të hartojë një strategji të qartë për përmirësimin e performancës fiskale, të forcojë kapacitetet administrative të sektorit të tatim-taksave, dhe të zbatojë masa konkrete për rritjen e arkëtimeve, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë për ndjekjen e debitorëve dhe formalizimin e tatimpaguesve.

23.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe përshpejtimin e rekomandimeve në proces zbatimi si më poshtë:
a. Për 4 masa organizative të zbatuar pjesërisht, 3 masa në proces zbatimi dhe 7 masa të pa zbatuar: nr. 1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 13.1, 15.1 dhe 16.1;
b. Për 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, në proces zbatimi: nr. 1.1;
c. Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash, e pa zbatuar: nr. 1.1.
d. Për 1 masë disiplinore e pa zbatuar: nr. 1.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"* neni 15 shkronja "b" dhe "c" *"Të drejtat e KLSH"*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015, *"Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë"*, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, **nga Titullari i njësisë publike,** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,398,412 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Rikonstruksioni i Gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambienteve sportive"* me nr. 1722/14 prot., datë 20.11.2024, lidhur midis AK Bashkia Memaliaj dhe Kontraktorit BOE *"S."* & *"G. C."* ShPK. Vlera e kontratës është 173,942,580 lekë me TVSh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren,

u konstatuan disa pasaktësi konkretisht: **1.** Në kapitullin e punimeve I të prishjeve të Gjimnazit dhe palestër, zëri nr. 10, nr. Anal. 2.426/9 *"Prishje suvatimi i jashtëm"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 1,713.29 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 1,713.29 m^3. Nga verifikimi i dokumentacionit fotografik në dosjen teknike, postimet e ndryshme të shkollës gjatë punimeve në faqen e Ministrisë së Arsimit konstatohet se prishja e suvatimit të jashtëm në fasadën e objektit *nuk është realizuar*. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin zëri nr. 10, nr. Anal. 2.426/9 *"Prishje suvatimi i jashtëm"*, në sasinë prej 1,713.29 m^3 dhe me çmimin 800 lekë/m^3, *rezulton vlera 1,370,632 lekë pa TVSh.* **2.** Në kapitullin e punimeve I, të prishjeve të Gjimnazit dhe palestër, zëri nr. 16, nr. Anal. 3.158/5a *"Transport dheu me auto deri 5 km"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 966.97 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit 966.97 m^3. Në llogaritjet në librezën e masave pasqyrohet llogaritja e volumit të prishjeve të suvatimeve jashtme (1,713.29 m^3 x 0.02 m = 34.27 m^3), e cila nuk është realizuar referuar edhe trajtimit më sipër mbi prishjen e suvatimeve të jashtme. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht më tepër volume në zërin zëri nr. 16, Anal. 3.158/5a *"Transport dheu me auto deri 5 km"*, në sasinë prej 34.27 m^3 dhe me çmimin 500 lekë/m^3, *rezulton vlera 17,135 lekë pa TVSh.* **3**. Në kapitullin III të punimeve të çatisë, zëri nr. 3, nr. Anal. 2.206 *"Kaseta shkarkimi llamarine xingat"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 14 copë dhe në librezën e masave pasqyrohet realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit 14 copë. Referuar kushteve teknike të zbatimit *(nëse ekziston ulluk horizontal dhe vertikal, nuk vendoset kasetë për shkak të lidhjes së tyre me njëri-tjetrin pa kasetë shkarkimi)* dhe verifikimit në objekt, u konstatua se në shkollën *"Sali Nivica"*, nuk janë vendosur kasetat e shkarkimit llamarinë xingat, vetëm janë vendosur në kapitullin IV, punime tarrace, zëri nr. 5, tek pjesa e palestrës. Pra, sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht 14 copë kaseta shkarkimi dhe me çmimin përkatës 1,500 lekë/copa, *rezulton vlera 21,000 lekë pa TVSh.* **4.** Në kapitullin V, të punimeve muraturës zëri nr. 2, nr. Anal. 2.76 *"Mur tulle me vrima t=20 cm, llaç përzier M-25"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 18.62 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë 18.62 m^3. Nga verifikimi i librezës së masave, konstatohet se nuk është zbritur volumi negativ i trarëve e arkitrarëve b/a C-16/20, në sasinë prej 1.12 m^3. Pra, sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht 1.12 m^3, në zërin *"Mur tulle me vrima t=20 cm, llaç përzier M-25"* dhe me çmimin përkatës 15,000 lekë/m^3, *rezulton vlera 16,800 lekë pa TVSh.* Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër **1,425,567 lekë pa TVSh** *(16,800 + 21,000 + 17,135 + 1,370,632)* ose 1,710,680 me TVSh**, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Memaliaj, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **1,425,567 lekë pa TVSh** nga kontraktori BOE *"S."* & *"G. C."* ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Riparimi i shkarjeve në rrugët e Njësive Administrative Luftinjë dhe Buz, Bashkia Memaliaj"* me nr. 1583/15 prot., datë 04.11.2024, lidhur midis AK Bashkia Memaliaj dhe Kontraktorit BOE *"Sh."* ShPK & *"V."* ShPK. Vlera e kontratës është 61,726,516.80 lekë me TVSh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi konkretisht: **1.** Në kapitullin e

riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 5, nr. Anal. 3.243/1 *"Brez betoni c16/20 mbi gabion, t=15 cm"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 5 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 5.16 m^3. Llogaritja në librezën e masave pasqyrohet duke llogaritur sipërfaqen e betonit 30.34 m^2 x 0.17 m = 5.16 m^3. Nga verifikimi i objektit në terren, u konstatua se lartësia e brezit të betonit ishte 10 cm ose 0.1 m dhe nga llogaritjet rezulton se volumi i betonit duhej të ishte 30.34 m^2 x 0.1 m = 3 m^3. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht më tepër volumin prej **2.16 m^3** (5.16 m^3- 3 m^3) të zëri nr. 5, nr. Anal. 3.243/1 *"Brez betoni c16/20 mbi gabion, t=15 cm"* dhe me çmimin 10,000 lekë/m^3, *rezulton vlera 21,600 lekë pa TVSh.* **2.** Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 6, nr. Anal. 3.396/1 *"Mbushje me zhavor pas gabionit"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 274 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 274 m^3. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se mbushja me zhavor *nuk ishte realizuar*. Pas gabionit u konstatua se ishte me materialin e njëjtë të gabionit ose tepricat krijuara nga ndërtimi i gabionëve. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 6, nr. Anal. 3.396/1 *"Mbushje me zhavor pas gabionit"*, në sasinë prej 274 m^3 dhe me çmimin 1,000 lekë/m^3, *rezulton vlera 274,000 lekë pa TVSh.* **3**. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 15, nr. Anal. 4.19 *"Prerje asfalti me disk në dy anët"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 100 ml dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 100 ml. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se prerja e asfaltit *nuk ishte realizuar*. Rruga ishte ekzistuese dhe nuk ekzistonte asnjë prerje asfalti apo hedhje asfalti të ri. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 15, nr. Anal. 4.19 *"Prerje asfalti me disk në dy anët"*, në sasinë prej 100 ml dhe me çmimin 100 lekë/ml, *rezulton vlera 10,000 lekë pa TVSh.* **4**. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 1,** zëri nr. 16, nr. Anal. 3.212/b *"Shtresë stabilizanti 10 cm"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 200 m^2 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 200 m^2. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se shtresa e stabilizantit *nuk ishte realizuar*. Rruga ishte ekzistuese dhe nuk ekzistonte asnjë shtresë stabilizanti apo hedhje stabilizanti gjatë rrugës. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 16, nr. Anal. 3.212/b *"Shtresë stabilizanti 10 cm"*, në sasinë prej 200 m^2 dhe me çmimin 300 lekë/m^2, *rezulton vlera 60,000 lekë pa TVSh.* **5**. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 3,** zëri nr. 10, nr. Anal. 3.185 *"Guard rail N2 anësore me 2 valëzime në 1 anë W 4 + aksesorë"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 70 ml dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 70 ml. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se guard railit ishte në gjatësinë 64 ml. Pra me një diferencë prej 6 ml (70ml - 64ml) dhe me çmimin 3,000 lekë/ml, *rezulton vlera 18,000 lekë pa TVSh.* **6**. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 3,** zëri nr. 15, nr. Anal. 3.243/1 *"Beton C16/20 për lugun e betonit ekzistues te muri"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 5 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 5.32 m^3. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se lugu i betonit ekzistues te muri *nuk ishte realizuar*. Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin nr. 15, nr. Anal. 3.243/1 *"Beton C16/20 për lugun e betonit ekzistues te muri"*, në sasinë prej 5 m^3 dhe me çmimin 10,000 lekë/m^3, *rezulton vlera 50,000 lekë pa TVSh.* **7**. Në kapitullin e riparimit të shkarjeve **nr. 4,** zëri nr. 14, nr. Anal. 3.185 *"Guard rail N2 anësore me 2 valëzime në 1 anë W 4 + aksesorë"*, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 60 ml dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 60 ml. Nga verifikimi i objektit në terren u konstatua se guard railit ishte në gjatësinë 19 ml. Pra me një diferencë prej 41 ml (60ml - 19ml) dhe me çmimin 3,000 lekë/ml, *rezulton vlera 123,000 lekë pa TVSh.* Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër **556,600 lekë pa TVSh** (*123,000 + 50,000 + 18,000*

+ 60,000 + 10,000 + 274,000 + 21,600) ose 667,920 me TVSh, **e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005, *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Memaliaj, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **556,600 lekë pa TVSh** nga kontraktori BOE *"Sh."* ShPK & *"V."* ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan **3 praktika** në të cilat pasqyrohet situata në lidhje me mos llogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt:
1. *"Ndërtim kapanon bujqësor dhe mur rrethues"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 29.05.2024, me zhvillues Shoqëria *"Th."* ShPK, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **289,933 lekë;** 2. *"Rikonstruksion me shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 2, datë 23.01.2025, me zhvillues znj. I. Sh., me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **84,443 lekë;** 3. *"Magazinë me kontruksion metalik për grumbullimin e produkteve bujqësore"*, për të cilën është marrë Vendimi nr. 4, datë 29.04.2025, me zhvillues z. P. F. H., me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **41,869 lekë.** Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* i ndryshuar, nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore"* i ndryshuar, VKB nr. 83, datë 15.12.2023, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 të Bashkisë Memaliaj"*, pika 5, nënpika 3, VKB nr. 4, datë 27.01.2025, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 të Bashkisë Memaliaj"*, pika 5, nënpika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 160-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Memaliaj të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, për arkëtimin e vlerës **416,245 lekë,** diferencë e konstatuar nga përllogaritja e pasaktë e taksës së ndikimit në infrastrukturë, që përbën dëm ndaj buxhetit të njësisë vendore. Përkatësisht: 1. Arkëtimin e vlerës **289,933 lekë** nga zhvilluesi i lejes së ndërtimit Shoqëria *"Th."* ShPK; 2. Arkëtimin e vlerës **84,443 lekë** nga zhvilluesi i lejes së ndërtimit znj. I. Sh.; 3. Arkëtimin e vlerës **41,869 lekë** nga zhvilluesi i lejes së ndërtimit z. P. F. H.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara viti 2024"*, me fond limit në vlerën 33,675,090 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 30,978,367.54 lekë pa TVSh u konstatua se: Referuar Raportit Përmbledhës së hartuar dhe nënshkruar nga KVO-ja dhe Titullari i AK-së me shkresën nr. 1637/12 prot., datë 11.10.2024, ku për këtë procedurë kanë marrë pjesë 7 OE nga të cilët janë kualifikuar 4 OE dhe s'kualifikuar 3 OE, vërehet se është s'kualifikuar BOE *"E."* ShPK & *"M."* ShPK me vlerë oferte 30,519,660 lekë pa TVSh me arsyen se, njëri prej operatorëve të BOE-së konkretisht *"M."* ShPK ka paraqitur disa punë të ngjashme për të cilat

nuk i ka regjistruar si Nipte Sekondare, duke ju shmangur detyrimeve vendore. Vlerësimi i KVO-së nuk është bërë i drejtë, pasi duke marrë në konsideratë faktin se kontratat e punëve publike i përkasin viteve 2019-2021, pra kusht vlen si arsye për s'kualifikim në qoftë se në kërkesën e DT do të kërkohej vërtetimi i taksave për vitet 2019-2021, ndërkohë që kërkesa i përket vitit 2023. OE *"M."* ShPK për vitin 2023 ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë me shkresën e datës 29.05.2024. Pra, rrjedhimisht nëse KVO-ja do të kualifikonte këtë BOE, në përputhje me qëllimin dhe parimet e LPP-së, Bashkia Memaliaj do të lidhte një kontratë me vlerë më pak nga kontrata që ka lidhur, me një diferencë prej **458,707.54 lekë** pa TVSh (30,978,367.54 - 30,519,660) dhe me një vlerë 550,449 lekë me TVSh e cila **përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Bashkisë Memaliaj.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, neni 2, neni 21, pika 2, neni 92, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike me efiçencë dhe ekonomicitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, debitorët progresiv nga taksat dhe tarifat vendore në fillim të vitit 2025, janë në vlerën 46,405,279 lekë. Gjatë vitit është përllogaritur ngarkesë fiskale në vlerën 12,385,141 lekë nga e cila janë arkëtuar detyrimet në vlerën 8,146,997 lekë, pra në fund të vitit debitorët progresivë janë në vlerën 50,643,432 lekë, ndërsa vetëm përgjatë vitit 2025 janë krijuar debitorë në vlerën **4,274,019 lekë** *(biznesi i vogël 658,309 lekë, institucionet 384,747 lekë, abonentët familjarë 654,042 lekë, taksë ndërtesë + truall 94,473 lekë, taksa e tokës bujqësore 2,160,239 lekë; shërbim taksi 18,750 lekë; taksë e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet 103,459 lekë dhe tarifa e liçencimit për karburantet 200,000 lekë)* **e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, *"Për financat e qeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 35. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa, për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve, për taksat dhe tarifat vendore për periudhën deri më datë 31.12.2025, në vlerën totale 50,643,432 lekë, e cila përbëhet nga:

- 19,352,193 lekë të trashëguara nga ish-komunat;
- 621,180 lekë biznesi i madh;
- 3,553,577 lekë biznesi i vogël;
- 474,500 lekë institucione;
- 2,584,378 lekë familjarët;
- 3,872,270 lekë taksa e ndërtesës + truallit;
- 18,386,263 lekë taksa e tokës bujqësore;
- 28,400 lekë shërbimi taksi;
- 170,662 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e objekteve informale;
- 1,600,000 lekë tarifa e licencimit për karburantet;

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, deri më datë 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Memaliaj kanë ushtruar aktivitet me status aktiv 127 subjekte të kategorisë biznes i madh dhe i vogël. Përgjatë vitit 2025 janë kryer 9 regjistrime të reja si biznes i vogël si dhe kanë mbyllur aktivitetin 4 subjekte biznes i madh, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja paraqitet me 132 subjekte aktivë nga të cilët 10 biznes i madh dhe 122 biznes i vogël. Nga të dhënat e DTTV-ja dhe në bazë të korrespodencës/procesverbaleve të inspektimit në terren të hartuara nga kjo drejtori u konstatua se, ekzistojnë subjekte të pa licencuara (QKB), të cilat janë evidentuar nga verifikimet në terren. Për vitin 2025 në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Memaliaj operojnë dhe ushtrojnë aktivitet 13 subjekte të biznesit të pa regjistruar në QKB *(të llojit si: shërbime, shitje me pakicë, këpucar, rrobaqepës, parukeri, bar kafe)*, për të cilët nuk janë ndjekur procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencimin dhe pagesën e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore, e për pasojë nuk kanë qenë objekt i taksave dhe tarifave vendore, duke sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritje vetëm për tarifën e pastrimit vlerën 9,100 lekë, ndriçimit vlerën 4,000 lekë, gjelbërimit vlerën 2,200 lekë, ndërtesë vlerën 900 lekë dhe truall vlerën 240 lekë (duke aplikuar tarifat më të ulta në vlerë), për subjektet e pataksuara, do të kishim 16,440 lekë * 13 subjekte mesatarisht **213,720 lekë duke krijuar të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Memaliaj.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 16. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë të pa pajisur me licencë për ushtrim aktiviteti në vlerën **213,720 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga DTTV-ja, në Bashkinë Memaliaj dhe Njësitë Administrative për vitin 2025 janë taksuar 3,195 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë *"familjar"*. Me qëllim vlerësimin nëse nga DTTV është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë *"familjar"*, u kryqëzua informacioni i administruar nga kjo drejtori me informacionin e administruar nga Gjendja Civile. Sipas Gjendjes Civile në Bashkinë Memaliaj dhe Njësitë Administrative janë 6,946 familje, ndërkohë që për vitin 2025 janë taksuar 3,195 familje si dhe janë të përjashtuar 816 familje si pasojë e përfitimit të lehtësirave nga Paketa Fiskale. Ndërkohë që për taksën e *"Ndërtesës + Truallit"* nuk është kryer faturimi i plotë ku janë shmangur nga tarifimi 2,147 abonentë familjarë në vlerën totale prej **854,560 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.** Këto veprime janë në kundërshtim me Paketën Fiskale për vitin 2025 të miratuar me VKB-në nr. 4, datë 27.01.2025, me objekt *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të koordinuar procesin për evidentimin e familjeve, për të cilat nuk janë përllogaritur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, duke rakorduar njëkohësisht informacionin mbi familjet e regjistruara sipas regjistrit të gjendjes civile me situatën faktike në terren, me qëllim arkëtimin e të ardhurave në vlerën 854,560 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme për vitet 2024-2025 u konstatua se:

a. Bashkia Memaliaj administron 254 kontrata qiraje për tokën bujqësore konkretisht: 9 kontrata në NjA Fshat Memaliaj, 24 kontrata NjA Buz, 56 kontrata në NjA Luftinjë, 99 kontrata

në NjA Qesarat dhe 66 kontrata në NjA Krahës të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2025 dhe me afat kryesit 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas përcaktimit të VKM-së nr. 373, datë 20.06.2018, *"Për tokën bujqësore"*, 6,000 lekë/Ha në vit. Më datë 31.12.2024, gjendja debitore paraqitet në vlerën 5,090,085 lekë. Gjatë vitit 2025 është faturuar vlera prej 2,170,622 lekë nga të cilat është likuiduar vlera prej 1,456,302 lekë me një diferencë mos arkëtimi në vlerën 714,320 lekë, ndërsa gjendja debitore më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën **5,651,345 lekë** në total për 159 individë debitorë.

b. Bashkia Memaliaj administron 19 kontrata aktive për dhënien me qira të objekteve brenda territorit të qytetit dhe në fshatrat Qesarat, Buz, Anë Vjosë dhe Toç. Për vitin 2025 për këto kontrata është përllogaritur detyrimi në vlerën 344,648 lekë ku është likuiduar vlera 146,100 lekë si dhe janë krijuar 2 debitorë në vlerën **198,548 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 182-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e aseteve në total në vlerën **5,849,893 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

D.1.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja "c", Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, gërma "a" dhe VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil"*, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

- **"Vërejtje",** për punonjësin e mëposhtëm:

1. znj. E. E. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet:

- Për diferencën e vlerës së ofertës ndërmjet BOE *"E."* ShPK & *"M."* ShPK të s'kualifikuar padrejtësisht dhe OE *"A. I. C."* ShPK të shpallur fitues në vlerën 458,707.54 lekë, për procedurën e prokurimit me objekt *"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara"* të zhvilluar nga Bashkia Memaliaj në vitin 2024, e cila ka ardhur si rezultat i vlerësimit të gabuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, neni 2, neni 21, pika 2, neni 93, pika 3;

2. z. T. A. me detyrë Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore në cilësinë e Kryetarit të Vlerësimit të Ofertave;

3. z. B. C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave *(vërejtja për këtë punojës përfshin edhe problematikën e konstatuar në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan").*

4. z. M. S. me detyrë Specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në cilësinë e Anëtarit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet:

- Për procedurën e prokurimit me objekt *"Asfaltimi i rrugëve Lagja Hasanbegaj-Fshati Leshnjë dhe segmenti nga rruga Nacionale Haxhiaj"*, nga KVO-ja janë s'kualifikuar OE *"N."* ShPK me vlerë oferte 7,434,714 lekë pa TVSh dhe OE *"S."* ShPK me vlerë oferte 9,090,480 lekë pa TVSh për arsye se nuk kanë paraqitur kontratë qiraje apo bashkëpunimi për 1 impiant prodhim inerte, 1 impiant prodhim betoni dhe 1 impiant prodhim asfalti e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve në distancë 50 km nga kantieri i punimeve të përcaktuar në DT, pra në

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca nr. 8, janë paraqitur vetëm kontratat e furnizimit por përcaktohet një dokument apo deklarim mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punime. Ndërkohë që edhe për OE *"S."* ShPK me vlerë oferte 9,545,004 lekë pa TVSh i cili është kualifikuar i katërti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur Standard i Dyfishtë ku për të njëjtë situatë (pra nuk disponohet apo deklarohet dokumentacion mbi distancën prej 50 km nga kantieri i punimeve për sa i përket impianteve të sipërcituar) duke kryer vetëm deklarimin sipas kontratave të furnizimit, KVO e ka shpallur fitues.

5. znj. L. M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet:

- Për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan"* nga KVO-ja është s'kualifikuar OE *"R. C."* ShPK me vlerë oferte 12,625,000 lekë pa TVSh për arsye se, në fazën e parë paraprake (dorëzimin e ofertave) në të cilën operatorët ekonomikë mund të dokumentojnë në Sistemin e Prokurimit Publik plotësimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojcën nr. 8, në rastin konkret ky dokumentacion është plotësuar nga OE i sipërpërmendur. Mangësia e vetme në këtë Formular ka të bëjë vetëm me mos deklarimin e lejes së mjedisit nga pala e tretë (që lidhet disponibilitet e lejes së mjedisit nga OE që janë kontraktuara për kontratat e furnizimit) për kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit. KVO-ja ka kryer s'kualifikimin e OE *"R. C."* ShPK për mos dorëzimin e dokumentacionit justifikues bashkëlidhur Shtojcës për pikat nr. 2.3.3.a, nr. 2.3.3.b dhe nr. 2.3.5, konkretisht si listëpagesa, vërtetim sigurimesh, kontrata pune dhe kontrata furnizimi, dokumentacion i cili paraqitet nga OE në fazën dorëzimit të dokumentacionit fizik provues përpara shpalljes së njoftimit të fituesit paraprak. Ndërkohë që për OE *"E. C. C."* ShPK me vlerë të ofertës 15,453,000 lekë i cili është kualifikuar i dyti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur Standard i Dyfishtë ku për të njëjtën situatë është kualifikuar në fazën paraprake në kushtet e mos dorëzimit bashkëlidhur dokumentacionin justifikues Shtojcës nr. 8, për pikën nr. 2.3.3.b dhe pikën nr. 2.3.5, kontrata pune, CV, diploma etj., apo kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit.

D.1.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me kodin e punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja "c" dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996, *"Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 37 *"Masa disiplinore"* dhe Kontratës Individuale të punës neni 13, gërma "a", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

- "Vërejtje me shkrim", për punonjësin e mëposhtëm:

1. znj. L. H. me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Shërbimit Social në cilësinë e Kryetarit të Komsionit të Vlerësimit të Ofertave;

2. z. J. T. me detyrë Specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet:

- Për diferencën e vlerës së ofertës ndërmjet BOE *"E."* ShPK & *"M."* ShPK të s'kualifikuar padrejtësisht dhe OE *"A. I. C."* ShPK të shpallur fitues në vlerën 458,707.54 lekë, për procedurën e prokurimit me objekt *"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara"* të zhvilluar nga Bashkia Memaliaj në vitin 2024, e cila ka ardhur si rezultat i vlerësimit të gabuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, neni 2, neni 21, pika 2, neni 93, pika 3;

3. z. B. Xh. me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Pyjeve dhe Kullota, për shkeljet:

Për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i rrugës Kufiri Toç-Koshtan"* nga KVO-ja është s'kualifikuar OE *"R. C."* ShPK me vlerë oferte 12,625,000 lekë pa TVSh për

arsye se, në fazën e parë paraprake (dorëzimin e ofertave) në të cilën operatorët ekonomikë mund të dokumentojnë në Sistemin e Prokurimit Publik plotësimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojcën nr. 8, në rastin konkret ky dokumentacion është plotësuar nga OE i sipërpërmendur. Mangësia e vetme në këtë Formular ka të bëjë vetëm me mos deklarimin e lejes së mjedisit nga pala e tretë (që lidhet disponibilitet e lejes së mjedisit nga OE që janë kontraktuara për kontratat e furnizimit) për kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit. KVO-ja ka kryer s'kualifikimin e OE *"R. C."* ShPK për mos dorëzimin e dokumentacionit justifikues bashkëlidhur Shtojcës për pikat nr. 2.3.3.a, nr. 2.3.3.b dhe nr. 2.3.5, konkretisht si listëpagesa, vërtetim sigurimesh, kontrata pune dhe kontrata furnizimi, dokumentacion i cili paraqitet nga OE në fazën dorëzimit të dokumentacionit fizik provues përpara shpalljes së njoftimit të fituesit paraprak. Ndërkohë që për OE *"E. C. C."* ShPK me vlerë të ofertës 15,453,000 lekë i cili është kualifikuar i dyti në klasifikimin përfundimtar, është përdorur Standard i Dyfishtë ku për të njëjtën situatë është kualifikuar në fazën paraprake në kushtet e mos dorëzimit bashkëlidhur dokumentacionin justifikues Shtojcës nr. 8, për pikën nr. 2.3.3.b dhe pikën nr. 2.3.5, kontrata pune, CV, diploma etj., apo kontratat e furnizimit të inerteve dhe asfaltit.

Shënim: Për punonjësit e tjerë të cilët kanë rezultuar me mangësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre institucionale, nuk rekomandojmë masa disiplinore, për shkak të nivelit të ulët të materialitetit sasior dhe cilësor.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Memaliaj, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT